



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

STRATEGJIA KOMBËTARE
E
ZHVILLIMIT EKONOMIK
DHE SOCIAL

Tiranë, Nëntor 2001

STRATEGJIA KOMBËTARE E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE SOCIAL

**Programi Afatmesëm i Qeverisë Shqiptare “Për Rritjen
Ekonomike Dhe Reduktimin E Varfërisë”.**

(SRERV 2002-2004)

Nëntor 2001

Programi Afatmesëm Për Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë (SRERV 2002-2004) është hapi i parë i ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare, për të mbështetur perspektivën e zhvillimit të vendit në vizione strategjike afatgjata. Programi u përgatit nën drejtimin e Kryeministrit të vendit, përmes një procesi intensiv bashkëpunimi mes strukturave qeveritare dhe shoqërisë civile shqiptare, si dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

Shprehje e mirënjohjes

Qeveria Shqiptare vlerëson dhe falenderon të gjithë kontribuesit që u angazhuan në procesin e përgatitjes së Strategjisë. Në veçanti, ajo falenderon:

- i) Të gjitha strukturat dhe ekspertet e institucioneve shtetërore që u angazhuan në procesin e përgatitjes së Strategjisë, të drejtuar nga Koordinatori Kombëtar i Strategjisë, Ministri i Financave Prof. Dr. Z. Anastas Angjeli.
- ii) BB, FMN, DFID, UNICEF, PNUD, Qeverinë Hollandeze, Qeverinë Gjermane, Qeverinë Italiane dhe Fondacionin SOROS për mbështetjen teknike dhe financiare që ato dhanë në të gjitha fazat e përgatitjes së strategjisë, duke respektuar njëkohësisht pronësinë shqiptare të këtij dokumenti, si dhe të gjithë donatorët e tjerë (BE, KE, OSBE, dhe USAID) dhe qeveritë e vendeve të ndryshme që u angazhuan në procesin e dhënies së mendimeve për përmirësimin e projekt-strategjisë, së bashku me stafin e tyre dhe ekspertet e huaj të angazhuar nga keto organizma.
- iii) Organizatat e shoqërisë civile, organizatat e biznesit dhe njësitë e qeverisjes vendore si dhe përfaqësuesit dhe ekspertët e angazhuar prej tyre në etapat e ndryshme të përgatitjes së strategjisë.
- iv) Qendrën Kartër për kontributin në organizimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në të gjitha etapat dhe nivelet e përgatitjes së strategjisë.
- v) Institutin e Studimeve Bashkëkohore (ISB) dhe Institutin e Edukimit Fiskal (IEF), për kontributin e tyre në përgatitjen e projekteve të strategjisë, të organizimit të konsultimeve me komunitetin e biznesit dhe qeverisjen vendore si dhe të organizimit të konferencës finalizuese.

Qeveria i shpreh falenderim të veçantë grupit të ekspertëve shqiptarë, të drejtuar nga ISB & IEF, dhe të përbërë prej: Prof. Dr. Genc Ruli, Bsc. Anesti Kashta, Prof. Dr. Ahmet Mançellari, Msc. Artan Hoxha, Dr. Selami Xhepa, Dr. Arlinda Ymeraj, Dr. Tonin Kola, Dr. Stavri Llambiri, Dr. Ardian Civici, Msc. Shkëlzen Marku, Msc. Lindita Çaçi, Msc. Neritan Mullai, për kontributin e vyer shkencor dhe profesional në përgatitjen e këtij dokumenti.

KRYEMINISTRI

ILIR META

Lista e shkurtimeve

SHKURTIMI	EMRI I PLOTE
2KR	Projekti i Rritjes së Prodhimit Ushqimor
AAATA	Asistencë për Shoqatat Shqiptare të Agrobiznesit dhe Tregtisë
AIDS	SIDA
AMC	Albanian Mobile Communication
ANEP	Projekti Kombëtar i Këshillimit Bujqësor (Agricultural National Extension Project)
APNSHS	Administrata e Përgjithshme e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale
ASHRT	Autoriteti Rajonal Shendetësor i Tiranës
ASP	Projekti i Shërbimeve Bujqësore (Agricultural Services Project)
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Europian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (Department for International Development)
DoPA	Departamenti i Administratës Publike
DPPK	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave
ESAF 1	Enhanced Structural Adjustment Facility 1
ESAF 2	Enhanced Structural Adjustment Facility 2
FFR	Fondi i Financimit Rural
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FYROM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (The Former Yugoslav Republic of Macedonia)
FZSHS	Fondi i Zhvillimit Shqiptar
GKKShC	Grupi Kombëtar Këshillimor i Shoqërisë Civile
GTZ	Agjensia Germane e Kooperimit Teknik (German Technical Cooperation)
IDA	International Development Agency (Agjensia e Zhvillimit Ndërkombëtar)
IFAD	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (International Fund for Agricultural Development)
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare (International Finance Corporation)
IFDC	Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Plehrave Kimike (International Fertilizers Development Center)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKV	Instituti i Kërkimeve Veterinare

INSIG	Instituti i Sigurimeve
INSTAT	Instituti i Statistikave
I-PRSP	Dokumenti i Ndërmjetëm i Strategjisë për Pakësimin e Varfërisë në Shqipëri (Interim Poverty Reduction Strategy Paper)
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISKSH	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
IT	Informacion Teknologjik (Information Technology)
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
IU	Instituti i Urbanistikës
KASH	Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
KKKP	Komisioni Kombëtar i Kthimit të Pronave
KM	Këshilli i Ministrave
KSHC	Komiteti i Shërbimit Civil
LCS	Studimi i Kushteve të Jetesës (Living Conditions Survey)
LSMS	Studimi mbi Nivelin e Jetesës (Living Standard Measurement Survey)
MADA	Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore (Mountain Area Development Agency)
MAFF	Fondi i Financimit të Zonave Malore (Mountain Area Financing Fund)
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBET	Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë
MBU	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
MEPP	Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit
MF	Ministria e Financave
MICS	Anketim Grupi Shumëfish Indikatorësh (Multiple Indicators Cluster Survey)
ML	Ministritë e Linjës
MM	Ministria e Mjedisit
MPÇS	Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
MPVD	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
MTEF	Programi i Shenzimeve Afatmesme (Medium-Term Expenditure Framework)
NFRE	Ekonomia Rurale Jo-bujqësore (Non-farm Rural Economy)
NM	Njësia e Monitorimit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregëtisë

OJQ	Organizata Jo–Qeveritare
PBB	Produkti I Brendshëm Bruto
PRE	Programi i Reformës Ekonomike
QKMZHRF	Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve
QSH	Qëndër Shëndetësore
QSUT	Qendra Spitalore Universitare e Tiranës
RTGS	Real Time Gross Settlement
SAA	Marrëveshja e Asocim Stabilizimit (Stabilization Association Agreement)
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SIDA	Agjensia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar (Swedish International Development Agency)
SME	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (Small and Medium Enterprise)
SRERV	Strategjia e Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit të Varfërisë
SRPP	Sistemi i Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme
SST	Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme
ST	Sekretariati Teknik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UBT	Universiteti Bujqesor i Tiranës
UNDP	United Nations Development Program
UNICEF	United Nations Children’s Fund
USD	United States Dollar (1 USD = 145 Lekë)

Përmbajtja

I	HYRJE	8
I.A	NEVOJA PËR STRATEGJINË PËR RITJEN EKONOMIKE DHE REDUKTIMIN E VARFËRISË (SRERV) DHE LIDHJA E SAJ ME PRSP	9
I.B	PARIMET KU MBËSHTETET HARTIMI DHE ZBATIMI I STRATEGJISË.....	11
I.C	FAKTORË FAVORIZUES E PENGUES TË JETËSIMIT TË STRATEGJISË.....	15
II	PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË PJESËMARRJES	16
II.A	AKTORËT PJESËMARRËS DHE ROLI I TYRE NË HARTIMIN E SRERV.....	17
II.B	PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE	19
II.C	PJESËMARRJA E PARLAMENTIT, PUSHTETIT VENDOR DHE KOMUNITETIT TË BIZNESIT	21
III	ANALIZA E VARFËRISË DHE VLERËSIMI I POLITIKAVE	26
III.A	ANALIZË E PËRGJITHSHME E VARFËRISË.....	27
III.B	VLERËSIMI I POLITIKAVE TË KALUARA	38
IV	MASAT PUBLIKE PRIORITARE	53
IV.A	HYRJE	54
IV.B	KUADRI MAKROEKONOMIK	55
IV.C	QEVERISJA DHE MENAXHIMI I SEKTORIT PUBLIK	60
IV.D	ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT DHE ATIJ FINANCIAR.....	68
IV.E	ZHVILLIMI NJERËZOR	74
IV.F	INFRASTRUKTURA DHE MBËSHTETJA E RITJES EKONOMIKE	82
IV.G	ZHVILLIMI I INTEGRUAR RURAL	87
IV.H	ZHVILLIMI URBAN	93
IV.I	MJEDISI, RITJA DHE REDUKTIMI I VARFËRISË.....	97
V	ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË	99
V.A	ROLI I SISTEMIT TE MONITORIMIT	100
V.B	KAPACITETET INSTITUCIONALE PËR MONITORIM DHE VLERËSIM	101
V.C	ZGJEDHJA E TREGUESVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT.	104
V.D	BURIMET DHE INSTRUMENTAT E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT.....	106
V.E	SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT	108
VI	ANEKSI 1: MATRICAT E PLANEVE TË VEPRIMIT	109
VII	ANEKSI 2: TABELAT E VARFËRISË	139
VIII	ANEKSI 3: KUADRI MAKROEKONOMIK 2000 – 2004	145
IX	ANEKSI 4: PROÇESI I PJESËMARRJES	147
IX.A	PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË PJESËMARRJES	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
IX.B	PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE – ROLI I QENDRËS CARTER.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
IX.C	KONSULTIMET ME PARLAMENTIN, PUSHTETIN VENDOR DHE KOMUNITETIN E BIZNESIT – ROLI I KONSULENTËVE TË QEVERISË	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

I HYRJE

I.A NEVOJA PËR STRATEGJINË PËR RITJEN EKONOMIKE DHE REDUKTIMIN E VARFËRISË (SRERV) DHE LIDHJA E SAJ ME PRSP

1. Gjatë dy-tre viteve të fundit Shqipëria ka shënuar një progres të dukshëm në drejtim të forcimit të rendit, sigurisë dhe reformimit institucional. Përkrah sigurimit të një qëndrueshmërie makroekonomike, janë ruajtur ritme relativisht të larta rritjeje ekonomike. Janë thelluar më tej reformat strukturore; veçanërisht të sukseshme konsiderohen hapat e hedhura në drejtim të privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha, institucioneve financiare e shërbimeve publike. Përmirësime të konsiderueshme po vërehen në infrastrukturë, sidomos në transport dhe telekomunikacion. Duke qenë anëtare e OBT që në shtator të vitit 2000, Shqipëria po ecën me ritme relativisht të larta në rrugën e thellimit të liberalizimit të tregtisë dhe hapjes së mëtejshme ekonomike. Integrimi rajonal dhe evropian janë shndërruar në perspektiva reale dhe jo të largëta. Në hapat e realizuara, Shqipëria ka pasur mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.
2. Megjithë arritjet e shënuara, Shqipëria vazhdon të ketë një ekonomi relativisht të dobët, të karakterizuar nga balancime makroekonomike të brendshme e të jashtme të brishta. Të ardhurat për frymë vazhdojnë të jenë nga më të ulëtat në Evropë. Niveli i varfërisë është relativisht i lartë, ndërsa papabarazia ekonomike ka ardhur duke u thelluar. Më të goditura nga varfëria janë zonat rurale e veçanërisht ato të thella të vendit. Për shtresa të caktuara në këto zona, të ardhurat për frymë janë shumë të ulëta. Janë përkeqësuar një sërë treguesish të arsimit, si shkalla e regjistrimit në arsimin bazë e veçanërisht në arsimin e mesëm dhe kohëzgjatja mesatare e arsimimit. Megjithë ndonjë prirje të lehtë përmirësimi, treguesit e vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë foshnjore e amëtare mbeten tepër të lartë. Vërehet një keqësim i shërbimit shëndetësor veçanërisht në zonat rurale dhe të thella të vendit. Është rritur shkalla e ekspozimit ndaj riskut për shtresa të caktuara të popullsisë. Përveç prapambetjes së trashëguar nga e kaluara, në një masë të caktuar varfëria e sotme në Shqipëri lidhet me zhvillimet e tranzicionit, duke pasqyruar problemet dhe vështirësitë që ka përballuar tranzicioni shqiptar.
3. Trajtimi dhe zgjidhja e problemeve të varfërisë dhe përgjithësisht të zhvillimit, kërkojnë vëmendje dhe adresim të veçantë. Strategjia e Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit të Varfërisë është shprehje si e mprehtësisë së problemeve të zhvillimit e veçanërisht të varfërisë me të cilat ballafaqohet vendi, ashtu edhe e vëmendjes së veçantë të qeverisë dhe të aktorëve të tjerë të interesuar për zgjidhjen e këtyre problemeve. Një mbështetje për hartimin e SRERV ka qenë "Dokumenti i Ndërmjetëm i Strategjisë për Pakësimin e Varfërisë në Shqipëri" (PRPS), i hartuar në maj të vitit 2000, që pasoi marrëveshjet ESAF 1 dhe ESAF 2 me Bankën Botërore dhe FMN. Megjithatë, SRERV është një dokument shumë më i plotë se PRPS. Përshkrimi dhe analiza e varfërisë është më e gjerë, e mbështetur në të dhëna më të plota, rezultat i studimeve më të reja dhe të specializuara. Identifikimi i objektivave dhe masave publike prioritare është paraprirë, ndryshe nga PRPS, nga një vlerësim komprehensiv i politikave të deritanishme. Priorizimi i objektivave është lidhur më mirë me synimet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit. Objektivat prioritare, të përcaktuara më qartë dhe më mirë nga pikëpamja cilësore dhe sasiore, janë mbështetur në mënyrë

shumë më të plotë në masa publike, të argumentuara nga pikëpamja institucionale dhe financiare dhe të verifikueshme nga një proces monitorues i përcaktuar në mënyrë më të plotë.

I.B PARIMET KU MBËSHTETET HARTIMI DHE ZBATIMI I STRATEGJISË

4. Parimet në të cilat mbështetet hartimi dhe zbatimi i Strategjisë janë (i) Mbjajtja parasysh e synimeve afatgjata të zhvillimit të vendit, (ii) priorizimi i aksioneve politike, (iii) dinamizimi, (iv) “pronësia” shqiptare e strategjisë dhe kooperimi me partnerët e zhvillimit të vendit.

I.B.1 MBAJTJA PARASYSH E OBJEKTIVAVE AFATGJATA

5. Objektivat e Strategjisë Për Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë, që është një strategji 3-vjeçare, janë të harmonizuara me objektivat afatgjata (i) të tranzicionit drejt një ekonomie tregu, (ii) objektivat e zhvillimit dhe (iii) objektivat e integritimit evropian të Shqipërisë.
6. Zhvillimet e ekonomisë shqiptare gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar janë dominuar nga reformat e tranzicionit. Ndërsa para fillimit të tranzicionit as që mund të flitej për pronë private, në fund të vitit 2000 më shumë se 75 për qind e PBB prodhohej nga sektori privat. Pothuajse është kompletuar liberalizimi i çmimeve. Lëvizja e kapitalit është liberalizuar në një masë të madhe. Përparime të rëndësishme janë realizuar në drejtim të liberalizimit të tregtisë. Shqipëria nuk ka asnjë kufizim sasior mbi importet dhe pothuajse asnjë kufizim mbi eksportet. Normat tarifore kanë ardhur duke u ulur. Megjithatë, tranzicioni ekonomik shqiptar ende nuk ka përfunduar. Objektivat themelore të thellimit të procesit të tranzicionit janë:
- i) Përfundimi i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve industriale, shërbimeve publike dhe institucioneve financiare që ende zotërohen nga shteti;
 - ii) Konsolidimi i reformave në sistemin bankar dhe krijimi i tregut të kapitalit;
 - iii) Thellimi i institucionalizimit të tregut, përfshirë konsolidimin e të drejtave të pronësisë, nxitjen e konkurrencës, mbrojtjen e konsumatorit;
 - iv) Thellimi i reformimit dhe modernizimit të institucioneve shtetërore, sipas normave të një shoqërie demokratike dhe një ekonomie të orientuar nga tregu.
7. Procesi i tranzicionit po hyn në një fazë të re. Arritjet e deritanishme në reformat e tranzicionit krijojnë mundësi për ndërmarrjen e politikave afatgjata të një zhvillimi të qëndrueshëm. Objektiva kryesore të politikave afatgjata të zhvillimit janë:
- i) Dy-tre fishimi i PBB real brenda një periudhe 10-15 vjeçare;
 - ii) Modernizimi teknologjik i prodhimit, duke nxitur veçanërisht teknologjitë informative (IT);
 - iii) Rritja e peshës së shërbimeve dhe industrisë në PBB, krahas përpjekjeve për rritjen e produktivitetit në bujqësi;
 - iv) Përmirësimi cilësor i infrastrukturës dhe veçanërisht i shërbimeve jetësore ndaj popullsisë;
 - v) Përmirësimi cilësor i shërbimeve të arsimit dhe shëndetësisë dhe rritja e aksesit të shtresave më pak të favorizuara ndaj këtyre shërbimeve;
 - vi) Përmirësimi dhe ruajtja e mjedisit;
 - vii) Ngushtimi i zbalancimeve rajonale.

8. Synim themelor i politikave afatgjata të qeverisë shqiptare, i mbështetur në një konsensus mbarëpopullor, është integrimi evropian i Shqipërisë. Rruga për integrimin evropian kalon përmes thellimit të kooperimit e integritit rajonal. Fillimi së shpejti i negociimeve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit me BE do të përbëjë një hap të rëndësishëm në rrugën e integritit. Detyrimet që do të rrjedhin nga kjo marrëveshje për qeverinë shqiptare dhe përgjithësisht angazhimet për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE, do të jenë njëkohësisht objektiva themelore politike të qeverisë shqiptare. Në veçanti, plotësimi i kriterëve të asociimit e më pas anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në BE do të kërkonte:
- i) Zhvillime cilësore në drejtim të thellimit të demokratizimit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut;
 - ii) Përafrim të legjislacionit të vendit me atë të BE dhe forcim të shtetit ligjor;
 - iii) Rritje cilësore të kapaciteteve projektuese, monitoruese e zbatuese të administratës shtetërore;
 - iv) Qëndrueshmëri makroekonomike, ndryshime strukturore, rritje të kapaciteteve prodhuese dhe modernizim të ekonomisë shqiptare. Në veçanti, kërkohet ruajtja dhe thellimi i qëndrueshmërisë së çmimeve, ulja e deficitit buxhetor në 1/3 e nivelit të tanishëm, ulja graduale dhe përafrimi i normave afatgjata të interesit me ato të BE; përmirësimi rrënjësor i pozicionit të bilancit të llogarive korrente; qëndrueshmëri e kursit të këmbimit valutor.
 - v) Funksionimin normal të ekonomisë së tregut, krijimin e një klime të përshtatshme e nxitëse për investime e përgjithësisht për biznes dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë.

I.B.2 PRIORIZIMI I AKSIONEVE PUBLIKE

9. SRERV, duke qenë një strategji afatmesme zhvillimi, është e fokusuar në reduktimin e varfërisë nëpërmjet një rritjeje ekonomike të qëndrueshme e përfshirëse. Nevoja për t'iu adresuar problemeve më të mprehta dhe njëkohësisht kufizimet kohore e financiare, kushtëzojnë priorizimin e objektivave të strategjisë e të masave publike përgjegjëse.
10. Objektiva kryesore të SRERV janë:
- i) Rritja në masën 22 - 25 për qind e PBB real;
 - ii) Ulja e përqindjes së popullsisë që jeton nën varfëri, duke synuar veçanërisht në zbutjen e varfërisë në grupet sociale dhe zonat më të goditura;
 - iii) Përmirësimi i ndjeshëm i infrastrukturës dhe shërbimeve të lidhura me të, si furnizimi me ujë të pijshëm, saniteti, furnizimi me energji elektrike etj, duke rritur aksesin e të varfërve në to;
 - iv) Ulja e vdekshmërisë foshnjore e amëtare dhe e incidencës së sëmundjeve infektive;
 - v) Rritja e shkallës së regjistrimit në arsimin tetëvjeçar e të mesëm dhe zgjatja e viteve të shkollimit
11. Fusha prioritare të aksioneve publike do të jenë:
- i) Shëndetësia dhe arsimi
 - ii) Infrastruktura

- iii) Përmirësimi i qeverisjes
- iv) Rritja ekonomike
- v) Mbështetja sociale
- vi) Stabiliteti makroekonomik

12. Objektivat e tranzicionit, objektivat afatgjata të zhvillimit, objektivat e integritit evropian të Shqipërisë dhe objektivat e SRERV, në themel, mbështesin njëra-tjetrën. Zbutja dhe reduktimi i varfërisë është komponent i zhvillimit dhe pritet të shoqërohet me efekte pozitive në të gjitha dimensionet e zhvillimit njerëzor. Zbutja e varfërisë pritet të ketë, në analizë të fundit, efekte pozitive edhe në shpejtësinë dhe thellësinë e tranzicionit, ashtu sikurse edhe në një rritje të qëndrueshme ekonomike. Çdo hap i hedhur në drejtim të zbutjes së varfërisë është edhe një kontribut në afrimin e Shqipërisë me Evropën. Nga ana tjetër, çdo progres i shënuar në realizimin e objektivave të tranzicionit, të zhvillimit, të integritit evropian të Shqipërisë krijon kushtet për reduktimin e mëtejshëm të varfërisë. I njëjti ndërveprim përforcues afatgjatë vërehet midis objektivave të tranzicionit dhe objektivave të zhvillimit nga njëra anë, me objektivat e integritit evropian të Shqipërisë nga ana tjetër. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, bisedimet për nënshkrimin e së cilës pritet të fillojnë së shpejti, duke konkretizuar dhe afruar perspektivën e integritit evropian të vendit, do të shërbejë, ndër të tjera, edhe për kolaudimin e objektivave të tranzicionit e atyre të zhvillimit. Faktorë lidhës të objektivave të të katër strategjive janë rritja ekonomike dhe modernizimi i institucioneve.

13. Megjithatë, objektivat e strategjive të mësipërme nuk mund të njësohen. Midis tyre ka dhe konflikte, që lidhen me kufizimet e burimeve, sidomos atyre financiare, në periudha afatshkurtra dhe afatmesme. Disa prej tyre janë: (i) Mbajtja parasysh e efekteve afatshkurtra dhe afatmesme të reformave të tranzicionit në nivelin e varfërisë dhe, lidhur me to, nevoja për politika zbutëse e reduktuese ndaj varfërisë, bëjnë të domosdoshme programe të balancuara, relativisht "të përmbajtura" transformuese. (ii) Po kështu, problemet më të mprehta të varfërisë në zonat rurale e të thella të vendit dhe cilësia relativisht e ulët e shërbimeve jetësore, sikurse edhe e shërbimeve të shëndetësisë dhe të arsimit veçanërisht në këto zona, kërkojnë adresimin e më shumë burimeve në zgjidhjen e këtyre problemeve, që do të thotë të më pak burimeve në zgjidhjen e problemeve të tjera të zhvillimit. (iii) Së fundi, përgatitja e vendit për integritin evropian kërkon uljen e defiçitit buxhetor në nivelin jo më shumë se 3 për qind e PBB, ndërkohë që niveli aktual i tij për vitin 2000 ishte 9.1 për qind e PBB. Ndërkaq, çdo politikë për zbutjen e varfërisë, për shkak të faturës financiare, ka ndikim negativ në bilancin fiskal. SRERV mban parasysh edhe këto konflikte dhe synon në minimizimin e kostove të tyre.

I.B.3 DINAMIZIMI I STRATEGJISË

14. GRPS është konceptuar jo si një kornizë e ngurtë objektivash, fushash a masash prioritare, por si një platformë zhvillimi që nxit një pjesëmarrje aktive të grupeve të interesuara në zbatimin e saj. Qeveria dhe grupet e tjera të interesuar do të jenë të vëmendshëm për të siguruar një monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të strategjisë. Qeveria do të jetë gjithashtu e vëmendshme për të përshtatur çdo vit, mbi bazën e rezultateve të monitorimit dhe në bashkëpunim me grupet e interesuara, objektivat dhe masat publike prioritare.

I.B.4 "PRONËSIA" SHQIPTARE DHE KOOPERIMI ME PARTNERËT E ZHVILLIMIT TË VENDIT

15. E adresuar ndaj problemeve të varfërisë e zhvillimit në Shqipëri, SRERV është një strategji shqiptare. Pronësia shqiptare e Strategjisë është realizuar që në procesin e hartimit të saj. SRERV është rezultat i bashkërendimit të përpjekjeve të qeverisë qendrore, pushtetit vendor, shoqërisë civile, sektorit privat, përfaqësuesve të shtresave të goditura nga varfëria, etj. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të Strategjisë do të kërkojnë të njëjtin bashkëpunim.
16. Pronësia shqiptare e Strategjisë përforcohet nga "fatura financiare" e saj ndaj buxhetit të shtetit. Efekti financiar i Strategjisë është parashkuar në buxhetin e viteve të ardhshme dhe është inkuadruar në PAB. SRERV është gjithashtu e lidhur dhe e harmonizuar me strategjitë sektoriale të zhvillimit të vendit, si strategjia e arsimit, shëndetësisë, e decentralizimit të pushtetit, etj.
17. Reformat e tranzicionit dhe politikat e zhvillimit, ashtu sikurse përballimi i situatave të vështira që ka kaluar vendi, janë mbështetur në mënyrë të gjithanshme nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit të vendit. Qeveria shqiptare është e ndërgjegjshme se zbatimi i Strategjisë do të kërkojë para së gjithash mobilizimin e të gjithë burimeve të brendshme financiare dhe përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të tyre. E ndërgjegjshme gjithashtu se realizimi i politikave të parashikuara në kuadrin e Strategjisë do të kërkonte edhe një mbështetje të konsiderueshme financiare nga ana e partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit, qeveria shqiptare angazhohet për një përdorim efektiv të kësaj mbështetjeje.

I.C FAKTORË FAVORIZUES E PENGUES TË JETËSIMIT TË STRATEGJISË

I.C.1 DISA NGA FAKTORËT QË FAVORIZOJNË JETËSIMIN E SRERV:

- i) Hapat pozitivë në reformat institucionale dhe në stabilizimin e mjedisit politik;
- ii) Stabilizimi makroekonomik i arritur dhe zhvillimet premtuese në reformën e administritit fiskal;
- iii) Realizimet në reformat strukturore dhe shkalla e arritur në "vetfungsionimin" e ekonomisë të bazuar në mekanizmin e tregut;
- iv) Pjesëmarrja e e gjerë dhe e vazhdueshme e grupeve të interesuara në procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë;
- v) Vendosija e Shqipërisë në shinat e integritit evropian;
- vi) Mbështetja nga partnerët e zhvillimit të vendit.

I.C.2 DISA NGA FAKTORËT QË VËSHTIRËSOJNË DHE RISCOJNË JETËSIMIN E STRATEGJISË:

- i) Dobësitë ende të theksuara institucionale, veçanërisht në kapacitetet zbatuese të administratës publike;
- ii) Dobësi dhe vulnerabilitete të ekonomisë në tërësi;
- iii) Risqe që lidhen me sigurinë rajonale.

II PËRMBLEDHJE


E

PROCESIT TË PJESËMARRJES

II.A AKTORËT PJESËMARRËS DHE ROLI I TYRE NË HARTIMIN E SRERV

18. Hartimi i GRPS është realizuar përmes një sistemi të gjerë pjesëmarrjeje, që përfshiu parlamentin, pushtetin qendror dhe vendor, shoqërinë civile (organizatat jo-qeveritare, komunitetin e biznesit, dhomat e tregëtisë, shoqatat profesionale e grupe të tjera shoqërore) dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit. Pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesuara përbën dhe një nga tiparet dalluese të kësaj strategjie, krahasuar me I-PRSP. Ajo përbën një nga garancitë e suksesit të Strategjisë. Mbështetja kryesisht në kapacitet njëjzore të vendit ka siguruar “pronësinë shqiptare” të GRPS.
19. Struktura institucionale e hartimit të SRERV përbëhet nga (i) Komiteti Drejtues, (ii) Grupi i Punës (iii) Grupet Teknike Sektoriale.
20. **Komiteti Drejtues**, i përbërë nga një pjesë e anëtarëve të Komitetit Ndërmintor të Politikave Ekonomike, një përfaqësues nga Komuniteti i Donatorëve dhe një përfaqësues nga Shoqëria Civile, i kryesuar nga Kryeministri, drejton gjithë veprimtarinë për hartimin dhe zbatimin e SRERV.
21. **Grupi i Punës**, i krijuar nga Komiteti Drejtues, është përgjegjës për koordinimin e veprimtarisë operative të të gjithë hallkave institucionale në procesin e hartimit dhe zbatimit të strategjisë. Grupi i Punës, i drejtuar nga Ministri i Financave në rolin e Koordinatorit Kombëtar të SRERV, përbëhet nga Z/Ministrat dhe një Drejtor Departamenti nga Ministrinë e Financave, Shëndetësisë, Arsimit, Punës dhe Çështjeve Sociale, Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Bujqësisë, Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregëtisë, Transportit, Punëve Publike dhe Turizmit, Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Me qëllim shfrytëzimin e kapaciteteve ekzistuese brenda vendit, sidomos të shoqërisë civile, Grupi i Punës caktoi dy organizata jo-qeveritare në rolin e Konsulentit për përgatitjen e Strategjisë: Institutin për Studime Bashkëkohore dhe Institutin e Edukimit Fiskal.
22. **Grupet Teknike Sektoriale**, të ngritura pranë ministrive të shënuara më sipër, janë përgjegjëse për përpunimin e problemeve sektoriale të strategjisë dhe furnizimin me informacionin përkatës. Në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, të Shëndetësisë, të Bujqësisë dhe të Arsimit e Shkencës, Grupet Teknike Sektoriale përbëhen nga 9–10 anëtarë; gjysma e tyre përfaqësojnë Ministrinë përkatëse kurse gjysma tjetër Grupet Sektoriale Këshillimore të Shoqërisë Civile.

Figura 1: Struktura Institucionale e Hartimit të SRERV



II.B PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE

23. Proçesi i pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile në hartimin e SRERV është realizuar me ndihmën e Qendrës Carter, e cila mori përsipër (i) identifikimin e aktorëve të shoqërisë civile, të interesuar për të kontribuar në hartimin e strategjisë, (ii) lehtësimin e komunikimit/bashkëpunimit mes tyre dhe grupeve teknike të punës në Ministrinë e Linjës dhe (iii) realizimin e konsultimeve rajonale me popullsinë lokale me qëllim përçimin e politikave qeveritare lidhur me SRERV. Ky proces zgjati nga Shtatori 2000 deri më Qershor të vitit 2001 (shih Aneksi 4, Proçesi i Pjesëmarrjes).

II.B.1 IDENTIFIKIMI I AKTORËVE TË SHOQËRISË CIVILE

24. Kriteret e identifikimit të aktorëve të shoqërisë civile ishin përcaktues dhe cilësorë. Përcaktueshmëria lidhej me vendndodhjen gjeografike, formën juridike, interesin sektorial, lidhjet organizative dhe përfshirjen femërore në të. Tipari cilësor lidhej me nivelin e përfaqësimit të institucionit, aftësinë për t'u shprehur dhe kontribuar, interesin në proçes dhe preferencat mbi politikat sektoriale.

25. Me qëllim identifikimin e aktorëve të shoqërisë civile, Qendra Carter vizitoi një numër krahinash gjatë muajve Gusht–Tetor 2000, në kërkim të OJQ-ve dhe pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë civile. Për këtë qëllim, ajo përdori një process sipas të cilit organizatat e shoqërisë civile bënë përzgjedhje midis njëra – tjetrës. Përfaqësuesit e saj zhvilluan takime të njëpasnjëshme me këta aktorë, me qëllim familiarizimin paraprak të tyre lidhur me objektivat e SRERV dhe kontributin që shoqëria civile do të mund të ofronte në përgatitjen e tij. Këto takime ndihmuan gjithashtu në qartësimin e ideve për hartimin struktural të pjesëmarrjes së shoqërisë civile.

26. Në kuadrin e përpunimit final të idesë së pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe shpalljes publike të fillimit të SRERV, Qeveria, me ndihmën e BB, Qendrës Carter, IDS dhe PNUD, organizuan në Tiranë, në fillim të Nëntorit 2000 një workshop me përfaqësues të ministrive, donatorëve të huaj, diplomatëve dhe medias.

27. Me ndihmën e Qendrës Carter u krijuan Grupet Këshillimore të Shoqërisë Civile për shumicën nga sektorët që ndërthureshin me PAB: shëndetësi, arsim, punësim dhe çështje sociale si dhe bujqësi. Këto grupe përbëheshin nga 10–15 veta, të selektuar në bazë të rekomandimeve profesionale të kolegëve të tyre gjatë dhe pas workshopit të Nëntorit.

28. Grupet e punës të SRERV/PAB zhvilluan një sërë takimesh me Grupet Këshillimore të Shoqërisë Civile, me qëllim vlerësimin më të qartë të çështjeve të varfërisë dhe potencialeve për rritje në sektorët përkatës si dhe identifikimin e zgjidhjeve të mundshme dhe rrugëve të pasqyrimin të tyre në SRERV/PAB. Pasi ishin njohur me natyrën dhe karakterin e SRERV/PAB dhe kishin përcaktuar një qëndrim të qartë lidhur me kontributin e tyre, secili prej Grupeve Këshillimore të Shoqërisë Civile zgjodhi 4-5 anëtarë me qëllim përfaqësimit të tij në Grupet Teknike Sektoriale, stafi i të cilave ishte i kombinuar me anëtarë nga ministrinë dhe shoqëria civile.

29. Gjatë periudhës Janar–Qershor 2001 u realizuan 37 takime grupesh, duke filluar me takimet e vetë Grupeve Këshillimore të Shoqërisë Civile deri tek takimet e Grupeve Teknike Sektoriale me zyrtarët e lartë të Ministrive. Ky proces kulmoi me një Workshop një ditor të mbajtur në mes të Prillit, gjatë të cilit përfaqësuesit e shoqërisë civile bashkërenduan përpjekjet me zyrtarë nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe Ministria e Shëndetësisë, me qëllim hartimin e deklaratave finale mbi prioritetet strategjike në sektorët përkatës.

II.B.2 GRUPI KOMBËTAR KËSHILLIMOR I SHOQËRISË CIVILE

30. **Grupi Kombëtar Këshillimor i Shoqërisë Civile**, përbëhet nga përfaqësues të Grupeve Sektoriale Këshillimore të Shoqërisë Civile (nga 2 për çdo grup) si dhe nga përfaqësues të sektorit privat, pushtetit vendor dhe segmente të tjera të shoqërisë. Grupi Kombëtar Këshillimor i Shoqërisë Civile ka marrë përsipër rishikimin dhe oponencën e SRERV, përgatitjen e komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve lidhur me të dhe paraqitjen e tyre pranë Grupit të Punës
31. Ne fund të muajit Maj 2001 Ministria e Financave u shpërndau Ministrive të linjës, komunitetit të donatorëve, dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile draftin e parë të strategjisë. Në 5 Qershor u mbajt një takim i Grupit Kombëtar Këshillimor të Shoqërisë Civile me qëllim që të rishikohej drafti i parë për SRERV. Takimi I dytë I GKSHC, i cili shqyrtoi draftin e dytë të SRERV, u mbajt në 28 Shtator 2001. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave, konsulentët e SRERV dhe përfaqësues nga Banka Botërore. Komentet dhe sugjerimet e ofruara gjatë të dy konsultimeve u morën në konsideratë dhe u reflektuan në përgatitjen e draftet përkatëse.

II.B.3 THELBI I PROCESIT TË PJESËMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE

32. Problemet kryesore që u vunë re gjatë takimeve dhe bashkërendimit të punës mes Grupeve Këshillimore të Shoqërisë Civile dhe Grupeve Teknike të ministrive mund të përmblihen në:
- i) Vështirësi lidhur me përzgjedhjen e duhur të përfaqësuesve të shoqërisë civile;
 - ii) Vështirësi komunikimi në disa raste;
 - iii) Paqartësi në konceptimin dhe zbatimin e duhur të roleve përkatëse.
33. Megjithë problemet e hasura gjatë procesit të pjesëmarrjes në të katër sektorët, u arrit në përpilimin e një deklaratë të përbashkët e cila shërbeu si pikë referimi e kërkesave të shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e SRERV.

II.B.4 KONSULTIMET RAJONALE

34. Gjatë muajve Prill dhe Maj 2001, Qendra Carter dhe Oxfam organizuan një seri takimesh konsultative me dymbëdhjetë komunitete lokale në fshatra dhe qytete të katër distrikteve: Shkodër, Korçë, Gjirokastrë and Kukës. Ato kanë synuar në tërheqjen e kontributit të vetë të varfërve në hartimin e Strategjisë (për detaje të mëtejshme shihni Aneksin 4, Proçesi i Pjesëmarrjes).

II.C PJESËMARRJA E PARLAMENTIT, PUSHTETIT VENDOR DHE KOMUNITETIT TË BIZNESIT

35. Krahas Punës për filtrimin e ideve/inputeve të ardhura nga ministrinë e linjës, grupi i konsulentëve të Qeverisë, i përbërë nga Instituti për Studime Bashkëkohore dhe Instituti i Edukimit Fiskal, realizoi edhe një fushatë konsulence me Parlamentin, pushtetin vendor dhe komunitetin e biznesit.

II.C.1 KONSULTIMET ME PARLAMENTIN

36. Për shkak të fillimit të periudhës elektorale (Maj 2001), konsultimet me Parlamentin u zhvilluan me numër dhe pjesëmarrje më të kufizuar se sa ishte parashikuar.

II.C.2 KONSULTIMET ME PUSHTETIN LOKAL

37. Procesi i konsultimeve për përgatitjen e SRERV-se ka përfshirë edhe qeverisjen vendore, një nga aktoret sa të interesuar aq edhe të rëndësishëm si në identifikimin e problemeve dhe adoptimin e zgjidhjeve të përshtatshme ashtu si edhe në fazën e zbatimit të vetë strategjisë. Ecuria e metejshme e reformës së decentralizimit do ta fuqizojë edhe më tej rolin e qeverisjes vendore në procesin e zbatimit, monitorimit dhe të përshtatjes së SRERV.
38. Konsultimet me qeverisjen vendore u zhvilluan në dy raste. Nepermjet tyre është synuar që shkallë shkallë të sillen në procesin e përgatitjes së SRERV të dhëna, sigjerime e zgjidhje të përshtatshme si dhe angazhime institucionale nga këndvështrime konkrete lokale dhe rajonale.
39. Rasti i parë, në të cilin morën pjesë rreth 40 përfaqësues të njesive të qeverisjes vendore nga i gjithë vendi, si dhe përfaqësues të ministrive, të shoqërisë civile dhe të donatorëve, u zhvillua në Prill 2001. Takimi bëri të mundur:
- i) Informimin e qeverisjes vendore mbi procesin e SRERV, prioritetet themelore, si dhe raportet e SRERV me dokumentat e tjera strategjike të qeverisë;
 - ii) Tërheqjen e mendimeve paraprake të pjesëmarrësve, mbi a) profilin e varferisë dhe shtrirjen e saj b) faktorët pengues/zhvillues të rritjes dhe reduktimit të varferisë; c) politikat dhe masat prioritare kombëtare ose vendore me të përshtatshme dhe institucionet/aktoret që mund t'i përgatisin ose t'i zbatojnë ato d) çështjet që duhen adresuar në reformën e decentralizimit që të mundësojnë një rol më efektiv të qeverisjes vendore në arritjen e objektivave të SRERV.
40. Konsultimi i dytë u zhvillua në Tetor 2001, mbas përgatitjes së draftit të dytë të SRERV me synimin për të bërë përmirësimet e fundit, për arritjen e konsensusit në lidhje me objektivat, masat prioritare si dhe vecanerisht për rolin e qeverisjes vendore në zbatimin e SRERV. Në takim morën pjesë rreth 80 përfaqësues të njesive të qeverisjes vendore si dhe nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore. Në veçanti u diskutuan disa nga çështjet që ndërthuren mes reformës në vazhdim të decentralizimit dhe masave prioritare në fushat e infrastruktures, arsimit, mbrojtjes dhe përkrahjes sociale,

shendetesise, zhvillimit te integruar rural dhe atij urban, nevojës dhe menyrave te perfshirjes se komuniteteve ne qeverisjen vendore.

II.C.3 KONSULTIMET ME KOMUNITETIN E BIZNESIT

41. Gjatë hartimit të SRERV u zhvilluan dy raunde të konsultimeve me komunitetin e biznesit privat. Raundi i parë i konsultimeve u zhvillua në Prill, me rreth 70 përfaqësues të komunitetit të biznesit, të organizuar sipas grupeve të interesit dhe profilit të aktivitetit si dhe përfaqësues të Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregëtisë. Gjatë raundit të parë të konsultimeve, vëmendje i'u kushtua familjarizimit të pjesëmarrësve me strategjinë dhe tërheqjes së opinionëve të tyre lidhur me barrierat për zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë dhe alternativat e mundshme të zgjidhjeve.
42. Shqetësimet kryesore të ngritura nga biznesi privat konsistonin në: (i) marrdhëniet e biznesit me administratën tatimore dhe doganore; (ii) paqëndrueshmërinë e politikave fiskale dhe barrën tatimore, që në disa raste është e lartë (veçanërisht pagesa e kontributeve për fuqinë punëtore e rrit ndjeshëm koston e saj dhe stimulon punën e zezë; (iii) problemet e strukturës së tregut dhe deformimet nga konkurrenca e pandershme; (iv) vështirësitë në përfitimin e shërbimeve publike cilësore (veçanërisht u mbajt qëndrim kritik në furnizimin e subjekteve me energji elektrike); dhe (v) probleme të kreditimit të pamjaftueshëm dhe koston e lartë të saj. Hartimi i kësaj strategjie, ka përcaktuar objektivat dhe masat publike prioritare duke adresuar shqetësimet e ngritura nga komuniteti i biznesit privat.
43. Raundi i dytë i konsultimeve u realizua, të Tetor 2001, pasi ishte shpërndarë drafti i dytë i SRERV. Takimi synoi në tërheqjen e opinionit të pjesëmarrësve nga komuniteti i biznesit lidhur me nivelin e përfaqësimit të interesave dhe sugjerimeve të tyre në material. Pjesëmarrësit u shprehën të kënaqur nga pasqyrimi i shqetësimeve të tyre. Në të njëjtën kohë, ata shprehën shqetësimin e tyre për ecurinë në zbatimin e politikave të shkruara në strategji, sidomos lidhur me konsolidimin e tokës ose alternativa të saj, furnizimin me energji elektrike, diferencimin e TVSH, dhe zgjerimin e bazës së tatimpaguesve.

Problemet e hasura

44. Procesi i konsultimeve të gjera me shoqërinë civile, parlamentin, komunitetin e biznesit dhe pushtetin vendor ndihmoi për identifikimin e objektivave, fushave dhe masave publike prioritare. Sigurisht, si një iniciativë e re, ky problem pati mangësitë e tij. Konsultimet me Parlamentarët nuk u zhvilluan me intensitetin e duhur, kjo për vetë faktin se Parlamenti u shpërnda pasi e kishte mbaruar mandatin e tij në momentin kur strategjia filloi të hartohej. Qeveria vendore ende nuk e ka të qartë rolin dhe kontributin e vet në implementimin e strategjisë, për vetë faktin se decentralizimi i pushteteve është në fazat fillestare të tij. Së fundi, komuniteti i biznesit është konservator në rekomandimet e tij, për arsyen se paragjykon mundësinë e vënies së tyre në jetë.

II.C.4 PROÇESI I INFORMIMIT PUBLIK


45. Per realizimin e informimit dhe ndergjegjesimit publik mbi rendesine e strategjise, Qeveria perdori disa prej metodave me te njohura si vijon:

Posteri dhe sllogani

46. Duke ruajtur logon e miratuar, posteri u zhvillua midis tre mesazheve dhe perfshirjeve:

- Shtresa se ciles I drejtohet strategjia,
- Strukturat pjesemarrrese ose dhe aktive ne strategji si dhe
- Apeli rezultativ I kombinuar nga perfshirja e te dy elementeve per zgjerimin e partnereve.

47. Sllogani qe u perdor ne fushaten sensibilizuese ishte “kapni kohën për vetë dhe për familjen tuaj”. Ky sllogan u ideua sipas shprehjes latine “*carpe diem*”. Ne kete rast u shmang perdorimi i fjales varferi dhe u perfshi femija si nje element i rendesishem i familjes shqiptare dhe simbol i te ardhmes.



Radio

48. Ne fazen e dyte te projektit te Informimit GPRS u realizua teresisht produkti I menduar per radion nepermjet serialit dhe spotit radiofonik.

➤ ***Seriali i emisioneve***

49. Seriali synoi te jape grupin e problemeve te zhvillimit. Ndertimi i nje dialogu radiofonik ishte efektiv ne pikepamje te zbulimit te nje lende te konsiderueshme te problemit dhe percimit te interesave te nje pale shume te rendesishme ne dialogun e pergjithshem te reduktimit te varferise.

50. Nxitja e nje dialogu te tille u ballafaqua shpesh me probleme konkrete te degjuesve dhe mundesite e zgjidhjes se tyre, qe ne fakt s'ishin objekt i ketij diskutimi. Ne te njejten kohe ne telefonatat direkte shpesh u ekspozua ngarkesa politike e folesve se ciles te ftuarit iu pergjigjen me qartesi. Dialogu ne radio realizoi te qenet i favorshem dhe i besueshem njekohesisht nisur nga koha relativisht e gjate qe te ftuarit paten ne dispozicion dhe te shprehurit direkt, nderkohe qe dialogu me degjuesit jepte dhe favoret e nje prezantimi direkt te opinionit te tyre.

51. Pjesemarrja e personave te ndryshem te projektit ne emisionet radiofonike perfaqesoi ne kohe te mjaftueshme palen qe merr persiper sqarimin e problemit ne dialog. Sipas dhe tematikes, per çdo emision u paraqit nje hallke e menduar e strategjise, p.sh. shendetesia, arsimi, emigracioni dhe ndihma sociale etj.

➤ **Spoti radiofonik**

52. Spoti u realizua nga Studio “Fasada” me variantin me humor te miratuar ne mbledhjen e grupit te punes GPRS ne radio Top Albania. Studio Fasada administroi dhe transmetimin tre here ne dite perkatesisht ne ora 08.58, 16.30 dhe 20.02.

Broshura

53. Ne fazen e dyte te projektit u realizua dhe broshura e strategjise, produkt i trashегuar nga faza e pare. Seleksionimi i materialeve qe paraqesin strategjine ne broshure u qarkullua per lexim te anetaret e grupit te punes. Ne parim u mendua nje parashtrim i materialit me pyetje, stilistik i llojit te internetit.


Televizioni

54. Pas konsultimesh te shumta ne 31 Mars ne televizionin publik kombetar u realizua emisioni televiziv promovues i strategjise. Ky eshte konsideruar gjithashtu dhe produkti me i rendesishem nga grupi realizues, per vete kompleksitetin qe ka televizioni.

➤ **Talk show**

55. Njė talk show me perfaqesues te te gjitha grupeve te interesave lidhur me GPRS, per fshire edhe qeverine, u organizua ne formen e nje bisede promovuese ne studion televizive te televizionit publik. Transmetimi ishte direkt, dhe debati u inspirua edhe nga demot dhe spoti televiziv.

Figura 2



➤ **Spoti televiziv**

56. Spoti televiziv u transmetua perpara talkshow-t. Realizimi i tij permbante xhirime dhe perpunim grafik. Spoti u konceptua si nje rruge ne te cilen fillon te ece nje femije dhe perfundon nje i moshuar (shih skemen e xhirimit). Ideja e rritjes, e kohes e gjithepershirjes dhe e nje rruge qe jepet me strategjine qendruan para kameres per rreth nje minute. Pas saj u identifikua strategjia me logon e vet dhe slloganin. Spoti u transmetua per tre jave rresht ne TVSH i kombinuar me njoftimin per transmetimin emisionit.

Gazeta

57. Perfaqesimi i strategjise ne gazeta eshte menduar me hapesira te kushtuara problemit ne pergjithesi. Keto hapesira kane synuar:
- o Berjen te njohur te standarteve ekzistuese te varferise
 - o Shtresat me te prekura te shoqerise dhe fenomenet me te ekspozuara
 - o Orientimin e tyre sipas strategjise kombetare.
58. Botimi i artikujve ka filluar ne dhjetorin e vitit te shkuar dhe ka vazhduar deri ne gusht. Nga data 16 qershor produkti i gazetave u grupua dhe nje here per te patur nje fushate botimi. Duke gjykuar ndryshimet kontekstuale nga plani I paraqitur ne fillim ne lidhje me realizimet ne gazete, ne propozuam realizimin e nje cikli te perditshem ne gazeten “Koha Jone”, “Republika”, “Gazeta Shqiptare”, “Shekulli”.

II.C.5 ROLI I DONATORËVE

59. (i) Një grup me donatorët kryesorë u formua në Dhjetor 2000, nën drejtimin e BB. Ky grup, i cili përbëhej nga përfaqësues të BB, FMN, PNUD, UK (DFID), USAID, Gjermani, Itali, Hollandë, Kanada dhe OSBE, u takua disa herë për të diskutuar procesin e SRERV dhe rolin e donatorëve. Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave morrën pjesë në një nga takimet. Ky grup gjithashtu u fokusua në financimin e mëtejshëm të procesit, si dhe në aksionet prioritare që lidhen me SRERV;
- (ii) Donatorët dhanë komentet e tyre mbi draftin e parë dhe të dytë të SRERV;
- (iii) Disa Donatorë ofruan asistencë financiare për procesin e SRERV si dhe inpute të rëndësishme në të - fushata informuese (UNICEF), Workshopi i Nëntorit (UNDP), analiza të aktorëve (DFID, BB), vlerësim cilësor i varfërisë (PNUD), konsulentët e qeverisë (DFID), sekretariati teknik (DFID), PAB (DFID). Një numër donatorësh kanë shprehur interesin e tyre për të financuar në të ardhmen aktivitetet e lidhura me SRERV – përfshirë qeverinë Hollandeze, CIDA, UNDP dhe DFID.

III ANALIZA E VARFËRISË
DHE
VLERËSIMI I POLITIKAVE

III.A ANALIZË E PËRGJITHSHME E VARFËRISË

60. Situata kritike e periudhës 1991-1992 kondicionoi hartimin e politikave sociale të zbutjes së varfërisë në kushtet e mungesës së studimeve specifike dhe një informacioni të kufizuar. Edhe pas vitit 1992, studimet mbi varfërinë, profilin, treguesit, shpërndarjen dhe karakteristikat themelore janë të pakta, të ndryshme në metodologji dhe të shkëputura në kohë. Studimet mbi varfërinë në periudhën 1992-1996 përmbliohen në dy dokumenta kryesore: studimi mbi buxhetin e familjes i vitit 1993-1994 i realizuar nga INSTAT vetëm në Tiranë dhe Studimi mbi Matjen e Nivelit të Jetesës (LSMS) I realizuar në vitin 1996 nga Administrata e Përgjithshme e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale, i shtrirë në të gjithë Shqipërinë, përjashtuar Tiranën.
61. Si burime kryesore informacioni në këtë dokument shërbejnë Studimi mbi Kushtet e Jetesës (LCS) i vitit 1998 i realizuar nga INSTAT, Studimi MICS 2000, i realizuar nga INSTAT me mbështetjen e UNICEF, Studimi Cilësor mbi Varfërinë në 10 rrethe të vendit realizuar në vitin 2001 me mbështetjen e Bankës Botërore si edhe statistikat administrative. Me gjithë vlerën e tyre, studimet e mësipërme përmbajnë dhe disa kufizime:
- LCS mbështetet në të dhëna të vitit 1998 dhe për zonat rurale **nuk përfshin vlerën e konsumit të mallrave të prodhuara nga vetë fermerët;**
 - Studimi Cilësor mbi Varfërinë shtrihet vetëm në 10 rrethe të vendit.
62. Krijimi i njësisë së studimit dhe monitorimit të varfërisë do të mundësojë një analizë të vazhdueshme e cilësore të varfërisë në Shqipëri, duke krijuar kushtet për hartimin e një politike më realiste dhe efektive. Në vitin 2002 do të realizohet LSMS, që do të përsëritet rregullisht çdo tre vjet.

III.A.1 PROFILI I VARFËRISË NË SHQIPËRI - VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

63. Varfëria, megjithëse me shtrirje masive në sistemin e kaluar, mori pranim zyrtar vetëm pas vitit 1991. Varfëria në Shqipëri paraqitet si dukuri shumëdimensionale. (i) nivelit të ulët apo shumë të ulët të të ardhurave të të varfërve, i shtohen (ii) prekshmëria më e lartë nga sëmundjet dhe pamundësia për shërbime të përshtatshme mjekësore, (iii) analfabetizmi apo niveli i ulët i shkollimit, (iv) shkalla e lartë e ekspozimit ndaj risqeve dhe (v) zëri i dobët në institucionet vendimmarrëse, qeveritare. Sipas studimeve të përmendura më sipër dhe statistikave zyrtare, rezulton se: (i) 29.6 për qind e shqiptarëve janë të varfër, ndërsa gjysma e kësaj kategorie jetojnë në varfëri ekstreme, (ii) një familje në tre përjeton probleme të strukturës së banimit, (iii) vdekshmëria foshnjore dhe ajo deri në pesë vjeç janë relativisht të larta krahasuar me vendet e rajonit, vdekshmëria amëtare është gjithashtu e lartë, (iv) pothuajse një në 7 fëmijë nën 5 vjeç (14 për qind) është i keqshqyer, (v) vihet re rritje e analfabetizmit (vetëm 88 për qind e popullsisë mbi 15 vjeç është në gjendje të shkruajë dhe të lexojë), dhe (vi) 75 për qind e familjeve të varfëra, përveç mungesës së të ardhurave, përjetojnë edhe probleme të mprehta sociale.

64. Probabiliteti i jetesës në varfëri rritet me rritjen e madhësisë së familjes, siç konfirmohet nga LCS 1998. Varësia e varfërisë nga madhësia e familjes është më e pranishme në zonat rurale, ku familjet e varfëra rezultojnë me 5.1 anëtarë, kundrejt 4.7 anëtarëve në familjet urbane. Gjithashtu, familjet me shumë fëmijë dhe të moshuar janë më pranë kufirit të varfërisë, sepse koeficienti i varësisë është më i lartë. Familjet, ku mbajtësit kryesorë janë të rinj dhe të paarsimuar, janë më të rrezikuar nga varfëria, ndërsa familjet ku kryefamiljari ndodhet në emigracion, nuk karakterizohen nga rrezik i lartë i rënies në varfëri (shih Aneksi 2, Tabela 1). Varfëria është më prezente në dy kategori familjesh ku gruaja është mbajtësi kryesor: gra të veja me fëmijë dhe gra të vetme. Këto kategori janë rreth 60 për qind më pranë kufirit të varfërisë sesa familjet me mbajtës meshkuj (shih Aneksi 2, Tabela 2).

Dritare 1: Të varfërit mbi varfërinë

Studimi Cilësor mbi Varfërinë i realizuar në vitin 2001 në bashkëpunim me Bankën Botërore konstatoi se individët kanë një konceptim multidimensional mbi varfërinë. Krahas elementeve bazë të jetesës si ushqimi, veshmbathja dhe strehimi, ata përfshijnë në konceptin e varfërisë edhe mungesën e shpresës, përjashtimin nga jeta ekonomike e sociale, pamundësinë për të vazhduar traditat familjare e sociale, etj. Konceptin e varfërisë e shohin në lidhje të drejtpërdrejtë me probleme të tjera të rëndësishme të jetës së përditshme, siç janë mungesa e një infrastrukture të përshtatshme (furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujrave të zeza, furnizimi i rregullt me energji elektrike, ngrohja, rrugët, etj), siguria (rendi publik, shëndeti, mirëqënia ekonomike, etj), cilësia e shërbimit shëndetësor dhe e edukimit, etj. Të gjitha këto elementë socio-ekonomike, që përfshihen në konceptin shumëdimensional të varfërisë, lidhen midis tyre dhe kushtëzojnë nivelin e saj.

65. Varfëria është në lidhje të zhdrejtë me shkallën e arsimimit. Më shumë se një e treta e të varfërve janë me arsim fillor dhe një e pesta e tyre janë me arsim tetëvjeçar. Pritshmëria e varfërisë për kryefamiljarët pa diplomë është 35.8 për qind, përkatësisht 29.3 për qind në zonën urbane dhe 37.1 për qind në zonën rurale. Niveli i varfërisë në zonën rurale, krahasuar me atë urbane, është afërsisht dy herë më i lartë për çdo nivel arsimor, me përjashtim të arsimit të lartë, ku nivelet e varfërisë janë të barabarta (shih Aneksi 2, Tabela 3).
66. Nivelet e varfërisë janë relativisht të larta në grupet shoqërore, për të cilët burimi kryesor i të ardhurave është bujqësia. Rreth 50 për qind e të varfërve janë të vetëpunësuar në bujqësi, 20 për qind janë pensionistë dhe 10 për qind janë të punësuar në sektorin jo bujqësor. Rreth 60 për qind e atyre që përfitojnë pagesë papunësie janë të varfër. Nivelet e varfërisë janë më të larta ndërmjet pensionistëve (shih Aneksi 2, Tabela 4).
67. Sipas LCS, më shumë se ½ e familjeve ku kryefamiljari është i papunë bie nën nivelin e varfërisë. Të punësuarit kanë më pak mundësi të bien në kategorinë e të varfërve nëse jetojnë në zonën urbane (5,3 për qind), krahasuar me ata që jetojnë në zonën rurale (32,6 për qind). Ndërkaq, nuk ekziston ndryshim i theksuar në nivelet e varfërisë ndërmjet të papunëve në zonën rurale dhe urbane. Pensionistët e zonave rurale, duke përfshirë edhe individët me paaftësi që përfitojnë një pension, kanë probabilitet dy herë më të lartë të jetojnë në varfëri krahasuar me pensionistët e zonave urbane. (shih Aneksi 2, Tabela 5)

III.A.2 AKSESI NDAJ BURIMEVE EKONOMIKE DHE VARFËRIA

Varfëria e matur me nivelin e të ardhurave

68. Në një ekonomi kryesisht bujqësore dhe informale si ekonomia shqiptare, matja e varfërisë nëpërmjet nivelit të konsumit do të ishte më e përshtatëshme. Sidoqoftë, për shkak të pamundësisë të matjes së treguesit të mësipërm, i vetmi tregues që mund të përdoret është niveli i të ardhurave për të plotësuar nevojat bazë. Ky nivel është konsideruar si “vija e varfërisë”. Analiza e varfërisë nëpërmjet të ardhurave bazohet në dy nivele të varfërisë relative, ku 60 për qind e medianës në modelin e zgjedhur¹ përdoret për të identifikuar të “varfërit” dhe 40 për qind për të identifikuar “shumë të varfërit”. Si tregues të varfërisë absolute janë përdorur numri i personave që jetojnë me nën 1 dollar në ditë dhe numri i personave që jetojnë me nën 2 dollarë në ditë. Duke iu referuar përcaktimeve relative apo atyre absolute të dhëna më sipër për vijën e varfërisë, për matjen e saj janë përdorur dy tregues: përqindja e popullsisë, të ardhurat për frymë të së cilës bien nën vijën e varfërisë (incidenca e varfërisë) dhe diferenca midis të ardhurave të të varfërve dhe vijës së varfërisë (hendeku apo thellësia e varfërisë).

69. Mbështetur në treguesin e nivelit relativ të varfërisë, 29.6 për qind e shqiptarëve në vitin 1998 ishin të varfër, ndërsa gjysma e tyre jetonin në kategorinë e varfërisë ekstreme. Varfëria është e përqëndruar kryesisht në zonat rurale: ndër 5 të varfër, 4-jetojnë në fshat.

Nëse merret në konsideratë niveli absolut i varfërisë, 1 në çdo 6 familje jetojnë me më pak se 1 dollar në ditë për person dhe pothuajse një në dy familje jetojnë me më pak se 2 dollarë në ditë për person (shih Aneksi 2, Tabela 6). Shpërndarja e mirëqënies sociale ndërmjet zonave urbane dhe rurale është gjithashtu jo proporcionale: 28 përqind e popullsisë rurale përfshihet në kuantilin e fundit, ndërsa thuajse i njëjti proporcion i popullsisë urbane përfshihet në kuantilin më të lartë (shih Aneksi 2, Tabela 7).


Dritare 2: Dimensionet e varfërisë

Studimi Cilësor i Varfërisë i realizuar në vitin 2001 në 10 rrethe të vendit dallon katër grupe të ndryshme socioekonomike mbështetur në treguesin shumë dimensional të varfërisë: familje shumë të varfëra, të varfëra, jo të varfëra dhe relativisht në gjendje të mirë. Familje shumë të varfëra janë ato të cilat nuk plotësojnë siç duhet nga ana sasiore dhe cilësore nevojat më të domosdoshme për ushqim. Familje të varfëra janë ato që i plotësojnë nevojat për ushqim, por nuk mund të përballojnë shpenzimet e nevojshme për veshmbathje. Familje jo të varfëra janë ato që mund të përballojnë shpenzimet e ushqimit dhe të veshmbathjes, por që nuk përballojnë dot të gjitha shpenzimet e tjera për mirëmbajtjen e shtëpisë ose të pajisjes së saj me orëndi të përdorimit afatgjatë. Ndërsa në familjet me gjendje relativisht të mirë bëjnë pjesë ato që mund të përballojnë shpenzimet e mësipërme dhe që mund të blejnë autovetura dhe një shtëpi të dytë. Dy grupet e para sigurojnë ushqim dhe veshmbathje të pamjaftueshme në sasi dhe cilësi, ndjejnë një stres psikologjik të vazhdueshëm. Ndërsa dy grupet e tjera e konsiderojnë veten të varfër në raport me kushtet e përjashtimit ekonomik dhe social, e mungesës së sigurisë, të infrastrukturës së varfër dhe të mungesës së institucioneve formale.

¹ Studimi i nivelit të jetesës, INSTAT, 1998, Draft Raport

70. Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave në të gjithë vendin është e lartë. Koeficienti Gini llogaritet në nivelin 0.43. Nuk vihen re diferenca të theksuara ndërmjet vlerës së treguesit Gini për zonën rurale dhe atë urbane (Figura 3). Sidoqoftë, duhet nënvizuar se këto të dhëna pasqyrojnë situatën e vitit 1998. Krahasuar me të dhënat që ofrohen nga studimet² e realizuara në vitin 1996, të shtrira në gjithë vendin përjashtuar Tiranën, pabarazia është thelluar³: vlera e koeficientit Gini në nivelin vendi ishte 0.276 (duke mos patur ndryshime të dallueshme midis zonave urbane, 0.242, dhe zonave rurale, 0.277). Krahasuar me disa vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, shkalla e pabarazisë në Shqipëri është e lartë. Vlera e koeficientit Gini në vitet 1996 dhe 1997, ishte: për Bullgarinë (1996) 0.291; për Çekinë (1997) 0.259; për FYROM (1997) 0.259; për Hungarinë (1998) 0.348; për Poloninë (1997) 0.3; për Federatën Ruse (1996) 0.483 dhe për Rumaninë (1997) 0.422.

Figura 4: Shpërndarja e të ardhurave familiare



Varfëria e matur sipas nivelit të kapitalit dhe pasurisë

71. Studimi i nivelit të jetesës së familjeve shqiptare i vitit 1998 siguron informacion mbi pronësinë e familjeve mbi kapitalin prodhues dhe sendet e konsumit afatgjatë. Sipas këtij burimi familjet në Kukës, Dibër dhe Elbasan janë më të varfërat. Treguesi i kapitalit jep thujtë të njëjtin informacion si edhe treguesi i varfërisë sipas të ardhurave. Familjet në qytetet si Tirana, Durrësi dhe Vlora kanë tregues mesatarë më të lartë, tre herë më të lartë se në prefekturat e varfëra. Diferenca ndërmjet grupeve më të varfëra dhe më të pasura është e lartë (shih Aneksi 2, Tabela 8). Ngarkesa shumë e vogël për frymë e sipërfaqes së tokës së punueshme në zonat rurale (mesatarisht 1,3 ha/frymë), është një nga shkaqet kryesore të varfërisë në këto zona.

² Studimi i Varfërisë, 1996, APNSHS,

³ Pjesërisht ndryshimi i madh i treguesit Gini në dy periudhat shpjegohet ndryshimet metodologjike të studimeve: koeficienti Gini i vitit 1998 bazohet në të ardhurat, ndërsa ai i vitit 1996 në konsumin.

Varfëria e matur me shkallën e mosplotësimit të nevojave bazë

72. Studimi i INSTAT mbi kushtet e jetesës (1998) siguron informacion mbi nivelin e mosplotësimit të disa nevojave bazë, të tilla si (i) mundësia e përdorimit të ujit të pijshëm dhe mjeteve të higjienës, (ii) kushte të papërshtatëshme të banesës, (iii) jetesa në të njëjtën shtëpi e shumë personave (kur në të njëjtën dhomë flenë më shumë se tre persona), (iv) ngrohje e papërshtatëshme dhe (v) nivel i ulët i shkollimit. Dy familje në pesë nuk plotësojnë dy nga pesë nevojat bazë dhe një në gjashtë familje nuk plotëson tre ose më shumë nga këto nevoja. Varfëria është më e lartë në zonën rurale. Rezultatet e studimit tregojnë se kushtet e banimit duhet të përmirësohen si në zonën rurale ashtu edhe urbane, ku një familje në tre përjeton probleme të strukturës së banimit (shih Aneks 2, Tabela 9).
73. Mbështetur në studimin MICS 2000, rezulton se më tepër se 45 për qind e popullsisë e marrin ujin e pijshëm nga çezma në shtëpi, 20 për qind e marrin nga çezma në oborr dhe 16.4 për qind e marrin nga çezma publike. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, më pak se 90 për qind e familjeve në zonat urbane kanë akses në ujin e pijshëm me tubacion; ndërsa më pak se 50 për qind e familjeve në zonat rurale kanë akses në ujin e pijshëm me tubacione dhe më pak se 5 për qind kanë akses në rrjetin e kanalizimeve me tubacione. Familjet në zonat urbane kanë ujë të rrjedhshëm vetëm për disa orë në ditë.

Varfëria dhe papunësia

74. Pamundësia e patjes së një vendi pune dhe të ardhurave që sigurohen prej saj, është një nga shkaqet kryesore të varfërisë në zonat urbane. Megjithëse papunësia është ulur nga 27 për qind në vitin 1992 në 16,8 për qind në vitin 2000 (siç rezulton nga statistikat zyrtare), ajo vazhdon të mbetet në nivele të larta, veçanërisht papunësia afatgjate. Për zonat rurale është karakteristikë papunësia e fshehtë. Sipas të dhënave, në Berat, Elbasan, Kurbin, Shkodër, Përmet dhe Kuçovë, papunësia është më e lartë se niveli mesatar.
75. Papunësia e fshehtë dhe nënpunëzënia si pasojë e normës së ulët të sipërfaqes së tokës së punueshme për frymë të popullsisë dhe të shkallës së ulët të zhvillimit

Dritare 3: Si jetojnë të varfërit

Kur njerëzit janë të papunë dhe nuk mund të sigurojnë mjetet e mjaftueshme të jetesës nga toka e tyre, atëherë ata fillojnë të mbështeten në burime alternative (coping mechanism). Aq e drejtpërdrejtë është lidhja midis këtyre burimeve të të ardhurave sa mund të themi se zvogëlimi i njërit burim e nxit familjen të drejtohet burimeve të tjera alternative. Kur të ardhurat nga bujqësia janë të pamjaftueshme, një pjesë e familjeve fshatare që janë në periferi ose në afërsi të qyteteve të mëdha përpiqen që ato të kompensojnë nëpërmjet punës së rastit në qytet, kryesisht në ndërtim por edhe në sektorë të tjerë. Disa nga anëtarët e tyre, sidomos djemtë e rinj, në periudha të caktuara të vitit i drejtohen emigracionit afat shkurtër, përgjithësisht në Greqi ose në Itali. Familje të tjera që nuk i kanë këto mundësi migrojnë drejt qendrave të mëdha urbane ose marrin ndihmë ekonomike nga shteti. Pothuajse të gjithë njerëzit e varfër bazohen tek strukturat e forta familjare, të afërmit, fqinjët dhe rrethi i gjerë i të njohurve. Nga të gjitha burimet e mësipërme elementi më elastik dhe burimi alternativ më i rëndësishëm është pa dyshim emigracioni. Ai rritet ose tkurret në varësi të vështirësive që ndesh familja. Dhe kur të ardhurat nga këto burime alternative, për një arsye ose tjetër, vonojnë të realizohen, atëherë familjet e varfëra i drejtohen sistemit të blerjes me kredi ose siç quhet ndryshe të blerjes me listë në dyqane ushqimore. Thuajse në të gjitha fshatrat e lagjet e varfëra të qyteteve sistemi i blerjes me listë është bërë një dukuri e zakonshme e jetës ekonomike. Ai është sistemi i kreditimit të familjeve të varfëra. Listat zgjaten ose zvogëlohen në varësi të peripeçive të emigrantëve në vendin e emigrimit, të gjetjes së punëve të rastit, të shitjes së ndonjë produkti bujqësor, të madhësisë dhe kohës së dhënies së ndihmës ekonomike, etj.

të aktiviteteve ekonomike jobujqësore në zonat rurale, mund të konsiderohen si shkaqe kryesore të varfërisë në këto zona. Duke mos patur burime të tjera jetese përveç tokës bujqësore, pjesa më e madhe e familjeve në rrethet Dibër, Kukës, Tropojë, Shkodër, Mirditë, Mat, jetojnë kryesisht me të ardhurat dhe prodhimet e fermës në pronësi, e cila është e kufizuar në sasi dhe e një cilësie të ulët. Nënpunëzënia dhe papunësia e lartë janë të pranishme edhe në zonat urbane të mbipopulluara nga migracioni i brendshëm pas vitit '90. Në komunat e Kamzës, Paskuqanit, në rrethin Tiranë, në komunat Katund i Ri në rrethin Durrës, pjesa më e madhe e popullsisë së aftë për punë është e papunë dhe jeton kryesisht me punësimin e përkohshëm në tregun joformal.

76. Përsa i përket përkatësisë gjinore të papunësisë, ajo është më e lartë tek femrat (21 për qind) dhe më e ulët tek meshkujt (16 për qind). Nivelet më të larta të papunësisë tek femrat në qytetet Vlorë, Tiranë, Berat, dhe Kavajë shpjegohen me mbylljen e aktiviteteve të industrisë ushqimore, asaj tekstile dhe artizanatit. Në qytetet Elbasan, Bulqizë, Durrës, Fier, Skrapar, papunësia në meshkujt është më e lartë se mesatarja dhe shpjegohet me mbylljen e ndërmarrjeve të industrisë së rëndë dhe minierave. Të dhënat e papunësisë në vite, tregojnë se, aktualisht, femrat kanë mundësi më të pakta punësimi.
77. Përsa i përket moshës së të papunëve, papunësia është e pranishme tek 60 për qind e grupmoshës 16-34 vjeç dhe është e lidhur me faktin e mungesës së eksperiencës apo të një profesioni të mirëfilltë për këtë grupmoshë. Sipas rretheve, me nivele më të larta renditen Vlora, ku grupmosha 16-34 vjeç përfaqëson 86 për qind e të papunëve të regjistruar, Mati (82 për qind), qyteti i Tiranës (66 për qind), Puka (65 për qind), Shkodra (63 për qind).

III.A.3 DIMENSIONET E ZHVILLIMIT NJERËZOR DHE VARFËRIA

Treguesit shëndetësorë si dimension i varfërisë

➤ *Jetëgjatësia e pritshme*

78. Duke iu referuar statistikave të Ministrisë së Shëndetësisë, jetëgjatësia mesatare e pritshme është relativisht e lartë: 69 vjet për burrat dhe 75 vjet për gratë. Ky tregues është pozitiv dhe i krahasueshëm me vendet e zhvilluara megjithëse vitet e fundit vihet re një tendencë e lehtë në rënie.
79. Vdekshmëria është rreth 5,5 për 1000 banorë, një tregues ky pak a shumë stabil, por me një tendencë rritjeje të numrit të vdekjeve për moshat e reja 20-45 vjeç, e lidhur kjo me shtimin e aksidenteve, gjakmarrjeve dhe abuzimet me mënyrën e jetesës.

➤ *Vdekshmëria foshnjore dhe amtare*

80. *Vdekshmëria foshnjore dhe amtare* në Shqipëri përbëjnë një problem të mprehtë dhe shqetësues për sistemin shëndetësor. Për vitin 2000, vdekshmëria foshnjore ka qënë 21 për 1,000 fëmijë të lindur gjallë, ndërsa vdekshmëria amtare rreth 20 për 100,000 lindje të gjalla. Megjithë një prirje uljeje në vitet e fundit, këta tregues qëndrojnë ende larg atyre mesatare të vendeve të Europës. Brenda vendit, diferencat midis zonave urbane dhe rurale si dhe midis rajoneve veri-lindore dhe atyre qëndrore e jugore janë mjaft të ndjeshme. Në zona të tilla si Tropoja, Hasi, Kukësi, këto shifra shkojnë tepër larg mesatares në shkallë vendi: vdekshmëria foshnjore në vitin 1997 në këto zona arrinte në 28,2 për 1000 lindje,

ndërsa ajo amtare deri 105 vdekje për 100.000 lindje. Në veçanti, më e lartë është përqindja e fëmijëve të vdekur ndërmjet nënave më të reja se 20 vjeç. Shkaqet kryesore të vdekjeve janë hemoragjia pas barrës, eklamsia, infeksionet, etj. Ashtu si dhe për vdekshmërinë amëtare, vdekshmëria foshnjore rritet shumë kur kultura shëndetësore dhe arsimore e nënës është e ulët, kur aksesit ndaj shërbimeve është i dobët, kur trajtimi nga specialistët është jo në nivelin e duhur, etj. Në uljen e vdekshmërisë foshnjore ka ndikuar edhe ulja e nivelit të lindjeve. Planifikimi familjar është lehtësisht i arritshëm për rreth 60 përqind të grave në Shqipëri dhe kufizimet më të mëdha vihen re në zonat fshatare.

➤ **Sëmundshmëria infektive**

81. Bazuar në incidencën dhe prevalencën e sëmundjeve, në tre vendet e para renditen sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes, aparatit gastrointestinal dhe ato infektive. Si pasojë e kushteve social-ekonomike, varfërisë dhe mungesës së infrastrukturës, *sëmundjet infektive* përbëjnë një problem shqetësues, ndaj të cilit shtresat e varfëra janë më të ekspozuara. Megjithatë niveli i sëmundjeve infektive të raportuara duket se po tregon një rënie, mundësia e përhapjes së mëtejshme të disa sëmundjeve ngjithëse si hepatiti me mbi 4400 raste në 1999 dhe tuberkulozi me 721 raste në 1999, nga asnjë rast në fillim të viteve 90⁴, përbën një shqetësim real. Epidemitë e kolerës në 1994 dhe të poliometitit në 1996, treguan se ishte e domosdoshme të aplikoheshin sisteme më të mira të kontrollit dhe parandalimit të sëmundjeve. Përpjekje të konsiderueshme janë bërë nga Ministria e Shëndetësisë për të arritur një mbulim të mirë vaksinal të popullsisë dhe kryesisht të fëmijëve, duke siguruar vaksinat për sëmundjet kryesore dhe kushtet e zinxhirit ftohës në të gjithë vendin. Një kontribut në përmirësimin e situatës në këtë drejtim është dhënë përmes asistencës direkte nga UNICEF dhe OBSH. Përqindja e fëmijëve të imunizuar kundër fruthit është rritur nga 90 në 95 për qind midis viteve 1994 dhe 1997. Mbulesa më e ulët ishte për tuberkulozin, me 87 për qind, dhe më e larta për poliometitin me 97 për qind. Për vitin 1999, përqindja e mbulimit me vaksina varion nga 83 për qind për tuberkulozin në 97 për qind për poliometitin. Si rezultat, në 4 vitet e fundit nuk është shfaqur asnjë rast epidemie poliometiti.

82. Për sëmundjet seksualisht të transmetueshme mendohet se informacioni nuk është i plotë. Një numër i konsiderueshëm të sëmurësh nuk regjistrohen, pra dhe nuk raportohen si të tillë. Sipas të dhënave nga Instituti i Shëndetit Publik, ka patur një incidencë në rritje të sifilisit, ndërsa incidenca e gonoresë është duke u ulur. Ndryshimet në tipin dhe prevalencën e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme kanë ardhur si pasojë e ndryshimit të realitetit në Shqipëri. Moshë relativisht e re e popullsisë, lëvizjet e pakontrolluara të saj, mungesa e një kulture seksuale, rritja e prostitucionit si një fenomen brenda dhe jashtë vendit, mungesa e udhëzimeve të qarta mbi parandalimin, trajtimin dhe raportimin, mungesa e informacionit dhe e edukimit të përshtatshëm veçanërisht mbi grupet e riskuara, janë disa nga shkaqet e shtimit të pakontrolluar të numrit të tyre.

➤ **Kequshqyerja**

83. Duke iu referuar studimit MICS 2000, pothuajse një në 7 fëmijë nën 5 vjeç (14 për qind) në Shqipëri rezulton me nënpeshë të moderuar, ndërsa 4.4 për qind klasifikohen me nënpeshë të theksuar. Pothuajse një në tre fëmijë nën 5 vjeç (31.7 për qind) ka mangësi të vogla në zhvillim, ndërsa 17.3 për qind klasifikohen me mangësi të theksuara në zhvillim.

⁴ Ministria e Shëndetësisë

Një në 9 fëmijë (11.1 për qind) nën 5 vjeç ka mungesa jo të theksuara në ushqim, ndërsa 3.6 për qind klasifikohen me mungesa të theksuara.

84. Egzistojnë diferenca të vogla përsa i përket mungesave në ushqim midis fëmijëve në zonat rurale dhe në ato urbane, sipas të njëjtit burim informacioni. Fëmijët me nëna që kanë arsim të mesëm ose të lartë, kanë shanse më të pakta për të qenë nën peshë dhe të pazhvilluar, sesa fëmijët me nëna me nivel më të ulët arsimor. Numri i fëmijëve që janë nën peshë, të pazhvilluar dhe me mangësi është më i lartë tek djemtë sesa tek vajzat. Analiza e të tre treguesve sipas moshës tregon se fëmijët e moshës 6-11 muajsh kanë mungesa më të mëdha ushqimi sesa fëmijët e tjerë në moshë më të vogël apo më të madhe.

Treguesit arsimorë si dimension i varfërisë

85. Sipas Studimit MICS 2000, rreth 90 për qind e fëmijëve të moshës së shkollës ndjekin arsimin e detyrueshëm. Ndryshimi midis zonave urbane e atyre rurale është me më pak se 1 për qind. Në nivel kombëtar nuk egziston diferencë e ndjeshme ndërmjet pjesëmarrjes së femrave dhe meshkujve në shkollë. Në nivel kombëtar e përfundojnë arsimin fillor 82 për qind e fëmijëve që regjistrohen në klasën e parë. Sidoqoftë, egzistojnë shpërpjestime ndërmjet fëmijëve që jetojnë në zona rurale dhe urbane. Afërsisht 87 për qind e fëmijëve të zonave urbane që regjistrohen në klasën e parë përfundojnë arsimin fillor, në raport me 77 për qind të fëmijëve të zonave rurale. Niveli i regjistrimit në shkollë ka rënë edhe për arsimin parashkollor dhe atë të mesëm. Shifrat konstatojnë ulje të ndjeshme, përkatësisht 37 për qind dhe 36 për qind (në krahasim me vitin 1990).
86. Sipas një studimi⁵, zvogëlimi i nivelit të regjistrimit në shkollë është reflektuar në treguesin e zgjatjes mesatare të shkollimit. Ky tregues në vitin 1989 ishte 11,6 vjet, por deri në vitin 1998 ra në 9,5 vjet, që do të thotë një humbje mesatarisht dy vjet shkollim në një dekadë. Ndërkohë, në numrin e studentëve që ndjekin shkollën e lartë ka rritje, nga 10 në 17 për qind në krahasim me vitin 1990. Zonat peri-urbane kanë një ndjekje të shkollës nën mesataren. Ndonëse të dhënat janë ende fragmentare, pranohet se aksesit dhe cilësia e shkollimit janë problematike në to.
87. Shkaqet e braktisjes së shkollës janë të ndryshme për nivele të ndryshme të arsimit. Në përgjithësi, ato reflektojnë ndryshimet në kërkesën dhe ofertën. Në arsimin parashkollor braktisja lidhet me mbylljen e institucioneve publike. Numri i kopshteve në vitin 2000 u zvogëlua me 42 për qind në krahasim me vitin 1990 (66 për qind në zonën urbane dhe 34 për qind në zonën rurale⁶). Nivelet e larta të papunësisë femërore ndikojnë gjithashtu në reduktimin e kërkesës.
88. Përsa i përket arsimit të detyrueshëm, zvogëlimi i numrit të të regjistruarve ka ardhur kryesisht prej dy faktorëve: 35 për qind e nxënësve që braktisin shkollën, e bëjnë këtë për arsye ekonomike, ndërsa pothuajse një e pesta e tyre e braktisin shkollën për shkak të nivelit të cilësisë së ulët të arsimimit (shih Aneks 2, Tabela 10).

⁵ Palomba dhe Vodopivec, 2000 "Financimi, Efektiviteti dhe Barazia në Arsimin Shqiptar", Banka Botërore, Mars 2000.

⁶ Ministria e Arsimit

89. Numri i shkollave të mesme rezulton i zvogëluar me 55 për qind, si rezultat i mbylljes së një numri të konsiderueshëm të shkollave të formimit profesional. Mbyllja e tyre pati ndikim veçanërisht mbi familjet e varfëra dhe solli zvogëlimin e nivelit arsimor të tyre. Rritja e popullsisë urbane, numri i madh i mësuesve pa arsimin përkatës sidomos në zonat e largëta, si edhe niveli arsimor i prindërve, janë faktorë që çojnë në zvogëlimin e numrit të nxënësve që ndjekin shkollat e mesme.
90. 12-përqind e popullsisë mbi 15 vjeç nuk është në gjendje të shkruajë dhe të lexojë, pra klasifikohet si “analfabete”. Në përgjithësi, niveli i analfabetizmit tek femrat është mjaft më i lartë se tek meshkujt (15.3 kundrejt 9.1 për qind). Egzistojnë shpërpjestime ndërmjet nivelit të analfabetizmit në zonat urbane (7 për qind) dhe ato rurale (19 për qind). Niveli i analfabetizmit rritet me rritjen e moshës: nga 7 për qind ndërmjet personave të moshës 15-34, në 35 për qind ndërmjet popullsisë së moshës mbi 65 vjeç⁷.
91. Shërbimi arsimor publik vuan nga probleme të cilësisë, që lidhen me mungesat në mjetet mësimore, shtimin progresiv të mësuesve pa arsim përkatës, mangësive serioze në rikualifikimin e mësuesve, metodave të vjetëruara apo të ngurtësuara të mësimdhënies, me probleme të përmbajtjes, etj. Cilësia e shkollimit është më e ulët në zonat rurale, zonat e largëta dhe ato peri-urbane.

Shkalla e ekspozimit ndaj riskut

92. Sipas studimit ‘Vlerësim i nevojave dhe kapaciteteve institucionale’ të Bankës Botërore, realizuar në Shkurt 2001, rreth 75 për qind e familjeve të varfëra, përveç problemeve ekonomike (mungesës së të ardhurave) përjetojnë edhe probleme sociale, si divorcin, vdekjen e njërit prej kryefamiliarëve, paaftësinë, problemet e shëndetit apo papunësinë. Shkalla e mundësisë për të rënë në varfëri është më e lartë tek familjet me një prind, familjet me fëmijë të paaftë dhe familjet me të moshuar ose me të sëmurë. Ndërmjet grupeve të rrezikuara dhe varfërisë ekonomike nuk ka një ndarje të prerë. Ato janë të ndërlidhura dhe kushtëzojnë njëri tjetrin. Shpërndarja territoriale është e njëjtë.
93. I njëjti studim, duke matur shkallën e ekspozimit ndaj riskut, identifikon (i) ndër fëmijët e rrezikuar: fëmijë që lypin, fëmijë që punojnë, fëmijë që abandonojnë shkollën, fëmijë në jetimoret publike, fëmijë të ngjuar për shkak të gjakmarrjes; (ii) ndër gratë: gra të dhunuara, gra të divorcuara, gra kryefamiljare dhe gra të trafikuar; (iii) ndër të rinjtë: të rinj të droguar, të rinj të papunë, të rinj të përfshirë në aktivitete kriminale; (iv) ndër të moshuarit: të moshuar të vetmuar/braktisur) dhe (v) ndër të paaftët në përgjithësi: të paaftë fizikë dhe të paaftë mendorë. Shkalla e ekspozimit ndaj riskut është më e lartë në zonat rurale. Kjo pjesë e popullsisë është më e përjashtuar nga e drejta e përfitimit të shërbimeve sociale dhe tërësisht e përjashtuar nga shërbimi i punësimit.

Treguesi i zhvillimit njerëzor dhe përjashtimit social

94. Treguesi i Zhvillimit Njerëzor është sintezë e tri komponenteve bazë të zhvillimit njerëzor: (i) jetëgjatësisë, (ii) nivelit të shkollimit dhe (iii) standartit të jetesës. Sipas

⁷ MICS 2000

llogaritjeve të bëra nga UNDP⁸, treguesi i zhvillimit njerëzor për Shqipërinë në vitin 1999 ishte 0.725, duke e renditur Shqipërinë të 85-tën midis 162 vendeve.

95. Në Shqipëri janë bërë përpjekje për matjen e përjashtimit social, duke u bazuar në treguesit e vdekshmërisë foshnjore, braktisjes së shkollës dhe varfërisë lidhur me të ardhurat. Duke ndërtuar një sistem pikësh dhe duke vlerësuar sipas të dhënave zyrtare nivelin e secilit nga tre treguesit e mësipërm, është përfutur *indeksi i përjashtimit social*, mbi bazën e të cilit është ndërtuar harta e përjashtimit social. Qarqet janë klasifikuar në katër grupe. Grupi me indeks më të lartë shpreh një shkallë më të lartë të përjashtimit social (Shih Aneksi 2, Grafiku 1)

Shpërndarja gjeografike e varfërisë

96. Duke u mbështetur në treguesin e varfërisë shumëdimensionale që rezulton nga Studimi Cilësor i Varfërisë i realizuar në 10 rrethe të vendit në vitin 2001, rezulton se rrethet e vendit mund të klasifikohen në tre grupe: në rrethe të varfëra, të mesme dhe relativisht të pasura. Studimi tregoi se në rrethet më të varfëra bëjnë pjesë Kukësi, Laçi dhe Gramshi. Në secilin nga këto rrethe ka më shumë familje të varfëra, sepse në to ka më pak burime punësimi dhe të ardhurash. Shumica e familjeve në këto rrethe bazohen vetëm në një burim të ardhurash. Kurse të ardhurat nga emigracioni, si pasojë e intensitetit më të ulët të tij, janë më të ulta se në rrethet e tjera. Në grupin e dytë bëjnë pjesë rrethet Vlorë, Mallakastër, Tiranë, Shkodër dhe Mirditë, ku burimet kryesore të punësimin dhe të të ardhurave në këto rrethe janë më të shumta dhe shumë familje bazohen në një ose dy burime të ardhurash. Tirana, e cila bën pjesë në këtë grup, është një rreth i veçantë për një varg arsyesh, duke përfshirë këtu faktin se është kryeqytet i vendit, ka aftësinë për të joshur më shumë investimet e huaja dhe njihet si epiqendër e migracionit. Këto karakteristika e bëjnë këtë rreth shumë më heterogjen nga pikëpamja ekonomike e sociale në krahasim me rrethet e tjera. Ndërsa në grupin e tretë bëjnë pjesë rrethet që kanë më pak familje të varfëra dhe shumë të varfëra, si Korça dhe Saranda. Këto rrethe kanë një ekonomi më të diversifikuar, kanë tre ose katër burime punësimi dhe të ardhurash për familje, ndërsa të ardhurat nga emigracioni janë më të larta.
97. Edhe Studimi i Nivelit të Jetesës konfirmon të njëjtat rezultate, gjë që tregon se prej vitit 1998 deri sot shpërndarja gjeografike e varfërisë ka ndryshuar pak. Duke përdorur treguesit e varfërisë ekonomike, konfirmohet se prefekturat e Kukësit, Dibër dhe Elbasanit janë më të varfërat në Shqipëri, ndërsa ato të Vlorës, Beratit dhe Fierit renditen në zonat me mirëqenie më të lartë (megjithëse edhe këto kanë nivele të larta të varfërisë urbane). Varfëria është kryesisht një fenomen rural, e shoqëruar me mungesë të theksuar të shanseve për zhvillim dhe akses të ulët ndaj infrastrukturës, sikurse është më karakteristike në zonat rurale malore (shih Aneks 2, Tabela 11).
98. Mbështetur në të dhënat mbi të ardhurat apo konsumin, është e vështirë të realizohet një analizë më e detajuar e shpërndarjes gjeografike të varfërisë. Megjithatë, duke marrë në konsideratë informacionin mbi shpërndarjen e ndihmës ekonomike, rezulton se brenda prefekturave të sipërpërmendura, varfëria është më e theksuar në rrethet: Kukës, Bulqizë, Dibër, Librazhd, Pukë dhe Gramsh.

⁸ UNDP, "Human Development Report, 2001".

Tabela 1: Krahasim i disa treguesve përfaqësues në nivel rajoni

Shtetet	Vdekshmëria foshnjore	Vdekshmëria deri 5 vjec	Regjistrimi arsimit fillor	Regjistrimi arsimit mesëm	Koeficienti Gini
Shqipëri	30	37	96	35	0.43
Armeni	25	30		87	0.59
Bullgari	14	17	92	76	0.41
Gjeorgji	19	23	83	73	0.43
Kyrgystan	56	66	97	78	0.47
Moldavi	28	35		80	0.42
Rusi	21	25	99.5	87	0.47

Vlerësime

99. Analiza e varfërisë, përcaktimi dhe profili të prezantuar në këtë kapitull janë të bazuara në; Studimi i Kushteve të Jetesës (LCS), Studimi i Treguesve të Shumfishtë të Grupuar (*Multiple Indicators Cluster Survey (MICS)*), Vlerësimi Cilësor i Varfërisë (2001), informacion administrativ dhe në studime të tjera. Kjo analizë është ndër analizat më të thelluara dhe më të mira, që mund të jenë realizuar, duke paraqitur të dhëna dhe informacione të vlefshme. Analiza reflekton në shumë aspekte të saj situatën aktuale në mënyrë të arsyeshme dhe të saktë. Megjithkëtë, mungesa e një vëzhgimi përfaqësues kombëtar të rregullt, kufizon aftësinë e Qeverisë për zhvillimin dhe drejtimin e ndryshimit të treguesve të varfërisë dhe prirjen e tyre në faktorin kohë, në shtrirje me të dhënat administrative dhe analizat. Për këtë arsye, Qeveria Shqiptare ka krijuar një plan të plotë dhe agresiv për fuqizimin e politikave të monitorimit dhe zhvillimit, duke përfshirë edhe përfundimin e regjistrimit kombëtar brenda 2001 që i hap rrugën një programi 5 vjeçar për vëzhgimin e të ardhurave që do të mbështetet nga DFID–UK dhe Banka Botërore, dhe gjithashtu inisiativa të tjera për rritjen e kapaciteteve në krijimin e hartave treguese të të dhënave, mbledhjen e të dhënave administrative dhe analizave, si dhe monitorimin cilësor të varfërisë. Këto inisiativa përfshijnë reforma institucionale të tilla si krijimi i një njësie të re kombëtare për monitorimin në Ministrinë e Financave (programi paraqitet i detajuar në kapitullin V, Implementimi, Monitorimi dhe Zbatimi i Strategjisë).

III.B VLERËSIMI I POLITIKAVE TË KALUARA

III.B.1 REFORMAT E TRANZICIONIT DHE STANDARTI I JETESËS

100. Si një dukuri shumëdimensionale, varfëria është produkt i ndikimit të shumë faktorëve. Rrënjët e varfërisë së sotme në Shqipëri shtrihen thellë në sistemin ekonomik që lamë pas, por ato janë ushqyer edhe nga zhvillime që kanë shoqëruar tranzicionin drejt ekonomisë së tregut. Reformat e tranzicionit kanë synuar në krijimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe rritjen e standartit të jetesës; përvoja dhjetëvjeçare e tranzicionit shqiptar provon se prona private dhe mekanizmi i tregut nxisin sipërmarrjen e lirë të njerëzve dhe krijojnë kushte për një përdorim efektiv dhe eficient të burimeve prodhuese. Megjithatë, gjatë procesit të realizimit reformat e tranzicionit janë shoqëruar, sidomos në fillimet e tyre, edhe me keqësimin e disa treguesve të nivelit të jetesës për shtresa të caktuara të popullsisë dhe zona të caktuara të vendit. Reformat strukturore u paraprinë nga liberalizimi i çmimeve, që goditi ndjeshëm fuqinë blerëse të popullsisë, sidomos gjatë viteve të para të tranzicionit, megjithë masat kompensuese të marra nga qeveria. Privatizimi dhe proceset ristrukturose, megjithë ndikimet pozitive ekonomike, u shoqëruan me efekte të ndjeshme në rritjen e papunësisë ndërsa shanset e pabarabarta të pjesëmarrjes kanë ndikuar në krijimin dhe rritjen e diferencimeve shoqërore. Nga ana tjetër, hapja e vendit ndaj tregut dhe kulturës botërore kanë shkaktuar një rritje shpërthyesë të nevojave të njerëzve, të mësuar në të kaluarën të "kënaqeshin me pak". Nevojat e shumëfishuara kanë shumëfishuar edhe aktivitetin ekonomik të shumë njerëzve, pra dhe mirëqënien e tyre. Por, nga mjaft njerëz të tjerë, të përballur me oportunitete të kufizuara, rritja e nevojave është përjetuar thjesht si rritje e varfërisë.

101. Tranzicioni shqiptar ka provuar se kryerja e reformave strukturore dhe institucionalizimi i tregjeve janë një proces i vështirë dhe që kërkon kohë. Edhe në masën që janë të suksesshme, megjithë oportunitetet e gjera që ofrojnë, ato shpesh shoqërohen me kosto, sidomos për grupet më të prekshme të shoqërisë. Megjithatë, këto kosto kanë ardhur jo aq si pasojat e natyrshme të vetë reformave sesa nga zbatimi ndonjëherë i shtrembëruar, nga inkoherenca, vonesat, kundërthëniet, mungesa e programeve të qarta. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar ekonomia shqiptare iu nënshtrua disa herë goditjeve të brendshme dhe të jashtme. Pastabiliteti politik i viteve të para të tranzicionit pati si kosto ekonomike dëmtimin serioz të aftësive prodhuese dhe të infrastrukturës si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale. Dëmtimi i aftësive prodhuese kompromentoi edhe procesin e privatizimit, duke e vështirësuar dhe duke e bërë atë joefektiv në jo pak raste. Niveli i jetesës u godit rëndë dhe varfëria arriti përmasa kritike. Rol shpëtimtar për vitet e para të tranzicionit luajtën ndihmat humanitare ndërkombëtare. Proceset stabilizuese, rimëkëmbja ekonomike dhe avancimi i reformave të filluara në vitet 1993-1994 u ndërpre në mënyrë të shpejtë pa kaluar shumë kohë. Lulëzimi i skemave piramidale veçanërisht gjatë vitit 1996 dhe trazirat politike, paraliza ekonomike e tronditjet sociale që pasuan shëmbjen e tyre në vitin 1997, i dhanë një goditje tjetër standartit të jetesës së njerëzve. Edhe viti 1998 nuk shpëtoi pa trazira politike. Ndërkaq, pastabilitetet dhe luftrat e zhvilluara në rajon gjatë gjithë kësaj periudhe kanë pasur ndikime të rëndësishme negative në ekonominë shqiptare. Përveç ndikimeve të drejtpërdrejta, pasiguria që ka zotëruar në rajon është ndjerë sidomos në nivelin e ulët të thithjes së investimeve të huaja.

102. Megjithë kostot, vështirësitë dhe problemet që kanë shoqëruar reformat e tranzicionit, thellimin e tyre qeveria e ka konsideruar si të vetmen alternativë për krijimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe për uljen e treguesve të varfërisë. Në kuadrin e reformave të tranzicionit, qeveria u ka kushtuar vëmendje të veçantë reformave strukturore, posaçërisht (i) privatizimit të ekonomisë, (ii) reformimit të institucioneve të sektorit publik dhe (iii) institucionalizimit të tregut.
103. Relativisht të suksesshëm kanë qenë privatizimi i apartamenteve të banimit dhe i njësisve tregtare. Privatizimi i tokës bujqësore (megjithëse ende ka probleme të pazgjidhura, sidomos në disa rajone të vendit) e nxori bujqësinë nga kolapsi i fillimit të tranzicionit dhe çeli rrugën për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e këtij sektori. Politikat dhe procedurat e ndjekura për privatizimin e ndërmarrjeve apo objekteve të tjera shtetërore provojnë se jo gjithmonë janë mbajtur parasysh dhe janë balancuar si duhet kriteret e efikasitetit, drejtësisë dhe shpejtësisë. Cënimi i tyre është shoqëruar me kosto sidomos për shtresat më të varfëra. Veçanërisht jo efektiv rezultoi privatizimi masiv. Viti 2000 shënoi përfundimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ecuri pozitive ka pasur privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha gjatë dy viteve të fundit. Privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare, i AMC, i fabrikave të çimentos në Elbasan dhe Fushë-Krujë, etj., shënuan një përvojë pozitive që do të shërbejë për thellimin e këtij procesi në të ardhmen. Edhe fillimi i përdorimit të kontratave konçensionale si forma pararendëse të privatizimit, i ka dhënë frymëmarrje më të gjerë këtij procesi.
104. Brishtësia e tranzicionit shqiptar është, ndër të tjera, edhe rezultat i dobësisë dhe brishtësisë institucionale. Administrata dhe institucionet e tjera shtetërore, legjislacioni dhe sistemi dhënies së drejtësisë, janë dëshmuar shpesh, sikurse e treguan ngjarjet e vitit 1997, të dobëta për të përballuar detyrat e vështira të tranzicionit. Qeveria është angazhuar në reformimin e legjislacionit, duke synuar që ai t'u përgjigjet dhe t'u hapë rrugë nevojave të zhvillimit. Qeveria ka qenë gjithashtu e angazhuar në reformimin e administratës publike, me synim për të rritur efektivitetin, efikasitetin, transparencën dhe për ta afruar atë me publikun. Ligji i Shërbimit Civil është një bazë e shëndoshë për reformimin e administratës civile. Mbyllja ligjore dhe me masat përkatëse e shtigjeve për abuzim me pushtetin dhe lufta kundër korrupsionit ka qenë një nga preokupimet e rëndësishme të qeverisë. Gjatë dy viteve të fundit është rritur ndjeshëm edhe siguria në vend, krahasuar me vitet 1997 dhe 1998. Pas zgjedhjeve për qeverisjen lokale të vitit 2000, hapa të konsiderueshëm janë bërë edhe në drejtim të zgjerimit të autonomisë së qeverisjes vendore. Jetësimi i autonomisë së qeverisjes vendore është konsideruar nga qeveria si një mjet për t'u dhënë më shumë zë shtresave të varfëra në procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, në të gjitha drejtimet e mësipërme hapat kanë qenë relativisht të ngadalshëm dhe problemet për t'u zgjidhur janë të shumta. (1) Dobësia e administratës publike, përfshirë: dobësitë strukturore dhe të bashkërendimit institucional, centralizimi i tepruar, kapacitetet ende të ulëta menaxhuese (programuese, monitoruese e kontrolluese), transparenca e ulët, motivimi relativisht i ulët i punonjësve të administratës; (2) dobësitë në sistemin gjyqësor (3) prania e një niveli të lartë korrupsioni, janë disa prej këtyre problemeve.
105. Vështirësitë e tranzicionit kanë goditur ndjeshëm edhe strukturat e kapitalit social, duke dobësuar edhe rolin e tyre si faktorë zhvillimi dhe si institucione mbështetëse për

shtresat e varfëra. U dëmtuan hallkat lidhëse midis interesave personale e familjare dhe interesave komunitare. Dëmtimet e infrastrukturës, dëmtimet e mjediseve urbane, të furnizimit me ujë dhe energji elektrike, etj, më shumë sesa me shkallën e lartë të amortizimit të tyre, shpjegohen me konceptime tepër të ngushta, anarkike të interesave personale dhe me paralizimin e strukturave të kultivuara sociale, ashtu sikurse janë edhe shprehje e dobësisë së institucioneve publike. Të njëjtin shpjegim kanë edhe lulëzimi i ndërtimeve të paautorizuara dhe përhapja e shfrenuar e kioskave në mjediset komunitare. Megjithatë, strukturat ende të padëmtuara apo më pak të dëmtuara të kapitalit social, që në çdo rast janë struktura që natyrisht ndodhen më afër individit, sikurse është familja, kanë vazhduar të luajnë një rol amortizues gjatë tranzicionit. Shembull i këtij roli janë dërgesat e emigrantëve.

106. Strukturat e tregut, megjithë hapat pozitivë të kryer, vuajnë nga mungesa të theksuara institucionale. Ende ka probleme ligjore dhe institucionale lidhur me qartësimin dhe respektimin e të drejtave të pronësisë. Janë ende të dobëta strukturat ligjore dhe administrative që ruajnë dhe nxisin natyrën konkurruese të tregjeve. Në një masë të madhe marrëdhëniet e biznesit realizohen jashtë kontratave të formalizuara, duke u dhënë shkas jo rrallë konflikteve që marrin forma të ashpra dhe që "zgjidhen" me mjete të ashpra joligjore. Ende nuk është bërë rregullimi i plotë juridik dhe administrativ i procedurave të falimentimit të biznesit. Ka prapambetje në institucionalizimin e tregut financiar, ndërsa disa struktura institucionale të tregut të punës janë provuar joefektive, të paktën jo në masën e duhur. Prapambetja dhe dobësitë e sistemit të pagesave rritin shumë kostot e transaksionit për bizneset. Me gjithë ekzistencën e ligjit përkatës, mbrojtja e konsumatorit është ende e dobët. Përgjithësisht, tregu vuan nga mungesa institucionesh e nga ngurtësime që vështirësojnë kryerjen e funksioneve të tij dhe funksionimin e ekonomisë në tërësi. Dobësitë e tregut formal i kanë çelur rrugën tregut informal. Lulëzimi i skemave piramidale në vitet 1995-1996 është një shembull domethënës. Informaliteti i lartë ekonomik, me gjithë pasojat e tij negative, është tregues i nevojës për treg dhe i nevojës për institucionalizimin e tij.

III.B.2 POLITIKA MË TË DREJTPËRDREJTA PËR REDUKTIMIN E VARFËRISË

107. Duke e konsideruar vazhdimin e reformave të tranzicionit të panjaftueshëm në vetvete për t'iu adresuar problemeve të varfërisë, qeveria u është drejtuar edhe faktorëve që kanë efekte më të drejtpërdrejta në standartin e jetesës. (i) Stabilizimi makroekonomik, (ii) zbatimi i politikave të përshtatshme për shpërndarjen dhe rishpërndarjen e të ardhurave, me efekte zbutëse ndaj varfërisë, kanë qenë dy nga drejtimit kryesore të vëmendjes së qeverisë gjatë gjithë periudhës. Jo jashtë vëmendjes kanë qenë edhe (iii) nxitja e rritjes ekonomike dhe (iv) zhvillimi i sektorëve që kontribuojnë drejtpërdrejt në standartin e jetesës.

Stabilizimi makroekonomik

108. Rivendosi dhe ruajtja e stabilitetit makroekonomik, i konceptuar para së gjithash si stabilitet çmimesh, ka qenë një prioritet qëndror për qeverinë. Stabilizimi makroekonomik është konsideruar nga qeveria si kusht për të siguruar ecjen përpara të reformave ekonomike dhe për të bërë efektive politikat për reduktimin e varfërisë. Në vetvete, stabilizimi makroekonomik kontribuon drejtpërdrejt në mbrojtjen e nivelit të jetesës,

sidomos të shtresave të varfra të popullsisë. Tranzicioni, sikurse provon përvoja shqiptare, shoqërohet me presione destabilizuese. Pjesërisht presionet destabilizuese u trashëguan nga sistemi i kaluar. Rritja shumë e lartë e çmimeve pas reformave liberalizuese në fillimet e tranzicionit janë shprehje e këtyre presioneve. Pjesërisht ato janë produkt i pashmangshëm, i përkohshëm, i reformave strukturore. Por, në një pjesë të madhe presionet destabilizuese në ekonominë shqiptare kanë ardhur nga goditjet e brendshme të sistemit. Periudhat 1991-1992 dhe 1997 dëshmojnë për efektet inflacioniste të këtyre goditjeve. Inflacioni arriti 104 për qind në vitin 1991 dhe 236.6 për qind në vitin 1992. Për vitin 1997 shifra e inflacionit ishte 42.1 për qind. Me rivendosjen e stabilitetit politik të vendit, shifrat e inflacionit u ulën përsëri. Në fund të vitit 2000 norma e inflacionit ishte vetëm 4.2 për qind, duke arritur një mesatare vjetore prej pothuajse 0 për qind.

109. Synimi i stabilizimit makroekonomik ka karakterizuar sidomos politikat fiskale dhe ato monetare. Me anë të politikës fiskale është synuar në rritjen e nivelit të të ardhurave dhe shpenzimeve publike në funksion të realizimit të synimeve rishpërndarëse dhe alokative të qeverisë, por vëmendja është përqëndruar në mbajtjen nën kontroll të nivelit të defiçitit fiskal. Ecuria e defiçitit fiskal mund të ndahet në tre periudha. Në periudhën e parë (1992-1995) defiçiti fiskal ra nga 44 për qind, në 10 për qind e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Në periudhën e dytë (1996-1997) defiçiti fiskal rritet përsëri, duke kapur nivelin e 13 për qind të PBB. Kjo rritje ishte pasojë e situatave zgjedhore të vitit 1996 dhe e krizës paspiramidale të vitit 1997. Në përmirësimin e situatës fiskale në fund të vitit 1997 ndikuan sidomos përmirësimet në administrimin e tatimeve dhe të doganave. Ndikim pati edhe rritja e TVSH-së nga 12.5 për qind në 20 për qind. Në periudhën e tretë (1998 e në vazhdim) vazhdon prirja e rënies së defiçitit fiskal. Në vitin 2000 defiçiti fiskal ishte 9.1 për qind. Viti 2000 u karakterizua sidomos nga një rritje e konsiderueshme e të ardhurave tatimore.
110. Defiçiti fiskal është përballuar nga financimet e brendshme (emetim i bonove të thesarit, kredi të Bankës së Shqipërisë dhe të ardhura nga privatizimi) dhe financimet e huaja (kryesisht në formën e granteve dhe të huamarrjes koncensionare). Për vitin 2000 niveli i tyre ka qenë përkatësisht 5 dhe 4.1 për qind e PBB.
111. Arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve i është nënshtruar edhe politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë. Si objektiv të drejtpërdrejtë të saj Banka e Shqipërisë ka pasur mbajtjen nën kontroll të ofertës monetare. Në funksion të këtij objektivi, deri në vitin 2000 Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumente të drejtpërdrejtë. Ndër ta, më të rëndësishmit kanë qenë përcaktimi i nivelit minimal të normave të interesit për depozitat në lekë të vendosura në bankat e nivelit të dytë me kapital shtetëror; vendosja e kufijve të sipërm për kredinë e re nga bankat e nivelit të dytë dhe vendosja e kufijve sasiorë në anën e aktiveve të bilanceve bankare. Efektiviteti i këtyre politikave përgjithësisht ka qenë modest. Përdorimi i tyre ka qenë jorezultativ veçanërisht gjatë periudhës së lulëzimit dhe shembjes së skemave piramidale.
112. Në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2000 Banka e Shqipërisë filloi të kontrollojë ofertën e parasë nëpërmjet zbatimit të instrumenteve të tërthortë, sikurse janë ankandet e riblerjes (repo). Nëpërmjet tyre synohet të përcillet në tregun bankar politika e Bankës së Shqipërisë në lidhje me normat e interesit. Që nga fillimi i zbatimit të këtij instrumenti (korrik 2000), normat e interesit janë ulur në mënyrë të vazhdueshme nga 9 për qind, në

6.5 për qind në fund të vitit 2000. Megjithatë, matja e efektivitetit të këtij instrumenti kërkon ende kohë. Përgjithësisht, mungesa e një tregu të zhvilluar, fleksibël dhe konkurrencial bankar, egzistenca e një tregu primar bonosh thesari shumë të përqëndruar dhe e një tregu kredish ku huazohet në një masë të madhe në monedhë të huaj, e vështirësojnë shumë transmetimin e vendimeve të politikës monetare në ekonomi.

Politikat e shpërndarjes dhe rishpërndarjes së të ardhurave dhe standarti i jetesës

113. Zbatimi i politikave të përshtatshme për shpërndarjen e të ardhurave, me efekte zbutëse ndaj varfërisë ka qenë një nga preokupimet e qeverisë gjatë gjithë periudhës 10-vjeçare të tranzicionit. (i) Reformimi dhe rritja e herëpashërshme e pagave në sektorin publik, (ii) reformimi i sistemit të sigurimeve shoqërore, (iii) pagesat për papunësinë, (iv) ndihma ekonomike dhe (v) përkujdesi social, kanë qenë disa nga komponentët kryesorë të këtyre politikave. Në përcaktimin e skemave për pagesat e papunësisë, ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social, qeveria ka mbajtur parasysh mundësitë buxhetore dhe karakterin përgjithësisht pasiv të tyre.
114. Qeveria vlerëson se rëndësia e politikës së pagave në sektorin publik e tejkalon peshën e këtij sektori në punëzënie totale, përderisa niveli i pagave në këtë sektor shërben në një farë mënyre si sistem reference edhe për sektorin privat. Gjatë viteve të para të tranzicionit pagat e një pjese të mirë të punonjësve, ndërmarrjet e të cilëve nuk funksiononin, ishin praktikisht një formë e mbështetjes sociale. Pagat në sektorin publik u janë nënshtruar rritjeve të herëpashërshme, para së gjithash për t'iu kundërvënë efekteve inflacioniste dhe për të siguruar një shpërblim më të drejtë të punonjësve të këtij sektori. Për periudhën 1993-2000, ritmet e rritjes së pagës nominale kanë qenë mesatarisht më të larta sesa ritmet e rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Ulja e pagës reale deri në vitin 1993, pasohet nga një rritje e saj në vitet 1994, 1995 dhe 1996. Viti 1997 shënon një rënie të konsiderueshme, e pasuar nga një rënie e lehtë në vitin 1998. Prirja e rritjes rikthehet në vitet 1999 dhe 2000. Në vitin 2000 nivelet mesatare dhe minimale të pagave ishin përkatësisht 14,963 lekë/muaj dhe 7,000 lekë/muaj (*INSTAT*). Pagat janë veçanërisht të ulëta në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë.
115. Reformimi i sigurimeve shoqërore ka qenë një nga preokupimet e qeverisë. Nëpërmjet këtij sistemi trajtohen rreth 1/6 e popullsisë së vendit. Krahas sigurimeve të detyrueshme shoqërore, është krijuar skema e sigurimit vullnetar dhe ajo e sigurimit suplementar. I është hapur rruga krijimit të institucioneve private të sigurimeve shoqërore. Megjithatë, sistemi i sigurimeve shoqërore vuan nga një sërë problemesh. Me gjithë nivelin mjaft të ulët të pensioneve (pavarësisht nga rritjet e herëpashërshme), sistemi i sigurimeve shoqërore subvencionohet në një masë të konsiderueshme nga buxheti i shtetit, që në vitin 2000 arrinte në 1,9 për qind të PBB. Numri i pensionistëve është më i madh se numri i kontribuesve. Përqindja e kontribuesve nga sektori privat dhe veçanërisht nga zonat rurale është shumë e ulët. Për këtë arsye pensionet në këto zona marrin më shumë pamjen e ndihmës sociale. Tarifa e kontributit për sigurimet shoqërore konsiderohet e lartë.
116. Programi i pagesës për papunësinë ka synuar në zbutjen e pasojave ekonomike e sociale të papunësisë. Nëpërmjet këtij programi janë trajtuar rreth 22 mijë persona në fund të vitit 2000. Përfitimi maksimal është në kuotën 5,230 lekë/muaj, me kohëzgjatje deri në

1 vit. Vlerësohet se kontributi i tij ka qenë tepër modest dhe se programi ka vuajtur nga ineffiçenca dhe u ka lënë shteg abuzimeve.

117. Programi i ndihmës ekonomike i financuar nga buxheti i shtetit ka synuar në dhënien e ndihmës në formë monetare familjeve pa të ardhura apo me të ardhura të ulta. Aktualisht, në kuadrin e këtij programi trajtohen 150,114 familje. Niveli i ndihmës ekonomike ndryshon në varësi nga kushtet e familjes që trajtohet me ndihmë, por në çdo rast nuk kalon 250 për qind të pagesës për papunësinë. Në krahasim me vitin 1993, në vitin 2000 numri i familjeve përftuese është zvogëluar me 2 për qind, ndërkohë që buxheti vjetor i ndihmës ekonomike është rritur 2.6 herë. Raporti i ndihmës ekonomike ndaj PBB më 1999 ishte 0.9 për qind, kundrejt 2,6 për qind që ishte në vitin 1994. Zona veri-lindore ka përqindjen më të lartë të familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike (20-40 për qind e popullsisë). Programi i ndihmës ekonomike vuan nga mosmbajtja parasysh e situatave specifike të familjeve të varfëra, nga një shpërndarje jo e balancuar rajonale, nga karakteri thjesht pasiv i saj, nga një shkallë e ulët monitorimi, etj.
118. Programi i përkujdesit shoqëror ka synuar në mbështetjen dhe integrimin e individëve të paaftë, në mbrojtjen e fëmijëve jetimë dhe të moshuarve të vetmuar. Numri i personave që kanë përftuar nga ky program në vitin 2000 ka qenë 2,6 herë më i lartë sesa në vitin 1994. Megjithatë, programi nuk arrin të mbulojë të gjithë kategoritë e personave që kanë nevojë për shërbimet që ofron ai dhe rrjeti i institucioneve përkatëse nuk arrin të mbulojë të gjitha zonat e vendit. Ofrohen vetëm shërbime rezidenciale nacionale dhe me spektër të ngushtë, duke mos arritur të realizojnë integrim social të këtyre shtresave. Edhe cilësia e shërbimeve të ofruara nuk është në standartet e kërkuara.

Rritja ekonomike dhe standarti i jetesës

119. Rritja ekonomike ka qenë një nga preokupimet e qeverisë. Përveç rritjes së punësimit dhe të të ardhurave personale, rritja ekonomike rrit mundësitë për ndërmarrjen e politikave më të drejtpërdrejta për reduktimin e varfërisë. Pas dy vitesh paralize, viti 1993 shënoi fillimin e rimëkëmbjes ekonomike me një rritje prej 10 për qind në krahasim me vitin paraardhës, e cila vazhdoi edhe në vitet 1994, 1995 dhe 1996, me ritme rritjeje përkatësisht 8.3 për qind, 13.3 për qind dhe 9.1 për qind. Këto ritme rritjeje i detyrohen kryesisht rimëkëmbjes ekstensive të bujqësisë pas privatizimit të tokës, efekteve pozitive të privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe zbatimit të politikave liberalizuese tregtare. Viti 1997, për shkak të krizës paspiramidale, shënoi një rënie të PBB me 7 për qind. Qeveria vlerëson se jo vetëm kriza paspiramidale, por edhe vetë dukuria e skemave piramidale ka pasur ndikime të konsiderueshme negative në rritjen afatgjatë. U shpërdoruan masa të mëdha të kursimeve të popullatës, veçanërisht të emigrantëve. U krijua një përfytyrim i shtrembëruar mbi ekonominë e tregut dhe rrugët që ajo ofron për rritjen e mirëqënies së njerëzve. U kultivuan qëndrime negative, parazitare ndaj punës dhe aktivitetit ekonomik përgjithësisht. Vitet 1998-2000 u karakterizuan nga një rritje e shpejtë dhe e qëndrueshme ekonomike, në nivelet 7-8 për qind. Megjithatë, po t'i referohemi periudhës së tranzicionit në tërësi, rritja ekonomike mund të karakterizohet si e paqëndrueshme.
120. Rimëkëmbja dhe rritja ekonomike janë mbështetur në mobilizimin ekstensiv të faktorëve bazë të prodhimit: forcës punëtore, kapitalit dhe tokës. Megjithatë, edhe nivelet

e sotme të përdorimit të këtyre faktorëve flasin për mundësi ende të gjera ekstensive të rritjes. Ende një pjesë e tokës bujqësore dhe burimeve të tjera natyrore kanë mbetur jashtë përdorimit ekonomik. Emigracioni dhe migrimi i brendshëm i popullsisë, prania ende e paqartësive të së drejtës pronësore mbi tokën, mosshndërrimi ende faktik i tokës në objekt tregu, janë disa nga faktorët që kanë ndikuar më shumë në këtë drejtim.

121. Rritje të konsiderueshme kanë patur investimet private dhe publike. Gjatë periudhës 1993-2000, investimet në ekonomi përbënin mesatarisht 17.6 për qind të PBB-së. Rol qendror kanë luajtur investimet private, me 11 për qind të PBB. Investimet publike kanë zënë vetëm 6.6 për qind. Ndërsa investimet publike kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve të ofrimit të shërbimeve publike dhe në përmirësimin e infrastrukturës fizike, investimet private janë orientuar në sektorët e tjerë të ekonomisë. Investimet në teknologji të reja janë reflektuar në një peshë në rritje të importeve të makinerive e pajisjeve, të cilat në fund të vitit 2000 zinin rreth 26 për qind të totalit të importeve. Rritja e investimeve ka qenë më e lartë në degë të tilla, si transport, telekomunikacione, shërbime dhe ndërtim, duke tejkaluar rritjen e aktivitetit ekonomik në këto degë. Këto degë kanë patur edhe një vlerë të shtuar më të lartë në raport me sektorët e tjerë⁹. Megjithatë, parë në tërësi, norma e investimeve në raport me PBB ka qenë në nivele modeste dhe raporti shumë i ulët kredi/depozita (9.4 për qind për vitin 1999) në sistemin tonë bankar flet për mundësi të pashfrytëzuara investimesh, që për shkaqe sigurie dhe institucionale nuk arrijnë të realizohen. Për mundësi të pashfrytëzuara flet edhe volatiliteti relativisht i lartë i investimeve të huaja.

122. Statistikat zyrtare të japin pak mundësi për analizën e dinamikës së treguesve të punësimit. Sidoqoftë, në strukturën e punësimit predominon bujqësia me më shumë se gjysmën e numrit total të të punësuarve. Krahas me zgjerimin e sektorit privat jobujqësor të ekonomisë, është rritur edhe punësimi në këtë sektor duke arritur nga 60.000 të punësuar në vitin 1992, në 116.000 në vitin 2000. Përfshirë edhe të punësuarit në bujqësi, pesha e sektorit privat në punëzënien totale për vitin 2000 ishte 82 për qind. Në vitet e para të tranzicionit papunësia arriti shifra tepër të larta. Në vitin 1992 papunësia, sipas statistikave zyrtare, arriti në 26.5 për qind. Por edhe një pjesë e të konsideruarve të punësuar realisht nuk ishin të tillë. Më pas, me fillimin e riaktivizimit të ekonomisë, papunësia filloi të ulet. Nivelin më të ulët papunësia e arriti në vitin 1996, me 12.4 për qind. Duke filluar nga viti 1997, norma e papunësisë ka ardhur në rritje deri në vitin 1999 (nga 14.9 për qind, në 18 për qind), ndërsa për vitin 2000 u ul në 16.8 për qind (*INSTAT*). Megjithë prirjen për ulje, ende shifra e papunësisë është shumë e lartë. Në qoftë se kësaj shifre do t'i shtohet edhe papunësia e "fshehtë", sidomos në zonat rurale dhe ajo e "dekurajuar", atëherë shkalla e mospërdorimit të burimeve të punës do të dilte edhe më e lartë¹⁰. Programi i nxitjes së punësimit dhe programi i formimit profesional vlerësohet se kanë pasur efekte pak të ndjeshme në tregun e punës. Një nga arsyet është dhe mosmbajtja parasysh e kërkesave të tregut të punës. Rol të rëndësishëm amortizues në tregun e punës ka luajtur emigracioni. Vlerësohet se në vitin 2000 numri i emigrantëve zinte rreth 1/4¹¹ e popullsisë.

⁹ INSTAT, Rezultate të anketës strukturore, 1999

¹⁰ Megjithatë, duhet mbajtur parasysh ndikimi i kundërt në nivelet reale të papunësisë i punësimit informal.

¹¹ PNUD, "Raporti i zhvillimit të burimeve njerëzore në Shqipëri 2000"

123. Shqipëria trashëgoi një alokim joefiçent burimesh, teknologji shumë të prapambetur dhe produktivitet të ulët të punës. Në të kaluarën, burime të mëdha ekonomike përdorshin në industrinë e rëndë, objektivi i së cilës ishte "të garantonte mbështetjen në forcat e veta" pavarësisht nga kostoja. Bëheshin përpjekje që problemet e nënzhvillimit të kapërceheshin duke e detyruar pjesën më të madhe të popullsisë të qëndronte në fshat, duke kushtëzuar edhe këtu një produktivitet shumë të ulët. Në masën e përparimit të reformave strukturore dhe të rritjes së rolit alokues të tregut, tranzicioni po shoqërohet edhe me rialokimin e burimeve prodhuese. Industria po i nënshtrohet një procesi rrënjësor rialokues nëpërmjet iniciativave investuese të biznesmenëve privatë, ndërkohë që reformat strukturore "nga lart" në këtë sektor kanë ecur mjaft ngadalë. Ndërsa është ulur në mënyrë drastike pesha e industrisë, ritme të larta rritjeje kanë pasur ndërtimi, transporti, shërbimet. Në këto degë po vërehen edhe përpjekje për zbatimin e teknologjive të përparuara.
124. Ekonomia shqiptare ende vuan nga përdorimi i një teknologjie të prapambetur, sidomos në bujqësi. Pengesa serioze për bujqësinë janë problemet institucionale të tokës, ngushtësia e mundësive të kreditimit, infrastruktura e dobët dhe mungesa e aksesit në treg. Pjesërisht të ardhurat nga emigracioni janë përdorur edhe për investime në bujqësi. Por, pjesërisht të ardhurat relativisht të larta nga emigracioni kanë zhvlerësuar aktivitetet bujqësore, sidomos në disa zona të vendit. Megjithëse jo shpesh, emigracioni i përkohshëm stinor sidomos në zonat më afër vendeve të destinacionit dhe sidomos ndër të rinjtë, komplementohet me periudha "parazitizmi" në shtëpi, gjatë të cilave thjesht harxhohen për konsum të ardhurat e fituara në emigracion. Për shkak të emigracionit të përkohshëm apo migrimit të brendshëm të pjesshëm të familjeve fshatare, në disa zona aktivitetet bujqësore kanë mbetur "përgjegjësi" e të moshuarve, grave dhe fëmijëve të shkollës.
125. Qeveria vlerëson se megjithë tronditjet e përsëritura që ka pësuar sistemi ekonomik në Shqipëri, reformat strukturore, veçanërisht privatizimi i ekonomisë, kanë pasur efekt qëndror në rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike. Rritja ka ardhur kryesisht nga sektori privat. (Sipas vlerësimeve të EBRD, pesha e sektorit privat ndaj PBB në mesin e vitit 2000 ishte 75 për qind). Sipërmarrja e lirë ka qenë motorri i kësaj rritjeje. Ngjarjet e vitit 1997 treguan se sistemi ekonomik, tashmë i dominuar nga sektori privat, kishte fituar një shkallë pavarësie nga zhvillimet negative politike dhe të sigurisë. Në qoftë se në periudhën 1991-1992 vendi ishte i varur tërësisht nga ndihmat humanitare, gjatë trazirave të vitit 1997 nevoja për ndihma humanitare ishte shumë më e vogël. Biznesmenët dhe tregtarët shqiptarë i mbajtën të hapura rrugët e importit dhe garantuan furnizimin e tregut me mallrat më të domosdoshme. Reformimi i sistemit bankar e përgjithësisht atij financiar, megjithëse i ngadalshëm, po kontribuon në financimin e biznesit.
126. Politikat monetare, megjithëse kanë synuar drejtpërdrejt në kontrollin e inflacionit, kanë ndikuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm rritjeje. Vëmendja kryesore e politikave fiskale u është kushtuar përpjekjeve për konsolidimin fiskal dhe ruajtjen e deficitit buxhetor brenda kufijve të caktuar, por ato kanë pasur ndikim të konsiderueshëm edhe në rritjen ekonomike. Megjithatë, pesha e shpenzimeve që kanë ndikim më të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike, ka qenë relativisht e vogël.

127. Hapja ekonomike ndërkombëtare e Shqipërisë ka qenë një faktor me rëndësi kritike për gjithë proceset transformuese në vend. Ajo ka kontribuar jo thjesht dhe jo vetëm në përbalimin e situatave të emergjencës, por dhe sidomos në stabilizimin makroekonomik dhe në mbështetjen e rimëkëmbjes dhe rritjes ekonomike. Nëpërmjet importit sigurohen rreth 1/3 e mallrave dhe shërbimeve që u ofrohen konsumatorëve shqiptarë. Në kushtet kur nga eksportet sigurohet vetëm rreth 1/4 e financimit të importeve, hapja ekonomike ka bërë të mundur që finacimi i pjesës kryesore të importeve të realizohet nëpërmjet transfertave të njëanshme private (dërgesat e emigrantëve) e zyrtare dhe programeve mbështetëse të institucioneve ndërkombëtare. Emigracioni i përkohshëm¹², lidhjet e biznesit me partnerë të huaj, asistenca teknike e ofruar nga institucione ndërkombëtare, shkollimi dhe trainimi i shumë njerëzve pranë shkollave perëndimore dhe reformimi i shkollave dhe qendrave të trainimit të vendit sipas përvojës perëndimore, kanë kontribuar *ndjeshëm* edhe në krijimin e kapitalit njerëzor. Veçanërisht të rëndësishme për vendin kanë qenë mbështetja teknike dhe financiare nga FMN dhe Banka Botërore. Procesi i zbatimit të Paktit të Stabilitetit po hap perspektiva të reja zhvillimi. Pranimi i Shqipërisë në OBT përbën një hap të rëndësishëm për "institucionalizimin" e marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë, për nxitjen e investimeve të huaja, për reformimin e krejt sistemit të tregut, për shpejtimin e proceve integruese rajonale dhe europiane të Shqipërisë.
128. Në periudhën 1993-2000 totali i eksporteve shqiptare u rrit me 129.3 për qind, me një rritje mesatare vjetore 16.2 për qind, ndërsa importet u rritën me 77.8 për qind, me një mesatare vjetore 9.7 për qind. Kjo diferencë në ritmet mesatare të rritjes lidhet me rritjen shumë të madhe të importit në vitet e para të tranzicionit. Megjithë ritmet më të larta mesatare të rritjes së eksportit, bilanci tregtar gjatë gjithë periudhës ka rezultuar me një deficit të theksuar dhe në rritje: nga 490 milionë dollarë në vitin 1993, në 814.1 milionë dollarë në vitin 2000. Dobësitë e eksportit lidhen jo vetëm me vëllimin e tij të vogël krahasuar me importet, por edhe me strukturën. Në totalin e eksporteve peshën më të madhe e ze eksporti nga përpunimi aktiv. Eksporti nga prodhimi i brendshëm ze një peshë të vogël dhe përbëhet kryesisht nga produkte minerale, produkte vegjetale, bimë medicinale. Në strukturën e importit, pozitive është prirja e rritjes së peshës së makinerive e pajisjeve. Një kontribut pozitiv në këtë drejtim po jep ulja e tarifave të importit për këtë grup mallrash, nga 5 për qind në vitin 2000 në 2 për qind në vitin 2001. Megjithatë, duke hedhur vështrimin në të gjithë periudhën e tranzicionit, mund të konstatohet se në politikën tregtare sidomos para vitit 1999 kanë zotëruar synimet fiskale. Anëtarësimi në OBT dhe orientimi integruer në rajon dhe në Evropë, po i përforcojnë objektivat zhvilluese të politikës tregtare.
129. Karakteristikë për vitet 1993-2000 ka qenë niveli i lartë i transfertave private, të cilat kanë financuar një pjesë të konsiderueshme të importeve. Për vitin 2000 ato arritën në 438.6 milionë dollarë amerikanë. Në dallim nga vitet e mëparshme, bilanci i shërbimeve për vitet 1999 dhe 2000 është mbyllur me tepriçë pozitive, përkatësisht 101.3 milionë dollarë (nën ndikimin e ngjarjeve në Kosovë) dhe 2.4 milionë dollarë amerikanë. Llogaria korrente e bilancit të pagesave është mbyllur çdo vit me deficit, i shkaktuar kryesisht nga rritja e importeve. Në vitin 2000 deficieti i llogarisë korrente arriti në 151.8 milionë dollarë amerikane.

¹² Efektet e emigracionit të përkohshëm në formimin e kapitalit njerëzor vlerësohet të jenë të kundërta me ato të emigracionit të përhershëm, veçanërisht të "emigracionit të trurit".

Politikat sektoriale dhe standarti i jetesës

➤ *Shëndetësia*

130. Vendi ka trashëguar nga e kaluara një infrastrukturë shëndetësore të papërshtatshme. Aparaturat dhe pajisjet mjekësore në institucionet shëndetësore ishin tepër të vjetëruara dhe të amortizuara, ndërsa kualifikimi i personelit mjaft i ulët. Një serë procesesh që shoqëruan tranzicionin, si paqëndrueshmëritë politike të brendshme dhe rajonale, zhvendosjet masive spontane të popullsisë, dëmtimi dhe ndotja e mjedisit, ndryshimet drastike në mënyrën e jetesës, etj., janë shoqëruar me pasoja negative në gjendjen shëndetësore të popullsisë. Janë shfaqur dhe po marrin përmasa serioze disa nga plagët e shoqërisë moderne, si abuzimi me drogën, alkoolin, duhanin. Rritja e pasigurisë për shtresa të gjera të popullsisë është shoqëruar me një rritje shumë të madhe të stresit, që është burim i problemeve të shumta shëndetësore. Vërehet përkeqësim i disa prej treguesve shëndetësore. Prirja pozitive e treguesve të vdekshmërisë foshnjore dhe asaj amëtare dhe shkallës së mbulimit me vakcina gjatë viteve të fundit, e ka ngushtuar vetëm pak hendekun midis tyre dhe treguesve mesatar përkatës të vendeve në zhvillim.
131. Politikat shëndetësore të ndjekura gjatë 10 viteve të tranzicionit kanë synuar në reformimin e sistemit shëndetësor. Vëmendja është përqëndruar në rehabilitimin e infrastrukturës së institucioneve, në plotësimin e hartës sanitare sipas normave të pranueshme, në zgjerimin e gamës e përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që i ofrohen popullsisë dhe në parandalimin e epidemive dhe sëmundjeve infektive. Është krijuar ISKSH, i cili është akoma në hapat e para dhe mbulon vetëm mjekun e familjes dhe rimbursimin e një liste barnash, ndërkohë që janë hedhur hapat e parë për zgjerimin e tij me projektin pilot të Autoritetit Rajonal të Tiranës dhe të spitalit të Durrësit. Janë privatizuar shërbimi farmaceutik dhe ai dentar, ndërsa privatizimi i shërbimit diagnostik është në hapat e para. Hapa janë hedhur edhe në privatizimin e shërbimit diagnostik. Vitet e fundit është vërejtur një rritje e pjesës së shëndetësisë në buxhetin e shtetit. Megjithatë, treguesi i raportit të shpenzimeve publike ndaj PPB (3.1 për qind) është shumë i ulët krahasuar jo vetëm me mesataren e vendeve europiane, por edhe të atyre në zhvillim (4 për qind).
132. Me gjithë arritjet pozitive, sistemi shëndetësor vuan ende nga *probleme serioze*. *Proçesi i reformimit* ka ecur ngadalë dhe me inkoherenca të theksuara. Vërehen *dobësi të theksuara menaxheriale* dhe të administrimit. *Shpërndarja e institucioneve shëndetësore* nuk u përgjigjet plotësisht nevojave të popullsisë. Veçanërisht e rëndë është gjendja e shërbimit ambulator në zonat rurale, ku ka mungesa të theksuara të ambulancave dhe personelit mjekësor. Edhe në masën që ekziston, shërbimi primar nuk arrin të luajë rolin e tij dhe dyndja e pacientëve në spitale, sidomos në QSUT është shumë e madhe. *Cilësia* e shërbimeve shëndetësore në të gjitha nivelet është relativisht e ulët. Infrastruktura dhe aparaturat jo të përshtatshme; motivimi i papërshtatshëm i personelit shëndetësor dhe mungesa e tij në zona të caktuara të vendit; mungesa e protokolleve mjekësore; mungesa e një sistemi informacioni të nevojshëm për vendim-marrjen në të gjithë nivelet; dobësitë menaxheriale etj., vlerësohet se janë kontribuesit kryesorë në nivelin e ulët të cilësisë së shërbimeve mjekësore. *Korrupsioni* përbën një dukuri shqetësuese në sistemin shëndetësor. Probleme ka me rregullimin dhe monitorimin e *sektorit shëndetësor privat*.

➤ **Arsimi**

133. Sistemi i arsimit i është nënshtruar një procesi reformimi, megjithëse të ngadalshëm, që ka prekur sidomos planet dhe programet mësimore dhe që ka synuar në përshtatjen e tij ndaj kërkesave të një shoqërie demokratike, të mbështetur në ekonominë e tregut. Qeveria është përballur gjithashtu me probleme të mprehta të infrastrukturës arsimore, të trashëguara nga e kaluara, të kushtëzuara nga ndryshimet demografike, para së gjithash lëvizjet e brendshme të popullsisë dhe, në një masë të konsiderueshme, të shkaktuara nga dëmtimet e pësura sidomos gjatë viteve 1991 dhe 1997. Problemet që kanë shoqëruar tranzicionin kanë shkaktuar rritjen në përmasa serioze të dukurive të braktisjes apo mosregjistrimit në shkollë, duke përkeqësuar ndjeshëm treguesit e zgjatjes mesatare të shkollimit dhe të shkallës së regjistrimit në shkollë. Treguesit e mësipërm paraqiten veçanërisht të ulët për zonat dhe shtresat dhe më të varfëra të popullsisë. Cilësia e mësimdhënies ka rënë në mënyrë të ndjeshme, sidomos në zona rurale dhe të thella të vendit.
134. Gjatë dhjetë viteve të fundit financimi publik për arsimin ka mbetur në rreth 10përqind të shpenzimeve buxhetore, por pesha e tyre ndaj PPB, megjithë disa luhatje, ka ardhur duke u ulur. Nga 3,8përqind që ishte në vitin 1995, ky tregues ra në 3.3 për qind në vitin 2000, duke qëndruar shumë më poshtë se niveli i të njëjtit tregues për vendet e Europës Lindore. Kontributi financiar i nivelit lokal është i pandjeshëm; akoma më i ulët ka qenë kontributi i komunitetit. Në financimin e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës arsimore si edhe në mbështetjen e reformimit të përmbajtjes së programeve mësimore, veçanërisht për arsimin e lartë, një kontribut kryesor ka dhënë mbështetja ndërkombëtare.
135. Zhvillimet në sektorin e arsimit, me gjithë rezultatet e arritura, dëshmojnë për inkoherenca dhe dobësi të procesit të reformimit. Sistemi arsimor vuan nga dobësi të konsiderueshme manaxheriale dhe veçanërisht nga një centralizim i tepruar. Efiçienca financiare është e ulët. Punonjësit e sistemit të arsimit janë pak të motivuar financiarisht, sidomos ata që punojnë në zonat rurale dhe të thella të vendit. Arsimi profesional është jo i përshtatur si duhet me nevojat e tregut, ze peshë të vogël në arsimin e mesëm, me shkallë të ulët diversifikimi dhe kurrikul të centralizuar. Egziston pabarazi shansesh ndërmjet zonave urbane dhe atyre suburbane e rurale. Mbështetja financiare shtetërore është ende e ulët. Inisiativat dhe pjesëmarrja e sektorit privat si dhe mbështetja e komunitetit janë ende të dobëta.

➤ **Infrastruktura**

136. Gjendjes së papërshtatshme infrastrukture të trashëguar nga e kaluara krahasuar me nevojat e një ekonomie të orientuar nga tregu e të hapur, iu shtuan edhe dëmtime serioze gjatë procesit të tranzicionit. Rrjeti rrugor i vendit, që edhe pa marrë parasysh dëmtimet vetëm në 39 për qind të tij ishte i asfaltuar, megjithë përmirësimet që po vihen re gjatë kohëve të fundit, vazhdon të karakterizohet nga një gjendje e vështirë. Kushte të vështira karakterizojnë edhe gjendjen e rrjetit hekurudhor, kryesisht për shkak të dëmtimeve serioze në fillim të periudhës së tranzicionit dhe më pas në vitin 1997, por edhe për shkak të prapambetjes teknike në sistemin hekurudhor. E njëjta situatë ka karakterizuar dhe furnizimin me ujë të pijshëm. Ndërhyrjet ilegale në rrjetin e furnizimit me ujë dhe shkalla e lartë e amortizimit të tij, jo vetëm kanë shkaktuar ndërprerje në furnizimin e popullsisë, por kanë ndikuar në keqësimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Në jo pak raste uji i pijshëm përziehet me ujërat e zeza dhe bëhet burim sëmundjesh infektive. Rrjetet e kanalizimeve të

ujërave të zeza në mjaft qendra urbane janë tepër të amortizuara e të dëmtuara dhe ndodhen në një gjendje kritike. Rritja e ndjeshme e konsumit familjar në mallrat ushqimore dhe ndërtimet e paautorizuara janë shoqëruar edhe me rritjen e sasisë së mbetjeve urbane.

137. Mbetjet urbane dhe dëmtimet serioze të kanalizimeve të ujërave të zeza, emisionet e gazrave nga automjetet që në një masë të madhe janë mjaft të konsumuara, pluhurat që ngrihen nga rrugët e dëmtuara apo të paasfaltuara, ndërtimet e paautorizuara në mjedise publike dhe kufizimi drastik i sipërfaqeve të gjelbra, ndotjet në ujërat e brendshme, dëmtimi i pyjeve, etj., kanë shkaktuar rritjen në një shkallë kritike të ndotjes së mjedisit.
138. Furnizimi me energji elektrike ka qenë mjaft i kufizuar gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të kaluar, si në zonat urbane dhe ato rurale. Kapacitetet e ngushta dhe të amortizuara të sistemeve të shpërndarjes së energjisë elektrike u ballafaquan jo vetëm me një kërkesë që pësoi një rritje të vullshme sidomos për konsum familjar, por edhe me ndërhyrje të paautorizuara në rrjet. Në agravimin e problemit kontribuan sidomos migrimet e popullsisë nga zonat rurale, drejt atyre urbane. Rritja e kostos së furnizimit të energjisë përkundrajt çmimeve të fiksuara të shitjes, shkalla e lartë e mospagimit të energjisë së konsumuar në disa zona të vendit (e përzier me një lloj tolerance nga organet përgjegjëse të administratës deri kohët e fundit) dhe problemet administrative e të menaxhimit e përkeqësuan edhe më shumë situatën. Si rezultat, avaritë në rrjet dhe ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike kanë qenë të vazhdueshme. Situata u vështirësua veçanërisht gjatë vitit 2000. Sistemi energjitik u përballua me një gjendje krize. Problemeve të shënuara më sipër iu shtua një mot shumë i pafavorshëm. Kapaciteteve të ulta prodhuese të lidhura pothuajse tërësisht (95 për qind) me burimet hidrike dhe të kushtëzuara në mënyrë përcaktuese nga gjendja e motit, iu shtua edhe ngushtësia e kapaciteteve të transmisionit, pra edhe ngushtësia e mundësive të importit të energjisë. Politika e investimeve në këtë sektor ka qenë kryesisht e orientuar nga riparimet e avarive të sistemit të shpërndarjes.
139. Në një gjendje më të vështirë ndodhet infrastruktura rurale, ku shumë zona pothuajse izolohen gjatë stinës së dimrit. Rrjeti rrugor ndodhet jashtë kushteve teknike minimale; furnizimi me ujë, me energji elektrike dhe rrjeti i kanalizimeve janë më të përkeqësuar se në zonat urbane. Të gjitha këto përbëjnë një vështirësi serioze në reduktimin e varfërisë në këto zona dhe integrimin e tyre me ekonominë kombëtare.
140. Përmirësimi i infrastrukturës ka qenë një nga shqetësimet kryesore të qeverisë gjatë gjithë periudhës 10-vjeçare. Investimet publike për infrastrukturën kanë përfaqësuar zërin kryesor në shpenzimet e buxhetit për investime gjatë gjithë periudhës (në vitin 2000 shërbimet ekonomike zinin 43.5 për qind të shpenzimeve të përgjithshme për investime të buxhetit, duke arritur në 3 për qind të PBB). Përkundrazi, peshat e investimeve publike në sektorin e transportit ndaj PBB është rritur nga 1 për qind në vitin 1996, në 1.8 dhe 1.6 për qind përkatësisht në vitet 1999 e 2000 (PAB). Krahasuar me vitin 1996, shpenzimet në rrjetin rrugor të financuar nga buxheti i shtetit në vitin 2000 janë rritur katër herë, ndërsa financimet e huaja gjashtë herë. Transporti detar nuk ka patur financime për vitet 1996-1998; hekurudhat janë subvencionuar nga buxheti i shtetit; transporti ajror është financuar me burime të huaja. Shpenzimet për punët publike kanë rënë nga 1.6 për qind e PBB-së në vitin 1996 në rreth 1.2 për qind në vitin 2000. Më shumë se gjysmën e investimeve në

këtë kategori e zënë shpenzimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet. Nxitja e pjesëmarrjes së sektorit privat në ofrimin dhe operimin e shërbimeve publike ka qenë një nga synimet e politikave qeveritare dhe konsiderohet si rruga kryesore e zhvillimit të mëtejshëm të këtij sektori. Veçanërisht pozitive vlerësohet përvoja e sektorit të telekomunikacionit.

III.B.3 VLERËSIME TË PËRGJITHSHME

Arritje, dobësi, vulnerabilitete

141. Vitet e fundit janë hedhur hapa të rëndësishëm përpara në drejtim të thellimit të reformave strukturore, të stabilizimit makroekonomik, të përmirësimit të sigurisë dhe mjedisit të biznesit, të rehabilitimit të infrastrukturës, etj. Megjithatë, ekonomia shqiptare ende vuan nga një varg dobësish dhe vulnerabilitetesh. Gjykojmë që evidentimi i dobësive dhe vulnerabiliteteve kryesore të ekonomisë është më i rëndësishëm se rreshtimi i arritjeve, pikërisht për të orientuar më drejt politikat e ardhshme ekonomike qeveritare. Ndër dobësitë më të përgjithshme do të veçonim (i) dobësitë institucionale, (ii) praninë e problemeve serioze në raportin rritje-zhvillim dhe (iii) shkallën e lartë të informalitetit. Nga ana tjetër, megjithë qëndrueshmërinë makroekonomike të arritur në vitet e fundit, ekuilibret e jashtme dhe të brendshme makroekonomike janë relativisht të brishta, të ekspozuara në një shkallë të konsiderueshme ndaj risqeve.
142. Megjithë përmirësimet e dukshme në vitet e fundit, dobësitë institucionale, përfshirë institucionet publike (në veçanti kapacitetet programuese e sidomos ato zbatuese) dhe institucionet e tjera sociale, mbeten një shqetësim për qeverinë. Një shembull i shprehjes së dobësisë institucionale të tregut është prania e paradoksit: shuma të mëdha depozitash të papërdorura në mënyrë aktive në sistemin bankar - nevoja po aq të mëdha për financime të huaja nga ana tjetër. Kështu, depozitat e sistemit bankar në banka jashtë vendit, në vitin 2000 zinin 24 për qind të totalit të aktiveve. Po në këtë vit, shuma e transfertave zyrtare dhe investimeve të huaja direkte ishte vetëm sa 60 për qind e depozitave të sistemit tonë bankar në banka jashtë vendit.
143. Megjithë ritmet relativisht të larta të rritjes (duke lenë mënjanë periudhat 1991-1992 dhe 1997), vetëm për vitin 2000 niveli real i vlerësuar i PBB e kalon atë të vitit 1989 (102 për qind e nivelit të 1999)¹³. Në ritmet relativisht të larta ka ndikuar baza e ulët e krahasimit, përderisa në vitet 1991-1992 prodhimi pothuajse u paralizua krejtësisht. Ritmet relativisht të larta lidhen, për rrjedhojë, më shumë me një *rritje ekstensive* të prodhimit. Me coptimet prezente të tokës bujqësore në mikroparcela dhe problemet e institucionalizimit të tregut të saj, vështirë se mund të pretendohet për ruajtjen e ritmeve të larta të rritjes në këtë sektor. Probleme institucionale pengojnë përdorimin e shumë burimeve prodhuese, sidomos në zonat rurale dhe lidhjen midis prodhimit dhe tregjeve në zonat e thella të vendit. Lëvizjet e brendshme spontane të popullsisë kanë krijuar disbalanca ekonomike si në zonat nisëse, ashtu edhe në zonat pritëse. Ritmet relativisht të larta të rritjes së prodhimit nuk janë shoqëruar me një zhvillim ekonomik gjithashtu të lartë dhe të balancuar. Pabarazia ekonomike është thelluar. Është përkeqësuar cilësia e shërbimit arsimor dhe shëndetësor edhe është vështirësuar ofrimi i tyre sidomos në zonat e

¹³ BERZH: Raporti korrent mbi tranzicionin (Transition report update), Prill 2001.

thella të vendit. Rritja ekonomike, për rrjedhojë, nuk ka qenë si duhet e adresuar në reduktimin e varfërisë.

144. Ekonomia shqiptare vuan nga një shkallë e lartë *informaliteti*. Vlerësohet se ekonomia informale është më shumë sesa 50 për qind e PBB¹⁴. Shkaqet e kësaj gjendjeje janë të ndryshme, por para së gjithash ajo është produkt i dobësive institucionale. Pavarësisht nga efektet në dukje zbutëse afatshkurtëra, qeveria ka bindjen se efektet afatgjata të ekonomisë informale në rritjen ekonomike dhe përgjithësisht në zhvillim, janë negative. Ekonomia informale, sikurse provon përvoja e tranzicionit shqiptar, i ze frymën ekonomisë formale; deformon tregun dhe shtrembëron sinjalet alokuese që dalin prej tij; dobëson nxitjet për përparim teknik, nxit korrupsionin në administratën publike dhe u kundërvihet reformave institucionale përgjithësisht. Efekte veçanërisht negative afatgjata në rritje dhe zhvillim kanë aktivitetet ilegale, si prodhimi dhe trafikimi i drogës, trafikimi i klandestinëve, etj.
145. Defiçiti ende mjaft i lartë fiskal dhe brishtësia e qëndrueshmërisë së kurseve të këmbimit valutor, i bën të *eksponuara ndaj risqeve* edhe balancimet e brendshme ekonomike e sidomos qëndrueshmërinë e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Borxhi i jashtëm, në përqindje ndaj PBB, megjithëse ka ardhur përgjithësisht duke u ulur nga viti 1994 (52.5 për qind), mbetet përsëri në nivele të larta (25, 4 për qind në vitin 1999). Nga ana tjetër, borxhi i brendshëm ka ardhur në rritje, nga 25.1 për qind në vitin 1995, në 34 për qind të PBB në vitin 1999. Studime të kryera provojnë lidhjen e fortë të inflacionit me kurset e këmbimit valutor. Një zhvlerësim i mundshëm i lekut shprehet si shtrenjtim i importeve në lekë. Pësia e madhe e produkteve të importit në shportën e konsumatorit do ta transmetonte shtrenjtësimin e importeve si rritje të inflacionit.
146. Defiçiti i theksuar, madje në rritje i bilancit tregtar shprehet, ndër të tjera, në varësinë e theksuar të financimit të importeve nga burime jashtë sistemit ekonomik të vendit. Varësia e ekuilibreve të jashtme ekonomike nga transfertat e njëanshme private (prurjet valutore të emigrantëve) dhe zyrtare, i bën këto ekuilibre të brishta. Për vitin 2000 raporti i remitancave ndaj totalit të importeve ishte 41 për qind.
147. Financimet e programuara nga institucionet financiare ndërkombëtare si për bilancin e pagesave, ashtu edhe për bilancin fiskal kanë shërbyer për uljen e shkallës së ekspozimit të ekuilibrave makroekonomikë ndaj risqeve. Ato kanë qenë dhe për një periudhë kohe do të vazhdojnë të jenë të domosdoshme për ekonominë shqiptare. Megjithatë, e ndërjegjshme se vendi nuk mund të parashikojë mbështetje financiare ndërkombëtare për një kohë të pakufizuar, qeveria është përpjekur për një përdorim efektiv të kësaj mbështetjeje. Mbështetja ndërkombëtare financiare ka edhe koston e saj, dhe kjo kosto rritet kur përdorimi i saj nuk është eficient. Shërbimi i borxhit (pagesa e principalit dhe e interesave) është rritur nga 0.69 milionë dollarë në vitin 1993, në 14.63 milionë dollarë në vitin 2000, që do të thotë 5.64 përqind të PBB.

¹⁴ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 1999, f.23.

Sfida për t'u përballuar

148. Me gjithë mprehtësinë që paraqesin problemet e varfërisë dhe nevojën e një adresimi të veçantë ndaj këtyre problemeve, qeveria shqiptare është e ndërgjegjshme se vazhdimi i zbatimit të strategjive afatgjata të thellimit dhe përfundimit të tranzicionit drejt një ekonomie tregu, të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit e, veçanërisht, të integritimit evropian të Shqipërisë, është me rëndësi jetike për të ardhmen e vendit. Përballimi i problemeve të varfërisë e njëkohësisht mbajtja parasysht dhe realizimi i objektivave të zhvillimit afatgjatë e sidomos të integritimit evropian të Shqipërisë përbëjnë sfida për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare. Integrimi evropian i Shqipërisë kërkon plotësimin e një vargu kriteresh institucionale dhe ekonomike. Krahas thellimit të demokratizimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përafrimit të lëgjislacionit të vendit me atë të BE, forcimit të shtetit ligjor dhe rritjes cilësore të kapaciteteve projektuese e zbatuese të administratës publike, kërkohet një makroekonomi me qëndrueshmëri afatgjatë, një ekonomi tregu që funksionon normalisht, e modernizuar dhe e hapur ndaj tregut dhe konkurrencës ndërkombëtare dhe një klimë e përshtatshme për investime dhe për biznes. Dobësitë dhe vulnerabilitetet ekonomike të shënuara më sipër i bëjnë më të mprehta sfidat. Por ato duhen përballuar, alternativë nuk ka. Përballimi i sfidave kërkon, ndër të tjera, *harmonizimin e objektivave* afatmesme të reduktimit të varfërisë, me objektivat afatgjata të tranzicionit, të zhvillimit e të integritimit evropian të Shqipërisë, duke ndërtuar një strategji për reduktimin e varfërisë me tipare të theksuara zhvillimi.

IV MASAT PUBLIKE PRIORITARE

IV.A HYRJE

149. Duke mbajtur parasysh:

- karakterin shumëdimensional të varfërisë;
- nivelin shqetësues të saj sidomos për zona dhe grupe të caktuara të popullsisë;
- arritjet dhe mosarritjet e deritanishme në reformat e tranzicionit dhe efektet e politikave të drejtpërdrejta të zbatuara për reduktimin e varfërisë gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar,
qeveria shqiptare mendon se reduktimi i varfërisë kërkon një vëmendje dhe adresim të posaçëm.

150. Reduktimi varfërisë kërkon (i) rritjen e oportuniteteve për të varfërit, (ii) rritjen e pjesëmarrjes dhe fuqizimin e zërit të tyre në institucionet qeverisëse dhe (iii) rritjen e sigurisë për të varfërit.

151. Për rritjen e oportuniteteve për të varfërit, qeveria do të përqëndrohet në nxitjen e rritjes ekonomike përfshirëse, rritjen e aksesit të të varfërve në shërbimin e arsimit dhe shëndetësisë, në shërbimet infrastrukturore urbane dhe rurale etj.

152. Për të afruar më shumë institucionet publike me të varfërit, për të fuqizuar zërin e tyre, qeveria do të vazhdojë reformën institucionale, dhe do të nxisë forcimin e lidhjeve sociale. Për të rritur shkallën e sigurisë të të varfërit, qeveria do të reformojë programet e përkrahjes sociale, të punëve publike, të mbështetjes për të papunët, etj.

153. Mprehtësia e problemeve të varfërisë me të cilat përballet shoqëria shqiptare nga njëra anë dhe kufizueshmëria kohore e kufizueshmëria e burimeve ekonomike nga ana tjetër, bëjnë të domosdoshme *priorizimin* e synimeve, objektivave dhe masave publike në kuadrin e SRERV (shih Aneksi 1, Matricat e planit të veprimit). Qëndrueshmëria makroekonomike dhe veçanërisht qëndrueshmëria fiskale janë *kushti bazë* për të ndërtuar dhe zbatuar një strategji të suksesshme zhvillimi dhe reduktimi të varfërisë dhe për të *harmonizuar* synimet dhe objektivat e kësaj strategjie me synimet dhe objektivat afatgjata të zhvillimit e integritit. Rritja ekonomike e qëndrueshme dhe përfshirëse dhe reformimi i thellë institucional janë *shtyllat kryesore* të këtij harmonizimi. Platforma e integritit evropian të Shqipërisë është *rruga* nëpër të cilën do të ecet edhe për realizimin e objektivave të reduktimit të varfërisë, thellimit të tranzicionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm e me ritme të larta të vendit.

IV.B KUADRI MAKROEKONOMIK

154. Qeveria shqiptare e konsideron rritjen ekonomike si instrumentin kryesor për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe reduktimin e varfërisë. Rezultatet e deritanishme të reformave ekonomike dhe vazhdimi konsequent i tyre krijojnë mundësi për të synuar një rritje përfshirëse, të balancuar e të qëndrueshme, që do të mbështetet në mobilizimin e të gjithë burimeve prodhuese, veçanërisht atyre njerëzore, si të zonave urbane, ashtu edhe atyre rurale dhe që do t'u lerë brezave të ardhshëm një mjedis të padëmtuar. Qeveria mendon se rritja ekonomike përfshirëse do të sjellë rezultate të ndjeshme në reduktimin e varfërisë sidomos nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të shtresave të varfëra të popullsisë në aktivitetet ekonomike. Nga ana tjetër, një rritje ekonomike e qëndrueshme dhe përfshirëse do të krijojë kushtet për thellimin e mëtejshëm dhe shpejtimin e reformave të tranzicionit. Rritja ekonomike përfshirëse dhe e qëndrueshme do të krijojë kushte edhe për fuqizimin e ekonomisë në tërësi, për konsolidimin e stabilitetit makroekonomik dhe për uljen e shkallës së ekspozimit të ekonomisë ndaj risqeve.
155. Për periudhën 3 vjeçare 2002-2004 synohet të ruhet një rritje ekonomike vjetore në nivelin 7 për qind (shih Aneksi 3, Kuadri makroekonomik). Mundësitë potenciale afatshkurtra dhe afatmesme për realizimin e rritjes së synuar ekonomike mbështeten në i) ruajtjen e ritmeve të verifikuara të rritjes së sektorëve kryesorë të ekonomisë si bujqësia, ndërtimi, shërbimet, shpenzimet publike etj; ii) vazhdimin e stabilitetit politik dhe institucional si një faktor i rëndësishëm në mbajtjen e ritmeve të larta të rritjes ekonomike; iii) vazhdimin dhe thellimin e stabilitetit makroekonomik; iv) pritshmërinë e ulët të mundësisë së goditjeve mbi ekonominë.
156. Rritja mbështetet edhe në (i) impaktin e pritur pozitiv të thellimit të reformave institucionale dhe strukturore; (ii) kombinimin e shfrytëzimit të faktorëve ekstensive me aktivizimin e faktorëve intensivë të rritjes; (iii) nivelin e lartë të akumulimeve monetare dhe transfertat private të pashfrytëzuara deri tani si mundësi për investime; (iv) investimet në kapitalin njerëzor; (v) impaktet e pritura pozitive të hapjes ekonomike, integrimin rajonal e hapave që do të hidhen drejt integritit evropian; (vi) nxitjen e investimeve të huaja. Ndonëse afatgjatë, këta faktorë do të japin efekte pozitive edhe afatmesme, bazuar në masat e ndërmarra në vitet e fundit dhe thellimin e tyre në vazhdim.
157. Prirja e vërejtur që nga viti 1998 për një rritje më të madhe të kërkesës agregate në krahasim me PBB, është, ndër të tjera, edhe një sinjal për qeverinë për t'u orientuar më shumë ndaj politikave ekonomike që synojnë nxitjen e ofertës agregate. Në këto kushte, reformat strukturore marrin një rëndësi të veçantë për realizimin e rritjes së dëshiruar ekonomike. Qeveria do të ketë si prioritete të saj vazhdimin me ritme të shpejta të privatizimit të shoqërive publike, forcimin e sektorit financiar për të mbështetur rritjen e nivelit të kreditimit të ekonomisë dhe rritjen e investimeve, përmirësimet e kuadrit institucional për krijimin e një ambjenti konkurrencial dhe nxitës për investimet e huaja.
158. Investimet e kapitalit si një ndër komponentët më kryesorë të rritjes ekonomike, edhe pse kanë pasur një rritje të lehtë nga viti në vit, përsëri zënë një peshë të vogël krahasuar me PBB. Në vitin 2000 ato arritën në 19 për qind të PBB ku pjesën më të madhe, 12,5 për qind, e përbënin investimet private. Për vitin 2004 niveli i investimeve parashikohet të

arrijë rreth 22 për qind të PBB. Investimet private, me gjithë rritjen që kanë pasur, mbeten poshtë niveleve të dëshiruara. Mangësitë në legjislacion, mungesa e një konkurrence të ndershme në treg, prania e elementëve korruptivë në dhënien e licencave dhe në prokurimet publike, mungesa e një tregu të mirëfilltë financiar dhe niveli i lartë i ekonomisë informale janë disa nga faktorët që duhen përmirësuar për të realizuar rritjen e investimeve private. Parashikohet që investimet private në vitin 2004 të arrijnë në 13,5 për qind të PBB. Mosrealizimi permanent i investimeve publike, si nga financimet e huaja ashtu dhe nga fondet e brendshme buxhetore, është i lidhur me dobësinë e kapaciteteve institucionale, të aktiviteteve të tyre programuese, negociuese dhe monitoruese. Përmirësimi i këtyre faktorëve është i domosdoshëm për të realizuar nivelet e parashikuara të investimeve publike. Nga 6,5 për qind e PBB në vitin 2000, investimet publike parashikohet të arrijnë në 8,3 për qind të PBB në vitin 2004. Parashikohet që për tre vitet e ardhshme (2002-2004) investimet e huaja të rriten. Ky parashikim mbështetet në vazhdimin e procesit të privatizimit, në përmirësimin e infrastrukturës si rezultat i investimeve që po kryhen, në rritjen e sigurisë publike, në masat lehtësuese që parashikon të ndërmarra qeveria për nxitjen e investimeve të huaja direkte, në thellimin e proceseve kooperuese-integruese në rajon dhe më gjerë.

159. Bujqësia do të vazhdojë të japë kontributin kryesor në PBB, megjithë rënien e ritmeve të rritjes në vitet e fundit. Sipas vlerësimeve statistikore, për vitet 1993-2000, sektori i bujqësisë ka kontribuar me mbi 0,6 për qind për çdo 1 për qind rritje të PBB¹⁵. Po të konsideronim vetëm vitet e fundit, shkalla e kontributit të bujqësisë del se është më e ulët, por përsëri mjaft e lartë për ta konsideruar bujqësinë si degën ku duhet përqëndruar vëmendja. Qeveria vlerëson se në sektorin e bujqësisë egzistojnë akoma mundësi ekstensive, shfrytëzimi i të cilave do të ndihmonte në ruajtjen e nivelit të rritjes së këtij sektori. Megjithatë, ka ardhur koha për të menduar seriozisht për përmirësimet teknologjike në bujqësi. Modernizimi i bujqësisë dhe rritja e produktivitetit të saj janë penguar nga shkalla e ulët e mekanizimit, copëzimi i tokës në ngastra shumë të vogla, mungesa e tregut të shitblerjes së tokës, mungesa e infrastrukturës rurale, marketingu i dobët, niveli i ulët i kreditimit të këtij sektori. Përmirësimi i këtyre faktorëve do të bënte të mundur një nivel rritjeje më të lartë. Duke u nisur nga kompleksiteti i këtyre faktorëve dhe vështirësitë e mobilizimit të tyre në një periudhë të shkurtër kohe, për tre vitet e ardhshme nuk pritet ndonjë hop i madh në këtë sektor. Parashikohet që deri në vitin 2004 bujqësia të ruajë një ritëm rritjeje rreth 5 për qind në vit. Brenda sektorit bujqësor blegtoria do të vazhdojë të mbajë peshën kryesore. Përparësi do t'i jepet mbështetjes së zhvillimit të agroindustrisë.

160. Duke u nisur nga normat e larta të kthimit të investimit, normat e larta të fitimit, risku më i ulët, niveli më i përparuar i teknologjisë, vlerësohet se ritmet e larta të sektorëve të ndërtimit dhe shërbimeve, të vërejtura sidomos vitet e fundit, do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke rritur kontributin e tyre në PBB. Një impuls më të madh sektorit të shërbimeve do t'i japë rritja e pritshme e sektorit të turizmit si rezultat thellimit të pritjes së proceseve stabilizuese e integruese në rajon dhe përmirësimit të infrastrukturës pas investimeve të mëdha që po kryhen në këtë sektor. Sektori i transportit do të vazhdojë të zhvillohet me ritme të larta. Investimet e mëdha në infrastrukturën e rrugëve, sidomos të

¹⁵ Koeficienti 0,6, duke qene se është llogaritur për periudhen 1993-2000, reflekton dhe nivelet e larta te rritjes së sektorit të bujqësisë në vitet e para pas privatizimit të tokës bujqësore.

korridoreve strategjike që do të lidhin vendin me pjesët e tjera të rajonit, do ti japin transportit një impuls më të madh, duke ndikuar veçanërisht në zhvillimin e zonave që përfshihen në këto korridore. Intensifikimi i rehabilitimit të rrugëve rurale do të kontribuojë drejtpërdrejt edhe në zhvillimin e bujqësisë dhe të aktiviteteve prodhuese jobujqësore në këto zona.

161. Industria për vitin 2000 pati një rritje prej 5 për qind, duke dhënë një kontribut prej 11.5 për qind në PBB¹⁶. Në pjesën më të madhe rritja e këtij sektori vjen nga sektori privat. Sektori shtetëror i industrisë ndodhet akoma në gjëndje të rënduar. Privatizimi dhe ristrukturimi i një pjese të tij në dy vitet e fundit kanë sjellë një farë rigjallërimi. Për tre vitet e ardhshme nuk priten efekte të mëdha të sektorit të industrisë në PBB. Brenda sektorit vërehen disa degë, që po zhvillohen me ritme më të shpejta, si industria e materialeve të ndërtimit, industria e lehtë dhe ajo ushqimore, të cilat pritet të ruajnë ritmet e larta të rritjes. Vazhdimi i procesit të privatizimit dhe nxitja e investimeve të huaja do t'i jepte impakt sektorit të industrisë.
162. Rritja ekonomike dhe programet e qeverisë në sektorët kryesorë socialë, në kuadrin e investimit në kapitalin njerëzor dhe të uljes së varfërisë, do të mbështeten edhe nga politika fiskale. Parashikohet që shpenzimet totale të buxhetit të rriten nga 31.4 për qind e PBB në vitin 2000, në 32.3 për qind të PBB në vitin 2004. Shpenzimet për investime, që kanë ndikim të drejtpërdrejt në rritjen ekonomike, parashikohen të rriten nga 6.5 për qind e PBB në vitin 2000 në 8.3 për qind në vitin 2004. Arsimi dhe shëndetësia, të vlerësuar si komponentë të rëndësishëm për reduktimin e varfërisë dhe rritjen ekonomike, sepse kanë të bëjnë me formimin dhe ruajtjen e kapitalit njerëzor, do të mbështeten me përparësi nga qeveria në buxhetin e viteve 2002-2004. Për këtë periudhë shpenzimet për arsimin dhe shëndetësinë në raport me PBB do të rriten, po ashtu edhe shpenzimet në transport dhe komunikacion.¹⁷
163. Qeveria do të vazhdojë politikën e konsolidimit fiskal. Parashikohet që defiçiti buxhetor të ulet nga 9.1 për qind në vitin 2000 në 6.5 për qind të PBB në vitin 2004. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mënyrës së financimit të defiçitit buxhetor, duke balancuar financimin e brendshëm, që ka ndikim në nivelin e inflacionit dhe të normës së interesit, me financimin e jashtëm. Financimi i brendshëm i defiçitit (duke përjashtuar të ardhurat nga privatizimi) do të ulet nga 3.5 për qind e PBB në vitin 2001, në 2.1 për qind në vitin 2004, ndërsa financimi i huaj, kostoja e të cilit është më e vogël se kostoja e financimit të brendshëm, pritet të jetë rreth 3.8 për qind e PBB në vit gjatë 2001-2004. Të ardhurat nga privatizimi edhe pse pritet të shënojnë rënie në krahasim me vitin 2000/2001, do të vazhdojnë të jenë burim për financimin e brendshëm edhe për dy-tre vitet e ardhshme. Vazhdimi i mëtejshëm i uljes së normave të interesit për bonot e thesarit, e vërejtur vitin e fundit, do të sjellë uljen e kostos së financimit të defiçitit buxhetor. Planifikimi konsistent kohor i të ardhurave dhe shpenzimeve do të krijojë mundësinë e evidentimit dhe të financimit në periudha më afatshkurtëra të defiçitit buxhetor, duke ndikuar në uljen e kostos së financimit të tij.

¹⁶ Ministria e Financave

¹⁷ MTEF 2002-2004

164. Rritja e shpenzimeve publike në kushtet e thellimit të konsolidimit fiskal do të përballohet nga rritja e të ardhurave me ritme më të shpejta. Synohet që të ardhurat e buxhetit të shtetit të rriten nga 22.4 për qind e PBB në vitin 2000, në 25.8 për qind në vitin 2004, ku të ardhurat tatimore gjithsej parashikohen të rriten nga 15.6 për qind e PBB në vitin 2000 në 18.7 për qind të PBB në vitin 2004. Për të aritur këta tregues, është përgatitur një strategji afatmesëme për të ardhurat. Kjo strategji ka si qëllim modernizimin e administratës sonë tatimore dhe doganore dhe për të luftuar më efektivisht evazionin fiskal dhe kontrabandën. Çështjet më të rëndësishme të kësaj strategjie janë: (i) zgjerimi i bazës së taksave duke rritur numrin e taksapaguesve të rregjistruar dhe reformuar politikën e taksave; (ii) kompjuterizimi dhe ristrukturimi i plotë Departamentit të Taksave në linjët funksionale; (iii) adoptimi i një politike të qartë për burimet njerëzore, duke përfshirë trainimin e inspektorëve të taksave dhe duke ofruar skema shpërblymje bazuar në meritat; (iv) zhvillimi i funksionit të kontrollit të brendshëm për të siguruar kontrollin e vazhdueshëm cilësor të operacioneve; (v) përmirësimi i shkëmbimit të koordinimit/informimit midis Institutit të Sigurimeve Shoqrore dhe Departamentit të Taksave; (vi) adoptimi i programit të qartë për edukimin e taksapaguesve për të nxitur përmbushjen vullnetarisht të detyrimit; dhe (vii) adoptimi i një procesi të ri dhe më të pavarur të apelit ndaj taksapaguesve. Masa specifike për arritjen e synimit të rritjes së të ardhurave nga taksat në buxhetin e 2002 janë shpjeguar në detaje në Memorandumin e Politikave Ekonomike dhe Fiskale për programin PRFG mbështetur nga FMN.
165. Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ketë si objektiv të saj ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Synohet që inflacioni të mbahet në nivele të ulta pozitive, të luhatshme në intervalin 2-4 për qind, në kushtet e vazhdimit të zbatimit të regjimit fleksibël të kurseve të këmbimit. Duke e vlerësuar inflacionin si një dukuri komplekse, që nuk ndikohet vetëm nga politika monetare, kontributi i Bankës së Shqipërisë në mbajtjen e inflacionit në këto nivele do të sigurohet nëpërmjet respektimit nga ana e saj të objektivave sasiorë: respektimi i kufijve sasiorë për mjetet valutore (kufiri i poshtëm për nivelin e rezervës ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë), mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë (kufiri i sipërm), niveli i kredisë neto të sistemit bankar për qeverinë (kufiri i sipërm). Respektimi i këtyre kufijve do të bëjë që rritja e ofertës së parasë të jetë nën kontroll, me një ritëm rënës (nga 15.4 për qind në vitin 2001, në rreth 10.8 për qind në vitin 2004). Në zbatim të politikës së saj për të rritur kontrollin mbi normën e inflacionit, Banka e Shqipërisë po punon për parapërgatitjen e zbatimit të regjimit Inflation Targeting në një të ardhme afatmesme (3-5 vjet).
166. Rritja e efektivitetit të politikës monetare kërkon përmirësimin e tregut financiar në përgjithësi dhe të atij të parasë dhe të kapitaleve në veçanti. Në tre vitet që vijnë, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbështetet tërësisht në instrumentet e tregut, duke pasur si synim rritjen e efikasitetit të mekanizmit të transmissimit të vendimeve të politikës monetare në ekonomi. Nëpërmjet instrumenteve të saj të politikës monetare, Banka e Shqipërisë do të synojë uljen e diferencës midis normave të larta të interesit për kreditë dhe normave të interesit për depozitat. Kjo do të çonte në uljen e kostos së kredisë dhe do të nxiste në një farë mënyre kërkesën për kredi dhe rritjen e investimeve. Kjo do të shënonte njëkohësisht profilizimin e politikës monetare edhe si politikë nxitëse e rritjes ekonomike.

167. Në kuadrin e marrëdhënieve ekonomike me jashtë, qeveria synon të bëjë një reduktim gradual të defiçitit të llogarisë korente nga në 6.7 për qind në vitin 2004. Në vitet e fundit është vërejtur procesi i zëvendësimit të një pjese të produkteve të importit nga prodhimi vendas, kryesisht materiale ndërtimi dhe produkte të industrisë së lehtë dhe ushqimore. Qeveria do të konsiderojë politikat dhe instrumentet e përshtatshëm për të nxitur prodhimin në vend të këtyre produkteve. Nga ana tjetër, qeveria do të shtojë përpjekjet për krijimin e kushteve për nxitjen e eksporteve. Kjo do të bënte që një pjesë e mirë e transfertave të emigrantëve shqiptarë të mos rridhte më jashtë për të financuar importet, por të ngelej dhe të investohej në vend. . Bilanci tregtar në raport me PBB parashikohet të ulet nga 21.7 për qind në vitin 2000 (pas një rritje në vitet 2001-2003), në 21.1 për qind në vitin 2004. Në vitin 2004 transfertat private parashikohet të arrijnë në 600 milionë dollarë amerikanë, duke përbërë më shumë se 35 për qind të vëllimit të importeve.
168. Në periudhën trevjeçare do të vazhdojë mbështetja tek asistenca e huaj për buxhetin në formën e granteve dhe të huave koncensionale dhe pothuajse koncensionale. Qeveria do të bashkëpunojë me donatorët për sigurimin dhe përdorimin e efektshëm të këtyre burimeve. Paguesa e borxhit, në kushtet kur shumica e financimeve jepen me kushte koncensionale dhe me afate të gjata maturimi, do të jetë në një nivel pak më të ulët se 10 për qind e eksporteve vjetore. Borxhi i jashtëm në raport me PBB do të pakësohet me rreth 5 për qind gjatë 2000-2004. Rritja e aftësisë së ekonomisë për të reaguar ndaj efekteve negative do të mundësohet nëpërmjet rritjes së rezervës së përgjithëshme ndërkombëtare në një nivel prej 4.7 muaj importe deri në 2004.
169. Qeveria do të rrisë përpjekjet për përmirësimin e treguesve të disbursimit, absorbimit (implementimit të projekteve) dhe të evidencimit të financimeve të huaja. Përvoja e vitit 2000, kur disbursimet faktike në krahasim me ato të parashikuara për Projektin e Investimeve Publike u realizuan në masën 83.4 për qind, krahasuar me 64.2 për qind në vitin 1999 dhe 73.2 për qind në vitin 1998¹⁸, tregon se janë të mundshme përmirësimet e mëtejshme të këtij procesi. Implementimi i projekteve, përveç vështirësive objektive (zhvillimet politike në vend dhe në rajon), ka hasur dhe shumë vështirësi të karakterit burokratik, organizativ dhe administrativ, shmangia e të cilave do të rriste shkallën e implementimit të këtyre projekteve.

¹⁸ MBET

IV.C QEVERISJA DHE MENAXHIMI I SEKTORIT PUBLIK

170. Megjithë arritjet e deritanishme, qeveria konsideron se thellimi i reformave institucionale dhe ligjore do të jete në qendër të vëmendjes edhe në të ardhmen. Nepermjet tyre synohet të realizohet synimi afatgjatë për një qeverisje sa me demokratike dhe efektive, ne shërbim të zhvillimit të shumeanshem të vendit dhe të integritit europian të tij. Reformat institucionale dhe ligjore do të orientohen nga modelet dhe standardet e BE. Ato do t'u nënshtrohen marrëveshjeve të Paktit të Stabilitetit dhe sidomos Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, negociatat për të cilën pritet të fillojnë së shpejti. Reformimi institucional e ligjor do të kryhet duke u mbështetur në bashkëpunimin me institucionet evropiane dhe euro-atlantike (BE, KE, OSBE, NATO etj)¹⁹.
171. Qeveria konsideron se suksesi i reformave institucionale dhe ligjore është baze për arritjen e objektivave afatmesme të rritjes ekonomike dhe të reduktimit të varferise. Objektivi i rritjes ekonomike kërkon arritjen e një niveli gjithnjë e më të lartë të efektivitetit qeverisës të institucioneve publike, ndërsa reduktimi i varferise kërkon që procesi vendimarrës të jete i drejtë, i hapur dhe përfshirës për të gjitha grupet sociale, por në veçanti për të varferit dhe grupet e tjera të dobëta e të pambrojtura.
172. Reformat institucionale në teresinë e tyre synojnë i) Përsosjen e metejshme të *check* dhe *balances* mes pushteteve; ii) Rritjen e aftësive programuese të institucioneve; iii) Rritjen e efektivitetit të tyre për zbatimin e politikave dhe të ligjit; iv) Rritjen e eficientës financiare; v) Forcimin e përgjegjshmerisë dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut vi) Demokratizimin, rritjen e transparencës dhe reduktimin e korrupsionit.
173. Reforma institucionale do të sigurojë gjithashtu për të gjitha grupet e interesit, por në veçanti për të varfërit: i) shanse përfitimi gjithnjë e më të gjera por edhe të barabarta nga oportunitetet zhvilluese; ii) zgjerim të drejtave dhe mundësira të barabarta përfaqësimi e pjesëmarrjeje në vendimarrjen publike të të gjitha niveleve; iii) shpërndarje të drejte të riskut të zhvillimit dhe garantimin e nivelit minimal të përshtatshëm të të mirave dhe shërbimeve publike.
174. Qeveria konsideron se forcimi i shtetit ligjor është faktor bazë i stabilizimit dhe rritjes ekonomike si dhe i suksesit të reformave. Me gjithë ecurinë pozitive të reformave institucionale dhe ligjore sidomos gjatë viteve të fundit, aftësia e institucioneve për zbatimin efektiv të ligjit mbetet në nivele të pakënaqeshme. Prandaj, një vëmendje e veçantë në periudhë afatmesme do t'i kushtohet rritjes së efektivitetit të institucioneve publike në zbatim të ligjit. Kjo do të arrihet nëpërmjet: i) ngritjes dhe/ose forcimit të institucioneve përgjegjëse e të specializuara për hartimin, zbatimin ose monitorimin e zbatimit të politikave dhe ligjit, ii) forcimit të bashkeveprimit nderinstitucional duke respektuar autonominë institucionale, iii) forcimit të kontrollit të brendshëm, iv) forcimit të përgjegjshmerisë publike të funksionareve dhe institucioneve v) adoptimit të

¹⁹ Qeveria shqiptare ka ndermarre disa reforma institucionale të cilat janë pjesë e angazhimeve të saj në marrëveshjen e stabilizim asociimit me BE. Në qershor 2001 KE pasi vlerësoi progresin e bërë nga Qeveria Shqiptare në përmbushjen e angazhimeve të saj mori vendimin për mundësimin e hapjes së negociatave për arritjen e SAA-së brenda vitit 2001

instrumentave per motivimin e funksionareve publike, vi) permiresimit të mjeteve dhe teknologjise ne dispozicion.

175. Drejtime prioritare të reformimit institucional e ligjor në kuadrin e SRERV janë: (i) forcimi i rendit publik dhe i luftës kundër krimit të organizuar; (ii) lufta kundër korrupsionit në të gjitha nivelet e administratës; (iii) reformimi i sistemit gjyqësor; (iv) thellimi i reformës në administratën publike; (v) përmirësimi rrënjësor i administrimit fiskal; (vi) thellimi i reformës së decentralizimit të pushtetit.
176. Qeveria do te vazhdoje perpjekjet e saj ne drejtim te forcimit te *rendit publik* dhe te luftes kunder krimit te organizuar dhe trafiqeve ilegale. Zbatimi i reformave të nisura ne organet e rendit publik do te behet ne perputhje me planet e aprovuara.²⁰ Drejtimet kryesore do te jene te lidhura me permiresimin e riorganizimit, profilizimit, rritjen e profesionalizmit, mbeshtetjen me mjete dhe teknologji informative si dhe shtrirjen efektive dhe me forma te pershtatshme te sherbimit te ruajtjes se rendit ne gjithe territorin, ne vecanti ne disa zona rurale dhe zonat periferike urbane ku mungesa e tij eshte me e theksuar. Nga ana tjeter qeveria do te angazhohet per nje bashkepunim me intensiv me organizmat nderkombetare ne luften kunder krimit te organizuar dhe trafiqeve ilegale. Per kete qellim Qeveria do te vazhdoje ne rrugen e ndermarrjes se iniciativave konkrete te perbashketa, dy dhe shume paleshe, mes institucioneve shqiptare dhe homologeve te tyre te huaj si dhe do te adoptoje dhe do te krijojte kushtet per zbatimin e marreveshjeve apo te konventave përkatëse nderkombetare. Qeveria dhe organet e rendit do te vazhdojne aksionin e grumbullimit dhe shkaterrimin e armeve duke bashkepunuar me shoqerine civile.
177. Qeveria ka qene e hapur ne trajtimin e *korruptsionit* si nje nga fenomenet me negative dhe me kosto te larte publike qe po bashkeshoqerojne tranzicionin. Qeveria do te vazhdoje te zbatoje Planin e Masave te Luftes Kundër Korrupsionit²¹ edhe ne harmoni me angazhimet e saj ne kuadrin e SAA-se, Paktit te Stabilitetit dhe nismes Anti-korrupsion te tij. Ne luften kunder korrupsionit do te kombinohen me efektivitet aksioni permanent kundra rasteve te abuzimit me pushtetin nga ana e funksionareve publike, me masa konkrete institucionale, me efekte afatgjata, qe ngushtojne hapesirat e abuzimit me kompetencat publike, ç' monopolizojne pushtetin dhe forcojne pergjegjshmerine ligjore e publike te funksionareve shteterore. Ne themel te luftes kundra korrupsionit do te qendrojne i) rritja e transparences dhe pergjegjshmerise, ii) adoptimi i masave parandaluese dhe dekurajuese per korrupsion iii) forcimi i forces goditese te ligjit, iv) forcimi i zerit dhe pjesemarrjes se publikut, grupeve te interesit, komunitetit te biznesit

²⁰ Ne kete fushe qeveria ka ndermarre nje reforme teresore ligjore dhe institucionale. Kane hyre ne fuqi apo jane bere permiresime ne kuadrin ligjor perfshire ratifikimin e konventave nderkombetare. Po keshtu me asistencen e disa donatoreve nderkombetare (MAPE/BE, KE, si dhe me asistence bilaterale) eshte ndermarre nje reforme teresore ne organet e rendit publik me qellim shdrrimin e tij ne nje sherbim efektiv publik sipas modeleve me te arrira dhe te pershtatshme europiane. Per me shume hollesira referohu dokumentave te Ministrise se Rendit Publik mbi planin e veprimet te reformes ne organet e rendit publik.

²¹ Ne korrik 1998 qeveria ne bashkepunim me BB zhvilloi vezhgimin e pare mbi korrupsion I cili u shoqerua me planin e masave anti-korrupsion 1998. Ky plan u ri-shikua dhe u permiresua me tej (Korrik 2000) si dhe u ngriten Njesia Antikorrupsion prane Keshillit te Ministrave si dhe Komiteti Nderministror Monitorimit te zbatimit te ketij plani. Ne kete te fundit bejne pjese perfaqesues te parlamentit, te shoqerise civile dhe te komunitetit te biznesit. Per me shume hollesira referohu dokumentave te qeverise per kete qellim.

dhe te medias dhe vecanerisht te te varferve. Qeveria do te analizoje cdo vit arritjet e Planit te Luftes Kundër Korrupsionit dhe do te ndermarre ndryshimet dhe permiresimet e nevojshme te tij. Qeveria do te mbeshtese iniciativat anti-korrupsion te shoqerise civile si dhe do te nxise procesin e adoptimit te programeve anti-korrupsion nga organet e qeverisjes vendore. Qeveria gjithashtu do te permiresoje ligjet dhe do te forcoje strukturat per kontrollin e pasurive te funksionareve publike dhe te rregullimit te konfliktit te interesit. Ajo do te vazhdoje te ratifikojte marreveshjet nderkombetare qe lidhen me luften kundra korrupsionit dhe pastrimit te parave, duke aktivizuar mekanizmat ligjore e institucionale për zbatimin e tyre²².

178. Reformat e *gjqesorit* do te perbejne nje nga drejtimet me te rendesishme te reformave institucionale, te cilat do te mundesojne qe ligji te zbatohet i barabarte per te gjithë. Reformat e gjyqsorit po zhvillohen ne kuadrin e angazhimeve te Shqiperise ne procesin e SAA dhe SP.²³ Drejtimet, tashme te percaktuara te reformave ne pushtetin gjyqsor do te thellohen edhe me tej. Në vecanti do te konsiderohen: i) rritja e cilesise se procesit gjyqsor/legjislativ nepermjet rritjes se cilesise se akteve normative, vleresimit te efekteve te ligjeve dhe publikimit te vendimeve gjyqsore dhe te ligjeve e akteve normativ ii) permiresimi i nivelit profesional të gjyqtareve, prokuroreve, avoketerve, adinistratoreve te gjykatave si dhe permiresimi i mekanizmave te motivimit te tyre iii) forcimi dhe permiresimi institucional i sistemit te drejtesis (vet-organizimit dhe vetekontrollit te gjyqsorit, racionalizimi i struktures organizativo/territoriale/funksionale si dhe forcimi i institucioneve te tjera të lidhura me gjyqësorin, si ministria e drejtesise, prokuroria, permbarimi gjyqsor, policia gjyqsore. Qeveria do te alokoje me shume fonde dhe mjete ne sherbim te formimit profesional dhe permiresimit te infrastruktures gjyqsore. Forcimi i permbarimit dhe mbeshtetja e tij nga organet e tjera ekzekutive do te ndikojte drejtperdrejt ne rritjen e shkalles se zbatimit te vendimeve gjyqsore ndersa institucionalizimi i formave alternative te zgjidhjes se mosmarreveshjeve do te ndikojte ne uljen e kosos se transakcioneve. Qeveria do te gjeje zgjidhjet e pershtatshme per problemin e akumuluar te detyrimeve te saj kontraktore, duke mbeshtetur keshtu shkallen e zbatueshmerise se vendimeve te gjyqsorit si dhe do te vere ne funksionim institucionin e avokatit te Shtetit. Reformimi i sistemit gjyqësor do të synojë në rritjen e aksesit te te varferve dhe grupeve sociale ne risk, nëpërmjet forcimit të rolit të Avokatit të Popullit, garantimit te sherbimit te konsulences gjyqsore/proceduriale falas, informimit dhe formave te tjera te pershtatshme. Qeveria do te mbeshtese dhe bashkepunoje edhe me angazhimet e shoqerise civile ne keto drejtime (klinikat ligjore, informimi. etj.)

²². Ne kuadrin e angazhimeve te Paktit te Stabilitetit (SPAI) dhe te marrveshjes se asocijim stabilizimit (SAA) programi i masave anti-korrupsion ka marre nje dimension rajonal dhe europian. Qeveria po thellon angazhimet e saj ne drejtim te luftes kunder korrupsionit dhe te trafikëve e krimit te organizuar ne partneritet me organizmat perkates rajonale dhe europiane.

²³. Dokumenti themelor per kete qellim eshte "Plani i dyte veprimit per nje funksionim efektiv te sistemit gjyqsor ne Shqiperi" bazuar ne marrveshjen e qeverise shqiptare me Keshillin e Europes. Qeveria shqiptare po gjen mbeshtetjen e disa donatoreve nderkombetare per zbatimin e ketij plani ne vecanti te KE, BE, BB, dhe te donatoreve bilaterale si qeveritë Holandeze, Daneze, Amerikane, Italiane etj.

Dritare 4: Programi Buxhetor Afatmesëm (PAB)

SRERV-ja do të ketë ndikim të rëndësishëm mbi planifikimin buxhetor dhe menaxhimin në Shqipëri. Zbatimi i suksesshem i saj do të kërkojë një bashkëpunim më të ngushtë midis politikave qeveritare dhe alokimit të shpenzimeve publike, ashtu si edhe përdorimin më efektiv dhe më eficient të burimeve publike. Gjithashtu do të kërkojë një parashikim më afatgjatë të alokimit të burimeve duke mbajtur në konsideratë se politikën dhe programin të reformave do t'i duhen disa vjet për t'u zbatuar. Keto kërkesa janë mbajtur parasysh në programin e qeverisë për reformat në menaxhimin e shpenzimeve publike. Një element i këtyre reformave, mjaft i rëndësishëm për SRERV-ne, është programi buxhetor afatmesëm. (PAB).

Qëllimet e PAB-s: PAB-ja në Shqipëri ka për detyrë të forcojë planifikimin e buxhetit dhe të arrijë përdorimin më efektiv të burimeve publike. Ajo ka për qëllim t'i bëjë keto nepermjet:

- promovimit të disiplinës fiskale gjatë një periudhe afatmesme, duke siguruar që të ardhurat dhe shpenzimet publike të jenë vazhdimisht të mbështetura dhe në përputhje me objektivat e rritjes ekonomike;
- krijimit të një kuadri strategjik prioritetesh të shpenzimeve publike që reflekton harmonizimin e politikave qeveritare me shpenzimet e planifikuara;
- krijimit të kushteve për një efektivitet dhe eficiencë më të madhe në përdorimin e burimeve buxhetore.

PAB parashikohet të përmirësojë pozitivisht metodën e aplikuar për përgatitjen e buxhetit vjetor. Duke marrë në konsideratë të kufizimeve të burimeve sektoriale të përcaktuara strategjikisht, ai zhvendos vëmendjen e ministrive nga maksimizimi i alokimeve ministrove në arritjen e një shpërndarje sa më të mirë të burimeve brenda alokimeve të paracaktuara. Kjo do të lejojë ministrin të përqendrohet tek përmirësimi i cilësisë së buxheteve të tyre, duke lehtësuar kështu zbatimin e buxhetit.

Integrimi me Ciklin Buxhetor. PAB-ja po hartohet si pjesë e ciklit të buxhetit. Me specifikisht ajo mbështetet në Nenin 14 të Ligjit Organik të Buxhetit, duke krijuar mundësi që Ministri i Financave të paraqesë në Këshillin e Ministrave gjatë qershorit, një analizë të situatës makroekonomike dhe fiskale aktuale, shoqëruar me një prognoze të buxhetit për vitin e ardhshëm. Pas miratimit në Këshillin e Ministrave, ky dokument përben bazën e udhëzimeve që u dërgohen Ministrive të linjës në momentin e fillimit të hartimit të buxhetit pasardhës.

Elementet kryesore. PAB-ja në Shqipëri është hartuar mbi bazën e këtyre elementeve të dallueshëm:

- Kuadri Makro-fiskal. Pika e fillimit të PAB është përpunimi i një kuadri makro-fiskal i cili siguron bazën e planifikimit të alokimit të shpenzimeve publike. Duke mbajtur parasysh kapacitetet e kufizuara për analizë parashikuese makro-fiskale, ky kuader si fillim është bazuar në kuadrin e programit të Fondit Monetar. Megjithatë, me rritjen e këtyre kapaciteteve ky kuader do të reflektojë gjithnjë e më shumë analizat dhe parashikimet e vetë qeverisë. Kuadri makro-fiskal siguron kuadrin i cili do të shërbejë si bazë për të analizuar çështjet kryesore buxhetore si dhe për të bërë rekomandime për miratimin e vendimeve nga qeveria. Gjithashtu ai përfshin analizën e kufizimit të burimeve, e cila është e nevojshme për hartimin e politikave e strategjive sektoriale sa më realiste.
- Shpenzimet publike ndërsektoriale. Elementi i dytë është analiza e çështjeve më kryesore të shpenzimeve të lidhura me kategoritë e mëdha ekonomike të shpenzimeve publike, të cilat ose prekin të gjithë sektorët ose për shkak të madhësisë së tyre ndikojnë programet e shpenzimeve të sektoreve të tjera.
- Strategjitë sektoriale të shpenzimeve. Elementi i tretë përfshin hartimin dhe rifreskimin e strategjive sektoriale të shpenzimeve për çdo nivelin prej komponenteve të sektoreve kryesore të programit të shpenzimeve publike. Objektivi i këtyre strategjive është të sigurojë që alokimi i shpenzimeve publike reflekton politikën sektoriale dhe prioritetet programore.
- Plani i shpenzimeve. Elementi i katërt parashikon hartimin e planeve tre-vjeçare të shpenzimeve në përputhje me kuadrin makro-fiskal dhe strategjitë sektoriale të shpenzimeve. Pas aprovimit të tyre nga qeveria këto plane shpenzimesh përbejnë kufijtë e burimeve brenda të cilave çdo ministri linjë planifikon aktivitetet në vijim dhe përgatit buxhetin e detajuar të saj.

Eksperiencat e deritanishme

Që prej fillimit, PAB është përqendruar tek prioritetet e identifikuara nga SRERV. PAB i parë mbulonte periudhën 2001-2003. Analizat e tij sektoriale u fokusuan në pesë sektore shpenzimesh: arsim, shëndetësi, infrastruktura bashkiake (pune publike), mbrojtja sociale dhe transporti. Të gjithë sëbashku këta sektore përbenin 60 % të totalit të shpenzimeve publike. Ky proces arriti një sukses të konsiderueshëm dhe krijoi mundësi për të arritur një fokusim më të mirë në përgatitjen e buxhetit të 2001, prioriteti i të cilit ishte rritja e shpenzimeve në sektorin e arsimit, transportit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës. PAB 2002-2004 përqendrohet në disa prej dobesive të këtij procesi fillestar. Ai përmbledh një analizë me të detajuar të elementeve të shpenzimeve ndërsektoriale, duke u përqendruar vecanerisht në reformat e sistemit të pagave. Ai, gjithashtu merr parasysh efektet buxhetore të decentralizimit fiskal. Analizat e shpenzimeve sektoriale janë shtrire edhe më tej duke përfshirë edhe bujqësinë, një sektor kyç i SRERV. Në fundi plani i shpenzimeve dhe kufizimet e burimeve janë përpunuar me të detajuar.

179. Thellimi i reformimit të *administrates publike*²⁴ do të jetë një nga preokupimet e rëndësishme të qeverisë. Objektivat kryesore të vazhdimit të reformës së nisur në këtë drejtim janë: (i) Percaktimi i qarte i përgjegjesive, autoritetit dhe përgjegjshmerise se institucioneve dhe funksionareve publike, dhe (ii) thellimi i ndarjes së nivelit politik me ate civil dhe forcimi i qendrueshmerise se administrates civile. Drejtimet kryesore të reformës janë: (i) Reformimi dhe persosja institucionalo-strukturore; (ii) Reformimi i kontrollit të brendshëm institucional; (iii) Zbatimi i plote i statusit të nepunesit civil dhe riformulimi i statusit të nëpunësit politik (iv) përmirësimi i informimit të publikut.
180. Procesi reformues i institucioneve do të përfshijë Keshillin e Ministrave, ministrite dhe institucionet e tjera qendrore si dhe njesite territoriale të tyre. Synimi është që përgjegjesite publike të institucioneve të jete të qarta dhe të mateshme ndersa strukturat organizative t'u përgjigjen si nevojave të hartimit të politikave afatgjata të zhvillimit, ashtu edhe të zbatimit të tyre. Institucionet dhe strukturat e tyre do të specializohen në struktura programuese, zbatuese dhe monitoruese. Do të përcaktohen gjithashtu me qarte sistemi i relacioneve institucionale, duke synuar përmirësimin e koordinimit institucional dhe sinergjinë në hartimin dhe zbatimin e politikave. Qeveria do të rishikojë edhe rolin e detyrat e organeve territoriale të tyre si nga këndvështrimi i shtrirjes së shërbimeve publike qeveritare në nivele sa më pranë publikut dhe përfituesve, ashtu edhe nga këndvështrimi i koordinimit me efektiv me organet e qeverisjes vendore.
181. Do të merren masat përkatëse për përcaktimin e formave dhe standarteve të kontrollit të brendshëm si dhe të përgjegjshmerise ligjore dhe publike të niveleve të larta të administrates.
182. Për zbatimin e statusit të nëpunësit civil, do t'i kushtohet vëmendja krijimit të kategorise së nepunesve civile dhe minimizimit të ndikimeve të interesave politike në performancën e administrates civile, si ato qendrore ashtu edhe ato vendore. Reforma do të bazohet në elementet e qendrueshmerise-profesionalizmit-motivimit-përgjegjshmerise. Do të përmirësohen dhe standartizohen procedurat dhe kushtet e rekrutimit, të shpërblimit dhe të karrierës në administratën civile të bazuara në aftësitë, eksperiencën dhe në performancën në zbatimin e detyrave të mateshme dhe të vlerësueshme periodikisht dhe me objektivitet. Fuqizimi i Komisionit të Shërbimit Civil do t'i shërbejë garantimit të drejtave të nepunesve civile si dhe zbatimin e ligjit mbi nepunesit civil në institucionet publike të pavarura nga Qeveria duke u mbështetur në një sistem të unifikuar standartesh dhe procedurash. Do të rishikohet struktura e pagave dhe shpërblimeve në administratën civile për t'i përafëruar ato, sipas mundësive, me strukturën e pagave në sektorin jo-shtetëror si dhe do të rriten financimet për trajnime profesionale dhe informacione në shërbim të nepunesve civile. Parimet baze të përcaktuara në ligjin për statusin e nepunesit civil do të shtrihen, në masën e përshatshme, edhe në institucionet e tjera publike. Gjithashtu, do të ripërcaktohen menyrat dhe mjetet e relacioneve mes nivelit politik dhe

²⁴ Reforma në administratën publike mbështetet tashmë në një kuader baze ligjor dhe normativ sipsh. Ligji për statusin e nepunesit civil dhe aktet nënligjore. (janar 2000) Qeveria është angazhuar tashmë në fazën e zbatimit të plote të këtij programi. Reforma e administrates publike është pjesë themelore e reformës institucionale dhe ka gjetur reflektim në angazhimet e qeverisë në kuadrin e Marrëveshtjes së Asociimit stabilizimit&paktit të stabilitetit si dhe të planit të masave anti-korrupsion. Në zbatimin e kësaj reforme qeveria gëzon mbështetjen e BE, BB, dhe të disa donatoreve të tjerë.

atij civil te administrates. Per kete qellim, do te riformulohet statusi i nepunesit politik, struktura e nivelit politik si dhe sistemi i relacioneve mes dy niveleve. Kjo do të synojë, nga nje ane, realizimin e programeve politike dhe, nga ana tjetër, minimizimin e deformimeve te performances administrative nga interesa politike. Një vemendje e vecante do t'i kushtohet rolit te sekretarit te pergjithshem si pika e lidhjes mes dy niveleve.

183. Ne reformen e cdo institucioni do t'i kushtohet vemendje krijimit te strukturave dhe procedurave te informimit te publikut dhe raportimit periodik, te aksesit te tij ne sistemin publik te te dhenave, lehtesimin e kontaktit te publikut me strukturat dhe permiresimin e ankimit administrativ deri ne rritjen e perfshirjes se publikut ne proceset e hartimit dhe zbatimit te politikave si dhe ne vleresimin e performances se institucionit dhe funksionarit publik.
184. Përmirësimi i administrimit fiskal konsiderohet me rëndësi të veçantë nga qeveria si për përballimin e sfidave të zhvillimit afatgjatë e të integritimit evropian të vendit, ashtu edhe për të siguruar burimet e nevojshme financiare për realizimin e SPRERV. Synimet kryesore të reformimit të administrimit fiskal do të jenë: (i) rritja e të ardhurave buxhetore duke zgjeruar bazën tatimore dhe ngushtuar informalitetin e ekonomisë; (ii) përmirësimi i administrimit të të ardhurave buxhetore, duke rritur efektivitetin dhe efizienzën e shpenzimeve buxhetore; (iii) përmirësimi i procedurave të prokurimit publik. (iv) regjistrimi dhe administrimi efektiv i aseteve shtetërore.
185. Të ardhurat buxhetore do të rriten kryesisht nëpërmjet forcimit dhe përmirësimit të organeve tatimore dhe doganore²⁵. Qeveria do te vazhdoje zbatimin e reformave tashme te nisura te cilat kane dhene rezultatet e para pozitive. Drejtimet do te jene: Permiresimi organizativ, informatizimi i plote, forcimi i kontrollit, rritja e profesionalizmit dhe e motivimit te stafit por edhe e eksperteve te licensuar kontabel, adoptimi i standarteve moderne te kontabilitetit (privat dhe publik). Ne periudhe afatmesme synohet qe sistemi tatimor te zere peshen kryesore perkundrejt atij doganor dhe njekohesisht do te rritet pesha e tatimeve direkte perkundrejt atyre të tërthorta.
186. Qeveria do te zbatoje reforma te thella, tashme te nisura ne strukturat e administrimit te buxhetit dhe te thesarit, në funksion të përmirësimit të programimit, zbatimit, dhe kontrollit të shpenzimeve buxhetore, ne te gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore²⁶. Do te informatizohet sistemi i buxhetit dhe thesarit dhe do te forcohet kontrolli i specializuar financiar, i brendshem dhe i jashtem. Qeveria do te vazhdoje te permiresoje procesin e Programin Buxhetor Afatmesem, per te bere ate nje instrument efektiv te politikave publike dhe te zbatimit te tyre. Sistemi i prokurimeve publike do te vazhdoje

²⁵ Programi CAM Albania me asistencë të KE po arrin suksese të dukeshme në permiresimin e administrimit te doganave ndersa donatore te tjere kane mbeshtetur programet e permiresimit ligjor dhe administrativ te sistemit te tatimeve/taksave. Qeveria do te vazhdoje thellimin e reformave ne organet doganore dhe tatimore ne menyre qe te permiresoje si administrimin financiar por edhe t'i pergjigjet efektivisht politikave te hapjes dhe integritimit ne kuadrin e paktit te stabilitetit dhe te marrveshjes se stabilizim asocijimit me BE dhe anetaresimit ne WTO Per me shume informacion referohu dokumentave perkates te Ministrise se Financave dhe autoriteteve tatimore dhe doganore.

²⁶ Nder programet me kryesore ne kete fushe jane ato te mbeshtetura nga WB ne kuadrin e projektit te Reformes Publike "Manazhimi i Shpenzimeve Publike"

procesin e reformimit. Drejtimet do të jenë: permiresimet proceduriale dhe adoptimi i metodave dhe standarteve kompaktibel me praktikën ndërkombëtare, rritja e konkurrencës, e aksesit të drejtë të furnizuesve dhe transparencës, forcimi i Agjencisë së Prokurimit Publik, rritja e shkallës së profesionalizimit.

187. Qeveria do të zbatojë ligjin për pronat e paluejtshme publike duke bërë inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve publike. Po kështu do të formulohen dhe vihen në zbatim kritere, kushte dhe kufizime mbi administrimin e pronave të paluejtshme publike si dhe të aseteve të tjera që posedohen nga shteti me qëllim një shfrytëzim të qendrueshëm të tyre. Privatizimi si dhe format e tjera të transferimit të pronësive apo përdorimit do të jenë ndër mënyrat kryesore të rritjes së shkallës së efektivitetit të përdorimit të tyre.²⁷

188. Qeveria do t'i kushtojë vëmendje reformës administrative dhe institucionale në sektorët e shërbimeve publike²⁸ në të cilat ajo do të vazhdojë të jetë:

- i) furnizuesi i vetëm ose kryesor (rendi publik, arsimit, shëndetësia, mbrojtja sociale, tregu i punës, mbrojtja civile, infrastruktura e transportit dhe transporti publik, mbrojtja e mjedisit etj.). Në këto sektore reforma administrative do të synojë rritjen e performancës qeverisëse nëpërmjet permiresimit të aftësive menaxheriale në të gjitha nivelet, rritjen e profesionalizimit, forcimin e motivimit të punonjësve, permiresimin e kapaciteteve politike berese por edhe zbatuesve të tyre përfshirë aftësinë e përdorimit efektiv të burimeve financiare, adoptimit sipas nevojave të aftësive për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të përfituesve si dhe të rritjes së pjesëmarrjes së përfituesve dhe kontribuesve në të gjitha momentet e vendimmarrjes përfshirë monitorim/vlerësimin;²⁹
- ii) më tepër rregullator për periudhën afatmesme – afatgjatë, në sektorët e telekomunikacioneve, energjisë, furnizimit me ujë, sigurimit, emittentët televizive etj. Në këtë drejtim do të harmonizohet me mirë drejtimi i privatizimit të këtyre sektorëve me rritjen e aftësive rregullatore të enteve përkatëse. Entet rregullatore do të paisen me kuadër normativ me të qartë, me mjetet monetare dhe materiale si dhe me personel të kualifikuar. Synimi është që entet rregullatore të mund të behen të afta të minimizojnë tendencat monopol dhe të mbrojnë si interesat e zhvillimit ashtu edhe të konsumatorit. Veprimtaria e enteve rregullatore do të behet me autonome, me transparente dhe e përgjigjeshme ndaj interesave që ato mbrojnë.

189. Vazhdimi i reformës së *decentralizimit* dhe fuqizimi i qeverisjes vendore konsiderohet një instrument drejtperdrejt i lidhur me objektivat e rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë. Një pushtet vendor efektiv dhe demokratik do të sigurojë me shumë përfaqësim dhe përfshirje të komuniteteve vendore dhe të kategorive sociale, përfshirë të varferit, në qeverisje si dhe një alokim me optimal të burimeve. Duke konsideruar decentralizimin si një reformë me përparësi/kryqezim me reformat në të gjitha fushat qeveria do të zbatojë strategjinë e decentralizimit sipas planit të saj të veprimit³⁰, me hapa të matur

²⁷ Në vitin 2001 kanë hyrë në fuqi ligji “për pronat e paluejtshme të shtetit” si dhe është në përfundim e sipër procesi i regjistrimit të pronave të paluejtshme në regjistrin e pronave me asistencë të USAID.

²⁸ Masat me specifike janë dhënë në kapitujt dhe matricat përkatëse të këtyre sektorëve

²⁹ Masat me të hollësishme për këto sektore jepen në kapitujt dhe matricat përkatëse

³⁰ Shqipëria ka ratifikuar Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe në këtë kuadër është në proces zbatimi Strategjia Kombëtare për Decentralizimin (Janar 2000). Njësitë e qeverisjes vendore ofrojnë shërbime dhe

por te vendosur, duke permiresuar dhe fuqizuar ne kete proces perfshirjen e vete organeve te qeverisjes vendore por edhe te komuniteteve vendore. Ne tre vitet e ardheshme do te realizohen:

- i) Decentralizimi i funksioneve e pergjegjesive publike te njesive te qeverisjes vendore si ne lidhje me funksionet e percaktuara si funksione te veta te pushtetit vendor ashtu edhe ne lidhje me funksionet e perbashketa (arsimin, shendetin publik, mbrojtjen sociale, mbrojtjen civile etj.) Per keto te fundit ligji do te percaktoje nen/funksionet qe do te kryhen nga secili nivel i pushtetit (qendror dhe vendor) ashtu edhe relacionet institucionale per secilen prej tyre duke i dhene pushtetit vendor, me shume te drejta vendimmarrese ne lidhje me prioritetet, perdorimin e burimeve dhe monitorimin e performances se ketyre sherbimeve.
- ii) Qeveria do te vazhdoje hapat e matur por te vendosur ne drejtim te decentralizimit fiskal duke perfshire si rritjen e oportuniteteve per burimet vendore ashtu edhe per nje ndarje me te drejte dhe me efektive te burimeve kombetare te financimit. Njesite e qeverisjes vendore do te paisen me pronat e patundeshme dhe do te jene pjesemarres aktive ne procesin e planifikimit te buxhetit te shtetit dhe te shperndarjes se fondeve per investime dhe sherbime.
- iii) Qeveria do te inkurajoje qe njesite e qeverisjes vendore te zbatojne te njejtat principe te qeverisjes dhe te reformes administrative dhe financiare, vecanerisht ato ne lidhje me a) statusin e nepunesit civil: pershkrimin dhe standartizimin e puneve dhe matshmerine e tyre, pergjegjshmerine institucionale dhe individuale, rritjen e profesionalizimit, forcimin e kontrollit te brendshem. Per kete qellim Qeveria do te mbeshtese, ne bashkepunim me shoqatat e te zgjedhurve vendore, ngritjen e qendres se trainimeve te te zgjedhurve dhe te administrates vendore; b) te pergatitjes, zbatimit dhe kontrollit te shpenzimeve te tyre perfshire pergatitjen e kuadrit te shpenzimeve afatmesme c) ne informimin dhe perfshirjen e komunitetit ne aspektet qeverisese dhe shmangien e riskut te kapjes se pushtetit nga elitat vendore dhe d) shtrirjen ne nivel lokal te programit te masave kunder korrupsionit.

ushtrojne kompetenca ne perputhje me ligjin "Per organizimin dhe funksionimin e njesive te qeverisjes vendore" (Tetor 2000). Reforma e decentralizimit po realizohet sipas nje procesi pjesemarres te organeve vendore, te shoqerise civile dhe te komuniteteve vendore. Komiteti Kombetar i Decentralizimit ne te cilin perfaqesohet te dy nivelet e pushtetit si dhe Grupi i Eksperteve kane adoptuar planin 3 vjecar te punes per zbatimin e strategjise. Reforma e decentralizimit po mbeshtetet nga shume donatore [KE, USAID, BB, qeveria holandeze, italiane, daneze etj]. dhe ka perbere nje nga temat kryesore ne axhenden e takimeve te klubit te miqve te shqiperise. Per me shume informacion referohu dokumenteve te permendura prane ministrise se pushtetit lokal.

IV.D ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT DHE ATIJ FINANCIAR

IV.D.1 ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT

190. Nxitja e zhvillimit të sektorit privat, konsiderohet si motorri kryesor i rritjes ekonomike dhe zbutjes së varfërisë. Objektivi i qeverisë është të promovojë zhvillimin e një sektori privat dinamik; të rrisë shkallën e konkurrencialitetit të ekonomisë dhe të krijojë një mjedis tërheqës për investimet e huaja private, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me sektorin e biznesit.
191. Reformat e deritanishme kanë kontribuar në liberalizimin e sektorëve të ekonomisë dhe hapjen e tyre për sipërmarrjen private, vendase dhe të huaj. Ky proces, së bashku me privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore, ka bërë që pesha e sektorit privat në jetën ekonomike të vendit të rritet ndjeshëm, duke kontribuar në rreth 75 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Sipas të dhënave zyrtare³¹, numri i subjekteve private të regjistruara deri në fund të vitit 1999, arrin në 63,670. Megjithatë, sektori privat vazhdon të mbetet i pakonsoliduar dhe vulnerabël ndaj goditjeve të brendshme dhe të jashtme. Në përbërjen e biznesit, dominues janë firmat shumë të vogla (mikrondërmarrjet) me 97 për qind të totalit dhe ndërmarrjet e vogla (deri në 50 punonjës) me 2 për qind të totalit. Madhësia e kapitalit të investuar mesatarisht nga çdo biznes arrin në 107 mijë dollarë. Sektorët ekonomik në të cilën biznesi privat është më aktiv janë tregtia dhe shërbimet, ndërtimi dhe transporti. Megjithëse sektori privat tashmë ka një fizionomi të saj të dallueshme dhe është një partner social kryesor, shkalla e zhvillimit të tij mbetet e ulët dhe po kështu dhe përqëndrimi i aktivitetit afarist. Firmat janë të nëninvestuara dhe lidhjet e sektorit privat me bankat janë jo të zhvilluara.
192. Tërheqja e investimeve të huaja përbën një komponente të rëndësishme të zhvillimit të sektorit privat. Përkundrajt një regjimi të vlerësuar si mjaft liberal për investitorët e huaj, evidencat e dekadës së shkuar provojnë se Shqipëria nuk ka qenë shumë e suksesshme në tërheqjen e investimeve të huaja, qoftë në tregues absolut apo dhe relativ. Sipas të dhënave zyrtare, investimet e huaja direkte kumulative gjatë viteve 1992-2000 arrijnë në 598 milionë dollarë, ose rreth 15.7 për qind të PBB³²-së. Programet e rëndësishme të privatizimit të ndërmarrja gjatë vitit 2000 bënë që ky tregues të shënonte shifrën më të lartë të regjistruar, me 143 milionë dollarë, ose sa 24 për qind e shifrës kumulative të investimeve të huaja. Numri i firmave të huaja që operojnë në Shqipëri është 2,422, prej të cilave 819 janë tërësisht të huaja dhe pjesa tjetër janë ndërmarrje të përbashkëta me firmat private lokale.
193. Liberalizimi i tregtisë së jashtme ishte ndër masat e para të Qeverisë Shqiptare në tranzicionin drejt ekonomisë së tregut. Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të

³¹ INSTAT: Statistika No 4/2000

³² Ilogaritur mbi PBB-në e vitit 1999. Të dhënat mbi IHD në vite janë marrë nga raportet statistikore të Bankës së Shqipërisë.

Tregtisë në vitin 2000. Regjimi tregtar i vendit vlerësohet të jetë mjaft liberal, me një nivel të moderuar tarifash doganore, një sistem të lehtë liçencash dhe pothuajse mungesë të plotë të barrierave jotarifore. Megjithatë, pozicioni i bilancit tregtar paraqitet i përkeqësuar. Raporti import/eksport është afërsisht 4/1. Volumi i eksporteve mbetet në nivele të ulëta dhe baza e produkteve të eksportit është e pa diversifikuar.

194. Reformat e kryera gjatë dekadës së kaluar kanë synuar në krijimin e një sistemi ligjor dhe institucionesh që t'u përgjigjen nevojave të biznesit. Vitet e fundit vërehet veçanërisht një përmirësim i ndjeshëm në dialogun midis biznesit privat dhe qeverisë. Gjatë vitit 2000 u krijua Këshilli Konsultativ i Biznesit, në përbërje të cilit janë përfaqësues të lartë shtetëror dhe drejtues të organizatave të ndryshme të biznesit si dhe drejtues të shoqatave të biznesit të huaj. Megjithë zhvillimet pozitive në vitet e fundit, ende janë të pranishme një numër problemesh, si (i) niveli i lartë i riskut të perceptuar nga biznesi dhe nga bankat; (ii) zbatimi i dobët i ligjeve dhe kontratave; (iii) problemet e pronësisë mbi tokën dhe mungesa e një tregu të tokës; (iv) paqëndrueshmëritë e politikave ekonomike (veçanërisht ndryshimet e shpeshta të sistemit të taksave, procedurave administrative, etj.); (v) aksesimi i dobët ndaj informacionit (veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin e SME-ve); (vi) shkalla e lartë e ekonomisë informale dhe konkurrenca e pandershme; (vii) zbatimi i dobët i standarteve të kontabilitetit dhe të auditimit; (viii) dobësitë strukturore (kriza energjitike dhe sigurimi i një furnizimi me rrymë të mjaftueshme të biznesit, niveli i dobët i infrastrukturës së transportit, dobësitë institucionale, etj.) dhe (ix) korrupsioni në hallka të ndryshme të administratës qendrore dhe lokale dhe në sistemin gjyqësor.
195. Objektivat e qeverisë në zhvillimin e sektorit privat janë: (i) nxitja e sipërmarrjes së lirë; (ii) fuqizimi i institucionalizimit dhe formalizimit të tregut; (iii) nxitja e investimeve të huaja; dhe (iv) thellimi i liberalizimit të tregtisë dhe nxitja e eksporteve.
196. Arritja e objektivave të mësipërm përfshijnë një numër masash ndërsektoriale, të cilat janë parashikuar në pjesët në vijim të këtij dokumenti, të tilla si qeverisja, zbatimi i legjislacionit dhe korrupsioni; zhvillimi i infrastrukturës, reformat e sistemit gjyqësor, etj. Masat publike prioritare të karakterit specifik të parashikuara të ndërmerren në kuadër të nxitjes së sipërmarrjes së lirë, përfshijnë:
- i) Lehtësimin e procedurave të hyrjes në biznes. Kjo do të arrihet nëpërmjet reformimit të institucioneve të licensimit dhe dhënies së lejeve të ndërtimit; rritjes së transparencës së organeve të administratës tatimore dhe doganore në raport me biznesin nëpërmjet publikimit të urdhërave dhe udhëzimeve, krijimit të zyrave të informimit publik pranë çdo ministrie; instalimit të linjave telefonike për regjistrimin e ankesave të biznesit, etj.
 - ii) Për forcimin e marrëdhënieve të bankave me biznesin dhe për të lehtësuar procesin e financimit të biznesit, masat e parashikuara përfshijnë: krijimin e Zyrës së Informacionit të Kredisë (nëpërmjet një projekti të financuar nga GTZ); përmirësimet në standartet e kontabilitetit dhe auditimit dhe përafrimi i tyre me kërkesat e standarteve ndërkombëtare; fuqizimi i institucionit të ekspertëve kontabël të pavarur; fuqizimin e legjislacionit për kolateralin dhe zbatimin e legjislacionit; hyrjen në fuqi të një ligji të ri për falimentimin (drafti i përgatitur me asistencën e huaj dhe i miratuar nga qeveria); zhvillimin e një sistemi gjyqësor efektiv.

Dritare 5: Problemet shqetësuese të komunitetit të biznesit

Në përgatitjen e dokumentit të SRERV lidhur me zhvillimin e sektorit privat dhe financiar, u zhvilluan katër raunde konsultimesh me: Bashkimin e Dhomave të Industrisë dhe Tregtisë së Shqipërisë dhe Dhomën Amerikane të Tregtisë; Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar; Shoqatën e Investitorëve të Huaj dhe Shoqatën e Investitorëve Italian; dhe Shoqatën e Bankierëve të Shqipërisë.

Shqetësimet kryesore të ngritura nga biznesi privat konsistojnë në:

1. Marrdhëniet e biznesit me administratën tatimore dhe doganore. Mendimi i biznesit ishte se efikasiteti i politikave zbutëse të qeverisë në drejtim të uljes së ngarkesës tatimore e doganore, përmirësimit të procedurave të rimbursimit të pagimit të TVSH-së, procedurat e parapagimit të tatimit mbi fitimin, etj., nuk japin ato efekte pozitive që priten. Shkaku sipas opinionit të tyre qëndron në arbitraritetin e punës së organeve tatimore e doganore. Psh, ngarkim-shkarkimi disa herë i mallit për t'u çdoganuar, diferencimi i subjekteve të ndryshëm në dogana, mungesa e transparencës mbi çmimet e referencës, arbitrariteti në përcaktimin e listës së mallrave se kush quhet 'investim', etj. Ka dhe boshllëqe ligjore në rimbursimin e TVSH-së kur firmat e mëdha hyjnë në marrëdhënie biznesi me firmat e vogla që nuk janë subjekt i pagimit të TVSH-së.
2. Shkalla e lartë e tatimeve. Veçanërisht pagesa e kontributeve për fuqinë punëtore e rrit ndjeshëm koston e saj dhe stimulon punën e zezë. TVSH-ja duke qenë një shkallëshe për të gjithë mallrat, rëndon bizneset siç është importimi i makinerive bujqësore.
3. Problemet e strukturës së tregut. Mungesa e institucioneve të nevojshme apo inefikasiteti i punës së tyre bën që biznesi të dëmtohet nga prodhimet fallso dhe të pakontrolluara, evazioni fiskal nga disa subjekte, monopolizimi i tregtimit të disa lloje mallrash, etj. Mungesa e tregut të tokës bujqësore dhe fragmentarizimi i saj në parcela të vogla shihen si barriera në rritjen e mekanizimit të bujqësisë.
4. Vështirësitë në përfitimin e shërbimeve publike cilësore. Veçanërisht u mbajt qëndrim kritik në furnizimin e subjekteve me energji elektrike (qoftë për ndërprerjet por dhe luhatjet e tensionit), rritjen e çmimit të energjisë, kostot e transportit të mallrave, etj.
5. Problemet e sistemit bankar dhe kreditimit. Biznesi i konsideron termat e kreditimit të pafavorshme; sistemin e pagesave të pazhvilluar; procedura bankare burokratike, etj. Nga ana e tyre, komuniteti i bankierëve u shpreh se ka mangësi në legjislacionin për kolateralin, shkalla e riskut të biznesit dikton kosto të larta transaksionesh, probleme të saktësisë së bilanceve të firmave private.

Për të marrë një vlerësim të peshuar të rëndësisë së faktorëve pengues për biznesin, u hartua dhe një pyetësor. Sipas të dhënave të marra, rezultoi se 59 për qind e biznesmenëve i konsiderojnë faktorët institucional (marrdhëniet me administratën qendrore dhe lokale; me organet tatimore dhe doganore dhe me gjykatat) si shumë problematike ose problematike. 61 për qind e biznesmenëve vlerësojnë si shumë problematike ose problematike gjendjen e infrastrukturës fizike (veçanërisht të rrugëve) dhe ndikimin e saj në kostot e transportit. Vetëm 22 për qind e biznesve i konsiderojnë si faktorë pengues legjislacionin e punës dhe kualifikimin e fuqisë punëtore. Nga 39 përgjigje të marra, 34 prej tyre e vlerësojnë si shumë penguese konkurrencën e pandershme në treg. Lidhur me rolin e faktorëve ekonomike (nivelet e tarifave doganore, kreditimin, sistemet e shpërndarjes dhe të furnizimit, etj.), 67 për qind e biznesmenëve i konsiderojnë si shumë pengues ose pengues.

Sa janë adresuar shqetësimet e biznesit në SRERV

Bazuar dhe në sygjerimet e bëra nga komuniteti i biznesit, plani i veprimeve prioritare për zhvillimin e sektorit privat dhe financiar, ashtu sikurse dhe programet ndërsektoriale, synojnë të adresojnë këto probleme.

Programet e përmirësimeve infrastrukturore (rrugë, energji elektrike, telekomunikacione, etj.) të parashikuara jo vetëm për rrjetin e transportit kombëtar, por dhe planet e ndërhyrjeve në zonat rurale, do të lehtësojnë kostot e transportit dhe përmirësojnë furnizimin me energji elektrike.

Plani i veprimit parashikon masat që do të ndërmerren për rritjen e transparencës së organeve të administratës shtetërore në marrëdhëniet me biznesin; forcimin e institucioneve që sigurojnë konkurrencën e lirë në treg; përmirësimin e punës së organeve tatimore dhe doganore (kompjuterizimin e sistemit, trajnime, publikime, etj.). Thellimi i reformave (nëpërmjet planit të masave të parashikuara) që do të nxisin konkurrencën në tregun financiar, përmirësimet e skemave institucionale në garantimin e transaksioneve të kredisë, përmirësimet në sistemin e pagesave etj., pritet të japin ndikime pozitive në forcimin e lidhjeve të sektorit privat me bankat.

198. Fuqizimi i institucionalizimit të tregut dhe formalizimit të tij, përbëjnë një drejtim të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të sektorit privat. Masat prioritare për realizimin e këtij objekti janë:
- i) Përmirësimi institucional për nxitjen e konkurrencës së lirë në treg. Në këtë kuadër, me rëndësi do të jenë forcimi i Drejtorisë së Konkurrencës dhe Komisionit të Konkurrencës si dhe fuqizimi i enteve shtetërore rregullatore.
 - ii) Fuqizimi i rrjetit të shërbimeve të informacionit do të kontribuojnë në përmirësimin e konkurrencialitetit dhe qëndrueshmërisë së biznesit. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe fuqizimit të strukturave të informacionit të biznesit; harmonizimit të aktiviteteve të institucioneve kërkimore e shkencore me nevojat e industrisë dhe të bujqësisë (duke i bërë dhe institucionet më *kost-efektive*) për programet të kualifikimit dhe trajnimit dhe asistencës teknike të nevojshme; promovimin e zhvillimit të dijes duke zgjeruar aksesin ndaj Internetit dhe promovimin e programeve të shkëmbimeve (panaire tregtare, ekspozita, etj.); lehtësimin e qarkullimit të informacionit mbi çmimet në tregun e produkteve bujqësore e blegtorale. Programe të posaçme të asistencës në krijimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme, promovimin e investimeve të huaja dhe të eksporteve do të adoptohen nga strukturat përgjegjëse që do të krijohen. Zhvillimi i mekanizmave institucionale mbështetëse do të lehtësojë ofrimin e asistencës teknike dhe kreditimin e biznesit dhe të SME-ve në veçanti.
 - iii) Përmirësimi i marrdhënieve të biznesit me administratën tatimore dhe doganore. Do të përmirësohen procedurat e rimbursimit të taksave; do të realizohet kompjuterizimi i degëve të tatimeve në rrethe; do të zbatohen programe permanente të trajnimit të administratës tatimore dhe doganore; si dhe do të ngrihet Komisioni i Pavarur për Apelimin e Taksapaguesve.
 - iv) Rritja e sigurisë dhe aksesit ndaj tokës. Prioritet në këtë drejtim do të marrë përfundimi i kartografisë për zonat kadastrale të mbetura.
199. Një objektiv i rëndësishëm i qeverisë do të jetë nxitja e Investimeve të Huaja direkte, nëpërmjet adoptimit të masave specifike si: (i) krijimi i Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja me statusin e një 'one-stop-shop' që do të ofrojë shërbimet e kërkuara nga investitorët; (ii) zhvillimit të parqeve industriale me një infrastrukturë të përqëndruar; dhe (iii) ndërmarrja e aktiviteteve promovuese për përmirësimin e imazhit të vendit.
200. Me synim përmirësimin e performancave të tregtisë së jashtme, një draft strategji për nxitjen e eksporteve është përgatitur nga MBET. Strategjia bazohet në konceptin e aftësisë konkurruese të sistemit, që presupozon partneritetin publik-privat, tre shtyllat mbështetëse të të cilit janë: (i) prodhimi dhe logjistikat e orientuara nga tregu; (ii) shërbimet e orientuara nga biznesi; dhe (iii) kadri legjislativ dhe institucional i orientuar nga biznesi.
201. Prioritet i qeverisë në afatin e mesëm lidhur me thellimin e liberalizimit dhe nxitjen e eksporteve do të jenë (i) marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe me BE-në; (ii) lehtësimi i procedurave kufitare; (iii) miratimi i strategjisë së nxitjes së eksporteve dhe rishikimi legjislativ me synim lehtësimin dhe nxitjen e eksporteve; (iv) ngritja e një agjencie të nxitjes së eksporteve dhe ofrimi i mekanizmave të garantimit të transaksioneve të eksportit; dhe (v) zhvillimi i programeve promovuese të eksporteve.

202. Mbështetja e zhvillimit të SME-ve janë një komponente e rëndësishme e strategjisë që lidh rritjen ekonomike me reduktimin e varfërisë. Veçanërisht e rëndësishme konsiderohet mbështetja e mikrobiznesit. Për këtë qëllim, një dokument strategjik për zhvillimin e SME-ve është miratuar tashmë nga Qeveria Shqiptare. Strategjia synon krijimin e vendeve të reja të punës dhe tenton për një zhvillim përpjestimor rajonal në gjithë vendin.
203. Masat publike prioritare që do të ndërmerren nga qeveria shqiptare në kuadrin e kësaj strategjie përfshijnë: (i) miratimin e një ligji të posaçëm mbi SME-të; (ii) krijimin e agjensisë së nxitjes së SME-ve dhe forcimin institucional në nivel ministrie; dhe (iii) përmirësimin e sistemit të kreditimit për SME-të dhe nxitjen e skemave të mikro-kredisë.

IV.D.2 ZHVILLIMI I SEKTORIT FINANCIAR

204. Sistemi financiar gjatë dekadës së tranzicionit mbeti në një gjendje të brishtë. Bankat shtetërore, të cilat dominonin sistemin bankar të vendit, vuanin nga një nivel i ulët kapitalizimi dhe me portofole të rënduara të kredive të këqia. Performancat e sistemit bankar u dëmtuan ndjeshëm veçanërisht nga zhvillimi në përmasa të mëdha i tregut informal financiar në vitet 1996 dhe 1997. Për rrjedhojë, ata i janë nënshtruar disa herë procesit të ristrukturimit dhe më tej privatizimit me investitorë institucional. Aktualisht sistemi bankar përfaqësohet nga 13 banka, ku vetëm njëra është akoma në pronësi shtetërore, por është përfshirë në procesin e privatizimit. Sistemi financiar në Shqipëri vazhdon të identifikohet kryesisht me sistemin bankar, për shkak të mungesës së aktorëve të tjerë të ndërmjetësve financiar. Një treg i letrave me vlerë, Bursa e Tiranës, u krijua në maj të vitit 1996. Megjithatë tregu nuk është operues. Instrumentet e mundshme të tregtimit në Bursë mbeten të kufizuara vetëm në bonot e thesarit. Asnjë firmë, shtetërore apo private, nuk është e listuar. Ndërmjetësit e tjerë financiar, si kompanitë menaxhuese, fondet e investimeve, fondet e pensioneve, etj. nuk janë të zhvilluara.
205. Megjithëse sistemi bankar po kalon drejt fazës së konsolidimit, përsëri ai vazhdon të mos jetë financuesi kryesor i sektorit privat. Gjendja e stokut të kredisë në fund të vitit 2000 zinte vetëm 4.6 për qind të PBB-së. Kufizime të tilla janë konsekuencë e: (i) mbështetjes kryesisht në burime afatshkurtra, (ii) përqëndrimit të aktiviteteve të bankave në një numër aktiviteteve të kufizuara fitimprurëse, kryesisht letrat me vlerë të qeverisë dhe transaksione tregtare; (iii) një diference të lartë mes normave të huadhënies dhe huamarrjes (qoftë në monedhë të vendit apo të huaj). Këto kufizime vijnë dhe për shkak të problemeve strukturore, të tilla si kolaterali dhe detyrimi i pagimit të borxheve, mungesa e informacionit mbi kredinë, besueshmërisë së bilanceve të firmave, etj. Vitet e fundit janë vërejtur përmirësime të rëndësishme si në aspektet ligjore (si ai mbi transaksionet e sigurta, përmirësimet në Kodin Civil dhe të Proçedurës Civile etj.), ashtu dhe të informacionit mbi kredinë. Kjo është shoqëruar me një rritje të kreditimit të ekonomisë gjatë vitit të fundit dhe ka tendenca pozitive. Vazhdimi i fushatës së kreditimit që është udhëhequr nga Banka e Shqipërisë është një iniciativë që do të thellohet në vazhdim, ndërsa adresimi i problemeve strukturore është parashikuar në pjesët përkatëse të kësaj strategjie.
206. Objektivi strategjik i qeverisë është të nxisë krijimin e një sistemi financiar konkurrues dhe që të jetë i aftë t'i përgjigjet nevojave të ekonomisë në tërësi dhe

zhvillimit të sektorit privat në veçanti. Synimet për t'u arritur në kuadër të kësaj strategjie janë: (i) ristrukturimi dhe fuqizimi i tregut financiar dhe (ii) nxitja e përmirësimit të shërbimeve bankare.

207. Masat publike prioritare që do të ndërmerren në funksion të ristrukturimit dhe fuqizimit të tregut financiar përfshijnë: (i) privatizimin e Bankës së Kursimeve, banka më e madhe në vend dhe me një pozitë dominuese në tregun bankar dhe të kompanisë shtetërore të sigurimeve INSIG; (ii) uljen e kostove të ndërmjetësimit bankar nëpërmjet stimulimit të konkurrencës dhe mekanizmave të tjerë të politikës monetare, sa herë që kushtet e tregut do ta lejojnë këtë; (iii) forcimin e sistemit të mbikqyrjes dhe rregullave të kujdesit të sistemit financiar, në përputhje me standartet ndërkombëtare; (iv) përmirësimin dhe kompletimin e bazës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e tregut të kapitalit.

208. Në funksion të nxitjes së përmirësimit të shërbimeve bankare, masat kryesore që do të ndërmerren janë: (i) promovimi i konkurrencës midis bankave; (ii) përmirësimi i sistemit të pagesave, nëpërmjet instalimit të sistemit Real Time Gross Settlement (RTGS); (iii) krijimi i Zyrës së Informacionit të Kredisë; (iv) krijimi i Agjensisë së Garantimit të Depozitave; dhe (v) promovimin e zgjerimit të skemave të kursim-kreditit dhe rrjetit të sistemit bankar në territorin e vendit, veçanërisht në mbulimin me shërbime bankare të zonave rurale.

IV.E ZHVILLIMI NJERËZOR

IV.E.1 SHËNDETËSIA

209. Objektivat e strategjisë për reduktimin e varfërisë në sektorin shëndetësor janë pjesë e strategjisë 10 vjeçare të zhvillimit të këtij sektori synimi i së cilës është përmirësimi i treguesve të shëndetit. Problematika e këtij sektori dhe roli i tij i veçantë lidhur me reduktimin e varfërisë e evidentojnë atë si një sektor prioritar për periudhën 2001-2004. Shpenzimet publike për sektorin e shëndetësisë nga 3 për qind në vitin 2001, do të rriten në 3.2 për qind të PBB-së në vitin 2004. Shpenzimet për investime në këtë sektor nga 5.6 për qind ndaj totalit të shpenzimeve për investime në vitin 1999, parashikohet të rriten në 9.9 për qind në vitin 2003. Drejtimet për realizimin e synimit të mësipërm do të jenë: reformimi i sistemit rregullator; reformimi i sistemit të financimit dhe shpërndarjes së burimeve; reformimi në fushën e ofrimit të shërbimeve.
210. Objektivat në shërbimin mjekësor në kuadrin e strategjisë së reduktimit të varfërisë janë: (i) rritja e efektivitetit dhe efijencës në përdorimin e burimeve; (ii) sigurimi i aksesit dhe barazisë në përfitimin e shërbimeve shëndetësore në të gjithë territorin dhe përmirësimi i cilësisë së tyre; (iii) përmirësimi i treguesve të shëndetit nëpërmjet ndërhyrjeve specifike në fusha të veçanta.
211. Rritja e efektivitetit dhe efijencës në përdorimin e burimeve do të arrihet nëpërmjet: i) përmirësimit të procesit të planifikimit, kryerjes së studimeve për vlerësimin e plotë të nevojave, financimit, menaxhimit dhe shpërndarjes me të drejtë të burimeve; ii) dekoncentrimit të kompetencave drejt institucioneve të bazës (krijimi i autoriteteve shëndetësore rajonale) dhe forcimit të rolit të organizatave të profesionistëve (që do të luajë një rol deçiziv në zbatimin e kërkesave të etikës mjekësore dhe të kartës së të drejtave së pacientit); iii) angazhimit në një luftë efektive kundër korrupsionit që përbën një dukuri shqetësuese në këtë sektor; iv) ngritjes graduale të sistemeve të informacionit duke synuar krijimin e një rrjeti të integruar; dhe v) mbështetjes së procesit të privatizimit në shërbimin shëndetësor dhe monitorimit të sektorit privat.
212. Në kuadrin e sigurimit të aksesit dhe barazisë në përfitimin e shërbimeve shëndetësore në të gjithë territorin dhe përmirësimit të cilësisë së tyre, rëndësi të veçantë marrin: (i) Plotësimi i hartës sanitare të shërbimit parësor. Nga 640 QSH të nevojshme, rreth 80 prej tyre duhen rehabilituar krejtësisht dhe nga 2000 ambulanca të fshatrave, rreth 1380 janë jashtë funksionit. Gjatë periudhës 2001-2004 do të synohet plotësimi 100përqind i nevojave për qendra shëndetësore pranë komunave dhe mbi 50përqind e nevojave për ambulanca pranë çdo fshati, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme dhe formimin e personelit mjekësor. (ii) përgatitja e masterplaneve për zhvillimin e shërbimit shëndetësor në dy qarqe; iii) riorganizimi i shërbimit spitalor; nëpërmjet krijimit të spitaleve rajonale. Këto spitale do të sigurojnë ofrimin e disa shërbimeve të specializuara që sot jepen vetëm në QSUT. (iv) motivimi i përshtatshëm i personelit mjekësor; (v) Përmirësimi i procedurave të liçencimit të aktivitetit privat, duke synuar para së gjithash në sigurimin e shërbimit në zonat rurale dhe qytetet e vegjël si dhe motivimin e personelit që punon në zonat rurale dhe të largëta.

213. Përmirësimi i treguesve të shëndetit nëpërmjet ndërhyrjeve specifike në fusha të veçanta do të sigurohet nëpërmjet përmirësimit të promocionit shëndetësor, kufizimit dhe parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektive, tuberkulozit, SST, përmirësimit të kujdesit për nënën dhe fëmijën, etj. Për këtë do të sigurohet mbulimi me vaksina i 90-100 përqind të popullsisë, sigurimi i kontrollit të ujit të pijshëm dhe ushqimeve si dhe sigurimi i vazhdimësisë dhe zgjerimi i mëtejshëm i programeve egzistuese në këto fusha.
214. Në kuadrin e strategjisë vëmendje e veçantë do t'i kushtohet kategorive specifike të të sëmurëve si: të sëmurët mendorë, të sëmurët kronikë dhe ata në fazë terminale. Krahas krijimit të kushteve normale nëpër spitale psikiatrike do të synohet zgjerimi i shërbimeve në këtë fushë, kryesisht lidhur me parandalimin dhe kurimin e hershëm të problemeve. Do të synohet shtrirja në të gjithë vendin e eksperiencës së QKMZHRF si dhe Organizatave të tjera që operojnë në këtë fushë.

IV.E.2 ARSIMI

215. Prania dhe mprehtësia e problemeve që po përjeton sistemi i arsimit, bëjnë të domosdoshme intensifikimin e reformave në këtë sektor. Synime kryesore të thellimit të procesit të reformimit, njëkohësisht dhe objektiva të strategjisë së arsimit, janë: rritja e pjesëmarrjes së popullsisë në shërbimin arsimor, duke përqëndruar vëmendjen në shtresat e varfra dhe zonat e thella të vendit; përmirësimi i cilësisë së këtij shërbimi dhe ristrukturimi e përshtatja e sistemit të arsimit ndaj zhvillimeve dhe nevojave të tregut.
216. Objektiva specifike të sektorit të arsimit në kuadrin e strategjisë për rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë, janë (i) rritja e pjesëmarrjes në arsimin tetëvjeçar duke përqëndruar vëmendjen në shtresat e varfëra dhe zonat e thella të vendit si dhe në rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm, kryesisht profesional, (ii) përmirësimi i cilësisë së mesimdhënies, (iii) zgjerimi i arsimit profesional dhe përshtatja më e mirë e tij ndaj nevojave të tregut; (iv) rritja e efektivitetit të administrimit dhe efikasitetit financiar të sistemit arsimor.
217. Rritja e pjesëmarrjes në arsimin tetëvjeçar do të arrihet kryesisht përmes tërheqjes në shkollë të fëmijëve nga familjet e varfëra, veçanërisht të zonave rurale dhe atyre peri-urbane, duke zbatuar projekte të posaçme, sikurse është projekti “fëmijët e rrugës”. Do të hartohen e zbatohen, gjithashtu, kritere të veçanta për familjet e varfëra duke i mbështetur me bursa, tekste falas ose me çmime të ulëta, ushqim falas, krijimin e qendrave të nxënësve të vështirë, etj. Do të zbatohen programe pilot për shërbimin “autobuz shkollor” në pesë zona rurale që kanë infrastrukturë të përshtatshme rrugore, si modele për t'u ndjekur nga qeveria vendore dhe komuniteti. Thellimi i aksioneve për rehabilitimin e shkollave dhe ngritjen e objekteve të reja shkollore, përmirësimi i furnizimit me tekstet mësimore, përmirësimi i furnizimit të shkollave me bazën e nevojshme didaktike, përmirësimi i sistemit të transportit të mësuesve dhe nxënësve dhe orientimi i këtyre masave veçanërisht në shtresat më të varfëra, do të kontribuojnë në rritjen e aksesit ndaj këtij shërbimi.
218. Motivimi financiar i punonjësve të sistemit të arsimit, veçanërisht atij parauniversitar, konsiderohet si një nga masat e rëndësishme për rritjen e cilësisë së personelit mësimor.

Parashikohet që për periudhën 2001-2004, fondi i pagave për arsimin parauniversitar të rritet me rreth 12 përqind në vit, 2/3 e të cilës do të shkojë për rritjen e pagës bazë të mësuesve dhe pjesa tjetër për të mbështetur reformën ristrukturuese. Nga ana tjetër, posaçërisht për rritjen e cilësisë së personelit mësimor në zonat rurale dhe të thella do të shtohet kompensimi financiar i mësuesve që punojnë në ato zona. Kjo masë do të kombinohet me programe trainimi, veçanërisht për mësuesit pa arsimin përkatës.

219. Zgjerimi dhe përmirësimi i arsimit të mesëm profesional do të mbështetet në përshtatjen e kuadrit ligjor për të mundësuar hapjen e shkollave profesionale në përputhje me nevojat dhe tendencat e zhvillimit rajonal/vendor; decentralizimin kurrikular dhe diversifikimin e profilit të tyre në përshtatje me nevojat e tregut të punës. Gjatë kësaj periudhe, do të synohet ristrukturimi ose hapja e 5 shkollave profesionale me konvikte në zonat urbane e suburbane.
220. Për realizimin e objektivave të mësipërme, një rol të rëndësishëm do të luajë reforma administrativo-financiare. Kjo reformë do të mundësojë rritjen e efikasitetit të administrimit përmes racionalizimit, harmonizimit dhe decentralizimit të strukturës vendimmarrëse në të gjitha nivelet, gjithashtu rritjen e efikasitetit të burimeve financiare përmes zbatimit të një formule të re të përdorimit të tyre, krijimit të fondeve të posaçme për nxitjen e iniciativave novatore të shkollave, komuniteteve e autoriteteve lokale. Pjesë e kësaj reforme është edhe hartimi dhe realizimi i një programi të plotë të përmirësimit të kriterëve dhe procedurave të rekrutimit dhe karrierës, të përshkrimit të punëve dhe detyrave, të ri-organizimit të Ministrisë së arsimit. Gjithashtu do të zhvillohen programe trainimi dhe kualifikimi të stafit të Ministrisë, të autoriteteve lokale dhe të drejtuesve të shkollave. Përmirësimi i administrimit dhe rritja e kapaciteteve menaxheriale pritet të japin efekte të drejtpërdrejta në përmirësimin e treguesve sasiorë e cilësorë të sistemit arsimor në tërësi dhe në zonat e pafavorizuara në veçanti.
221. Problematika e këtij sektori dhe roli i tij i veçantë në formimin e kapitalit njerëzor si faktor i rritjes ekonomike dhe reduktimit të varfërisë e evidentojnë atë si një sektor prioritar për periudhën 2001-2004. Shpenzimet publike për investime në këtë sektor nga 7.5 për qind ndaj totalit të shpenzimeve për investime në vitin 1999, parashikohet të rriten në 9.8 për qind në vitin 2003.

IV.E.3 TREGU I PUNËS DHE MBROJTJA SOCIALE

Tregu i Punës

222. Zhvillimi i tregut të punës dhe nxitja e punësimit përbëjnë një nga komponentët kryesorë të politikave për reduktimin e varfërisë, përderisa papunësia është një nga shkaqet kryesore të saj. Legjislacioni përkatës është thuajse i stabilizuar, por zbatimi i tij kërkon trajtimin me prioritet të problemit të formimit profesional në përshtatshmëri të plotë me kërkesat e tregut, si edhe përmirësimin e cilësisë së trajnimit profesional. Kjo kërkon rishpërndarjen e qendrave të trajnimit, vendosjen e standarteve të vendeve të punës dhe kualifikimin si dhe përgatitjen e kurrikulave në përshtatshmëri me kërkesën dhe ofertën për fuqi punëtore.

223. Politika e nxitjes së punësimit është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të tregut të punës, e cila synon gjatë periudhës trevjeçare të ardhme në (i) nxitjen dhe intensifikimin e formimit profesional dhe zhvillimin e fuqisë punëtore në përgjithësi, (ii) thellimin e institucionalizimit dhe formalizimit të tregut të punës dhe në (iii) nxitjen e punësimit.
224. *Nxitja dhe intensifikimi i formimit profesional* do të arrihet nëpërmjet përgatitjes së strategjisë përkatëse, e cila do të konsistojë në studimin e kërkesës dhe ofertës për punë dhe profesione si edhe në mundësitë e parashikimit të tendencës së tregut të punës. Rritja e numrit të qendrave të formimit profesional dhe shpërndarja më e mirë e tyre do të ndikojnë pozitivisht në formimin dhe zhvillimin e fuqisë punëtore të vendit.
225. *Thellimi i institucionalizimit dhe formalizimit të tregut të punës* do të arrihet nëpërmjet rritjes së numrit të shërbimeve të punësimit, që lidhen jo vetëm me formimin profesional dhe pagesën e papunësisë, por edhe me ndërmjetësimin, këshillimin e aplikimin për punë në përputhje me kërkesën e individit. Realizimi i kësaj politike do të mbështetet nga zhvillimi institucional i Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe kualifikimi i administratës në të tre nivelet. Gjithashtu, do të nxitet ofrimi i shërbimeve të punësimit jashtë sektorit publik.
226. *Rritja e punësimit* do të arrihet nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të SME, zbatimit të programit të punëve publike si dhe të programit të punëve komunitare. *Nxitja e punësimit* të të varfërve, përveç nxitësve fiskalë dhe masave të përgjithshme për nxitjen e investimeve dhe të rritjes ekonomike, do të realizohet edhe me masa specifike që lidhen me (i) zbatimin e programeve të punëve publike, (ii) zbatimin e programeve të punëve komunitare, (iii) nxitjen e formave të mikrokreditimit, etj. Nxitjes së punësimit do t'i shërbejë edhe thellimi i institucionalizimit të tregut të punës.
227. Zbatimi i politikave të përmendura kërkon, nga njëra anë, mbështetje financiare dhe, nga ana tjetër, zhvillim të kapaciteteve institucionale në nivel qendror, rajonal dhe lokal. Këto masa përfshijnë shpenzimet për krijimin e rrjetit të përgjithshëm të informacionit, vazhdimin e programeve të nxitjes së punësimit, rritjen e kapacitetit trajnues në qendrat e formimit profesional, mbështetjen me të ardhura nga buxheti i shtetit të programit të pagesës së papunësisë, si edhe kualifikimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për të thithur efektivisht investimin.

Mbrojtja Sociale

228. Zgjidhja e problemeve të programit të mbrojtjes sociale kërkon një rishikim të saj dhe përshtatje me kushtet ekonomike dhe shoqërore të vendit. Në kuadrin e Strategjisë, programi do të synojë në: (i) rritjen e raportit të mbulimit me ndihmë ekonomike të të varfërve (ritje e numrit të të varfërve që përfitojnë ndihmë ekonomike në raport me numrin total të të varfërve); (ii) rritjen e nivelit të mbulimit të nevojave ekonomike dhe sociale të familjes nëpërmjet ndihmës ekonomike; (iii) zbatimin e programeve aktive riintegruese të mbrojtjes shoqërore. Duke marrë në konsideratë shumëdimensionalitetin e varfërisë në Shqipëri, programi synon që gjatë viteve 2001-2004 ndihma ekonomike të shërbejë si nxitje për familjen për të dalë nga situata e varfërisë, duke e riintegruar atë në

mjedisin shoqëror, nëpërmjet harmonizimit të tij me programet e tjera të mbrojtjes dhe të zhvillimit social.

229. Arritja e objektivit të rritjes së raportit të mbulimit do të mundësohet nëpërmjet identifikimit dhe matjes së treguesve ekonomikë dhe socialë, vlerësues të situatës ekonomike dhe sociale të rajoneve të vendit, si edhe alokimit të fondeve nga buxheti qendror në bllok duke u mbështetur tërësisht në rrjetin e treguesve ekonomikë dhe socialë të matur. Përmirësimet legjislative dhe organizative do të qartësojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të angazhuara në dhënien e ndihmës ekonomike, si MPCPS, APNSHS, organe të qeverisjes vendore, OJQ. Decentralizimi i mëtejshëm i skemës, do të mundësojë fleksibilitetin e nevojshëm për operacionalizimin e saj. Reforma do të mbështetet nga forcimi i kapaciteteve menaxhuese të institucioneve të ndihmës ekonomike jo vetëm në nivel qendror, por edhe rajonal e lokal.
230. Rritja e nivelit të mbulimit të nevojave ekonomike dhe sociale të familjeve nëpërmjet ndihmës ekonomike do të mundësohet nga (i) krijimi i bazës së të dhënave mbi situatën ekonomike dhe sociale të shtresave të shoqërisë; (2) harmonizimi i ndihmës ekonomike me mekanizmat e tjerë të mbrojtjes shoqërore, si shërbimet sociale, me qëllim ofrimin e ndihmës ose/dhe shërbimeve sipas nevojës së paraqitur; (3) përcaktimi i prioriteteve ekonomike dhe sociale sipas grupeve shoqërore dhe karakteristikave të tyre, duke e orientuar gradualisht sistemin tek minimumi jetik. Rivlerësimi i politikës egzistuese të ndihmës ekonomike, duke u mbështetur në informacionet dhe të dhënat përkatëse, përcaktimi dhe matja e treguesve të varfërisë dhe monitorimi i tyre i vazhdueshëm, do të bëjnë të mundur analiza realiste dhe marrjen e masave konkrete. Gjithashtu, rivlerësimi i mekanizmit të financim-alokimit nga buxheti i shtetit dhe shpërndarjes tek përfituesit, do të ndikojë në një targetim më të mirë të ndihmës ekonomike.
231. Implementimi i programeve aktive riintegruese kërkon rishikimin e kuadrit ligjor, ndryshimin dhe përshtatjen e tij me kushtet shoqërore. Reforma nënkupton krijimin e kushteve ligjore dhe institucionale për nxitjen e modeleve të ofrimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete dobiprurëse të formës së biznesit social.

Përkujdesi Shoqëror

232. Duke marrë në konsideratë karakterin shumë dimensional të varfërisë, politika e shërbimeve sociale do të synojë të shndërrohet nga një politikë pasive (politikë e zbutjes së pasojave të tranzicionit) në një politikë aktive (politikë e zhvillimit të kapitalit social). Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet përdorimit të formave të reja të politikës sociale, të cilat do të ofrojnë riintegrimin real social të kategorive të marxhinalizuara nëpërmjet pjesëmarrjes në biznesin social. Kusht i domosdoshëm për suksesin e biznesit social është bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. Ky bashkëpunim do të mbështetet nga krijimi i një kuadri të ri legjislativ, në të cilin harmonizohen mekanizmat financiare dhe sociale.
233. Programi i përkujdesit shoqëror kërkon një zhvillim thelbësor të shërbimeve sociale, i cili nënkupton (i) mbulimin e plotë të territorit me shërbime sociale në përputhje me nevojat sasiore dhe cilësore të kategorive shoqërore të rrezikuara dhe (ii) rritjen e numrit të shërbimeve sociale në institucionet përkatëse dhe përmirësimin cilësor të tyre. Krijimi i

grupeve të reja sociale të rrezikuara kërkon përgjigje të shpejtë dhe efikase me politika të përshtatshme si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe të shoqërisë civile. Programi synon të reformojë legjislacionin e shërbimeve sociale, duke nxitur aplikimin e formave të tjera, përveç atyre publike, të ofrimit të shërbimeve sociale. Njëkohësisht, programi nënvizon domosdoshmërinë e nxitjes së shërbimeve mbështetur në nevojat shoqërore të individit.

234. Objektivi i mbulimit të plotë të territorit me shërbime sociale në përputhje me nevojat sasiore dhe cilësore të kategorive shoqërore vulnerable, mund të arrihet nëpërmjet (i) hartimit të strategjisë së shërbimeve sociale, duke theksuar veçanërisht nevojën e decentralizimit të plotë të shërbimeve, (ii) kufizimit të ndërtimit të qendrave residenciale nacionale, (iii) harmonizimit të ofrimit të shërbimeve sociale me ndihmën ekonomike, si edhe (iv) nxitjes së krijimit të qendrave ditore, komunitare të trajtimit me shërbime të kategorive në nevojë.
235. Rritja e numrit të shërbimeve sociale në institucione dhe përmirësimi cilësor i tyre do të arrihet nëpërmjet investimit në burimet njerëzore, zhvillimit të kapaciteteve institucionale për thithjen e investimeve jashtë buxhetit të shtetit, zgjerimit të bashkëpunimit me donatorët, si edhe forcimit të rolit dhe bashkëpunimit me Fakultetin e Punës Sociale.

Sigurimet Shoqërore

236. Programi i sigurimeve shoqërore, duke marrë në konsideratë analizën e problemeve më të mprehta legjislative dhe institucionale, synon që gjatë tre viteve të ardhshme (i) të rrisë shkallën e përfshirjes në skemën e detyrueshme, duke përmirësuar në këtë mënyrë raportin kontribues-përfitues, si edhe (ii) të zvogëlojë subvencionin e buxhetit të shtetit në skemën e pensioneve dhe të rrisë qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të saj
237. Rritja e numrit të kontribuesve do të bëhet nëpërmjet nxitjes së përfshirjes së popullsisë rurale në kontributet për sigurime shoqërore, me qëllim që të dy skemat e sigurimeve shoqërore, të qytetit dhe të fshatit të konvergojnë në një të vetme brenda një periudhe 10-vjeçare. Një monitorim më i kujdesshëm i skemës, një politike më e studjuar e menaxhimit të fondit të pensioneve do të ndikojë pozitivisht edhe në ngushtimin e diferencave në pensione. Në rritjen e kontribuesve, krahas përmirësimeve të mëtejshme ligjore dhe administrative, forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, forcimit të kontrollit, do të ndikojë edhe tërësia e masave për ngushtimin e hapësirës së sektorit informal.
238. Zvogëlimi i subvencionit të shtetit në fondin e pensioneve do të arrihet nëpërmjet përmirësimeve legjislative, që do të ndikojnë në rritjen e numrit të kontribuesve dhe, për rrjedhojë, edhe në rritjen e të ardhurave. Realizimit të këtij objektivi do t'i shërbejë edhe investimi në zhvillimin institucional të sigurimeve shoqërore, nëpërmjet operacionalizimit të numrit të sigurimit, automatizimit të sistemit të informacionit, zhvillimit institucional në të gjitha nivelet e funksionimit, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve si edhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit.

IV.E.4 FUQIZIMI I KAPITALIT SOCIAL

239. Zhvillimet e tranzicionit, ndryshimet demografike, prirjet që po përvijohen në zhvillimet sociale, janë reflektuar në rikonturimin dhe ridimensionimin e kapitalit social. Shumë struktura të tij, veçanërisht struktura të kultivuara, kanë përjetuar ndryshime përkeqësuese. Qeveria do të përkrahë fuqizimin e strukturave të kapitalit social dhe të rolit të tij për rritjen e oportuniteteve dhe të sigurisë për të varfërit.
240. Shoqatat dhe organizatat e ndryshme komunitare, përfaqësuese të grupeve të interesit, shoqëria civile përgjithësisht, familja, format e ndryshme të lidhjeve shoqërore pranë individit dhe familjes, përfaqësojnë disa nga strukturat kryesore të kapitalit social, që kërkojnë mbështetje dhe vëmendje nga ana e qeverisë. Strukturat e pushtetit vendor, duke qenë më pranë komunitetit dhe individit, do të luajnë një rol të veçantë në nxitjen e marrëdhënieve shoqërore të individit brenda vetë komunitetit dhe në fuqizimin e kapitalit social e të rolit të tij.
241. Në shumë nga rrethet e vendit janë krijuar shoqatat e fermerëve, shoqatat e agro-biznesit, shoqatat e përdoruesve të ujit, shoqata të profesioneve të caktuara, dhomat e tregëtisë dhe industrisë, shoqatat e biznesmenëve, organizimi i komuniteteve në bashkëpunim me donatorë të huaj ose institucione qeveritare për përmirësimin e kushteve të jetesës, etj. Të mbështetur dhe nga donatorët, roli i këtyre grupeve dhe përfshirja e vetë komunitetit në realizimin e projekteve që nxisin fuqizimin e marrëdhënieve sociale brenda komunitetit, po bëhet një praktikë pozitive. Megjithatë, kapacitetet dhe shtrirja gjeografike e këtyre shoqatave mbeten të kufizuara, e për rrjedhojë dhe shkalla e pjesëmarrjes së komunitetit është e vogël. Zgjerimi dhe shtrirja e programeve të shërbimeve publike në interes të komunitetit me pjesëmarrjen e vetë anëtarëve të komunitetit, do të jenë një drejtim i rëndësishëm në politikat e qeverisë. Praktikrat e suksesshme të realizuara deri tani, si ai i Bankës Botërore në zonën e Bathores, projektet bashkiake të rrugëve tregtare, të furnizimit me ujë të pijshëm të aplikuara në disa rrethe të vendit, etj., do të synohet që në të ardhmen të promovohen dhe të kenë një shtrirje më të gjerë gjeografike.
242. Qeveria do të adoptojë programe të nxitjes së pjesëmarrjes së *shoqërisë civile*, në të gjitha format që ajo shfaqet, në çështjet publike (identifikim problemi, gjetje e zgjidhjeve, zbatim, monitorim), duke e konsideruar këtë edhe si mënyrë të shëndoshjes së kapitalit social me efekte pozitive në zhvillim duke u kujdesur njëkohësisht për minimizimin e riskut që mund të krijojnë forma të caktuara të kapitalit social në transparencën, drejtësinë dhe efektivitetin e politikave publike.
243. Vëzhgime të kryera konfirmojnë se për zgjidhjen e problemeve të punësimit, të shëndetit, të edukimit, të sigurisë dhe të shërbimeve të tjera, individët mbështeten fort *në strukturat e forta familjare*, të afërmit, fqinjët dhe rrethi i gjerë i të njohurve. Roli i dërgesave të emigrantëve në mirëqenjen e familjeve është një provë e ruajtjes së këtyre lidhjeve tradicionale brenda familjeve. Qeveria të mbështesë programet e ndryshme sociale për të krijuar premisa për zhvillimin e mëtejshëm të familjes dhe rolit të saj shoqëror.
244. Reforma në zhvillimin e kapitalit social do të kërkojë aplikimin e mbrojtjes sociale nëpërmjet përfshirjes së të përjashtuarve dhe aktivizimit të tyre në proceset ekonomike

dhe shoqërore. Qeveria konsideron se ridimensionimi i politikës sociale, trajtimi me prioritet i integritit social përmes formave të ndryshme të përkrahjes sociale komunitare apo të biznesit social, arritja e rritjes ekonomike dhe përmirësimi i mënyrës së rishpërndarjes së mbështetjes sociale janë mënyra më efektive për reduktimin e varfërisë. Per kete qellim Qeveria do te marre masa per fuqizimi e kapaciteteve te strukturave te saj per zbatimin e formave te reja aktive te perkrahjes sociale te natyres investuese. Ajo do te perdore nje pjese te fondeve ne kete fushe per te mbeshtetur iniciativa te ketij lloji qe do te ndermerren nga ana e organizatave te shoqerise civile, te komunitetetve apo te bizneseve si dhe do te adoptoje masa lehtesuese fiskale.

Dritare 6: Eksperienca e UNICEF - Tirane me biznesin social. Projekti YAPS

UNICEF-Tirane mbeshteti krijimin e e biznesit te pare social ne Shqiperi me synimin e reduktimit te perjashtimit social. Projekti YAPS (Youth Albanian Parcel Service-Sherbimi Postar i te Rinjve Shqiptare) eshte sherbimi i pare postal i cili ka punesuar 32 te rinj nga grupe te marxhinalizuar perfshire jetime, te rinj nga familje te varfera si dhe te rinj me te meta ose me prinder te tille. Aktiviteti eshte ne thelb jo-fitimprures dhe ne interes te publikut. Projekti u mbeshtet nga nje koalicion organizatash private dhe publike te cilat dhane ndihmesen e tyre ne proceset pergatitore (studimi i tregut, studimi i beshmerise, perzgjedhja i te punesuarve, trainimi i tyre, ngritja e strukturave, regjistrimi etj) si dhe mbeshtetje me fonde per mblerjen e pajisjeve dhe per kapitalin e punes. Per te pare ecurine e projektit u UNICEF angazhoi edhe eksperte te pavarur. Konkluzionet kryesore te vleresimit te fazes se pare te projektit nxorren ne pah disa avantazhe te tij. Megjithese ne muajt e pare te aktivitetit YAPS po jep rezultatet e para pozitive. Te rinjte e punesuar shprehen se tashme e ndejne veten te dobishem per vetehten e tyre. si dhe se po fitojne nje rol shoqeror. Ndjenja e marxhinalizimit tek te rinjte po dobeshohet gradualisht. Nga ana tjeter sherbimi i ofruar nga YAPS po zgjeron klientelen dhe volumen e aktivitetit. Klientet nga ana e tyre shprehen per cilesine e mire dhe garancine e sherbimit. Ky opinion bashkeshoqerohet edhe me gjykimin se motivimi i brendshem i YAPS eshte nje faktor i forces konkurruese. Mbeshtetesit e YAPS vleresojne gjithashtu se kontributet e tyre per ngritjen e sherbimit kane dhene rezultatet te vlefshme dhe se ato jane perdorur per qellime investimi ne kapitalin njerezor dhe social.

YAPS ka terhequr vemendjen edhe te specialisteve te fushave shoqerore dhe ekonomike te cilet kane vizituar ambientet e YAPS, kane intervistuar te rinje, kane analizuar ecurine e aktivitetit etj. Vleresimet e dhena jane optimiste. Konkluzioni i pergjithshem eshte se shtimi i rasteve te biznesit social bazuar ne modele te ngjashme me YAPS do te kishte efekte pozitive paresore dhe dytesore. Ato do te rrisnin mundesine e trajtimit ne forma aktive te disa prej grupeve te marxhinalizuara dhe lehtesimin apo mundesimin e integritit te tyre ne shoqeri. Nga ana tjeter surplusit i te ardhurave nga biznesi social mund te ri-investohet per te zgjeruar rrethin e perfituesve. Ne kete aspekt te punesuarit kuptojne se behen te dobishem jo vetem per vehte por edhe per te tjere. Modeli eshte terheqes edhe per bizneset sepse ai eshte me prane natyres se biznesit dhe njekoheesisht i jep mundesi bizneseve te luajne nje rol social. Modeli i biznesit social mund te jene terheqes edhe per autoritetet publike pasi krijojne munesine e nje perdorim me efektiv dhe eficient te fondeve publike, nxisin integritim dhe ka elementet e nevojshem per forcimin e efekteve parandaluese dhe kuruese te sherbimeve sociale krahasuar me format tradicionale te perkrahjes sociale. Ne kete menyre biznesi social sherben si nje instrument per nxitjen e nje partneriteti real mes shtetit, sektorit privat dhe shoqerise civile.

Gjithsesi nga ana tjeter vete iniciatorët e projektit mendojnë se YAPS dhe modele të tjera të ngjashme me të nuk janë çelësi i arte. Ato janë forma plotësuese dhe përmirësuese të sistemeve tradicionale të asistencës sociale dhe në këtë këndvështrim duhen përkrahur dhe duhet të bëjnë pjesë në sistemin e metodave dhe formave të përkrahjes aktive sociale.

IV.F INFRASTRUKTURA DHE MBËSHTETJA E RITJES EKONOMIKE

245. Zhvillimi i infrastrukturës ekonomike është me rëndësi esenciale në mbështetjen e rritjes dhe zhvillimit ekonomik të vendit, nëpërmjet lehtësimit të tregtisë, reduktimit të kostove të prodhimit dhe zgjerimit të shkallës së konkurrencialitetit të ekonomisë. Objektivi i synuar është krijimi gradual i një rrjeti të infrastrukturës moderne (telekomunikacion, energji, rrugë, porte, aeroporte, etj.) dhe themelimi i sistemeve eficiente të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së tyre.
246. Infrastruktura konsiderohet si një pikë kritike për shkak të gjendjes aktuale tepër të amortizuar të saj, në raport me vendet e tjera kufitare dhe pozicionit të Shqipërisë në projektimin e rrjetit paneuropean të transporteve. Për këtë arsye, zhvillimi i infrastrukturës është konsideruar si një prioritet i rëndësishëm në projektet e Shqipërisë në kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.

IV.F.1 TRANSPORTI

247. Megjithë angazhimet gjatë viteve të fundit nga qeveria dhe organizmat financiarë ndërkombëtarë, gjendja nuk paraqet përmirësime të dukshme. Kjo për shkak të mungesës së projekteve dhe studimeve të plota, burimeve të kufizuara financiare, kohës së nevojshme për programim, financim dhe zbatim të projekteve, ashtu si edhe të ndikimit të trazirave të brendshme dhe në rajon.
248. Objektivat strategjike në sektorin e transportit përfshijnë: krijimin e një rrjeti të infrastrukturës moderne, i nevojshëm për një sistem efikas transporti, i cili të lehtësojë rritjen ekonomike; rritjen e efikasitetit të mbulimit të kostos në operacionet e transportit duke reduktuar kërkesat ndaj buxhetit të shtetit; rregullimit të përshtatshëm të operacioneve të transportit me qëllim rritjen e efikasitetit ekonomik, sigurisë rrugore dhe mbrojtjen e mjedisit; dhe nxitjen e bashkëpunimit me sektorin privat dhe zhvillimit në kuadrin e Paktit të Stabilitetit.
249. Masat dhe politikat në funksion të arritjes së këtyre objektivave strategjike përfshijnë:
- (i) rehabilitimin e infrastrukturës egzistuese të transportit; (ii) zhvillimin e lidhjeve të transportit rajonal; (iii) komercializimin e shërbimeve dhe privatizimin e operacioneve shtetërore të transportit; (iv) krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të përshtatshëm; (v) përmirësimin e sistemeve informatike të transportit dhe forcimin e planifikimit dhe menaxhimit të sektorit. Masat prioritare të qeverisë sipas nënsektorëve do të përfshijnë:
 - i) Planifikimin, menaxhimin dhe administrimin. Në funksion të saj, qeveria do të (i) rishikojë dhe ristrukturojë funksionet e Ministrisë së Transportit; do të riorganizojë Drejtorinë e Përgjithëshme të Rrugëve (DPRr) dhe Sektorët e Mirëmbajtjes së Rrugëve; (ii) përmirësojë programet e sigurisë rrugore nëpërmjet ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Transportit Rrugor dhe (iii) krijojë Administratën Shqiptare të Transportit Detar.
 - ii) Përmirësimin e Administrimit dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve kombëtare. Aktivitetet kryesore të planifikuara përfshijnë (i) riorganizimin e mirëmbajtjes së rrugëve dhe

- privatizimin e ndërmarrjeve në varësi të DPRr; (ii) rritja e financimeve për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor dhe (iii) zbatimin e projektit të sigurisë rrugore (rehabilitimin e qendrave të testimit të automjeteve; kompletimin e sistemeve informatike të regjistrimit të automjeteve; dhe edukimin e shoferëve dhe të popullatës).
- iii) Përmirësimin e sistemit të transportit rrugor. Aktivitetet e planifikuara përfshijnë (i) përfundimin e rehabilitimit të ndërtimit të korridoreve rrugore kombëtare Lindje-Perëndim dhe Veri-Jug, dhe degëve të tyre; (ii) përmirësimin e rrjetit të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale dhe rritja e sistemeve të sigurisë (ndriçimi, tabelat orientuese, forcimit të kontrollit të qarkullimit rrugor etj.) (iii) realizimin e projektit të detajuar për ndërtimin e aksit rrugor Durrës-Kukës-Morinë dhe Tiranë-Klos-Peshkopi-Bllatë; (iv) realizimin e studimeve për ndërtimin e rrugës turistike Vlorë-Sarandë dhe segmenteve të tjera të rrugëve turistike.
 - iv) Përmirësimin e sistemit të transportit ujor, i cili do të përfshijë (i) përfundimin e punimeve për plotësimin e Master-Planit të Portit të Durrësit (rehabilitimi i kalatave, ndërtimi i terminalit të trageteve, kontenierëve dhe magazinave tranzite); (ii) përfundimin e punimeve në portin e Vlorës (rehabilitimi kalatave dhe mekanizimin e portit); (iii) kryerja e punimeve sipas Masterplanit në portet sekondare të Sarandës dhe Shëngjinit.
 - v) Përmirësimin e sistemit të transportit hekurudhor, i cili do të synojë në (i) finalizimin e Programit Emergjent të Rehabilitimit të rrjetit egzistues (faza e parë: përfundimi rikonstruksionit të linjës Tiranë-Durrës; vendosjen e sistemit të telefonisë dhe sinjalizimit; rikonstruksionin e linjës Durrës-Rrogzhinë; rinovimin tërësor të inventarit të vagonëve të udhëtarëve); (ii) rehabilitimin e linjës hekurudhore Shkodër-Hani i Hotit; (iii) përfundimin e studimit të fizibilitetit dhe projekteve të detajuara për lidhjen hekurudhore me Maqedoninë.
 - vi) Përmirësimin e transportit ajror, i cili do të fokusohet në (i) ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në Aeroportin e Rinasit (me një kontratë koncesionare); (ii) zbatimin e Masterplanit të Trafikut Ajror; (iii) ndërtimin e një vendqëndrimi të ri për avionët në Aeroportin e Rinasit; (iv) kryerjen e studimit të fizibilitetit dhe hartimin e Masterplanit të zhvillimit të transportit ajror në Shqipëri dhe (v) zhvillimin e aeroporteve lokale.

IV.F.2 UJI I PIJSHËM DHE KANALIZIMET

250. Megjithëse Shqipëria është një vend i pasur me rezerva ujore, situata vazhdon të dominohet nga mungesa e aksesit të popullsisë urbane dhe rurale në shërbimin e ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe shërbime të tjera të nivelit lokal; një zbatim me ritme të ngadalta të politikave dhe reformave në fushën e shërbimeve publike; një përqendrim të popullsisë në zonat sub-urbane duke krijuar mbingarkesa kritike në infrastrukturën dhe shërbimet publike egzistuese.
251. Një draft strategji për adresimin e këtyre problemeve është hartuar nga MPP. Prioritetet e qeverisë në një periudhë 5 vjeçare do të jenë përfundimi i projekteve që janë në proces dhe zgjerimi i tyre në rrethet e tjera të vendit.

252. Objektivi i politikave të qeverisë për shërbimet në furnizimin me ujë dhe kanalizimet janë rritja e aksesit të popullsisë ndaj ujit të pijshëm dhe përmirësimi i cilësisë dhe përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza.
253. Masat prioritare në këto sektorë do të jenë: (i) ndërmarrja e investimeve për përmirësimin dhe zgjerimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe përmirësimin e cilësisë së ujit; (ii) rehabilitimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza; (iii) mbulimin e kostove nëpërmjet menaxhimit më të mirë të shërbimit, rregullimit të tarifave, matjes reale të konsumit të ujit, reduktimit të lidhjeve ilegale, përmirësimit të pagesave; (iv) decentralizimin e investimeve dhe procesin e vendimmarrjes si dhe kontrollit nga organet qendrore; (v) përdorimit të formave alternative të menaxhimit të ujësellsave si kontratat e menaxhimit, koncesionit ose privatizimit të përgjithshëm; dhe (vi) kalimin e pronësisë për infrastrukturën e ujësjellsve dhe kanalizimeve nga pushteti qendror tek ai lokal. Në kuadër të procesit të decentralizimit, një theks i veçantë do t'i jepet rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit në projektet e furnizimit me ujë dhe përmirësimit të kanalizimeve, nëpërmjet aplikimit të skemave të provuara dhe që kanë qenë të suksesshme. Zbatimi i programit të masave të parashikuara më sipër, do të mbështetet me plotësimet e kuadrit ligjor egzistues dhe bërjen funksionale të strukturave përkatëse të parashikuara në legjislacion.

IV.F.3 ENERGJIA

254. Shqipëria zotëron një potencial të madh hidroenergjitik nga i cili vlerësohet se shfrytëzohen vetëm 35 për qind e rezervave, pa përfshirë rezervat në naftë, gaz dhe qymyre. Ndryshimet strukturore në ekonomi kanë patur ndikime të rëndësishme në konsumin e energjisë. Ndërsa ka rënë ndjeshëm prodhimi i gazit dhe qymyrit, konsumi i popullsisë është rritur duke ndikuar strukturën e përdorimit të energjisë. Vlerësohet se konsumi popullatës përbën 35 për qind të totalit të energjisë së konsumuar dhe rreth 55 për qind të kërkesës totale për energji elektrike. Nevojat e vendit për energji ofrohen thuajse tërësisht nga burimet hidrike, gjë që i jep atij një varësi të lartë nga kushtet atmosferike. Në kushtet aktuale atmosferike, importi së bashku me prodhimin e vendit lejojnë plotësimin vetëm të 57 për qind të kërkesës së brendshme për energji.
255. Furnizimi me energji elektrike për konsumatorët vazhdon të mbetet përgjegjësi e shtetit. Në vitin 1993 u krijua Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) si ndërmarrje shtetërore. Një përpjekje e ndërmarrë nga qeveria shqiptare në vitin 1995 për komercializimin e këtij sektori, si një program pilot për privatizimin e tre njësisve të shpërndarjes në Vlorë, Elbasan dhe Shkodër, dështoi. Tre ndërmarrjet janë në krizë financiare dhe janë planifikuar që të ribashkohen me KESH-in. Në vitin 1995 u krijua Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) si institucion përgjegjës për rregullimin e sektorit të energjisë, përfshirë procedurat e liçensimit, aprovimit të tarifave, mbrojtjen e konsumatorit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, etj. Në vitin 1995 u krijua gjithashtu dhe Qendra e Eficiencës së Energjisë Shqipëri-BE, si një fondacion jo-fitimprurës, përgjegjës për politikën e eficiencës së energjisë dhe përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë.
256. Çmimet e energjisë elektrike janë ende të kontrolluara, ndërkohë që çmimet e burimeve alternative të energjisë janë liberalizuar plotësisht. Humbjet teknike dhe

joteknike në rrjet vlerësohen ende të larta, edhe pse janë ndërmarrë një seri masash për reduktimin e tyre. Në paketën e masave të ndërmarrë për normalizimin e sektorit, reduktimi i humbjeve teknike dhe jo teknike ze një vend të veçantë, përfshirë dhe shlyerjen e detyrimeve të papaguara të debitorëve. Kompania energjitike KESH po asistohet në menaxhim nga ENEL, enti italian i energjisë, nëpërmjet një programi të Bankës Botërore.

257. Duke konsideruar zhvillimet aktuale në sektorin e energjisë elektrike dhe situatën e vështirë në të cilën ndodhet ai, qeveria është e angazhuar në përmirësimin sa më të shpejtë të gjendjes së furnizimit me energji të konsumatorëve. Në strategjinë e përgjithëshme sektoriale për të ardhmen do të synohet sigurimi i një furnizimi të mjaftueshëm për të gjithë konsumatorët të bazuar në burimet alternative të energjisë si dhe një administrim më të mirë të burimeve energjitike në vend; fuqizimit të kapaciteteve importuese dhe një balancimi më të mirë të sistemit. Vëmendje do t'i kushtohet zhvillimit të burimeve të tjera energjitike, reduktimit të ndotjes së mjedisit dhe minimizimit të rrisqeve për të varfërit. Drejtimit themelore të politikave që do të ndiqen konsistojnë në: (i) kompletimin e reformave institucionale të ndërmarrë për normalizimin e sektorit; (ii) komercializimin e plotë të ndërmarrjeve prodhuese dhe transmetuese të sektorit të energjisë; (iii) reduktimin e humbjeve joteknike, përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave dhe një liberalizim gradual të çmimit të energjisë elektrike, duke siguruar mbështetjen e grupeve të varfëra të popullsisë; (iv) sigurimin e financimeve të përshtatshme për investime në sektorin e energjisë elektrike për kompletimin e programeve të rehabilitimit të rrjeteve të transmetimit, shpërndarjes dhe prodhimit dhe (v) forcimin e institucioneve rregullatore.

258. Masat prioritare në këto drejtime përfshijnë: (i) ristrukturimin e KESH-it, duke ndarë prodhimin nga transmetimi dhe shpërndarja; (ii) përgatitjen e sektorit për privatizim; (iii) shtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë duke nxitur pjesëmarrjen e sektorit privat dhe (iv) integrimin e rrjetit elektrik me atë Ballkanik dhe European.

IV.F.4 TELEKOMUNIKACIONI

259. Infrastruktura globale e informacionit, bazuar në teknologjitë e reja të informacionit dhe telekomunikacionit me përdorimin e fibrave optike dhe komunikimet satelitore, krijojnë kushte për zhvillimin në shkallë të gjerë të shërbimeve të reja në fushën e administratës publike, tregtisë, bankave dhe tregjeve financiare, arsimit nëpërmjet edukimit në distancë, kujdesit për shëndetin, etj.

260. Shërbimet e telekomunikacionit të trashëguara reflektonin një pamundësi të plotë për t'u ballafaquar me realitetet e reja. Në vitin 1992 u realizua ndarja e telekomunikacionit nga shërbimi postar, duke krijuar ndërmarrjen shtetërore të Albtelekom-it. Mbi bazën e një Masterplani të zhvillimit të sektorit, me mbështetjen financiare të BERZH-it dhe vendeve donatore, telekomunikacioni hyri në një rrugë të zhvillimeve të rëndësishme, duke përmirësuar ndjeshëm nevojat e popullsisë dhe të biznesit.

261. Zhvillime të rëndësishme në sektorin e telekomunikacioneve gjatë kësaj periudhe përfshijnë (i) krijimin e legjislacionit për rregullimin e aktivitetit të telekomunikacioneve dhe liberalizimin pjesor të sektorit; (ii) hyrjen dhe zhvillimin e Internetit; (iii) krijimin e

një autoriteti të pavarur rregullator dhe (iv) inkurajimin e hyrjes së sektorit privat në këtë industri.

262. Rezultati i masave të adoptuara ka bërë që shkalla e penetrimit të linjave telefonike gjatë dekadës së kaluar të rritet me një ritëm të kënaqshëm, nga 5 linja për 1,000 banorë në vitet 1992-1993, në 30.5 linja në vitin 1999. Ky shërbim operohet nga kompania shtetërore Albtelekom. Rrjeti i Albtelekom është i integruar me rrjetin botëror të telekomunikacioneve nëpërmjet objekteve të transmetimit me fibër optike nënujore dhe tokësore si Trans Balkan Line (korridori i 8-të i telekomunikacioneve: Bari-Durrës-Elbasan-Maqedoni-Bullgari-Turqi) dhe Adria 1 (Greqi-Shqipëri-Kroaci-Gjermani). Rrjeti i komutimit aktualisht është 80 për qind dixhital ndërsa rrjeti i transmetimit është 95 për qind dixhital.
263. Një kompani e shërbimit telefonik jokabllor u krijua nga qeveria shqiptare në vitin 1995 e cila është privatizuar në vitin 2000. Ofrimi i këtij shërbimi telefonik gjithashtu është rritur dhe masivizuar dhe është rritur gama e shërbimeve të reja. Një licensë e dytë për operimin e telefonisë celulare është dhënë nëpërmjet një tenderi të hapur ndërkombëtar.
264. Përdorimi i shërbimit të internetit është rritur nga 0.1 përdorues për 10,000 banorë në vitin 1995, në 0.3 përdorues në vitin 1999. Projekti i Albtelekom-it për Internetin përfshinë krijimin e një ISP në nivel kombëtar, duke ofruar pika prezence në qytetet kryesore. Shërbimi i ofrimit të internetit dhe telefonisë në zonat rurale është liberalizuar dhe aktualisht ato ofrohen nga: shërbimi i internetit nga 12 operatorë privat ndërsa telefonia në zonat rurale nga 10 operatorë privat të licensuar.
265. Objektivat për zhvillimin e sektorit përfshijnë: (i) thellimin e liberalizimit të sektorit të telekomunikacioneve dhe (ii) zgjerimin e shërbimeve dhe përmirësimin e cilësisë.
266. Masat publike prioritare që do të ndërmerren gjatë kësaj periudhe përfshijnë: (i) privatizimin e kompanisë Albtelekom; (ii) liberalizimin dhe futjen e konkurrencës në telefoninë fikse nga viti 2003; (iii) shtrirjen e shërbimit të internetit në institucionet arsimore dhe të edukimit dhe në përdorim të biznesit dhe (iv) forcimin e institucioneve rregullatore.

IV.G ZHVILLIMI I INTEGRUAR RURAL

267. Varfëria në Shqipëri shfaqet si një fenomen shumëdimensional dhe kryesisht rural (ku jeton rreth 55 për qind e popullsisë së vendit dhe mbi 80përqind e të varfërve të vendit), i shoqëruar me mungesë të theksuar të shanseve për zhvillim dhe akses të ulët ndaj infrastrukturës dhe shërbimeve, gjë që është akoma më problematike në zonat rurale malore. Megjithë reformat e kryera gjatë dekadës së fundit, diktonomia fshat-qytet vazhdon të jetë prezente. Aktiviteti kryesor në zonat rurale mbetet bujqësia, ndërsa zhvillimi i bizneseve jo-bujqësore ka filluar të shfaqet në mënyrë shumë embrionale. Nivelet e varfërisë janë relativisht të larta në grupet shoqërore, për të cilët burimi kryesor i të ardhurave është bujqësia (rreth 50 për qind e të varfërve janë të vetëpunësuar në bujqësi): kryesisht për shkak të: i) sipërfaqeve të kufizuara të tokës bujqësore (1.1 ha për familje ose 0.25 ha për person, ndërsa në zonat kodrinore dhe malore mbi 50 për qind e familjeve kanë më pak se 0.5 ha tokë për familje); ii) fragmentarizimit të lartë të bujqësisë; iii) mungesës së infrastrukturës ekonomike dhe aksesit ndaj tregut e shërbimeve të tjera bazë; iv) mbështetjes së pamjaftueshme në kreditim dhe mungesës së shërbimeve financiare; v) shkallës së ulët të përdorimit të mekanikës bujqësore dhe inpueteve të tjera, etj.

268. Objektivat strategjik që synohet të arrihen janë: (i) reduktimi i varfërisë nëpërmjet sigurimit të një rritje të qëndrueshme të prodhimit dhe të ardhurave nga bujqësia, blegtoria dhe agro-përpunimi; (ii) ruajtja dhe përmirësimi i përdorimit të burimeve natyrore; (iii) rritja e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve rurale (arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale), ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, si dhe infrastrukturës së transportit rural; dhe iv) diversifikimit të ekonomisë rurale dhe rritjes e punësimit dhe të ardhurave nga aktivitete jo-bujqësore në zonat rurale.

IV.G.1 RITJA E PRODHIMIT DHE TË ARDHURAVE NGA BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE AGRO-PËRPUNIMI

269. Duke konsideruar dimensionet e gjera të sfidave me të cilat ballafaqohen zonat rurale, zbatimi i një strategjie kombëtare të koordinuar për reduktimin e varfërisë dhe eliminimin e barrierave të rritjes dhe zhvillimin e sektorit bujqësor, është e një rëndësie të veçantë. Objektivat strategjik që synohet të arrihen në këtë fushë për periudhën 2002-2004 janë: i) ruajtja e nivelit të rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral në nivelet rreth 5për qind; ii) rritja e shkallës së përpunimit të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të peshkut; dhe iii) përmirësimi i kushteve dhe nivelit të komercializimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

270. Ritmet e rritjes së deritanishme në bujqësi janë bazuar kryesisht mbi një zhvillim ekstensiv. Ndërkohë, në vitet e ardhshme pritet një rritje më intensive e prodhimit dhe produktivitetit bujqësor e blegtoral si pasojë e rritjes së rendimenteve, futjes së varieteteve dhe hibrideve të reja, përmirësimit të nivelit të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore si dhe rritjes së përdorimit të inpueteve dhe mekanikës. Ruajtja e nivelit të rritjes në bujqësi kërkon rigjallërimin e prodhimit në nënsektorët kryesorë të bujqësisë nëpërmjet programeve sektoriale, duke synuar: (i) rritjen e aksesit ndaj faktorëve të prodhimit dhe shërbimeve bujqësore; (ii) konsolidimin e fermave dhe diversifikimit të aktivitetit të tyre;

iii) përmirësimin e gjendjes së infrastrukturës dhe shërbimeve bujqësore; iv) masat institucionale dhe organizimeve sektoriale përfshirë institucionalizimin e tregut të tokës v) përmirësimi i shkallës dhe efijencës së përdorimit të tokës bujqësore, kullotave dhe futja nën efijencë e tokave të lëna djerrë.

271. Blegtoria është një nga kontribuesit kryesorë në të ardhurat e fermës (65përqind) dhe rëndësia e saj po rritet vazhdimisht e më shumë. Duke patur parasysh këtë zhvillim të shpejtë, sidomos tre-katër vitet e fundit, i reflektuar kryesisht në rritjen rendimenteve për krerë, përparësi do të ketë: i) ngritja e një sistemi të qëndrueshëm të prodhimit blegtoral nëpërmjet nxitjes së fermerëve për ngritje dhe konsolidimin e fermave të mëdha që mbarëshojnë 10-15 krerë lopë dhe/ose 100-200 krerë bagëti të imta; ii) balancimi i prodhimit të ushqimit të kafshëve me numrin e tyre përmes përdorimit të qëndrueshëm dhe rritjes së efektivitetit të kullotave; iii) ngritja e qendrave të përmirësimit racor dhe futjes së racave të reja; iv) forcimi i shërbimit veterinar dhe rrjetit të laboratorëve; v) rritja e insiminimit artificial në gjedhë mesatarisht 5përqind në vit dhe ngritja e qendrave racore dhe aplikimi i kryqëzimeve në gjedh, të imta dhe buaj; vi) harmonizimi i legjislacionit veterinar dhe atij mbi cilësinë dhe higjenën e ushqimeve me standartet e Komunitetit Europian dhe OBT-se.

272. Kulturat bujqësore (crops). Në vitet e ardhshme, prioritet do të kenë më shumë zhvillimi i frutikulturës, vreshtarisë dhe perimeve në sera dhe fushë të hapur. Sipërfaqet e mbjella me këto kultura janë pothuajse dyfishuar në krahasim me vitet e para të tranzicionit. Kulturat industriale, si luledielli apo kultura të tjera vajore do të mund të rigjallërohen. Masat më prioritare për periudhën 2001-2004 janë: i) shtimi i numrit të drufrutorëve (pemëve frutore, agrume, ullinj), sipërfaqeve me vreshta (mesatarisht 7përqind) dhe atyre me serra (mesatarisht 10përqind); ii) futja e varieteteve të reja me prodhimtari të lartë e të përshtatshme për kushtet e vendit tonë; iii) forcimi i kontrollit fitosanitar dhe mbrojtjes së bimëve; iv) rritja e përpjekjeve për mbështetjen me kredi për ndërtimin e shërbimit e pemëtoreve të reja cilësore.

273. Rehabilitimi i ujitjes dhe kullimit. Deri në vitin 90-të, mbi 60 për qind e sipërfaqes së tokës së kultivuar ose 423,000 ha ishte e ujitshme, ndërkohë që për 267,000 ha ose 38 për qind të saj ishte siguruar dhe kullimi. Por gjatë periudhës 1990-98, sistemi i ujitjes dhe kullimit u dëmtua shumë duke e ulur ndjeshëm aftësinë ujitëse dhe kulluese. Aktualisht vetëm 54 për qind e sipërfaqes së ujitëshme ose rreth 240,000 ha janë efektive. Masat kryesore në këtë fushë janë: i) rehabilitimi i sistemit të ujitjes në 80,000 ha të rinj përqind dhe të rehabilitimi i sistemeve të kullimit në 100,000 hapërqind; ii) ristrukturimi i ndërmarrjeve të ujrave dhe forcimi i Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (SHPU) dhe Federatave të SHPU-ve; iii) përmirësimi i menaxhimit të burimeve ujore përmes dhënies së skemave të ujitjes dhe kullimit tek SHPU-të; iv) promovimi i pjesëmarrjes së fermerëve në manaxhimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujitjes.

274. Konsolidimi dhe tregu i tokës. Në Shqipëri nuk ka akoma një treg efektiv të tokës bujqësore për përdorim bujqësor. Problemit të funksionimit efektiv të tregut të tokës Qeveria i ka kushtuar një vëmendje të veçantë. Në këtë kuadër, masat kryesore për periudhën 2002-2004 do të synojnë: i) përfundimin e regjistrimit të tokës, pyjeve dhe kullotave në mbi 90përqind të zonave kadastrale (janë gjithsej 3062 zona kadastrale), ii) ngritjen e zyrave të administrimit të tokës në qendër dhe në rrethe deri në fund të gjashtë-

mujorit të parë të vitit 2002; iii) forcimin e shërbimeve kadastrale dhe plotësimin e dokumentacionit mbi pasurinë private në mbi 3.5 milion pasuri ose rreth 90përqind të tyre; iv) përgatitjen e ligjit mbi pasuritë publike dhe plotësimin e legjislacionit mbi tokën bujqësore; v) forcimin juridik dhe administrativ të strukturave lokale.

275. Mekanizimi dhe inputet bujqësore. Përdorimit të mekanikës, farave cilësore dhe inputeve në përgjithësi është mjaft i ulët (psh. sot përdoren rreth 35-40 kgLA/ha pleh kimik kundrejt 150-160kgLA/ha në 1989) gjë që reflektohet në rendimentet e ulta të përfituara. Në këtë kontekst, masat kryesore që do të merren në tre vitet e ardhshme do të jenë: i) aplikimi i skemave kompetitive për futjen e teknologjive të reja në prodhim; ii) ristrukturimi dhe forcimi i institucioneve të kontrollit dhe çertifikimit të farave dhe fidaneve; iii) mbështetja e sektorit privat të prodhimit të farave dhe fidaneve.

276. Shërbimet mbështetëse të bujqësisë. Kërkimi shkencor bujqësor sot realizohet nga një rrjet prej 14 institutesh kërkimore bujqësore në vartësi të MBU-së, si dhe nga Universitetet e vendit, kryesisht nga UBT. Nga ana tjetër, shërbimi këshillimor përbëhet sot nga rreth 300 ekspertë që u japin këshilla teknike e teknologjike, biznesi dhe marketingu fermerëve në të gjitha rrethet e vendit. Mjaft përpjekje janë bërë gjithashtu në ngritjen dhe forcimin e sistemit të inspektoriateve dhe laboratorëve të kontrollit të ushqimeve. Veprimet prioritare, për periudhën 2002-2004, në këtë drejtim do të jenë: i) rehabilitimi dhe fuqizimi i institucioneve kërkimore bujqësore dhe krijimi i qendrës kombëtare të kërkimit shkencor dhe këshillimit bujqësor; ii) rritja e peshës së kërkimit të aplikuar në përputhje me nevojat e fermerëve dhe përfshirja e përfituesve në formulimin e prioriteteve të kërkimit; iii) forcimi i shërbimit të këshillimit në të gjitha rrethet dhe vazhdimi i punës për ngritjen e një qendre kombëtare të kërkimit bujqësor të aplikuar dhe shërbimit këshillimor, dhe promovimi i kërkimit “cost-effective”; v) plotësimi i laboratoreve rajonale të kontrollit ushqimor me bazën materialo-laboratorike dhe nxitja e mbulimit të një pjese të kostos nga laboratorët përmes kryerjes së shërbimeve me pagesë ndaj klientëve.

277. **Rritja e aksesit në shërbimet financiare dhe kreditim**. Sot, egzisojnë vetëm një numër i kufizuar aktorësh që japin kredi të vogla për sektorin bujqësor dhe aktivitete të tjera jo-bujqësore në zonat rurale të tilla si Fondet e Kredive të Fshatit dhe Shoqata Kursim-Kreditit të mbështetura nga Fondi i Financimit Rural dhe Fondi i Financimit të Zonave Malore dhe disa prej tyre të mbështetura nga Liga Irlandeze e Mikro-kredisë. Megjithë punën e mirë të bërë nga këta aktorë, duke patur parasysh që kërkesa për kredi rurale vazhdon të rritet, këto iniciativa nuk janë të mjaftueshme për të realizuar atë që nevojitet. Masat që do të merren gjatë viteve që vijnë janë: i) promovimi i bankave për t’u futur me shërbime financiare në zonat rurale; ii) futja dhe zhvillimi i ndërmjetësve financiar të qëndrueshëm, si një pjesë e sektorit të gjerë financiar; iii) krijimi i një rrjeti privat të qëndrueshëm të Shoqatave të kursim-kredisë në zonat rurale duke u bazuar në Fondet fshatare të kredisë.

278. Rritja e shkallës së përpunimit të produkteve. Aktualisht, në Shqipëri përpunohet vetëm një sasi e vogël e prodhimit bujqësor e blegtoral vendas. Agro-industria kontribuon jo më shumë se 5-8 për qind të PBB-së dhe punëson rreth 5 për qind të fuqisë punëtore në nivel kombëtar. Sektori përbëhet nga afro 2000 ndërrmarje private, kryesisht të vogla. Në vitin 1999, investimet në këtë industri llogariten në rreth 2.5 miliard lekë, ose rreth tre

herë më shumë se ato të realizuara në vitin 1998. Investimet më të mëdha i përkasin sektorit të pijeve freskuese, vajit të ullirit, përpunimit të mishit, qumështit, etj. dhe janë kryer tërësisht nga sektori privat. Veprimet prioritare të qeverisë për periudhën 2001-2004 janë: i) nxitja e skemave të kreditit dhe mikrokreditit rural (shoqëritë e kursim kreditit, etj.) dhe tërheqja e investimeve të huaja në këtë sektor; ii) përmirësimi i mundësive të sigurimit dhe cilësisë së lëndëve të para; iii) futja e teknikave dhe teknologjive të reja në këtë sektor (projektet 2KR dhe ASP); iv) plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit mbi standartet, cilësinë, higjenën, etiketimin dhe ambalazhimin e produkteve agro-industriale.

279. Përmirësimi i kushteve dhe nivelit të tregtimit. Sistemi dhe strukturat e marketingut përbëjnë një nga hallkat më të dobëta të tregut të produkteve agro-ushqimore në Shqipëri. Mungesa e informacioneve për çmimet dhe elementeve të tjerë të tregut të brendshëm e të jashtëm, standartizimi, paketimi dhe etiketimi i papërshtatshëm, si dhe infrastruktura gati e pazhvilluar e marketingut, që nga pikat e grumbullimit, të ftohjes, transporti, tregjet e shumicës e pakicës etj, bëjnë që produktet agro-ushqimore shqiptare të kenë një kompetivitet të dobët në treg. Në këtë kuadër, veprimet prioritare do të jenë: i) ndërtimi dhe organizimi i tregjeve të shumicës në rrethet Tiranë, Vlorë, Korçë Lushnjë e Shkodër dhe përfshirja e përfituesve në menaxhimin dhe funksionimin e tyre; ii) ngritja e impianteve pilot të qendrave të grumbullimit të produkteve bujqësore e blegtorale dhe zgjerimi i sistemit të informacionit mbi tregjet; iii) përmirësimi dhe plotësimi i legjislacionit në drejtim të normave të higjenës, etiketimit dhe standarteve që duhen respektuar; iv) ngritja e projekteve për mbështetjen teknike dhe financiare të prodhuesve për eksport dhe krijimi i rrjetit të aktorëve për promovimin e eksporteve; v) rritja e kapaciteteve të strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe ofruesve të shërbimeve me qëllim përmirësimin e analizës ekonomike dhe të tregut si dhe sigurimin e informacionit në shërbim të fermerëve dhe agro-biznesit.

IV.G.2 RUAJTJA DHE PËRMIRËSIMI I PËRDORIMIT TË BURIMEVE TË TJERA NATYRORE

280. Degradimi i mjedisit është një nga vështirësitë më të mëdha në afatgjatë përse i përket zhvillimit të qëndrueshëm rural. Pyjet dhe kullotat zenë rreth 50 për qind (36përqind pyjet, 14përqind kullotat) të sipërfaqes së vendit. Gjatë këtyre njëzet viteve të fundit ky sektor është ndeshur me shumë fenomene negative, si shpyllëzimet pa kriter të pyjeve pas viteve 1980, dëmtimet masive dhe prerjet e pakontrolluara të pyjeve, dëmtimet dhe abandonimi i kullotave, etj. Burimet ujore të peshkimit janë gjithashtu një burim i rëndësishëm por jo i menaxhuar mirë deri tani. Si pasojë, prodhimi i peshkut në Shqipëri gjatë dhjetë viteve të fundit ka ardhur në rënie të vazhdueshme. Objektivi kryesor i strategjisë në këtë fushë do të jetë ruajtja dhe përmirësimi i përdorimit të burimeve të natyrës në tërësi. Në këtë kontekst, masat më prioritare që do të ndërmerren gjatë periudhës 2002-2004 janë: (i) ristrukturimi dhe forcimi i strukturave të menaxhimit të mjedisit në nivelin e qeverisjes vendore, kumune dhe qark; (ii) kontrolli i prerjeve të paligjshme të pyjeve; (iii) transferimi i pyjeve dhe kullotave në pronësi apo përdorim komune; (iv) plotësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin dhe gjetja e formave të menaxhimit të përbashkët shtet-komunitet të pyjeve dhe kullotave, veçanërisht përse i përket dhënies me qera afatgjatë të kullotave; (v) mbrojtja e tokave nga erozioni përmes mbjelljeve të pemëve dhe ndërtimit të pritave malore; (vi) fuqizimi dhe shtrirja e

shoqatave kombëtare dhe rajonale të mjedisit, dhe atyre të peshkimit; (vii) krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional për monitorimin dhe kontrollin e burimeve të peshkut.

IV.G.3 ZHVILLIMI I EKONOMISË JO-BUJQËSORE NË ZONAT RURALE

281. Qeveria është e vendosur të inkurajojë zhvillimin rural shumë sektorial dhe të qëndrueshëm bazuar në një Ekonomi Rurale Jo-Bujqësore (NFRE) të fortë dhe të orientuar nga rritja. Aktivitetet jo-bujqësore janë një kontribues i rëndësishëm potencial në reduktimin e varfërisë në zonat rurale, në rritjen e ekonomisë kombëtare si dhe në rritjen e mundësive të popullsisë rurale për të përfituar nga zhvillimi kombëtar. Gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit, këto aktivitete kanë marrë një zhvillim më të shpejtë në zonat fushore dhe më afër qyteteve, ku koncentrimi i faktorëve të prodhimit bën të mundur një kthim më të shpejtë të fitimeve nga investimet e bëra. Politikat zhvillimit të NFRE, gjatë periudhës 2002-2004, do të kenë për qëllim kryesor nxitjen e punësimit dhe rritjes së të ardhurave nga aktivitetet jo-bujqësore në zonat rurale. Për të arritur këtë objektiv, do të ndërmerret një strategji me dy faza.

282. Në momentin e parë mbështetja e duhur do t'i jepet zhvillimit të qendrave tregtare rurale. Në këtë fazë, rëndësi më e madhe do t'i jepet *inter alia*: i) transferimit të teknologjive të adoptueshme dhe të përbalueshme në nivel lokal; ii) implementimit të skemave të trajnimit profesional në shkollë dhe në punë; iii) shtrirjes së skemave të mikro-financimit, bazuar në Fondet e Kreditit të Fshatit dhe Shoqatat e Kursim-Kreditit; iv) zhvillimit të infrastrukturës fizike dhe përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve këshilluese; v) krijimit dhe komunikimit të bazës ligjore për organizatat e shoqërisë civile lokale dhe procedurat që lidhen me zhvillimin NFRE.

283. Në fazën e dytë, me krijimin e mundësive financiare, qendrat tregtare të krijuara do të integrohen totalisht në sistemet kombëtare të transportit dhe telekomunikacionit. Lidhja e plotë e NFRE me tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës komunikuese do të lejojë që tranzicioni i plotë nga zbutja e varfërisë rurale në një sektor rural modern të orientuar nga rritja të artikulohet në mënyrë produktive me sektorin urban dhe ekonominë kombëtare. Gjatë kësaj faze mbështetja do të shkojë kryesisht drejt: i) mbështetjes së iniciativave lokale për biznesin; ii) investimeve në zhvillimin e shërbimeve publike të nevojshëm për funksionimin e sipërmarrjeve më të mëdha; iii) punësimit në programet e punëve publike të një shkalle të gjerë; iv) përhapjes dhe themelimit të shërbimeve financiare të plota dhe moderne; v) skema trajnuese dhe shërbime kombëtare dhe ndërkombëtare që mbështesin marketingun.

Zhvillimi i infrastrukturës rurale

284. Plotësimi i nevojave të infrastrukturës rurale bazë dhe shërbimeve sociale do të realizohet si komponente e politikave sektoriale (si arsimit, shëndetësia, energjia, telekomunikacioni, etj.).

285. Uji i pijshëm dhe kanalizimet. Situata aktuale mund të shihet si rrjedhojë e mungesës së grumbullimit të të ardhurave, mbikonsumit për shkak të strukturës tarifore, dhe projektimit jo të përshtatshëm të sistemit. Nevojat për investimet e lidhjes së ujit të pijshëm në zonat rurale vlerësohen midis 150-300 milionë dollarë, ndërsa investimet e

kërkuara në rrjetin sanitar vlerësohen dhe më të larta se këto shifra. Rregullimi institucional i nën-sektorit gjatë dekadës së fundit ka ndryshuar. Deri tani, egzistojnë 52-ndërmarrje shtetërore ujësjellësi të cilat subvencionohen nga shteti, dhe janë përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit. Që nga korriku i vitit 2000, ky funksion i është kaluar pushtetit vendor (transferimi bëhet efektiv duke filluar nga janari i vitit 2002). Legjislacioni në këtë çështje akoma nuk është i plotësuar dhe strukturat për respektimin e kuadrit ligjor akoma nuk janë krijuar.

286. Objektivi i strategjisë në këtë fushë është përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së ujit të pijshëm dhe kanalizimeve: Masat prioritare në këtë aspekt do të jenë: i) ndërtimi i ujësjellësve dhe kanalizimeve në zonat rurale; ii) nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit në projektet e furnizimit me ujë dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve iii) krijimit të një Agjensie Rurale Sanitare dhe të Ujit të pijshëm për zonat rurale
287. Infrastruktura e transportit rural. Defiçitet e mëdha në infrastrukturën bazë me të cilat ballafaqohen zonat rurale, përbëjnë një pengesë madhore lidhur me reduktimin e varfërisë në zonat rurale dhe integrimin e tyre me ekonominë kombëtare. Aktualisht niveli i vendimmarrjes ndodhet në procesin e decentralizimit, duke kaluar përgjegjësitë dhe vendimmarrjen nga autoritetet qendrore (ministrinë) në autoritetet e pushtetit lokal. Rrjeti i rrugëve rurale të kaluar në administrim lokal përbëhet nga 4,137 km, i shtrirë në 379 akse dhe ka vetëm 309 km rrugë të asfaltuara. Sipas disa studimeve të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përveç rrjetit të mësipërm rrugor, egzistojnë dhe rreth 4,000 km rrugë të tjera të cilat nuk janë të inventarizuara. Në tërësi, gjithë sistemi i rrugëve rurale është thuajse jashtë kushteve teknike. Financimet e rrjetit rrugor rural kanë qenë të pamjaftueshme dhe shkalla e kufizuar e ndërhyrjeve ka bërë që këto të kenë ndikuar pak në përmirësimin e rrjetit rrugor.
288. Përmirësimet e projektuara për periudhën 2002-2004 parashikojnë: i) mirëmbajtjen dhe rikonstruktimin e një rrjeti rrugor rural të permblendhura në 920 projekte që përfshijnë një rrjet rrugor me një gjatësi prej 1,800 km, të shtrirë kryesisht në zonat Veri-Lindore dhe Jug-Lindore të vendit; ii) riorganizimi dhe përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit të rrugëve dytësore dhe terciare.

Zhvillimi njerësor në zonat rurale

289. Përsa i përket zhvillimit njerëzor në zonat rurale, strategjia ka për qëllim: i) rritjen e aksesit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të arsimit, shëndetësisë, dhe mbrojtjes sociale; dhe ii) rritjen e shkallës së vetëqeverisjes së popullsisë dhe organizatave lokale. Masat kryesore të parashikuara për këtë periudhë kanë të bëjnë me: i) përmirësimin e infrastrukturës shkollërore shëndetësore dhe sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; ii) vazhdimin e programeve të trajnimit të mësuesve dhe stafit mjekësor në zonat rurale; iii) zbatimin kohor i planit të decentralizimit dhe rritja e kapaciteteve lokale për hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve publike; iv) rritja e kapaciteteve lokale përmes trajnimit të tyre si në hartimin e politikave të zhvillimit rajonal dhe në ofrimin e shërbimeve publike; v) stimulimi i formave të shoqërizimit i shoqëruar ky me vetë format e procesit të decentralizimit dhe thellimi i autonomisë; vi) nxitja e përfshirjes së vetë komunitetit në vetëqeverisje.

IV.H ZHVILLIMI URBAN

290. Zhvillimi i qëndrueshëm urban është një objektiv themelor afatgjatë i qeverisë. Ai do të arrihet nëpërmjet programeve integrale e strategjike që do të harmonizojnë elementet bazë të hapësirës urbane: tokën, teknologjinë e shërbimet dhe bashkëjetesën e kulturën qytetare. Duke konsideruar efektet e tranzicionit, qeveria synon që në periudhën afatmesme të frenojë procesin e degradimit urban, të ulë varfërinë tashmë të shfaqur urbane si dhe të krijojë premisat e nevojshme për zhvillimin afatgjatë urban.
291. Zhvillimi urban dhe reduktimi i varfërisë urbane, i mbështetur nga zhvillimi i përgjithshëm ekonomikë dhe socialë i vendit, do të arrihet nëpërmjet politikave integrale urbane. Këto politika synojnë në: i) nxit-krijimin e një klime biznesi e cila të jetë në gjendje të tërheqë burimet e sektorit privat drejt investimeve të reja produktive në strehim, infrastrukturë, aktivitete të biznesit të vogël etj që do të rrisin kapacitetet punësuese ii) vendosjen e një kuadri të qartë dhe transparent rregulator i cili lehtëson dhe transformon ekonominë informale në ekonomi formale; iii) zhvillimin e sigurimit efektiv të shërbimeve të arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes shoqërore dhe shërbimeve të tjera publike në hapësirën urbane; iv) ruajtjen dhe rehabilitimin e pjesës së mjedisit urban; v) forcimi i sigurisë dhe rendit publik në hapësirën urbane.
292. Për periudhën e ardhshme 3-vjeçare veprimet do të përqëndrohen në (i) planifikimin dhe programimin strategjik urban, (ii) formulimin e politikave urbane, (iii) përmirësimet në kuadrin ligjor dhe intuticional dhe (iv) përmirësimin e politikave të strehimit.
293. Planifikimi dhe Programimi Strategjik Urban përbëhet nga:
- i) Formulimi i planeve strategjike të zhvillimit, duke synuar në krijimin e më tepër lidhjeve direkte midis tendencave/modeleve të zhvillimit të tokës, aktivitetet ekonomike dhe investimi në infrastrukturë, veçanërisht për zonat me rritje të shpejtë urbane, si korridori Tiranë-Durrës dhe zonat e Bashkisë së Kamzës, etj. Rishikimi i planeve strategjike kërkohet gjithashtu në zonat industriale të depresuara
 - ii) Nxitja e një zhvillimi urban të balancuar për të ulur koston e lartë afatgjatë të zhvillimit kaotik urban (e matur në problemet ambientaliste të neglizhuara, inefiçencë e përdorimit të tokës dhe kosto të tjera të larta të infrastrukturës), duke i dhënë prioritet komuniteteve joformale të periferisë së qyteteve, dhe duke i integruar ato në zhvillimin e rregullt urban.
 - iii) Ecja paralelisht e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të zhvillimit të qyteteve me zhvillimin rajonal, veçanërisht në zonën e Tiranës më të madhe.
 - iv) Formulimi i programeve për të varfërit urbanë: a) sigurimi i shërbimeve esenciale dhe aksesit në infrastrukturë (p.sh. shëndeti dhe arsimit) në komunitetet e lëna mënjanë; b) pjesëmarrja e komunitetit në të gjitha fazat e përgatitjes së projektit deri në zbatim; c) optimizimi i investimeve duke u përqëndruar në zonat me ndërtime të reja.

294. Formulimi i Politikave Urbane përbëhet nga:

- i) Shndërrimi i komuniteteve jo formale në formale nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit me bashkitë për të bërë përmirësime thelbësore në përdorimin e tokës, përmirësimin e infrastrukturës, dhe përfshirjen sociale..
- ii) Zhvendosja nga politikat e subvencionit në ato të mbulimit të kostos në projektet/programet e zhvillimit urban. Një pagesë toke për të përmirësuar infrastrukturën i është paraqitur Projektit të Menaxhimit të Tokës dhe është përkrahur nga komunitete në Laprakë dhe Bathore.
- iii) Të prezantojë politika të reja që sigurojnë standarte infrastrukture të përballueshme nga të varfërit, dhe ta vendosë çmimin e shërbimeve publike në nivelin e përballueshmërisë të të varfërve si:
- iv) Përcaktimi i politikave për të integruar komunitetet e varfëra në zhvillime të rregullta urbane përmes rregullimit të pronës mbi tokën, përmirësimit të infrastrukturës fizike, dhe shërbimet sociale. Projekti i Menaxhimit të Tokës urbane me financim nga Banka Botërore po zbaton këto politika nëpërmjet një marrëveshjeje partnershipi me shoqatat e komunitetit dhe Bashkinë e Tiranës; dhe
- v) Të komercializojë shërbimet publike (ujin e pijshëm, ujrat e zeza, energjinë elektrike, mbetjet e ngurta, etj) për të siguruar efikasitet në operimin dhe menaxhimin e shërbimeve si dhe të mbulimit të kostos me të ardhurat.
- vi) Përfundimi i procesit për kthimin dhe kompensimin e tokës me qëllim që të bëhet e mundur zbatimi i më shumë programeve për zhvillimin e tokës dhe aktiviteteve për investime private.
- vii) Zbatimi i Ligjeve për Pronat e Paluajtshme Publike për të vendosur ligjërisht pronësinë bashkiake mbi tokat publike dhe pronat e tjera publike të dhëna nga ligji, pa vonesë.

295. Përmirësimet në Kuadrin Ligjor dhe Forcimi Institucional përbëhet nga:

- i) Forcimi i kapaciteteve për qeverisjen urbane, i cili përfshin: (i) forcimin e pushtetit vendor duke i dhënë një rol efektiv në planifikimin urban dhe funksione të tjera të përshtatëshme për një ekonomi tregu; (ii) përcaktimin e kufijve të qartë të tokës publike bashkiake dhe pronave të tjera bashkiake; (iii) krijimin e kapaciteteve për ruajtjen e rendit dhe zbatimin e ligjit; (iv) zhvillimin dhe përmirësimin e tregut të tokës nëpërmjet ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe rregullator, si psh. planifikimi dhe zonimi i përdorimit të tokës, regjistrimi dhe pronësia e përshtatëshme mbi tokën, përgatitja e kodeve të ndërtimit dhe liçencat (lejet) e ndërtimit, për të bërë të mundur menaxhimin eficient të përdorimit të tokës dhe mjeteve.
- ii) Rregullimi i problemeve të pronësisë së tokës: a) përcaktimin e masave të zbatimit për të vendosur ligjërisht pronësinë e bashkisë mbi tokën publike dhe pronave të tjera të bashkisë; b) të mbledhë informacion të rregullt mbi statusin e pronësisë së tokës; c) të plotësojë kërkesat ligjore për të formalizuar vendbanimet ilegale (i.e. rregullimi i pronësisë mbi tokën dhe akte të tjera ligjore)
- iii) Zhvillimi i tregut të tokës për të rritur produktivitetin e përdorimit të tokës, lëvizjen e krahut të punës dhe transaksionet për tokën: a) finalizimin e regjistrimit të pronës së paluajtshme për të krijuar një sistem unik të pronës së kadastruar ; b) të përfundojë kuadri ligjor për një treg eficient të tokës.
- iv) Zgjerimi i burimeve financiare bashkiake nëpërmjet rritjes së burimeve lokale me anë të taksave mbi pasurinë dhe biznesin, si dhe vendosjes së tarifave për zhvillimin e tokës.

- v) Përcaktimi i treguesve monitorues për matjen e shkallës së urbanizimit në qytetet e vendit, dhe për identifikimin e tendencave dhe problemeve kryesore të cilat të mund të përdoren në procesin e formulimit të politikave urbane.

296. Politikat e Strehimit përbëhen nga:

- i) Krijimi i mekanizmave dhe kushteve të duhura, ligjore, financiare dhe institucionale për mundësi më të mira për të varfërit në tregun e banesave dhe grupeve të tjera vulnerabile, duke zbatuar strategjinë e aprovuar nga qeveria që synon në: a) uljen e financimeve shtetërore në strehim; b) decentralizimin e përgjegjësisë të strehimit ndaj pushtetit lokal; c) racionalizimin e fondeve për subvencione duke u përqendruar në familjet e varfëra që kanë nevojë më shumë; d) nxitja e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së shtëpive private. Shteti do të jetë në të ardhmen më shumë një lehtësues se sa një ndërtues shtëpish për të varfërit.
- ii) Nxitja e ndërtimit të shtëpive me kosto të ulët duke përfshirë veprimet e mëposhtme:
- Përcaktimi i nivelit maksimal dhe minimal të të ardhurave të familjeve që kanë nevojë për përkrahje nga shteti për strehim dhe përmirësimin e statusit ligjor të “të pastrehit” duke përfshirë të varfërin në legjislacion për strehim – ripërkufizohet termi “i pastrehë”
 - Të bashkërendojë kategoritë e zgjedhura për përkrahje nga shteti për strehim me nivelin e përballueshmërisë dhe burimet egzistuese financiare, private dhe publike
 - Vendosja e një minimumi standard për banesat me kosto të ulët, si edhe tipin e ndërtimit, materialet e ndërtimit, etj.
 - Të krijojë stimuj për ato firma që ndërtojnë banesa me kosto të ulët, si dhe për industrinë e materialeve të ndërtimit. Kjo do të rrisë ofertën për shtëpi me kosto të ulta, do të ulë koston e ndërtimit dhe si pasojë edhe çmimin e shitjes së apartamenteve dhe do të nxisë konkurrencë midis kompanive ndërtuese dhe të materialeve të ndërtimit. Nga ana tjetër efektet e këtij veprimi janë të lidhur me përkrahjen e firmave të vogla, rritjen e aktiviteteve ndërtuese dhe për pasojë rritjen e mundësive për punë në sektorin e ndërtimit dhe aktiviteteve të tjera të lidhura me të.
 - Futja e programeve për zhvillim të tokës për qëllime strehimi për familje me të ardhura të ndryshme. Kjo masë do të lehtësojë procesin e ndërtimit, do të rrisë ofertën për shtëpi dhe do të nxisë zhvillimin e strehimit si një mënyrë e planifikuar duke shmangur kështu zhvillimet e parregullta dhe joligjore.
- iii) Përmirësimi i sistemit financiar për strehim duke përfshirë veprimet në vijim:
- Përcaktimin e nivelit të përballueshmërisë për familjet me të ardhura të ulta për të krijuar linja krediti të përqëndruara tek ata;
 - Mobilizimi i kursimeve private për qëllime strehimi;
 - Përkrahja e skemave të kursimeve të komunitetit;
 - Mobilizimi i kursimeve të Instituteve që kanë depozita afatgjata për dhënie të kredive për shtëpi duke ofruar garanci shtetërore dhe norma të interesit tërheqëse.
- iv) Programet mbështetëse për përmirësim dhe mirëmbajtjen e shtëpive dhe komuniteteve, duke përfshirë veprimet e mëposhtme:
- Nxitje e komunitetit për të rritur përgjegjësinë në mirëmbajtje si një faktor që ndikon në vlerën e vërtetë të pronës së tyre;

- Krijimi i strukturave të menaxhimit për mirëmbajtjen e tregut egzistues të banesave
- Krijimi i mekanizmave kreditues për pronarët e apartamenteve dhe shoqata të bashkëpronësisë me synim përmirësimin e pronës së përbashkët;
- Rishikimi dhe përmirësimi (nëse është i nevojshëm) i ligjit mbi bashkëpronësinë dhe rregullimet e nevojshme në lidhje me detyrimet për mirëmbajtje të rregullt.

IV.I MJEDISI, RRIJTJA DHE REDUKTIMI I VARFËRISË

297. Politikat mjedisore synojnë që të sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm. Në një perspektivë afatgjatë do të mundësohet arritja graduale e standarteve të përshtatëshme mjedisore në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në procesin e asociimit me BE.
298. Në periudhën afatmesme synohet: i) frenimi i procesit të degradimit mjedisor; ii) krijimi i kushteve për rehabilitimin e zonave të ndotura brenda standarteve minimale të sigurisë; iii) rritja e qëndrueshmërisë së përdorimit të burimeve mjedisore.
299. Arritja e këtyre objektivave do të ketë ndikime pozitive si në cilësinë e rritjes ashtu dhe në reduktimin e varfërisë, që nga ana e tyre do të krijojnë premisa për një zhvillim dhe përdorim të qëndrueshëm të burimeve mjedisore. Ndërhyrjet në mjedis, përfshirë fondet publike, do të përqëndrohen me përparësi në ato zona në të cilat a) janë verifikuar nivele të larta të ekspozimit të njerëzve ndaj riskut ambjental, b) rrezikohen asete të konsiderueshme mjedisore dhe burimore c) dëmtimi ndikon më shumë mbi të varfërit. Masat prioritare janë:
- i) *Fuqizimi institucional*: Në këtë drejtim vëmendja do të përqëndrohet në forcimin e Ministrisë së Mjedisit, të degëve të saj dhe të inspektoriatit të mjedisit, në përcaktimin e përgjegjësive të institucioneve të tjera qëndrore dhe vendore në fushën e mjedisit dhe ngritja/forcimi i strukturave përkatëse përfshirë edhe institucionet e specializuara për parandalimin dhe për ndërhyrjet emergjente në raste fatkeqësish natyrore. Vëmendje do t'i kushtohet ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komuniteteve vendore, shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit në strukturat konsultuese dhe vendimmarrëse vendore, rajonale dhe kombëtare.
 - ii) *Adoptimi i politikave dhe instrumentave* mjedisorë: Ministria e Mjedisit do të përgatisë disa dokumenta të rëndësishme strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm. Ndër më të rëndësishmit do të jenë Plani Kombëtar i Ndërhyrjes në Mjedis 2001, strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm urban, rural, të përdorimit të tokës, të transportit, të monitorimit. Politikat mjedisore do të mundësohen nga adoptimi i instrumentave të nxitjes ekonomike dhe të kontrollit. Në politikat mjedisore përfshihen edhe adoptimi i taksës së karbonit, i taksës së ambalazhit si dhe adoptimi i standarteve të shkarkimeve të burimeve stacionare e të lëvizëshme dhe të standarteve të cilësisë së mjedisit (ajrit, ujit dhe tokës). Gjithashtu, do të adoptohen politikat dhe instrumentat e nevojshme kompensuese që minimizojnë peshën e kostove ose efekteve negative mbi të varfërit.
 - iii) *Reduktimi i ndotjes nga burime egzistuese*: vëmendja do të përqëndrohet në burimet e ndotjes, që a) janë pranë zonave të banuara; b) rrezikojnë dëmtimin e vlerave të konsiderueshme ekonomike ose kompromentojnë zhvillimin, dhe c) që rëndojnë veçanërisht mbi të varfërit. Masat konsistojnë në një numër të kufizuar ndërhyrjesh rehabilituese prioritare dhe urgjente: . a) ndërhyrjet në zonat e "Hot Spot"; b) eliminimi i lëndëve toksike c) reduktimi i ndotjeve industriale d) reduktimi i pluhurit në ajër në disa qendra urbane.
 - iv) *Masat për zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve*: në këtë drejtim do të zhvillohen një seri masash të cilat gjatë periudhës afatmesme do të krijojnë premisa për mirëpërdorimin e burimeve dhe aksesin e barabartë në to, veçanërisht të të varfërve. Në këtë fushë do të kombinohen politika që rrisin motivimin për

shfrytëzimin racional të burimeve nga vetë përfituesit me masat që rrisin aftësitë manaxheriale dhe ato që forcojnë përgjegjshmërinë. Masat do të përqëndrohen në ato burime që janë më të rrezikuara, si pyje, toka bujqësore, ekosistemet, fauna ujore. Masat do të jenë të kombinuara si: a) përcaktim dhe zbatim i të drejtave të pronësisë dhe aksesit për përdorim, përfshirë transferimin e të drejtave të pronësisë në nivel vendor në lidhje me burime të tilla vendore, si pyje, kullota, etj.; b) rikategorizimi dhe zgjerimi i sipërfaqeve së zonave të mbrojtura dhe ngritja e strukturave për mbrojtjen e tyre c) investime dhe ndërhyrje për rehabilitime në zonat e dëmtuara.

V ZBATIMI, MONITORIMI

DHE

VLERËSIMI I STRATEGJISË

V.A ROLI I SISTEMIT TE MONITORIMIT

300. Procesi i zbatimit të Strategjisë do të jetë proces i realizimit të synimeve dhe objektivave të saj. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së masave publike përkatëse janë pjesë integrale e Strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e Strategjisë, për të matur në proces shkallen e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimet e axhustimeve, veçanërisht lidhur me masat publike. Ai do të shoqërohet me ndërmarrjen e një vargu studimesh të thelluara për problemet më kryesore, duke sugjeruar rrugët për kapërcimin e tyre. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të realizohet përmes një pjesëmarrjeje të gjerë të të gjithë grupeve të interesuara. Duke qartësuar përgjegjësitë institucionale të organeve të administratës shtetërore e të pushtetit vendor dhe përmes një transparence të plotë, do të sigurohet përfshirja e shoqërisë civile, komunitetit të biznesit e veçanërisht e të varfërve.
301. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mbështetet nga ngritja dhe forcimi i kapaciteteve përkatëse institucionale. Këtë nevojë e bën më të mprehtë dhe më urdhëruese brishtësia e institucioneve ekzistuese dhe vështirësitë institucionale që u hasën gjatë procesit të hartimit të Strategjisë, veçanërisht: i) pamjaftueshmëria e informacionit administrativ dhe jo rrallë pasaktësia e tij, që shprehin edhe një shkallë relativisht të ulët të zhvillimit të sistemit statistikor në Shqipëri; ii) mungesa apo dobësia e njësive përgjegjëse institucionale, veçanërisht brenda strukturave dikasteriale e në strukturat e pushtetit vendor; iii) pamjaftueshmëria apo mungesa e studimeve të thelluara e metodologjikisht të standartizuara për probleme të zhvillimit e veçanërisht për probleme që lidhen me varfërinë. Monitorimi dhe vlerësimi do të fuqizohen progresivisht, me ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve përkatëse në të gjitha strukturat e qeverisjes, si dhe me qartësimin e roleve dhe përgjegjësi të të gjithë aktorëve pjesëmarrës në zbatimin e strategjisë.
302. Dimensionet kryesore të Monitorimit dhe Vlerësimit të SRERV janë:
- i) kapacitetet institucionale;
 - ii) treguesit e monitorimit, përfshirë vlerat e synuara të tyre përgjatë dhe në fund të periudhës tre vjeçare;
 - iii) burimet dhe instrumentet;
 - iv) shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

V.B KAPACITETET INSTITUCIONALE PËR MONITORIM DHE VLERËSIM

303. Sistemi institucional për monitorim dhe vlerësim do të shtrihet në të gjitha agjensitë kryesore të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe në strukturat e shoqërisë civile.

- i) Ministritë e linjës do të përgjigjen për monitorimin dhe vlerësimin e politikave në sektorët e tyre. Në secilën ministri do të ngrihen njësi monitoruese dhe monitorimi e vlerësimi do të bëhen pjesë e procesit të vendimmarrjes së çdo ministrie. Disa ministri kanë kapacitete në këtë drejtim dhe gjithashtu ka projekte në vazhdim për zhvillim kapacitetesh (Projekti i BB për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Arsimit), ndërsa ministri të tjera do të kenë nevojë për mbështetje;
- ii) Njësia e Monitorimit dhe Vlerësimit (NM) në Ministrinë e Punës dhe Cështjeve Sociale (MPCS) do të ketë funksione shtesë, përveç atyre të monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe treguesve me rëndësi direkte për këtë ministri. Kështu, ajo do të monitorojë varfërinë në përgjithësi si dhe do të bëjë analiza për shkaqet e varfërisë. Me ndihmën e donatorëve, pranë kësaj ministrie do të krijohen kapacitete të veçanta për analizën e LSMS, si dhe për të nxjerrë informacione të sintetizuara të vlefshme për qeverinë;
- iii) Sekretariati Teknik (ST) në Ministrinë e Financave do të luajë rolin e koordinatorit për të gjithë sistemin e monitorimit dhe vlerësimit. Ai do të mbikëqyrë procedurat e monitorimit dhe vlerësimit në të gjitha ministrinë, do të japë orientime të përgjithëshme për këtë proces, do të sigurojë që informacionet nga ministrinë të jepen në kohë dhe në formën e përshtatëshme, dhe do të përgatisë raportet për qeverinë si dhe për shoqërinë civile dhe donatorët. Në fund të çdo viti, ST do të përgatisë një raport progresi mbi shkallën e realizimit të objektivave të SRERV. Gjithashtu ST do të përgjigjet për integrimin e të dhënave të monitorimit nga ministrinë dhe sektorët e tyre në rrethet me informacionin e dhënë nga hartat e të dhënave administrative dhe buxheti³³;
- iv) Do të krijohet një njësi e veçantë (brenda ST) për të administruar databazën e hartave të të dhënave administrative;
- v) Agjensitë e zbatimit të projekteve, që menaxhojnë projektet e programet e ndryshme të donatorëve dhe ato kombëtare, do të përgjigjen për realizimin në afatet kohore të monitorimit dhe zbatimit të tyre;
- vi) INSTAT, që është një nga institucionet kyç në marrjen e të dhënave dhe në përpunimin e tyre, do të marrë përsipër kryerjen e LSMS;
- vii) ST dhe NM do të jenë përgjegjëse për kryerjen periodike të Vlerësimeve Cilësore të Varfërisë;
- viii) GKKShC do të luajë një rol të veçantë si koordinator i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Ky grup do të përgatisë në fund të çdo viti një dokument ku do të paraqiten konkluzionet dhe rekomandimet e shoqërisë civile mbi ecurinë e SRERV. Dokumenti do të përfshihet dhe në raportin e progresit të SRERV, të përgatitur nga ST. Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e monitorimit dhe vlerësimit do të jetë graduale. Ekziston rreziku i futjes


³³ Për referencë; Diagrama 1

së shumë pjesmarrësve para se instrumentat e procesit të jenë maturuar plotësisht dhe të jetë fituar një eksperiencë e konsiderueshme. Strukturat e shoqërisë civile do të luajnë një rol primar veçanërisht në tërheqjen e mendimit të përfituesve të drejtpërdrejtë nga politikat e kësaj strategjie (të varfrit, prindrit dhe mësuesit në sektorin e arsimit, etj);

- ix) Duke synuar rritjen e transparencës dhe kredibilitetit të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit, qeveria do të kërkojë, kur të jetë e nevojshme, angazhimin e agjensive të pavarura dhe të specializuara në kryerjen e vlerësimeve e të studimeve monitoruese;

304. Për ngritjen dhe bërjen funksional të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit, qeveria do të angazhojë burimet e saj njerëzore dhe materiale. Në të njëjtën kohë ajo gjykon se nevojat e këtij sistemi i kapërcejnë kapacitetet ekzistues të strukturave të saj, ndaj sikundër dhe në vetë procesin e hartimit të strategjisë, asistencë teknike shqiptare dhe e huaj në këtë drejtim do të jetë e domosdoshme.

Diagrama 1: Skema institucionale e monitorimit



V.C ZGJEDHJA E TREGUESVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT.

305. Objektivat e SRERV, i) rritja e PBB për frymë, ii) ulja e përqindjes së popullsisë që jeton nën vijën e varfërisë dhe ngushtimi i pabarazisë së të ardhurave për grupet e ndryshme sociale e zonat e ndryshme të vendit, iii) ulja e vdekshmërisë dhe e sëmundshmërisë foshnjore e amëtare, iv) rritja e shkallës së regjistrimit në arsimin tetëvjeçar dhe e zgjatjes mesatare të shkollimit, v) përmirësimi i shërbimeve jetësore ndaj popullatës, sidomos në zonat rurale e ato peri-urbane, janë shprehur dhe kuantifikuar nëpërmjet *treguesve* dhe vlerave të synuara të tyre. Treguesit janë klasifikuar në tregues finalë dhe të ndërmjetëm. Në përcaktimin e treguesve finalë dhe vlerave të synuara të tyre janë mbajtur parasysh edhe objektivat afatgjata të zhvillimit të vendit.

V.C.1 TREGUESIT FINALË

306. Treguesit finalë, sipas fushave prioritare, përfshijnë:
- i) Rritja e PBB në masën 22 - 25 përqind për periudhën tre vjeçare deri në 2004 dhe 2-3 herë për një periudhë 10-15 vjeçare³⁴.
 - ii) Përqindja e popullsisë që jeton në varfëri sipas vijës absolute të varfërisë (nën 2 dollarë/frymë në ditë) do të ulet nga 46.6përqind në vitin 1998, në 38përqind në vitin 2004 dhe 25përqind në vitin 2015. Përqindja e popullsisë në varfëri ekstreme (nën 1 dollar/frymë në ditë) do të ulet nga 17.4 përqind në vitin 1998, në 14 përqind në vitin 2004 dhe në 9 përqind në vitin 2015.
 - iii) Vdekshmëria foshnjore parashikohet të ulet nga 21/mijë lindje të gjalla në vitin 2000, në 17/mijë lindje të gjalla në vitin 2004 dhe në 10/mijë lindje të gjalla në vitin 2015; vdekshmëria amëtare nga 20/100 mijë lindje të gjalla në vitin 2000, në 15/100 mijë lindje të gjalla në vitin 2004 dhe në 11/100 mijë lindje të gjalla në vitin 2015; incidenca e rasteve të sëmundjeve diareike e parashikohet të ulet nga 1,200 për 100 mijë banorë në 600 për 100 mijë banorë në vitin 2004.
 - iv) Rritja e shkallës së regjistrimit në arsimin tetëvjeçar nga 90përqind në vitin 2000 në 94përqind në 2004 dhe në 100përqind në 2015, ndarë sipas grupeve të popullsisë dhe zonave. Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm synohet të rritet nga rreth 40përqind në vitin 2000 në rreth 50 përqind në vitin 2004. Mesatarja e viteve të shkollimit që synohet të rritet nga 9.5 vjet në vitin 1998 në 10 vjet deri në 2004.

V.C.2 TREGUESIT E NDËRMJETËM

307. Treguesit e ndërmjetëm përfshijnë:
- i) *Tregues të punësimit, ndihmës ekonomike dhe përkujdesit shoqëror*: përqindja e papunësisë dhe struktura e saj sipas moshës, profesionit dhe zonave gjeografike (synohet ulja nga 14 përqind në 2001 në 12 përqind në 2004); përqindja e të papunëve që kërkojnë shërbime dhe numri i shërbimeve që ofrohen nga zyrat e punës (krijimi i 60 mije vendeve të reja të punës nga programet e punësimit gjate

³⁴ Treguesit kryesorë makroekonomik japin në Aneksin 3, Kuadri Makroekonomik 2002 – 2004.

viteve 2002 – 2004); përqindja e të varfërve që përfitojnë ndihmë ekonomike; përqindja e mbulimit të territorit me shërbime sociale, numri dhe llojshmëria e tyre, raporti kontribues-përfitues në sistemin e sigurimeve shoqërore me synim rritjen e numrit të kontribuesve; përqindja e shpenzimeve dhe e subvencionit për sigurimet shoqërore në raport me PBB, koeficienti i mbulimit dhe i zëvendësimit në sigurimet shoqërore.

- ii) *Tregues të investimeve*: investimet totale (nga 19 përqind e PBB në vitin 2000, parashikohet të arrijnë në 21-22 përqind në vitin 2004); investimet publike (nga 6.5 përqind e PBB në vitin 2000 do të arrijnë në 8.3 përqind³⁵ në vitin 2004).
- iii) *Tregues të financimit të sektorit privat*: vëllimi i kredisë në ekonomi parashikohet të rritet mesatarisht me 30 përqind në vit për tre vitet e ardhëshme.
- iv) *Zhvillimi njerëzor: Arsimi*. Shpenzimet për arsimin si përqindje ndaj PBB do të rriten nga 3.4 përqind në vitin 2001 në 3.7 përqind e PBB në vitin 2004. Tregues të tjerë monitorues të arsimit do të jenë: përqindja e mësuesve pa arsim përkatës në arsimin tetëvjeçar dhe të mesëm dhe numri i personelit mësimor ndaj numrit të nxënësve.
- v) *Zhvillimi njerëzor: Shëndetësia*. Shpenzimet për shëndetësinë do të rriten nga 3 përqind e PBB në vitin 2001 në 3.2 përqind e PBB në vitin 2004. Tregues të tjerë monitorues të shëndetësisë do të jenë: numri i mjekëve për 1,000 banorë; përqindja e mbulimit me vaksina të popullsisë (synohet mbulimi 100përqind për fëmijët deri në 2 vjeç dhe mbi 98përqind për pjesën tjetër të popullsisë), numri farmacistëve për 1000 banorë, numri i stomatologëve për 1000 banorë, numri i infermierëve për 1000 banorë, numri i shtretërve për 1000 banorë.
- vi) *Përmirësimi i infrastrukturës*; Shpenzimet publike në sektorin e transportit dhe komunikacionit nga 2.4 përqind e PBB në vitin 2001, do të rriten në 3.1 përqind e PBB në vitin 2004; shpenzimet për punët publike (uji, kanalizime) nga 1.2 përqind e PBB në vitin 2000 do të rriten në 2 përqind në vitin 2004;
- vii) *Zhvillimi urban, rural dhe ambjenti*: ulja e numrit të të pastrehëve; rritja e shkallës së urbanizimit në zonat peri-urbane³⁶; rehabilitimi i rrugëve kryesore rurale me rreth 1800 km deri në 2004; rritja e shkallës së përdorimit të tokës në përgjithësi me rreth 20përqind deri në 2004; rritja e sipërfaqjes e tokës bujqësore me sistem ujitje dhe kullimi deri në përkatësisht 50përqind dhe 70përqind të sipërfaqes që kërkon rehabilitim deri në 2004; reduktimi i ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike; ulja e shkallës së ndotjes së ajrit; sipërfaqet e pyllëzuara; shkalla e neutralizimit të lëndëve toksike.

308. Treguesit e mësipërm do të diferencohen sipas zonave të ndryshme të vendit (duke mbajtur parasysh ndarjen në zona urbane e rurale dhe shkallën e zhvillimit ekonomik të tyre), dhe sipas gjinisë.

³⁵Ky tregues i referohet PAB Tabela 10. Treguesit në vazhdim janë sipas PAB Tabela 14.

³⁶ Ky tregues do të sintetizojë tregues në lidhje me përqindjen e popullsisë që shërbehet nga sistemi i ujit të pijshëm, kanalizimeve, dhe energjisë elektrike (zona peri-urbane dhe urbane).

V.D BURIMET DHE INSTRUMENTAT E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT.

V.D.1 BURIMET

309. Burime të marrjes së të dhënave për qëllime të monitorimit do të jenë:

- i) *Për treguesit e ndërmjetëm:* Në nivel kombëtar, të dhënat për PBB, konsumin, investimet, çmimet, importin, eksportin do të nxirren nga sistemi kombëtar i llogarive dhe statistikave tregtare nëpërmjet INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë. Të dhënat për financat publike, të ardhurat, shpenzimet si dhe ndarjet e tyre sipas rajoneve dhe sektorëve do të kenë si burim Ministrinë e Financave dhe ministritë e tjera. Në nivel lokal do të merren të dhëna kryesisht në lidhje me cilësinë e shërbimeve dhe peshën që zënë ato në nivel kombëtar. Për nxjerrjen e këtyre të dhënave do të shërbejnë administratat lokale të bashkive dhe komunave si dhe të dhëna nga ministritë sipas sektorëve (Institute në nivel kombëtar dhe vendor si dhe Agjensi të pavarura).
- ii) *Për treguesit finalë:* vëzhgime dhe anketime të familjeve dhe individëve si dhe studime që do të shfrytëzojnë të dhënat mbi treguesit e tjerë sasiorë dhe cilësorë. Të dhëna kryesore do të mblidhen në lidhje me përdorimin e shërbimeve dhe që do të kenë të bëjnë me konsumin dhe të ardhurat e familjeve duke krijuar bazën për të dhënat mbi kushtet e jetesës dhe treguesit shoqërorë. Anketimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat e familjeve janë burimi kryesor për këta tregues. Regjistrimi i popullsisë që u zhvillua nga INSTAT, do të shërbejë për këtë qëllim. Një shpërndarje më konkrete të burimeve për marrjen e të dhënave në lidhje me treguesit e monitorimit e jep tabela më poshtë.

Tabela 2: Të dhëna mbi monitorimin dhe burimet

TË DHËNA	BURIMI	AGJENSIA
PBB, Konsumin, investimet, eksportin, importin etj.	Sistemi i llogarive kombëtare, statistikave e tregtisë.	INSTAT, BSH.
Financat publike	Buxheti.	MF, Ministrit e tjera.
Indeksi i çmimeve të konsumatorit dhe të prodhuesit	Anketime të çmimeve dhe pagave.	INSTAT, BSH.
Niveli i varfërisë në Shqipëri, kushtet e jetesës, treguesit shoqërorë	Buxheti i familjeve, shpenzimet të ardhurat.	INSTAT – (LSMS).
Shpërndarja e varfërisë, dimensionet, prioritetet (treguesit e shëndetësisë, arsimit etj)	Harta Administrative e Varfërisë.	Njësia e Monitorimit, Ministritë sipas sektorëve, Institute kërkimore.

310. Disa aspekte të rëndësishme në mbledhjen e të dhënave janë: (i) Mbledhja në mënyrë sistematike e të dhënave mbi treguesit e rëndësishëm, me qëllim vlerësimin e ndryshimeve si rrjedhojë e ndërhyrjeve nëpërmjet masave publike prioritare; (ii) Përcaktimi i drejtë i nivelit të mbledhjes së të dhënave në nivel kombëtar, rajonal, gjinisë, moshës etj; (iii) Grumbullimi dhe përpunimi i saktë i të dhënave; dhe (iv) Përfshirja e

përfituesve dhe sidomos e shtresave të varfëra të shoqërisë në monitorimin e të dhënave dhe në marrjen e vendimeve. Këto aspekte të mbledhjes së të dhënave do të arrihen nëpërmjet përmirësimit të sistemit statistikor të bazuar në regjistrimin dhe përpunimin kompjuterik të tyre, duke identifikuar prioritetet për nevojat statistikore dhe fuqizimin e zyrave statistikore, sidomos në njësitë lokale. Procesi i mbledhjes së të dhënave do të jetë: a) sistematik, b) i diferencuar sipas zonave të vendit dhe grupeve shoqërore, c) eficient

V.D.2 INSTRUMENTET

311. Anketime të plota për Matjen e Standarteve të Jetesës (LSMS) do të kryhen në vitet 2002 dhe 2005. Anketime në përmasa më të vogla do të kryhen çdo vit brenda këtij intervali kohor. Të gjitha këto anketime do të realizohen nga INSTAT, do të financohen nga DFID dhe do të ketë asistencën e Bankës Botërore. Anketimi i parë do të vlerësojë nivelin bazë të varfërisë në Shqipëri, nivel i cili do të vazhdojë të gjurmohet nga anketimet më të vogla që vijnë. Gjithashtu ai do të konturojë profilin e varfërisë (shpërndarjen rajonale, tipet e familjeve të prekura, rolin e edukimit dhe shërbimeve shëndetësore etj) në mënyrë që të mundësojë ndërmarrjen e politikave ndërhyrëse me synime të caktuara për reduktimin e saj.
312. Një mjet tjetër monitorimi do të jetë dhe Vlerësimi Cilësor i Varfërisë (një vlerësim i tillë është bërë në 2001 me ndihmën e BB), i cili do të synojë të analizojë në thellësi profilin, shkaqet dhe pasojat e varfërisë. Ai do të shërbejë edhe për të sjellë mendimin e të varfërve për problemet e tyre si dhe zgjidhjet alternative ekzistuese. Mes dy studimeve do të ketë lidhje metodologjike, ku përfundimet e njërit do të shërbejnë për përgatitjen e tjetrit dhe anasjelltas.
313. Harta Administrative të Varfërisë, e cila ka të bëjë me (i) mbledhjen në qendër të të dhënave administrative nga burime të ndryshme si dhe (ii) lidhjen e këtyre informacioneve me të dhëna nga buxheti dhe LSMS. Kjo lidhje do të lejojë mundësinë e krijimit të “hartave” që do të bëjnë të mundur të thellohet analiza e situatës në vend. Hartat e të dhënave administrative do të përdoren gjithashtu në marrjen e vendimeve për shpërndarjen e burimeve. Një eksperiencë e mirë në këtë drejtim ka nisur me projektin pilot të zbatuar në Rrethin e Lushnjes³⁷.
314. Anketimet e herëpashershme të përfituesve të shërbimeve do të jenë gjithashtu instrument i rëndësishëm i monitorimit dhe vlerësimit. Një nga format e realizimit të tij do të jetë dhe anketimi me zgjedhje i familjeve nëpërmjet një karte raportuese e cila do të fokusohet në shërbimet e kryera nga qeveria dhe nivelin e plotësimit të nevojave të tyre.

³⁷ Studim nga ekspertë të Bankës Botërore.

V.E SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

315. Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen dhe përdoren për të bërë të njohur progresin në uljen e varfërisë dhe në objektivat e tjera të SRERV, si dhe për të ndikuar në veprimet e mëtejshme. Pasi të dhënat të jenë mbledhur në mënyrë të plotë dhe përfundimtare ato do të shpërndahen midis përdoruesve të cilët do të jenë;
- i) Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore;
 - ii) Shoqëria civile;
 - iii) Sektori privat;
 - iv) Donatorët e huaj;
 - v) Media;
 - vi) Publiku në përgjithësi.
316. Përgjegjësitë kryesorë për përgatitjen dhe shpërndarjen e rezultateve do të jenë; (i) Njësia e Monitorimit në MPCs dhe njësitë e tjera monitoruese sipas ministrive të linjës dhe (ii) Sekretariati Teknik në MF, të cilat do të hartojnë raporte ad-hoc dhe periodik mbi treguesit e monitorimit dhe vlerësimit. Gjithashtu publikimi i rezultateve do të bëhet dhe nëpërmjet medias, por dhe duke organizuar seminare për të diskutuar e për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë duke angazhuar në mënyrë të veçantë shoqërinë civile.
317. Krahas shpërndarjes së këtyre raporteve tek përdoruesit, forma të tjera të komunikimit do të përfshijnë seminare dhe konferenca me karakter njohës dhe promovues, broshura dhe fletë-palosje, publikime në media, debate publike, krijime faqesh interneti, etj.

VI ANEKSI 1: MATRICAT

E

PLANEVE TË VEPRIMIT

Fusha/ Sektori	Objektivi	Masat Publike Prioritare	Institucioni Përgjegjes	Afati Kohor	Efektet në Buxhet (milionë. Lekë)
Kuadri Makro- ekonomik	1. Ruajtja e ritmeve të rritjes ekonomike (Sigurimi i një rritjeje ekonomike prej 7-8 për qind në vit)	1. Thellimi i reformave strukturore dhe institucionale. 2. Nxitja e rritjes së investimeve private të brendshme dhe të huaja nëpërmjet: - nxitjes së kreditimit të ekonomisë; - ngushtimit të diferencës midis normës së interesit për depozitat dhe për kreditë; - përsheptimit të procesit të privatizimit 3. Nxitja e rritjes së investimeve publike të orientuara në përmirësimin e infrastrukturës dhe ruajtjen dhe formimin e kapitalit njerëzor 4. Ruajtja e ritmeve të larta të rritjes së ndërtimit, shërbimeve dhe transportit; ruajtja e ritmeve të rritjes së bujqësisë dhe nxitja e prodhimit të industrisë përpunuese.	Qeveria	2001-2004	
	2. Thellimi i Stabilizimit Makroekonomik (Ruajtja e inflacionit në nivelin 2-4 për qind)	1. Respektimi i objektivave sasiorë nga ana e Bankës së Shqipërisë 2. Ruajtja e qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit 3. Mbajtja nën kontroll e defiçitit buxhetor 4. Perfeksionimi i instrumentave të tregut në politikën monetare	Qeveria, Banka e Shqipërisë	2001-2004	
	3. Thellimi i konsolidimit fiskal (Ulja e defiçitit buxhetor nga 9,1 për qind e PBB në vitin 2000 në 6,5 për qind e PBB në vitin 2004)	1. Rritja e të ardhurave me ritme më të shpejta se shpenzimet nëpërmjet përmirësimit të administrimit fiskal dhe zgjerimit të bazës së tatueshme 2. Përdorimi eficient i shpenzimeve 3. Planifikimi konsistent kohor i të ardhurave dhe shpenzimeve	Qeveria, Ministria e Financave	2001-2004	
	4. Thellimi i hapjes dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë (-Ulja graduale e defiçitit të llogarisë korente nga 6,9 për qind e PBB në vitin 2000 në 6,7 për qind e PBB në vitin 2004. -Rritje e rezervës valutore në nivelin 4,7 muaj importe në vitin 2004.	1.Permiresimi i pozicionit te bilancit tregtar duke konsideruar politika dhe instrumente të përshtatshëm për zëvendësimin e nje pjese te importeve dhe duke krijuar kushtet per nxitjen e eksporteve. 2.Avancimi drejt marrëveshjeve të tregtisë së lirë bilaterale dhe multilaterale në rajon dhe më gjërë	Qeveria, Banka e Shqipërisë	2001-2004	

Fusha/ Sektori	Objektivat	Masat Publike Prioritare	Institucioni Përgjegjës	Afati Kohor	Efektet në Buxhet (milionë Lekë)
Zhvillimi i Sektori Privat	1. Nxitja e sipërmarrjes së lirë	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Lehtësimi i procedurave të hyrjes në biznes. - reformimi i institucioneve të licensimit dhe të lejeve të ndërtimit; - rritja e transparencës së organeve të administratës tatimore dhe doganore nëpërmjet publikimit të urdhërave dhe udhëzimeve; krijimit të zyrave të informimit publik pranë çdo ministrie; instalimin e linjave telefonike për regjistrimin e ankesave. ◆ Krijimi i zyrave të informacionit publik praën çdo ministrie ◆ Nxitja e kreditimit dhe përmirësimit të kushteve të financimit të sipërmarrjes private - ngritja e Zyrës së Informacionit të Kredisë; - përmirësimi i transparencës dhe informacionit së tregut nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit mbi kontabilitetin dhe auditimin dhe të institucioneve të kontrollit dhe auditimit; - përmirësimi i zbatimit të legjislacionit mbi kolateralin; - përmirësimi i legjislacionit tregtar, veçanërisht bërja efektive e ligjit të ri mbi falimentimin; - 	<p>Qeveria Ministritë e linjës Ministria e Financave</p> <p>Qeveria Banka e Shqipërisë</p>	<p>2001 – 2003</p> <p>2001 – 2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004</p>	
	2. Fuqizimi i institucionalizimit dhe formalizimit të tregut	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi institucional dhe ligjore për nxitjen e konkurrencës së lirë në treg. - forcimi i Drejtorisë së Konkurrencës dhe Komisionit të Konkurrencës dhe plotësimet ligjore të nevojshme; - fuqizimi i Enteve Rregullatore; - krijimi dhe fuqizimi i strukturave të informacionit të biznesit; ◆ Përmirësimi i marrëdhënieve të biznesit me administratën tatimore dhe doganore. - përmirësimi i procedurave të rimbursimit të taksave; - kompjuterizimi i degëve të tatimeve në rrethe; - trainimi i administratës tatimore dhe doganore; - ngritja e Komisionit të Pavarur për Apelimin e Taksapaguesve. ◆ Rritja e sigurisë dhe aksesit ndaj tokës. - Përfundimi i kartografisë për zonat kadastrale të mbetura 	<p>Qeveria Ministria e Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik</p> <p>Ministria e Financave Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit</p>	<p>2002-2004</p> <p>2002</p> <p>2001-2002</p> <p>2001-2004</p> <p>2002</p> <p>2002</p>	

	3. Mbështjetja e zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Miratimi i ligjit për SME-të; ◆ Përgatitja e kuadrit ligjor për krijimin e agjencisë së SME-ve dhe bërja funksionale e tij; ◆ Përmirësimin e kuadrit ligjor për zhvillimin dhe fuqizimi i aktivitetit të skemave të mikro-kredive; ◆ Krijimi i Fondit të Garantimit të Kredive; ◆ Fuqizimi dhe zgjerimi i inkubatorëve të biznesit. 	Qeveria Ministria e bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, B.SH.	Mars 2002 2002 2001-2004 2002 2002-2004 2002 - 2003	145 1,450 145
	4. Nxitja e Investimeve të Huaja Direkte	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Krijimi i Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja si një 'one-stop service shop' në ofrimin e shërbimeve për investitorët e huaj. ◆ Zhvillimi i zonave të lira dhe parqeve industriale; ◆ Krijimi dhe bërja funksionale e bazës së të dhënave që lehtësojnë vendimmarrjen e investitorëve të huaj. 	Qeveria Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, INSTAT	2001 2002-2004 2002	
	5. Nxitja e eksporteve	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Miratimi i strategjisë për nxitjen e eksporteve; ◆ Rishqyrtimi dhe përmirësimi i legjislacionit me synim nxitjen e eksporteve; ◆ Krijimi i Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve; ◆ Zhvillimi i programeve promovuese të eksporteve ◆ Zhvillimi i funksioneve të garantimit të transaksioneve të eksportit nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Garancisë. 	Qeveria Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	2001 2002-2003 2002 2002-2004 2002-2004	
Zhvillimi i Sektorit Financiar	1. Riskstrukturimi dhe fuqizimi i tregut financiar	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit për funksionimin e tregut të kapitaleve; ◆ Privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe kompanisë shtetërore të sigurimeve INSIG; ◆ Zhvillimi i skemës së garantimit të depozitave; ◆ Forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të sistemit financiar 	Ministria e Financave Banka e Shqipërisë	2001-2004 2002 2001 2001-2004	
	2. Nxitja e përmirësimit të shërbimeve bankare	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nxitja e konkurrencës midis bankave; ◆ Hartimi dhe zbatimi i sistemit të pagesave në kohë reale bruto (RTGS); ◆ Nxitja e diversifikimit të produkteve dhe shërbimeve bankare dhe financiare; ◆ Nxitja e zgjerimit territorial të rrjetit bankar. 		2001-2004 2001 2001-2004 2001-2004	

Fusha/ Sektori	Objektivat	Masat Publike Prioritare	Institucioni Përgjegjës	Afati Kohor	Efektet ne Buxhet (milionë Lekë)
Shëndetësia	<p>1. Permiresimi i efikasitetit dhe eficences ne perdorimin e burimeve</p> <p>a. Permiresimi i procesit te planifikimit, shperndarjes se burimeve dhe monitorimit te perdorimit te tyre ne nivel qendror dhe lokal</p> <p>b. Minimizimi i korrupsionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Trainimi i personelit qe do te angazhohet ne procesin e planifikimit ◆ Kryerja e studimeve per njohjen e sakte te nevojave ne disa nga aspektet me te rendesishem te sistemit ◆ Hartimi i dy masterplaneve rajonale ◆ Permiresimi i menyres se financimit te sistemit duke synuar ne rradhe te pare fuqizimin e ISKSH ◆ Decentralizimi i vazhdueshem i kompetencave. ◆ Krijimi i njesise se monitorimit ne MSH. <ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi dhe zbatimi i një programi për kufizimin e korrupsionit 	M. Shendetesise Donatoret: (DFID, ÈHO, Banka Boterore)	2002-2003	72.5
				2002-2003	130.5
				2002 – 2004	87
				2002 - 2004	43.5
				2002 -	72.5
	<p>2. Sigurimi i aksesit per sherbime shendetesore ne te gjithë territorin dhe permiresimi i cilesise se tyre</p> <p>a. Mbulimi 100përqind e territorit me QSh dhe 50 përqind me ambulanca</p> <p>b. Riorganizimi i sherbimit spitalor duke synuar krijimin e spitaleve rajonale</p> <p>c. Mbulimi i shërbimeve me personelin e nevojshëm në të gjithë territorin</p>	<p>a. Ndertimi dhe rehabilitimi i rreth 80 QSH dhe rreth 400 Ambulancave, pajisja e tyre me mjetet e nevojshme dhe trainimi i personelit.</p> <p>b. Transformimi i 5 spitaleve te medhenj ne spitale rajonale</p> <p>c. Motivimi i personelit që punon në zonat rurale dhe të largëta për të penguar rrejdhen e tij drejt qyteteve të mëdhenj.</p>	M. Shendetesise Donatorët	2002-2004	1,740
				2002-2004	3,625
				2002-2004	609

	<p>3. Permiresimi i treguesve te shendetit nepermjet nderhyrjeve specifike</p> <p>a. Te parandalohen semundjet ngjitesse te EPI-t,</p> <p>b. Të parandalohet përhapja e TBC, HIV-AIDS dhe SST, etj.</p> <p>c. Të sigurohet ulja e kërkesës për drogë, alkool dhe duhan.</p> <p>d. Te sigurohet parandalimi i semundjeve diareike dhe i epidemive.</p> <p>e. Te sigurohet nje sherbim me i plote komplet dhe cilesor per nenen dhe femijen duke synuar nje reduktim prej 15 përqind te vdekshmerise dhe asaj amtare.</p> <p>f. Te zgjerohen sherbimet e ofruara ne fushen e shendetit mendor</p> <p>g. Të monitorohen dhe të koordinohen sa më mirë programet e veçanta në fushat e mësipërme.</p>	<p>a. Sigurimi i mbulimit 100 përqind te femijeve deri ne dy vjec me vaksina. Zgjerimi i grup moshave dhe perfshirja graduale e vaksinave te reja te EPI-t. Përfshirja graduale e MSH në financimin e tyre.</p> <p>b. Sigurimi i vazhdimesise se programeve ne fushat perkatese dhe zgjerimi i tyre</p> <p>c. Permiresimi dhe zgjerimi i programeve ne fushat perkatese. Hartimi i strategjive dhe forcimi i bazes ligjore</p> <p>d. Përmirësimi i sistemit të survejances ne rrethe (laboratore, pajisje, trainim) qe do te sigurojne kontrollin e cilesise se ujit te pishem dhe ushqimeve.</p> <p>e. Zgjerimi i rrjetit te konsultoreve te nenes dhe femijes dhe sigurimi i kushteve te pershtatshme per pune ne to, sigurimi i pajisjeve te nevojshme dhe trainimi i stafit.</p> <p>f. Hartimi i strategjise se Shendetit Mendor. Sigurimi i vazhdimesise se projektit te OMS-it ne kete fushe, dhe zgjerimi i tij ne 4 rrethe te tjera (ngritja e qendrave komunitare me ekipe multidisiplinare qe do te sigurojne integrimin ne komunitet te personave qe dalin nga spitali).</p> <p>g. Implantimi i një sistemi informacioni për programet dhe treguesit e shëndetit publik.</p>	M. Shendetesise Donatorët	<p>2002-2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004</p>	<p>87</p> <p>290</p> <p>217.5</p> <p>290</p> <p>145</p> <p>174</p> <p>50.75</p>

Fusha/ Sektori	Objektivat	Masat Publike Prioritare	Institucioni Përgjegjës	Afati Kohor	Efektet në Buxhet (milionë Lekë)
Arsimi	1. Rritja e efektivitetit të administrimit publik dhe e eficientës financiare të sistemit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i strategjise se reformes administrative dhe financiare <ul style="list-style-type: none"> ➤ Racionalizimi i funksioneve te sektorit në nivelet qëndror, vendor dhe shkollë. ➤ Krijimi ose fuqizimi i strukturave te reja ne MA ne lidhje me funksionet e planifikimit dhe analizës së politikave, , menaxhimin të burimeve njerëzore dhe menaxhimit financiar ➤ Ngritja e njësinë e monitorimit të SRERV . ➤ Zbatimi shkalle shkalle i reformes administrative dhe financiare duke filluar me projekte pilot 2. Hartimi dhe zbatimi i programit te trainimit për stafin drejtues në nivelet qëndrore, vendor dhe shkollore me qëllim forcimin e aftësive të punonjësve në përballimin e përgjegjesive të reja funksionale. 	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Departamenti i Administrimit Publik	2003 2002 2002 2002-2004	5.8
	2. Rritja e pjesëmarrjes në arsimin bazë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Analizimi i faktorëve që ndikojnë në kërkesën për arsimin bazë nga nëngrupet e familjeve që priren për braktisjen e shkollës. 2. Hartimi dhe pilotimi i programeve që synojnë të rrisin pjesëmarrjen në shkollë të këtyre nëngrupeve. 3. Pilotimi i projektit te perdorimit te autobuzave shkollorë në pesë zona ku ka akses për këtë shërbim. 4. Përgatitja dhe zbatimi i paketës ligjore për mbështetjen financiare të fëmijve të familjeve të varfëra. 5. Vazhdimi i ristrukturimit te shkollave ne zonat urbane dhe ngritja e shkollave te reja ne zona periurbane 	Parlamenti MASH INSTAT	2002 2002-2004 2002 2002-2004 2002-2004	145 704.7
	3. Rritja e cilësisë së personelit mësues	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja dhe ristrukturimi i pagave te personelit mesimor me 12përqind në vit (2/3 për rritjen e pagës bazë të mësuesve dhe 1/3 për reformën strukturale të pagave) 2. Rritja e kompensimit financiar për mësuesit që punojnë në zona me disavantazhe. Studimi paraprak i faktorëve që do të tërhiqnin mësuesit e mirë në zonat rurale ose në zona të vështira peri-urbane. 3. Hartimi dhe testimi i programit te trainimit për mësuesit pa arsimin përkatës. 4. Identifikimi i mësuesve që duhet të trainohen, planifikimi i trainimit dhe zbatimi i tij. 	Qeveria MASH MOF	2002-2004 2002-2004 2002-2004 2002-2004	4,350 1,450 58

	4. Zgjerimi i pjesëmarrjes në arsimin e mesëm profesional dhe përshtatja më e mirë e tij ndaj nevojave të tregut	<ol style="list-style-type: none"> 1. Decentralizimi i kurrikulës së arsimit profesional 2. Përgatitja e kuadrit legjislativ që do të mundësojë ngritjen e shkollave profesionale mbi bazën e planifikimit rajonal të nevojave të tregut të punës. 3. Botimi i materialeve të mësimdhënjes dhe mësimnxënies që mbështesin kurrikulën e re. 4. Ristrukturimi ose ngritja e pesë shkollave të arsimit dhe formimit profesional, me konvikt, në përfitim të zonave rurale dhe peri-urbane. 5. Hartohtimi, pilotimi dhe zbatimi i ritrainimit të mësuesve të shkollave profesionale. 	Kuvendi, MA,	2002-2004 2003-2004 2002-2004 2002-2004 2002-2004	 21.75 435 43.5
--	---	---	--------------	---	------------------------------

Fusha/ Sektori	Objektivat	Masat Publike Prioritare	Institucionet Pergjegjese	Afati Kohor	Efektet në Buxhet (mln Lekë)
Tregu i Punës	1. Nxitja e punezenies nepermjet formimit profesional	Pergatitja e strategjise se formimit profesional Studimi i kerkeses dhe ofertes per fuqine punetore dhe profesionet Rritja e numrit te qendrave te formimit profesional Plotesimi i kuadrit ligjor ne fushen e aresimit profesional	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	2002 - 2004	76 (2002) 86 (2003) 92 (2004)
	2. Thellimi i institucionalizimit dhe formalizimit te tregut te punes	Rritja e numrit te sherbimeve te punesimit Kualifikimi i nepunesve ne drejtim te cilesise se sherbimeve Nxitja e formimit dhe fuqizimit te institucioneve private qe ofrojne sherbime punesimi	Sherbimi Kombetar i Punesimit	2002-2004	Pagese papunesie 1,800 (2002) 1,800 (2003) 1,800 (2004)
	3. Rritja e nivelit te punesimit	Krijimi i fondit kombetar te punesimit Nxitja e zhvillimit te SMEve Implementimi i programit te puneve publike Implementimi i programit te puneve komunitare		2003-2004	Nxitje punesimi 500 (2002) 500 (2002) 500 (2002)
Ndihma Ekonomike	1. Rritja e shkalles se mbulimit te te varferve	Krijimi i fondit te mbrojtjes shoqerore Identifikimi dhe matja e treguesve ekonomike dhe sociale, vleresues te situates ekonomike dhe sociale te rajoneve te vendit Alokimi i fondeve nga buxheti qendror ne bllok duke u mbeshtetur teresisht ne rrjetin e treguesve ekonomike dhe sociale Decentralizimi i plote i skemes Plotesimi i kuadrit ligjor Kualifikimi i nepunesve	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	2002 - 2004	6,000 (2002) 6,940 (2002) 7,635 (2002)
	2. Rritja e shkalles se mbulimit te nevojave ekonomike dhe sociale te familjes nepermjetndihmes ekonomike	Krijimi i bazeve te dhenave mbi situaten ekonomike dhe sociale te shtresave te shoqerise Harmonizimi i ndihmes ekonomike me mekanizmat e tjere te mbrojtjes shoqerore Orientimi i sistemit gradualisht tek minimumi jetik Reformimi i kuadrit ligjor ne drejtim te nxitjes se programeve aktive Pergatitja e modelit te perfshirjes se te varferve ne biznes social Kualifikimi i nepunesve	Administrata e Pergjithshme e Ndhimes dhe Sherbimeve Sociale	2002-2004	70 (2002) 89 (2003) 150 (2004)
	3. Implementimi i programeve aktive te mbrojtjes shoqerore	Llogaritja e minimumit jetik Percaktimi i mundesive te mbulimit			2003

Perkujdesi Shoqeror	1. Mbulimi i plote i territorit me sherbime sociale ne perputhje me nevojat sasiore dhe cilesore te kategorive shoqerore vulnerabile apo ne risk	Hartimi i strategjise se sherbimeve sociale Permiresimi i legjislacionit ne drejtim te decentralizimit te plote te sherbimeve Kualifikimi i administrates Bashkepunimi me organizatat joqeveritare Financimi nga fondi kombetar i mbrojtjes shoqerore Harmonizimi me skemen e ndihmes ekonomike Krijimi i qendrave ditore lokale te trajtimit te kategorive ne nevoja specifike	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	2002 2004 2002 2002-2004 2002-2004 2003-2004	3,597 (2002) 3,960 (2003) 4,355 (2004)
	2. Rritja e numrit te sherbimeve sociale ne institucionet dhe permiresimi i cilesise	Zgjerimi i bashkepunimit me donatoret Kualifikimi i stafit Perfshirja e Fakultetit te Punes Sociale	Administrata e Pergjithshme e Ndhimes dhe Sherbimeve Sociale	2003-2004 2002-2004 2002-2004 2002	700 (2002) 826 (2003) 838 (2004)
Sigurimet shoqerore	1. Rritja e numrit te kontribuesve	Perfshirja e popullsise rurale ne kontributet per sigurime shoqerore Eliminimi I diferencave ne pensione Permiresimi i legjislacionit Konvergimi i dy skemave te qytetit dhe te fshatit ne nje te vetme Permiresimi i kontrollit, monitorimit	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	2002-2004	1,300 milion leke
	2. Zvogelimi i subvencionit te buxhetit te shtetit ne fondin e pensioneve.	Operacionalizimi i numrit te sigurimit Automatizimi i sistemit te informacionit Kualifikimi i vazhdueshem i stafit Permiresimi i cilesise se sherbimeve Zhvillimi institucional ne te gjitha nivelet e funksionimit	Instituti i Siurimeve Shoqerore	2002-2003	

Fusha/ Sektori	Objektivat	Masat Publike Prioritare	Institucioni Përgjegjës	Afati Kohor	Efektet në Buxhet (milionë Lekë)
Zhvillimi i Infra-strukturës					
Transporti	<p>1. Rehabilitimi i rrjetit të infrastrukturës ekzistuese të transportit.</p> <p>2. Komercializimi i shërbimeve të transportit dhe privatizimi i shërbimeve shtetërore</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Përfundimi i fazës së parë të rehabilitimit të ndërtimit të korridoreve rrugore të transportit; ◆ Rritja e financimeve për mirëmbajtjen dhe riorganizimi i shërbimeve të mirëmbajtjes; ◆ Realizimi studimeve dhe projekteve të detajuara për ndërtimin e rrugëve turistike dhe akseve Durrës-Kukës-Morinë dhe Tiranë-Klos-Peshkopi-Bllatë; ◆ Përfundimi i punimeve në portet e Durrësit dhe të Vlorës dhe në portet sekondare të Shëngjinit dhe Sarandës; ◆ Realizimi projekteve të rehabilitimit të rrjetit hekurudhor që janë në proces (Durrës-Tiranë dhe Durrës-Rrogzhinë); Shkodër-Hani-Hotit; dhe kryerja e studimit të fizibilitetit për lidhjen me Maqedoninë; ◆ Realizimi kontratës koncesionare për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në aeroportin e Rinasit dhe ndërtimi i një vendqëndrimi të ri për avionët. ◆ Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional. ◆ Krijimin e Autoritetit Shqiptar të Detarisë për menaxhimin e infrastrukturës portuale; ◆ Përmirësimi i sistemeve të informacionit dhe të menaxhimit. ◆ Rinovimi i inventarit të vagonëve të udhëtarëve. ◆ Zbatimi i masterplanit të Trafikut Ajror; ◆ Kryerja e studimit të fizibilitetit dhe hartimi Master Planit për zhvillimin e transportit ajror. 	<p>Ministria Transporteve;</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve</p> <p>Donatorët</p>	<p>2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004 2002-2004</p> <p>2002-2004</p> <p>2002-2004 2002-2004</p> <p>2002 2003</p> <p>2002-2004 2002-2004 2002-2004 2002</p>	
Energjia	<p>1. Përmirësimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve energjitike</p> <p>2. Fuqizimi i kapaciteteve</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Amendimi i ligjit për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike duke eliminuar rolin e qeverisë në vendosjen e çmimeve; ◆ Fuqizimi i kompetencave dhe me burime financiare të nevojshme të Entit Rregullator të Energjisë që të aftësohet të përmbushë funksionet që janë parashikuar në ligjin për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike. ◆ Aprovimi nga Enti Rregullator i Energjisë i një strukture të re tarifore të energjisë elektrike mbi bazën e kostos si dhe mekanizmave të ndryshimeve të ardhshme; ◆ Adoptimi nga qeveria i mekanizmave për mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta ndaj rritjes së çmimit të energjisë; 	<p>Qeveria;</p> <p>Ministria e Ekonomisë</p>	<p>2002</p> <p>2002</p> <p>2003</p> <p>2003 2002-2004</p>	

Official transfers 7/	111	107	106	104	107
(in percent of GDP)	3.0	2.6	2.3	2.1	1.9
Gross international reserves	608	687	744	879	929
(in months of imports of goods and services)	4.2	4.4	4.6	4.8	4.7
(relative to external debt service)	25.8	20.6	13.0	13.8	12.9
(in percent of broad money)	26.4	26.3	26.6	27.3	27.0
Change in real effective exchange rate	7.0
Memorandum items					
Nominal GDP (in millions of lek)	539,210	594,346	657,030	726,219	802,569
Sources: Albanian authorities; and Fund staff estimates and projections.					
1/ Estimates based on very preliminary information in the absence of national accounts.					
2/ Current account excluding official transfers.					
3/ Revenue minus current expenditure.					
4/ Including interest payments for bank restructuring.					
5/ Excluding privatization revenues.					
6/ Including bonds for bank restructuring (lek 4.3 bn for 1999; lek 20.3 bn for 2000).					
7/ For 1999 excluding imports of direct humanitarian aid related to the Kosovo crisis.					

IX ANEKSI 4: PROÇESI I PJESEMARRJES

1. ANËTARËSIA NË GRUPET KËSHILLIMORE TË SHOQËRISË CIVILE

<u>Bujqësia</u>	<u>Shëndetësia</u>
Përfaqësues të Agro-Biznesit	Unioni Shëndetësor (shtetëror)
Organiza të Prodhimit Bujqësor	Unioni Shëndetësor (i lirë)
Organizata bazuar në Komuna	Shoqata e Infermierëve Profesionalë
Organizata bazuar në Komuna	Doktorë
OJQ të Zhvillimit Rural	Organizata e Shëndetit të Gruas
Universiteti Bujqësor	Organizata e Invalidëve dhe Paraplegjikve
Instituti i Kërkimit	Shërbimi Shëndetësor Privat
Kryetari i Komunës	Farmacistë
Kryetari i Komunës	Kryetari i Bashkisë
Kredi-dhënësit Ruralë	Kryetari i Komunës
Përfaqësuesi i Unioni të Fermerëve	Kryetari i Komunës
<u>Edukimi</u>	<u>Puna dhe Çështjet Sociale</u>
Profesorë	Organizata e të Drejtave të Gruas
Mësues	Unioni Tregtar
Mësues	Unioni Tregtar
OJQ Edukimi	Përfaqësues të Grupeve Minoritare
Organizata e Trajnimit të Gruas	Organizata e Zgjidhjes së Konflikteve
Kryetari i Bashkisë	Organizata e Zhvillimit Ekonomik
Kryetari i Komunës	Komuniteti i Biznesit
Kryetari i Komunës	Kryetari i Bashkisë
Shkolla Private	Kryetari i Komunës
Organizta e Kërkimit	Organizata e Rinisë
Organizata e Prindërve	Organizata e Kërkimit
Organizata e Rinisë	

2. HARTA E SHPËRNDARJES SË PJESËMARRËSVE NË WORKSHOPIN E NËNTORIT



3. SEMINARI I PRILLIT I SHOQËRISË CIVILE

Seminari i Prillit vulosi përfundimisht bashkerendimin e punës mes shoqërisë civile dhe ministrive. Në fund të këtij Workshopi, lista e **prioriteteve strategjike** sipas sektorëve përkatës u inkorporua në inputet e të dhënave, të cilat u përgatitën nga grupet teknike të punës në ministrinë e linjës, dhe që shërbyen si bazë ndaj konsulentëve të Qeverisë për përgatitjen SRERV. Në fund të këtij Seminari u përpilua edhe deklarata e shoqërisë civile, e cila reflektoi diskutimet e realizuara dhe pikat e marrëveshjeve dhe mosmarrëveshjeve.

Prioritetet strategjike

a. Arsimi

- Decentralizimi financiar dhe transparenca e shpërndarjes së burimeve;
- Nevoja për një draft të standarteve kombëtare për edukimin;
- Programe dhe projekte për të çuar në rritje numrin e nxënësve të përfshirë në nivelet e edukimit përkatës dhe nevoja për të inkurajuar dhe vendosur rregullat në shkollat private.

b. Puna dhe Çështjet Sociale

Politikat e Punësimit:

- Mbështetje më të fortë për të drejtat e punëtorëve nëpërmjet zhvillimeve në kuadrin legjislativ;
- Rritjen e kapaciteteve qeveritare lokale në fushën e punësimit dhe shërbimit social;
- Marrëveshje institucionale për minimizimin e tregut joformal të punës;
- Marrëdhënie të ngushta ndërmjet trajtimit profesional dhe kërkesave të tregut të punës;
- Zhvillimin e programeve të punës për gratë dhe të rinjtë.

Mbrojtja Sociale

- Norma të lejueshme financimi për përfitimet e asistencës ekonomike;
- Zgjerim dhe përhapje të mëtejshme të shërbimeve sociale;
- Programe draftimi në vazhdim të integritit të grupit të nevojave;
- Mbështetje të shërbimeve sociale të ofruar nga OJQ-të, etj.

Siguria Sociale

- Promocion për stabilizimin e instituteve private për tju ofruar mundësi të barabarta;
- Përmirësime të tregut për sigurimet shoqërore.

c. Shëndetësia


- Rritja dhe ndarja e sektorit të shëndetësisë në PBB, duke i dhënë prioritet shërbimeve primare;
- Ristrukturimin e shërbimit shëndetësor nga sektorët privatë, duke përmirësuar infrastrukturën shëndetësore;
- Fuqizimin e skemës së sigurimit shëndetësor, prezantimin e programeve manaxheriale për spitalet, dhe trajnimin e personelit mjekësor, etj.

d. Bujqësia

- Konsolidimi i pronarëve të tokave;
- Promocioni i industrive ushqimore;
- Aktivizimi i fondeve për tju garantuar kredi fermerëve;
- Diversifikimi i energjive të zairesë;
- Rritjen e marketingut nëpërmjet zhvillimit infrastrukturual;
- Këndvështrime institucionale më të mira të cilat duhet t'u përgjigjen nevojave të fermerëve.

4. KONSULTIMET RAJONALE

Gjatë periudhës Prill dhe Maj 2001 Qendra Karter dhe Oxfam organizuan një seri takimesh konsultive me 12 komunitete lokale në fshatrat dhe qytetet e 4 rretheve, Shkodër, Korçë, Gjirokastër dhe Kukës. Ata insistuan që të merrnin të dhënat nga vetë të varfërit në krijimin e strategjise së reduktimit të varfërisë. Shkurtimisht, takimet nxorën në pah që varfëria varion shumë nga pozita gjeografike, historia, taksat, kushtet klimatike, relievi, politikat, institucionet, komunitetet, njerëzit etj. Të gjithë qytetet dhe fshatrat në Shqipëri kanë tipare të njëjta të varfërisë, sikurse dhe veçori, të bazuara në karakteristika të ndryshme. Shumica, e zonave rurale në Shqipëri janë më të varfëra sesa ato urbane, për një sërë arsyesh.



Lista e kërkesave të popullsisë së zonave të varfëra është shumë modeste: ujë dhe drita, ilaçe më pak të shtrenjta, më shumë ushqim për të ngrënë, më shumë mundësi punësimi, më shumë shanse për të rinjtë për të shkuar nëpër shkolla, rikthimin e “pallateve të kulturës” me lojrat dhe shfaqjet, dhe ndoshta më tepër respekt nga bashkëfshatarët e tyre. Të varfërit presin nga ana e qeverisë t’i mbështesë me studime teknike dhe një shumë parash të mjaftueshme për fillimin e aktiviteteve të tyre. Ata presin rindërtimin e rrugëve dhe kanalizimeve, hapa drejt teknologjise së re, riparimin dhe përmirësimin e sistemit elektrik, dhe mbështetje për shkollimin e tyre.

5. KONSULTIMET ME PARLAMENTIN

Konsultimet me Parlamentarët synuan familiarizimin e tyre me subjektin e SRERV thithjen e ideve të tyre për identifikimin e problemeve dhe rrugëzgjdhjeve të tyre të mundshme. Për shkak të fillimit të periudhës elektorale (Maj 2001), konsultimet me Parlamentin u zhvilluan me numër dhe pjesëmarrje më të kufizuar nga sa ishte parashikuar.

6. KONSULTIMET ME PUSHTETIN VENDOR

6.1 Raundi i parë i konsultimeve, prill 2001: faktorë favorizues dhe faktorë pengues

a. Grupi i Bashkive të mëdha dhe të mesme

	Burimet ekonomike (financiare, materiale, natyrore)	Njerëzore dhe sociale	Institucionale
Faktorët pengues për zhvillim dhe/ose për reduktim të varfërisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Papunësia (faktori kryesor) 2. Paga e ulët në sektorin buxhetor 3. Mundësi të pakta të zhvillimit të biznesit të vogël 4. Sasia e kufizuar e tokës 5. Shkalla e ulët e mekanizimit, ujitjes, pamundesia e investimeve 6. Treg i kufizuar shitjeve për prodhimin bujqësor 7. Kosto e lartë e prodhimit bujqësor 8. Një industri teknologjike e prapambetur. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shkala e ulët e kualifikimit 2. Mospërputhja e kërkes-ofertës për potencial njerëzor të kualifikuar 3. Mentaliteti i prapambetur 4. Mungesa e politikave nxitëse rajonale të kuadrove specialiste. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Politika jofavorizuese doganore ndaj prodhimit vendas 2. Paaftësia e sistemit bankar për kreditim 3. Politikat fiskale jo favorizuese 4. Moskoordinimi, bashkeveprimi ndërmjet institucioneve të njëjtë dikaster (Ministrisë së Punës, Inspektoriati i Punës etj..) 5. Kompetenca të kufizuara të qeverisë lokale. 6. Tendencë e dikastereve për të deleguar vendim-marrje në nivele më të ulta. 7. Shtrirje e kufizuar e institucioneve të kujdesit social. 8. Menaxhim i dobët i burimeve

			<p>financiare. (paaftësia e administrimit)</p> <p>9. Mungesa e strategjive afatshkurtra-afatmesme për zhvillimin lokal-rajonal.</p> <p>10. Harmonozimi i politikave qendrore-lokale.</p> <p>11. Levizja e pakontrolluar e popullsisë</p> <p>12. Mungesa e projekteve urbanistike.</p>
<p>Politikat e mundshme dhe institucionet që mund të hartonin apo zbatonin ato</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Politike kreditimi me interesa të ulta për biznesin prodhues dhe fermeret (Ministria e Financave) 2. Politike nxitese për zhvillimin e industrisë, agroindustrisë, sektoreve strategjike (plane rajonale) (Ministria e Ekonomisë) 3. Permiresimi i infrastruktureve (Ministria e Transporteve dhe Pushtetit Lokal) 4. Hartimi i prioriteteve ekonomike kombëtare (Ministria e Pushtetit Lokal dhe Njësia e Qeverisjes lokale dhe rajonale) 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbeshtetja e prioriteteve ekonomike me kapacitete njerezore të kualifikuara. 2. Hartimi I kriterëve për punësimin në administratën publike për komunat. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Politike të diferencuara rajonale fiskale dhe kreditim 2. Zbatimi i legjislativës në fuqi 3. Domosdoshmëria e përgatitjes së strategjive të zhvillimit rajonal-lokal (afatshkurter-mesëm-gjatë) 4. Politike të nxitjes së punësimit, (mekanizma fiskale) 5. Zgjedhja dhe motivimi I firmave me bilanc ekonomik pozitiv. 6. Nxitja e investimeve të huaja 7. Decentralizimi lokal I plotë 8. Tarifa për prodhimin bujqësor 9. Tatimi mbi prodhimin bujqësor 10. Fuqizimi i luftës kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit. 11. Aplikimi i sistemit fiskal të diferencuar për kapacitete prodhuese të privatizuara jo-eficiente. 12. Kompetenca lokale për ndihmën ekonomike
<p>Ceshtje që duhet adresuar në reformën e decentralizimit që të fuqizohet roli I pushteteve vendore në SRERV</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mekanizmi i ndihmës ekonomike duhet të ndryshojë nga pasiv në aktiv 2. Studimet lokale-rajonale mbi urbanizimin dhe potencialin ekonomik 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kualifikimi i kapaciteteve menaxhuese të qeverisë vendore dhe të administratës lokale. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zgjerimi i autonomisë financiare, në vecanti për funksionet e veta të qeverisë vendore 2. Menyra e mbledhjes së taksave lokale 3. Zgjerimi i autonomisë lokale në shëndetësi, arsim 4. Zbatimi i politikave të diferencuara (social-ekonomike) rajonale-lokale sipas prioriteteve të zonave me problematike.

b. Grupi i bashkive te vogla dhe komunave te medha

	Burimet ekonomike (financiare, materiale, natyrore)	Njerezore dhe sociale	Institucionale
Faktorët favorizues per zhvillim dhe/ose për reduktim te varfërisë	<p>Kreditimi i fermerëve me kushte lehtësuese : (sektoret prioritare) Frutikultura; Serrat; Prodhimi blegtoral; Agro- perpunimi; Turizmi familiar; Artizanati, Sherbimet e ndryshme;</p> <p>Permiresimi i infrastruktures rurale. (Sidomos i rrugeve)</p> <p>Shtimi i prezences se strukturave te Sherbimit ekstensiv ne zonat rurale (sidomos ne komunat e largeta).</p>	<p>Formimi profesional i fermerëve: (fushat prioritare) Agro-perpunimi; Teknologjite e reja; Marketingu dhe reklama; Kooperimi ne grup; Teknikat e ujitjes; Teknikat e ruajtjes se produkteve bujqesore; Menaxhimi i fermave.</p> <p>Permiresimi i sherbimeve per nevojat jetike: Furnizimi me uje; Furnizimi me energji elektrike; Permiresimi i sherbimeve ne rrjetin farmaceutik, ambulator e spitalor.</p>	<p>Planifikimi dhe kontrolli Disiplinimi i ndertimeve dhe investimeve ne nivel komune ne kuadrin e planeve rregulluese te studiuara e miratuara nga organet kopetente;</p> <p>Trainimi i personelit të komunave.</p> <p>Venia në efijencë e shkollave bujqësore.</p>
Politikat e mundshme dhe institucionet që mund te hartonin apo zbatonin ato	<p>Politika kredituese ne favor te fermerëve qe paraqisin plane biznesi efektive;</p> <p>Politika mbrojtëse ndaj prodhimit vendas.</p> <p>Politika subvencionuese ndaj imputeve kryesore.</p>	<p>Informim sa me i gjere i fermerëve apo shoqatave te ndryshme ne lidhje me kushtet dhe procedurat e marrjes se kredive nga Bankat apo institucione te tjera kreditimi.</p>	<p>Rol me aktiv i Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit.</p> <p>Hartimi i politikave me reale ne favor të fermerëve shqiptare.</p>
Cështje që duhet adresuar në reformen e decentralizimit që të fuqizohet roli i pushteteve vendore në SRERV	<p>Hartimi i politikave orientuese të zhvillimit per zonat rurale ne funksion te veçorive te tyre.</p> <p>Studime per rajonizimin e kulturave dhe aktiviteteve te tjera prodhuese e perpunuese.</p> <p>Permiresimi i sistemit te taksave vendore ne favor te komunave.</p>	<p>Motivim me i mire financiar per strukturat e te zgjedhurve e te punesuarve ne organet lokale.</p> <p>Formimi me i plote profesional i strukturave te te zgjedhurve lokale.</p>	<p>Plotesimi i kuadrit ligjor per funksionimin e organeve lokale</p> <p>Monitorimi financiar i organeve te pushtetit lokal.</p> <p>Krijimi i policise komunale e bashkiake.</p> <p>Rritja e kopetencave te komunave ne fushen e arsimit dhe shendetsise.</p>

c. Grupi i komunave të vogla dhe të mesme

	Burimet ekonomike (financiare, materiale, natyrore)	Njerezore dhe sociale	Institucionale
Faktoret perngues per zhvillim dhe/ose per reduktim te varferise	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Te ardhurat financiare per komunen ◆ 30-40përqind e familjeve kane te ardhura te ulta, 10përqind e tyre kane mungesa ushqimore ◆ infrastrukture e pazhvilluar sherbimesh ◆ energjitika ◆ taksa e kufizuar per aktivitetet bujqesore ◆ infrastruktura bujqesore ◆ mungese produkti lokal bujqesor ◆ 19përqind e popullsise ndihme ekonomike, 40përqind e papune ◆ s'ka asnje sektor prodhues 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mungese ne kualifikime, specializime ◆ Shendeti publik/riaktivizimi I vatrave te vjetra te semundjeve ◆ Kequshqimi ne shendetin e femijeve ◆ Rritja e ngarkeses se gruas -ndikon ne rritjen e femijes ◆ Gjakmarrja/konflikte pronesore ◆ Mungesa e sherbimit ekstensiv ◆ Cfare liderhipi?? <ul style="list-style-type: none"> - Fisnor - Komunitar - Fetar - Ekonomik ◆ Boshatisja e fshatrave/braktisja ◆ Braktisja e bujqesise nga moshat e reja 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Nivel I ulet decentralizimi ◆ Te drejtat e pronesise mbi token ◆ Informacion dhe transparence ◆ Mungese e pronave per komunen ◆ Institucione ne nivel rrethi dhe Qarku (idhjet nderinstitucionale) ◆ Mungese realizimi vendimarrjes qendrore ◆ Raportet me shoqerine civile ◆ Mungon bashkepunimi ndërkomunar ◆ Roli i keshillit perkundrejt kryetarit/perjegjshmeria ◆ Raportet komune-bashki ne komunitet ◆ Mbingarkese burokratike
Faktoret favorizues per zhvillim dhe/ose per reduktim te varferise	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Burime pyjore dhe perpunimi perfundimtar ◆ Esence natyrore ◆ Bime mjekesore ◆ Zone e pasur me kerpudha ◆ Turizem malor dhe familjar ◆ Artizanat ◆ Pulari ◆ Uji shume i mire, por larg/mikroenergji/uje I pishem ◆ Kosto e fuqise punetore e ulet ◆ Burime ushqimore per blegtorine ◆ Inerte ◆ Uje ◆ Pyje ◆ Kalimi I koridorit te 8--te - pozitive 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mosha e re (Puke)?? ◆ Aftesia eksportuese e fuqise punetore ◆ Tradite profesionale+shkollim profesional per moshat e mesme ◆ Edukimi i pergjithshem I mire por ka renie ◆ Ka inisiativa për SME 	
Politikat e mundshme dhe institucionet qe mund te hartonin apo zbatonin ato	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Te rriten kreditimet ◆ Te rriten financimet ◆ Te permiresohet infrastruktura ◆ Financat vendore ◆ Sherbimet publike ◆ Burimet natyrore 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Ri-kualifikime ◆ Forcimi I administrates ◆ Kush mbizoteron? <ul style="list-style-type: none"> - Fisi - Komuniteti ◆ Politika aktive sociale +pune. Pune 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Roli i keshillit ◆ Rregullimet e standartizuara/normative ◆ Fleksibilitet ◆ Decentralizim ◆ Dekoncentrim

	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Strukturat e tregut ◆ Mbeshtetje e SME dhe industrise ◆ Energjitike 	komunitare.	
Ceshtje qe duhet adresuar ne reformen e decentralizimit qe te fuqizohet roli I pushteteve vendore ne SRERV			

6.2 Raundi i dytë i konsultimeve me qeverisjen vendore, tetor 2001

Në këtë raund u bë një prezantim i përgjithshëm i SRERV, duke u përqëndruar veçanërisht te objektivat, masat publike prioritare, monitorimi dhe pjesëmarrja në hartim dhe në zbatim. Gjithashtu u diskutuan edhe **dy tema** të veçanta:

- *Lidhja mes SRERV dhe Reformes në vazhdim të decentralizimit:* Tema analizozi në mënyrë krahasimore lidhjet, perfitimet reciproke, rolet dhe dilemat mes SRERV dhe decentralizimit.
- *Koordinimi i SRERV, PAB dhe decentralizimit fiskal:* tema trajtoi mënyrën dhe masën e përfshirjes së aspekteve të decentralizimit fiskal në PAB si dhe të efekteve dhe qasjes së tij me SRERV. Një fokus i veçantë i temës ishte adoptimi për herë të parë i formulës së shpërndarjes së transfertes së pakushtëzuar të Buxhetit të shtetit të njësitë e qeverisjes vendore

Në **vazhdim** pjesëmarrësit diskutuan mbi çështjet më me interes. Diskutimet u përqëndruan në rolin e njësisë të qeverisjes vendore në zbatimin e SRERV, në zgjidhjen e disa çështjeve në zonën e prerjes së roleve midis tyre dhe Ministrive në fushat e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, arsimit, mbrojtjes sociale dhe në çështjet e decentralizimit fiskal. Ndër përfundimet kryesore të konsultimit ishin:

- SRERV është një dokument bindës që arrin të përcaktojë objektiva të rëndësishme dhe realiste, një qasje të përshtatshme dhe hapësirë për bashkëpunim.
- Thellimi i mëtejshëm i reformes së decentralizimit do të fuqizojë rolin e njësisë të qeverisjes vendore dhe do të krijojë kështu premisa për shfrytëzimin e avantazheve që ato krijojnë në lidhje me afersinë e vendimmarrjes me perfituesit, mundësinë e rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së komuniteteve, përfshirë të varferit. Pjesëmarrësit arritën në përfundimin se njësitë e qeverisjes vendore janë institucione që i përgjigjen me se miri qasjes baze për reduktimin e varferisë pra të krijimit të oportuniteteve, të sigurisë dhe të fuqizimit të zerit të të varferve
- Decentralizimi fiskal duhet të vazhdojë si në aspektin e zgjerimit të autonomisë për krijim të ardhurash nga burimet vendore ashtu edhe në përmirësimin e kushteve dhe mënyrës së shpërndarjes së transfertave nga buxheti i shtetit. Në lidhje me taksat vendore pjesëmarrësit ishin të mendimit se ka ardhur koha që të ri-vendoset tatimi mbi token bujqësore si dhe të bëhet transformimi i tatimit mbi biznesin e vogël në një taksë vendore. Në lidhje me këtë aspekt pjesëmarrësit argumentuan se këto ndryshime do të përmirësojnë financat vendore por njëkohësisht do të krijojnë mundësinë e rritjes së të ardhurave nga këto dy taksa në krahasim me nivelin e mbledhjes së tyre nga administrata tatimore qendrore. Nga ana tjetër fondet e mbledhura do të mundësojnë përdorimin e tyre në rritjen e sasive dhe cilësisë së shërbimeve publike vendore si mënyra të rritjes ekonomike dhe reduktimit të varferisë. Në lidhje me transfertat nga buxheti i shtetit pjesëmarrësit vlerësuan rezultatet e pozitive të pritshme nga adoptimi i formulës për transfertat e pakushtëzuara dhe kërkuan që të përmirësohet edhe procesi i negociimit dhe shpërndarjes së fondeve të kushtëzuara për investime. Në këtë aspekt u kërkuar që ky proces të nisë njëkohësisht me përgatitjen e projekt-buxhetit në mënyrë që këto fonde të pasqyrohen si në ligjin e buxhetit të shtetit ashtu edhe në buxhetet e

seciles njesi vendore. Në përgjithësi, pjesëmarrësit ishin të mendimit se hapat në fushën e decentralizimit fiskal duhet të jenë të matur por të vendosur.

- Në lidhje me problemet në fushën e infrastrukturës, vëmendja u përqëndrua në çështjen e furnizimit me ujë. Pjesëmarrësit u shprehën se janë të informuar me problematiken dhe idete me të fundit në të cilën po ecen përgatitja e decentralizimit të sektorit. Ata theksuan se ky sektor duhet të decentralizohet por me menyrë dhe mjete të pershtatshme, duke konsideruar me realizem problematiken e akumuluar të sektorit dhe duke shmangur risqet e mundshme të fazës së tranzicionit.
- Në lidhje me sektorët e shërbimeve publike të arsimit dhe të mbrojtjes sociale, konkluzionet ishin së njesitë e qeverisjes vendore mund dhe duhet të kenë rol në drejtim të identifikimit të problemeve, të përfituesve, të formave më të përshtatshme të ofrimit të shërbimeve, por gjithësesi brenda standarteve dhe objektivave kombëtare. Në lidhje me sektorin e shëndetit publik, idetë ishin më të përgjithshme.
- Pjesëmarrësit theksuan se përfshirja e komunitetit po bëhet një qasje gjithnjë e më e përhapur në praktiken e qeverisjes vendore. Atë gjithashtu ishin të mendimit se neglizhimi i komuniteteve e dobëson dhe e shtrembëron qeverisjen vendore. Por, nga ana tjetër, anashkalimi i njësive të qeverisjes vendore dhe fokusimi vetëm në komunitetet, fakt ky që vërehet në disa raste, është gjithashtu një praktikë e gabuar sepse ul mundësinë e koordinimit dhe trajtimit integral të problematikes lokale e për pasojë të përdorimit me efikasitet të burimeve.
- Pjesëmarrësit u shprehën se nevojë e forcimit të kapaciteteve qeverisëse vendore është një prioritet, por ky argument nuk duhet të shërbejë si pretekst për vonë në zbatimin e strategjisë së decentralizimit.

7. KONSULTIMET ME KOMUNITETIN E BIZNESIT

U zhvilluan konsultime me Bashkimin e Dhomave të Industrisë dhe Tregtisë së Shqipërisë dhe Dhomen Amerikane të Tregtisë; Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar; Shoqatën e Investitorëve të Huaj dhe Shoqatën e Investitorëve Italianë; dhe Shoqatën e Bankierëve të Shqipërisë.

7.1 Raundi i parë

7.1a Faktorë pengues dhe politika të mundshme

Faktorët Pengues për Zhvillim dhe/ose Reduktim të Varfërisë	Politikat e Mundshme që Mund të Zbatohen
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kufizimi i punës së fermerëve që zotërojnë 0.5 – 1.5 ha tokë deri në plotësimin e nevojave të familjeve së tyre, duke kufizuar dhe penguar në këtë mënyrë zgjerimin e mekanikës bujqësore. 2. Moskreditimi i mekanikës bujqësore. 3. Kufizimet (orar pa orar) të energjisë elektrike (duke ulur në këtë mënyrë humbjet në rrjet artificialisht). 4. Kontratat e shërbimeve publike (energji, ujë) janë të njëanëshme dhe nuk përmbajnë aspekte reciproke të matshme. 5. Përkrahja e Qeverisë ndaj investitorëve të huaj dhe qëndrimi arbitrar ndaj investitorëve vendas në drejtim të furnizimit me energji elektrike dhe çmimit të saj (çmimi më i ulët për investitorët e huaj dhe më i lartë për ata vendas) 6. Rritja e çmimit të lëndëve djegëse. 7. Trajnimi i burimeve njerëzore është i pamjaftueshëm (sidomos i studentëve të universitetit) – Roli i Institutit të Punësimit nuk ndihet. 8. Fondi Kombëtar i Punës (Bizneset paguajnë 5përqind tatim për trajnim për t'u punuar me Ministrinë e Punës. Ky fond hyn në skemën e subvencionit të Qeverisë. A ka nevojë për infrastrukturë ligjore?) 9. Kosto e punës e ulët por taksa (sigurimet) mbi të është e lartë. 10. Plotësimi i nevojave për të ardhura monetare nga aktivitete dhe burime jo të rregullta (klandestine, trafikë të ndryshme). 11. Taksat doganore për makineritë bujqësore janë ulur nga 5përqind në 2përqind, por megjithatë janë përsëri në nivele të larta (përfaqësuesi deklaroi se ka paguar më shumë për taksën doganore në rastin kur ajo është 2përqind sesa në rastin kur ishte 5përqind). 12. Mosmarrja parasysh nga organet tatimore e gjendjes së bizneseve shqiptare. 13. TVSH është e lartë dhe duke iu rënduar bizneseve bën që të rriten çmimet (rasti i makinerive bujqësore). 14. TVSH uniforme për çdo mall, pavarësisht nëse është i konsumit të përditshëm apo luksit. Në vendet e BE, TVSH për mallra të konsumit të përditshëm matet në nivelet 3 – 6përqind. 15. Mosrimbursimi i TVSH në rastet e blerjes nga bizneset e vogla pasi ato nuk kanë TVSH. 16. Përgjithësimi i një sistemi fiskal të dyfishtë: pagimi i taksës mbi taksë (TVSH mbi taksë doganore). 17. Pagimi i tatimeve që në fillim të vitit, që nënkupton derdhjen e shumave nga bizneset pavarësisht nëse ata e vazhdojnë ose jo aktivitetin e tyre përgjatë gjithë vitit në vazhdim. 18. Vendimet apriori dhe rritja artificiale nga Drejtoria e Tatimeve e vlerave për t'u paguar nga biznese të ndryshme. 19. Inspektorët fiskalë nuk respektojnë bilancet që u paraqiten. Ata nuk kontabilizojnë bilancet e paraqitura nga kompanitë. 20. Dogana (paafësia e punonjësve të doganës, ngarkim – shkarkim disa herë i mallit për t'u ç' doganuar). 21. Diferencime në kontroll doganor ndaj subjekteve të ndryshme 22. Mungesa e informacionit dhe transparencës së sistemit doganor mbi llojet e makinerive që quhen “për investim”. 23. Çmimi referencë duke qenë ditor, javor ose mujor lë vend për abuzime nga punonjësit e doganës. 24. Të gjitha subjektet i nënshtrohen çmimit reference. 25. Marka tregtare. Rreziku nga prodhimet falco. 26. Mungesa e kontrollit ndaj prodhimeve “pirate” nëpër shtëpi, moszbatimi i ligjit. 27. Hyrja e mallrave kondrabandë. 28. Mbushja e tregut me mallra nga vendet fqinje (kontrolli i mallrave pa cilësi, mallrat që janë për t'u hedhur vijnë në Shqipëri) 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkimi i fermerëve për të zgjeruar sipërfaqen e tokës së punës, në mënyrë të tillë që të mundësohet zgjerimi i mekanikës bujqësore. 2. Moskufizimi me energji elektrike (ose të paktën kufizim me një orar të caktuar të ditur nga investitori). 3. Ulja e çmimit të lëndëve djegëse (diferencim për prodhuesit). 4. Zgjerimi i bazës (infrastruktura & baza ligjore) së taksapaguesve (një zgjerim cilësor shmang deformimin e tregut). 5. Zbatimi i ligjit njëloj për të gjithë (në lidhje me doganat dhe tatimet). 6. Diferencim në TVSH: TVSH duhet të jetë e lartë për mallrat e luksit (jo të konsumit të përditshëm) dhe më e ulët për mallrat e konsumit të përditshëm (ushqimet). 7. Heqja ose reduktimi në minimum i TVSH për prodhimet bazë (buka). 8. Reduktimi i sistemit tatimor, në mënyrë që të arrihet ulja e evazionit fiskal. 9. Heqja e pagesës të taksave shtetit në paradhënie. 10. Vendosja e barrierave importit për të nxitur prodhimin vendas. Rritja e TVSH dhe taksave doganore për produktet e importuara. 11. Dhënia e prioritetit të shfrytëzimit të pasurive të vendit duke nxitur kështu prodhimin vendas dhe duke kufizuar importin e produkteve nga jashtë. 12. Diferencim në taksa doganore. 13. Transparenca e sistemit doganor – njohja e publikut me tarifatat dhe referencat (sipas bazës). 14. Çmimi referencë duhet t'u zbatohet vetëm atyre subjekteve për të cilat doganieri ka dyshim për çmimin që deklarojnë. 15. Harmonizimi me sistemet doganore evropiane në përcaktimin e çmimeve të referencës ose heqja fare e çmimeve reference dhe dhënia e kësaj kompetence sistemit fiskal tatimor. 16. Mundësimi i lidhjeve elektronike doganore me vendet fqinje. 17. Lidhja e sistemit doganor me atë tatimor duhet të sigurojë shmangien e abuzimeve me pagesat. 18. Zgjidhja e problemeve të pronësisë,

<p>29. Prishja (reduktimi) e standarteve të prodhimit</p> <p>30. Blerja e lëndës së parë me dollarë dhe shitja e produkteve me lekë.</p> <p>31. Monopolizimi i importit të grurit.</p> <p>32. Evazioni fiskal i tregtarëve të miellit (duke deklaruar më pak ose fare).</p> <p>33. Fermeri - i patatueshëm, ndërsa prodhuesi – i tatueshëm për prodhimin e tij</p> <p>34. Vështirësi në marrëdhëniet Biznes – Administratë shtetërore. Administrata shtetërore e konsideron privatit si “hajdut”.</p> <p>35. Ekzistenca e një sistemi pagesash jo të zhvilluar.</p> <p>36. Niveli i ulët i zhvillimit të infrastrukturës (energji elektrike, rrugët dhe telekomunikacioni), vështirëson aktivitetin modern bankar, veçanërisht në komunikimin e tyre me rrjetin bankar që operon në zonat e tjera jashtë Tiranës.</p> <p>37. Kanalizimi i kredive n.p.m bankave, gjë që çon në rritje të interesave të kreditit.</p> <p>38. Kreditimi nga bankat është me kosto të lartë.</p> <p>39. Vështirësi dhe procese të stërzgjatura të bankave për t’u dhënë kredi bizneseve.</p> <p>40. Mangësi ligjore, veçanërisht në ligjin për kolaterale, gjë që pengon aktivitetin dhe marrëdhëniet e bankave me biznesin privat.</p> <p>41. Shkalla e lartë e riskut të vendit, bën që bankat e huaja korrespondente të mos preferojnë të operojnë me bankat që punojnë në Shqipëri. Kjo i detyron ata të operojnë duke përdorur si garanci bankat e tyre mëmë (ose aksionerët e huaj të banës). U soll shembull edhe me hapjen e një letre kredie të konfirmuar, ku bankat e huaja nuk i pranojnë direkt nga një bankë shqiptare. Të gjitha këto, bëjnë që kostoja e parasë të rritet.</p> <p>42. Pozitat dominuese të Bankës së Kursimeve në treg dhe mungesën për rrjedhje të konkurrencës. Ka diskriminim në praktikat bankare, veçanërisht në marrëdhëniet mes tyre, biznesit privat dhe organeve shtetërore. Këto janë krijuar nga administrata tatimore ku pagimi nga biznesi i taksave detyrohet nga organet e tatimeve të kryhet vetëm nëpërmjet bankave shtetërore. Kjo e pengon konkurrencën e lirë në treg dhe krijon premisa për pozita dominuese në shërbime të caktuara.</p> <p>43. Vështirësi të tjera u konsideruan edhe problemet e saktësisë së bilanceve të subjekteve private dhe hezitimet nga bankat për tu bazuar në to; mungesa e tregut të kapitaleve që mund të shërbente si referencë në orientimin e tyre me kushtet e tregut.</p> <p>44. Elemente të pasigurisë në Shqipëri.</p>	<p>tatimi i tokës së fermerit.</p> <p>19. Mbështetja e biznesit privat vendas nga qeveria. Vendosija e bashkëpunimit dhe partneritetit midis qeverisë dhe komunitetit të biznesit.</p> <p>20. Funksionimi dhe sjellja e shtetit si rregullator i bizneseve dhe jo si ortak i tyre.</p> <p>21. Përkrahja dhe trajtimi i privatit si partner nga administrata shtetërore.</p> <p>22. Ngritja e një Komisioni Arbitrazhi (Apeli) për marrëdhëniet ekonomike, në përbërje të të cilit të ketë individë të shoqërisë së interesuar.</p> <p>23. Futja e Strategjisë së SME si pjesë e SRERV.</p> <p>24. Roli i Komisionit të Konsultimit të Biznesit: Të krijohet Këshilli Socio – Ekonomik Kombëtar.</p> <p>25. Finalizimi i projektit të përmirësimit të sistemit të pagesave RTGS.</p> <p>26. Krijimi i Fondit të Garancisë së Kreditit, i cili do të lehtësojë sektorin privat nga kërkesat e larta për kolateral, dhe nga ana tjetër do të ulë dhe koston e kreditimit të këtij sektori.</p> <p>27. Kreditimi i biznesit.</p> <p>28. Krijimi i zyrës së informimit për kredinë, që do të lehtësojë komunikimin e bankave me sektorin privat.</p>
--	---

7.1b Rezultatet e pyetësorit për marrjen e mendimit të komunitetit të biznesit rreth barrierave të rritjes ekonomike, të plotësuar nga 20 përfaqësues të biznesit

Faktorët:				
Faktorët institucional	Shumë problematike	Problematike	Normale	Aspak problematike
1. Sa të lehta i vlerësoni rregullat e autoriteteve lokale për marrjen e lejeve apo licencave apo në trajtimin e praktikave tuaja nga këto autoritete?	7	4	8	-
2. Sa të lehta i vlerësoni rregullat e autoriteteve qendrore (ministri /institucione qendrore) për marrjen e lejeve apo licencave apo në trajtimin e praktikave tuaja nga këto autoritete?	4	6	10	-
3. Si i vlerësoni marrdhëniet tuaja me administratën doganore?	5	10	4	-
4. Si i vlerësoni marrdhëniet tuaja me administratën tatimore?	5	7	7	-
5. Si i vlerësoni marrdhëniet tuaja me gjykatat?	4	2	8	1
VLERËSIMI TOTAL	25	29	37	1
Infrastruktura dhe biznesi:	Shumë problematike	Problematike	Normale	Aspak problematike
1. Si e vlerësoni shkallën e ndikimit të gjendjes së rrugëve në kostot e biznesit tuaj?	11	9	-	-
2. Si e vlerësoni shkallën e ndikimit të gjendjes së hekurudhës në kostot e biznesit tuaj?	6	2	4	6
3. Si e vlerësoni shkallën e ndikimit të gjendjes së porteve në kostot e biznesit tuaj?	2	6	9	1
4. Si e vlerësoni shkallën e ndikimit të gjendjes së telekomunikacionit në kostot e biznesit tuaj? (tel., fax., internet, e-mail, etj.)	5	5	7	2
VLERËSIMI TOTAL	24	22	20	9
Fuqia punëtore dhe biznesi:	Shumë problematike	Problematike	Normale	Aspak problematike
1. Si e vlerësoni ndikimin e legjislacionit të punës në praktikën e marrjes në punë dhe pushimit nga puna të personelit?	1	4	13	1
2. Si i vlerësoni marrdhëniet tuaja me sindikatat?	-	1	13	4
3. Si e vlerësoni gjendjen e njohurive dhe shkallën e trajnimit të personelit që ju keni punësuar?	2	5	10	1
VLERËSIMI TOTAL	3	9	36	6
Kostot dhe konkurrenca:	Shumë të rëndësishëm	Të rëndësishëm	Pak të rëndësishëm	Aspak
1. Sa ndikim kanë në biznesin tuaj kostot e sigurimit të lejeve, licencave, regjistrimeve, etj.	6	8	5	-
2. Sa shumë është i ndikuar biznesi juaj nga konkurrenca e pandershme në treg?	17	3	-	-
VLERËSIMI TOTAL	23	11	5	-
Faktorët ekonomik	Faktorë shumë pengues	Faktorë jo shumë pengues	Faktorë lehtësues	Faktorë pa ndikim

1. Niveli i tarifave doganore në biznesin tuaj	14	3	-	1
2. Sigurimi i financimeve për biznesin tuaj	9	5	4	-
3. Shkalla e teknologjisë që përdor kompania juaj	2	5	8	2
4. Sistemet e shpërndarjes dhe të furnizimit	5	4	6	2
VLERËSIMI TOTAL	30	17	18	5

Rreth 59 për qind e biznesmenëve i konsiderojnë faktorët institucionalë (marrdhëniet me administratën qendrore dhe lokale; me organet taimore dhe doganore dhe me gjykatat) si shumë problematike ose problematike. Rreth 61 për qind e biznesmenëve vlerësojnë si shumë problematike ose problematike gjendjen e infrastrukturës fizike (veçanërisht të rrugëve) dhe ndikimin e saj në kostot e transportit. Vetëm 22 për qind e biznesve e konsiderojnë si faktorë pengues legjislacionin e punës dhe kualifikimin e fuqisë punëtore. Nga 39 përgjigje të marra, 34 prej tyre e vlerësojnë si shumë penguese konkurrencën e pandershme në treg. Lidhur me rolin e faktorëve ekonomikë (niveлин e tarifave doganore, kreditimin, sistemet e shpërndarjes dhe të furnizimit, etj.), 67 për qind e biznesmenëve i konsiderojnë si shumë pengues ose pengues.

7.1c Nivelin i përfaqësimit, në draftin e parë të SRERV, të problemeve shqetësuese të biznesit privat.

Shqetësimet kryesore të ngritura nga biznesi privat

- i *Marrdhëniet e biznesit me administratën tatimore dhe doganore.* Mendimi i biznesit ishte se efikasiteti i politikave zbutëse të qeverisë në drejtim të uljes së ngarkesës tatimore e doganore, përmirësimit të procedurave të rimbursimit të pagimit të TVSH-së, procedurat e parapagimit të tatimit mbi fitimin, etj., nuk japin ato efekte pozitive që priten. Shkaku sipas opinionit të tyre qëndron në arbitraritetin e punës së organeve tatimore e doganore. Psh, ngarkim-shkarkimi disa herë i mallit për t'u çdoganuar, diferencimi i subjekteve të ndryshëm në dogana, mungesa e transparencës mbi çmimet e referencës, arbitrariteti në përcaktimin e listës së mallrave se kush quhet 'investim', etj. Ka dhe boshllëqe ligjore në rimbursimin e TVSH-së kur firmat e mëdha hyjnë në marrëdhnie biznesi me firmat e vogla që nuk janë subjekt i pagimit të TVSH-së.
- ii *Disa lloje taksash janë të larta.* Veçanërisht pagesa e kontributeve për fuqinë punëtore e rrit ndjeshëm koston e saj dhe stimulon punën e zezë. TVSH-ja duke qenë një shkallëshe për të gjithë mallrat, rëndon bizneset siç është importimi i makerinerive bujqësore.
- iii *Problemet e strukturës së tregut.* Mungesa e institucioneve të nevojshme apo ineffikasiteti i punës së tyre bën që biznesi të dëmtohet nga prodhimet fallso dhe të pakontrolluara, evazioni fiskal nga disa subjekte, monopolizimi i tregtimit të disa lloje mallrash, etj. Mungesa e tregut të tokës bujqësore dhe fragmentarizimi i saj në parcela të vogla shihen si barriera në rritjen e mekanizimit të bujqësisë.
- iv *Vështirësitë në përfitimin e shërbimeve publike cilësore.* Veçanërisht u mbajt qëndrim kritik në furnizimin e subjekteve me energji elektrike (qoftë për ndërprerjet por dhe luhatjet e tensionit), rritjen e çmimit të energjisë, kostot e transportit të mallrave, etj.

- v *Probleme të sistemit bankar dhe kreditimit.* Biznesi i konsideron termat e kreditimit të pafavorshme; sistemin e pagesave të pazhvilluar; procedura bankare burokratike, etj. Nga ana e tyre, komuniteti i bankierëve u shpreh se ka mangësi në legjislacionin për kolateralin, shkalla e riskut të biznesit dikton kosto të larta transaksionesh, probleme të saktësisë së bilanceve të firmave private.

➤ **Adresimi i shqetësimeve të biznesit në SRERV**

Bazuar dhe në sygjerimet e bëra nga komuniteti i biznesit, plani i veprimeve prioritare për zhvillimin e sektorit privat dhe financiar, ashtu sikurse dhe programet ndërsektoriale, synojnë të adresojnë këto probleme.

- i) Programet e përmirësimeve infrastrukturore (rrugë, energji elektrike, telekomunikacione, etj.) të parashikura jo vetëm për rrjetin e transportit kombëtar, por dhe planet e ndërhyrjeve në zonat rurale, do të lehtësojnë kostot e transportit dhe përmirësojnë furnizimin me energji elektrike.
- ii) Plani i veprimit parashikon masat që do të ndërmerren për rritjen e transparencës së organeve të administratës shtetërore në marrdhëniet me biznesin; forcimin e institucioneve që sigurojnë konkurrencën e lirë në treg; përmirësimin e punës së organeve tatimore dhe doganore (kompjuterizimin e sistemit, trajnime, publikime, etj.).
- iii) Thellimi i reformave (nëpërmjet planit të masave të parashikuara) që do të nxisin konkurrencën në tregun financiar, përmirësimet e skemave institucionale në garantimin e transaksioneve të kredisë, përmirësimet në sistemin e pagesave etj., pritet të japin ndikime pozitive në forcimin e lidhjeve të sektorit privat me bankat.

7.2 Konsultimet me Biznesin – Raundi II

Instituti i Edukimit Fiskal zhvilloi më datën 3 Tetor, 2001 në Tiranë raundin e dytë të konsultimeve me komunitetin e biznesit. Raundi i dytë i konsultimeve konsistonte në një takim një ditor me përfaqësues të ndryshëm të biznesit, që i referohej specifikave të tyre industriale (Dhoma e tregtisë, Investitorët e Huaj, Agrobiznesi, dhe Sektori bankar). Ky raund u realizua në bashkëpunim të ngushtë me grupin e punës të SRERV dhe në veçanti në bashkëpunim me Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, e cila ra dakort të siguronte që interesat e sektorit privat do të inkuropoheshin në strategjinë e rritjes dhe reduktimit të varfërisë. Konsultimet e raundit të dytë u karakterizuan nga këta komponentë kryesorë:

- Së pari*, Kontributi i Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar në mbarrëvajtjen e SRERV;
- Së dyti*, Politikat e zhvillimit në sektorin privat dhe atë financiar brenda SRERV;
- Së treti*, Diskutime dhe opinione për alternativa të mundshme të rritjes dhe reduktimit të varfërisë.

Aspektet kryesore rreth të cilave u zhvilluan diskutimet ishin:

➤ **Marrëdhëniet Biznes – Punë**

1. Roli i Komitetit të Konsultimeve të Biznesit: Është e nevojshme të përforcohet roli i Këshillit Social-Ekonomik Kombëtar.

2. Shtrirje e bazës ligjore (baza infrastruktoriale dhe juridike) të tatimpaguesve – një shtrirje cilësor mënjanon deformimet e tregut.
3. Kreditimi – Krijimi i një Fondi të Sigurimit të Kredive duhet te nënvizohet në dokumentat e SRERV.

➤ **Marrëdhëniet Biznes – KESH**

Problemi i kufizimit të energjisë elektrike në të gjithë vendin, dëmton bizneset industriale. Komunitet e biznesit konfirmojnë se ata paguajnë të gjitha detyrimet në lidhje me KESH dhe njëkohësisht kërkojnë që edhe Korporata Energjitike tju përgjigjet përpikmërisë së tyre me të njëjtën formë. Nga përfaqësuesit e Korporatës Energjitike Shqiptare u prezantua një strategji e re e quajtur strategjia e fiderave (ushqyesve), e cila do të konsistonte kryesisht në krijimin e fiderave të rinj vetëm për qendrat e bizneseve. Këta fidera do të ushqejnë me energji 24 orë në ditë.

➤ **Marrëdhëniet Biznes - Dogana**

Komunitet e biznesit kanë nevojë për një sistem më të besueshëm, të tillë si një sistem kompjuterash në vend të një linjë të gjatë nëpunësish të doganës, për realizimin e procedurave.

➤ **Marrëdhëniet Biznes – Investitorët e huaj**

Tashmë është bërë e ditur që **kapitali dhe biznesi** (kryesisht bizneset e vogla) **mërgojnë** nëpër shtete të tjera të Europës, për shkak të elementëve që i referohen jo vetëm Sistemit të Taksave, por edhe atyre të mosigurimit. Mëgjithatë, reforma në Sistemin e Taksave, (ulja e taksave) do të reduktojë evazionin fiskal.